



SHTABI I PËRGJITHSHËM I FA

**ARSIMIMI DHE STËRVITJA
NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(MP-3-4)**

Miratuar me urdhër Nr.292, datë 06.04.2009 të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm
të FA

**DREJTORIA E OPERACIONEVE DHE STERVITJES (J-3/7)
2009**

Doktrina e Sdtërvitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

- 1. MP-3-4 Doktrina e Stërvitjes dhe Arsimimit në Forcat e Armatosura, është publikim i paklasifikuar i Shtabit të Përgjithshëm të FA.**
- 2. MP-3-4 zëvendëson MP-3-4 (Doktrina e Stërvitjes), botuar në vitin 2005.**
- 3. MP-3-4 bëhet efektive me botimin e saj.**

**Gjeneral Brigade Maksim MALAJ
Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA**

HYRJE

KREU I: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STËRVITJES

- 1.1. Domosdoshmëria e stërvitjes
- 1.2. Objekti i stërvitjes
- 1.3. Kërkesat dhe karakteristikat e stërvitjes
- 1.4. Parimet e stërvitjes
- 1.5. Sistemi i stërvitjes në Forcat e Armatosura
- 1.6. Institucionet e planëzimit, drejtimit, realizimit të stërvitjes dhe përgjegjësitë e tyre
- 1.7. Komandantët dhe stërvitja
- 1.8. Përkufizime

Kreu II: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ARSIMIMIT USHTARAK

- 2.1 Domosdoshmëria e arsimimit
- 2.2 Arsimi i përgjithshëm
- 2.3 Arsimimi dhe kualifikimi ushtarak i oficerëve
- 2.5. Përgatitja e civilëve
- 2.6. Programet e zhvillimit të gjuhës së huaj
- 2.7. Përgjegjësia për arsimimin Ushtarak
- 2.8. Integrimi ndërmjet arsimimit dhe stërvitjes

KREU III: PËRGATITJA PROFESIONALE DHE STËRVITJA

- 3.1. Zhvillimi profesional ushtarak
- 3.2. Metodologjia e zhvillimit profesional
- 3.3. Progresi në karrierën stërvitore në Forcat e Armatosura
- 3.4. Kategoritë dhe llojet e stërvitjeve
- 3.5. Llojet e ushtrimeve stërvitore
- 3.6. Nivelet e stërvitjes dhe të ushtrimeve stërvitore
- 3.7. Zhvillimi i drejtuesve

KREU IV: HARTIMI I LISTËS ME DETYRAT THEMELORE TË MISIONIT (LDTHM)

- 4.1. Detyrat themelore të misionit dhe lista e tyre
- 4.2. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e LDTHM
- 4.3. Analiza e komandantit
- 4.4. Parimet dhe kërkesat themelore të zhvillimit të LDTHM
- 4.5. Hartimi i LDTHM për misionet në mbështetje të paqes
- 4.6. Hartimi i LDTHM të Forcës së Bashkuar (LDTHMFB)
- 4.7. Zhvillimi i LDTHM të reparteve e nënreparteve mbështetëse
- 4.8. Strategjia e stërvitjes, e lidhur me LDTHM
- 4.9. Përmbledhja e Procesit të Zhvillimit të Listës së Detyrave Themelore të Misionit.

Kreu V: PLANËZIMI I STËRVITJES

- 5.1. Procesi i planëzimit të stërvitjes
- 5.2. Udhëzimet e komandantit
- 5.3. Udhëzimet stërvitore të komandantit
- 5.4. Planet stërvitore të njësisë/organizmave ushtarakë
- 5.5. Planet e stërvitjes
- 5.6. Formatit i planit stërvitor
- 5.7. Përgjegjësia e komandantit për planin stërvitor
- 5.8. Planet stërvitore të njësisë
- 5.9. Planet e mbështetjes së stërvitjes

Kreu VI: REALIZIMI I STËRVITJES

- 6.1. Realizimi i mbikëqyrjes së stërvitjes
- 6.2. Ushtrimet stërvitore dhe detyrat
- 6.3. Procesi i realizimit të stërvitjes
- 6.4. Roli i komandantëve dhe drejtuesve
- 6.5. Roli i nënoficerëve
- 6.6. Përgatitja për stërvitje
- 6.7. Ekzekutimi i stërvitjes
- 6.8. Procesi i mirëmbajtjes pas stërvitjes

Kreu VII: VLERËSIMI DHE GJYKIMI I STËRVITJES

- 7.1. Procesi i vlerësimit të stërvitjes
- 7.2. Procesi i gjykimit të stërvitjes
- 7.3. Organizimi i vlerësimit dhe gjykimit
- 7.4. Llojet e vlerësimit
- 7.5. Vlerësimi i stërvitjes
- 7.6. Rishikimi pas veprimit (AAR)
- 7.7. Mësimet e nxjerra
- 7.8. Vlerësuesit
- 7.9. Stërvitja e vlerësuesve
- 7.10. Planifikimi për vlerësimet
- 7.11. Vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës dhe i planëzuar
- 7.12. Roli i komandantëve dhe i drejtuesve eprorë

Aneksi 1: VLERËSIMET SIPAS KONCEPTIT TË AFTËSIVE OPERACIONALE (OCC)

- A. Programi i vlerësimit dhe reagimit sipas Konceptit të Aftësive Operacionale (OCC).
- B. Kushtet dhe masat e programit të vlerësimit dhe reagimit të OCC- së.
- C. Veprimtaritë e programit të vlerësimit dhe reagimit të OCC.
- D. Standardet e vlerësimeve të OCC-së.
- E. Shpeshtësia dhe vlefshmëria e vlerësimeve.
- F. Lidhja e programit të OCC-së me programe të tjera të NATO-s

Aneksi 2: DOKUMENTET E PLANËZIMIT NË STRUKTURAT OPERACIONALE, ARSIMORE DHE STËRVITORE TË FORCAVE TË ARMATOSURA

- A. Dokumentet e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Forcave të Armatosura
- B. Dokumentet e komandave kryesore/operative
- C. Dokumentet në nivel brigade
- D. Dokumentet në nivel batalioni

PARATHËNIE

Komandantët dhe drejtuesit ushtarakë të të gjitha niveleve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) janë përgjegjës për përgatitjen e ushtarëve, detarëve dhe pilotëve të tyre, për të përmbushur misionet e ngarkuara në kuadrin e betejave apo luftimeve. Për të qenë të suksesshme, forcat tona duhet të stërviten, fillimisht dhe kryesisht për situata reale të luftës. Forcat e Armatosura duhet të operojnë e të jenë të suksesshme në të gjitha llojet e operacioneve ushtarake, të bashkuara/përbashkëta (Joint) dhe shumëkombëshe. Të jetë i trajnuar dhe i gatshëm, është detyra e parë e çdo komandanti në shërbim të FA. Me qëllim që të planëzojnë dhe zhvillojnë stërvitje efektive dhe kuptimplotë, individët, shtabet dhe njësitë, në të gjitha nivelet e drejtimit të FA, kanë nevojë edhe për udhëzime nga komandantët e tyre.

Zhvillimet e shpejta të FASH në rrugën e integritit të plotë në Aleancën Euroatlantike, diktojnë konsolidimin dhe përsosjen e sistemit të arsimimit e të stërvitjes së integruar, duke i dhënë atij vlera të reja, në funksion të krijimit të përvojave dhe realiteteve të reja bashkëkohore, për garantimin e forcimit të vazhdueshëm të një shoqërie të qëndrueshme, demokratike dhe paqësore.

Përmbushja e misionit të FASH kërkon, në radhë të parë, personel të arsimuar, të mirëstërvitur, por edhe të motivuar. Për këtë qëllim, vëmendje e veçantë t'i kushtohet arsimimit dhe stërvitjes së fokusuar nga misioni, në përputhje me standarde reale, që u përgjigjen nivelit të zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe atyre të NATO-s.

Doktrina e Arsimimit dhe e Stërvitjes (MP-3-4) është projektuar për të gjithë komandantët dhe drejtuesit e tjerë ushtarakë në FA. Ajo siguron jo vetëm një panoramë të stërvitjes dhe arsimimit, por është edhe udhërrëfyes i dobishëm për të gjithë ata që planëzojnë dhe zhvillojnë arsimimin dhe stërvitjen. Ky dokument nënvizon rolin e komandantëve dhe të drejtuesve ushtarakë në planëzimin, zhvillimin dhe vlerësimin e arsimimit dhe stërvitjes. Studimi dhe kuptimi i këtij dokumenti është i detyrueshëm për të gjithë oficerët dhe personelin e karrierës; ai përmbledh udhëzimet e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe proceset që kërkohen për të zhvilluar Sistemin e Menaxhimit të Stërvitjes në FA, ashtu edhe Sistemin e Menaxhimit të Arsimimit Ushtarak Profesional. Udhëzimet e një komandanti për shtabin dhe vartësit e tij duhet të garantojnë një trajnim efektiv, të fokusuar nga misioni.

Doktrina e Arsimimit dhe Stërvitjes (MP-3-4) siguron të gjithë komandantët dhe drejtuesit e operacioneve për një përafrim sistematik në trajnimin dhe arsimimin e trupës. Ajo përfaqëson një seri procesesh të përbashkuara, logjike dhe të përsëritshme, që janë hartuar për të përmirësuar vazhdimisht gatishmërinë operacionale të Forcave të Armatosura. E përdorur rregullisht, Doktrina e Arsimimit dhe e Stërvitjes (MP-3-4) i ndihmon komandantët të trajnojnë më me efektivitet dhe të identifikojnë menjëherë fushat që kanë nevojë për përmirësime. Përdorimi me sukses i këtyre proceseve në Sistemin e Menaxhimit të Stërvitjes u krijon mundësi më të mira komandantëve, që këta

Doktrina e Stërviitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

të vlerësojnë nivelin e stërviitjes e të gatishmërisë dhe më pas të bëjnë gjykime të thella mbi mundësitë e tyre në përmbushjen e misionëve e të detyrave të ngarkuara.

Doktrina e Arsimimit dhe e Stërviitjes (MP-3-4) synon të orientojë dhe udhëheqë strukturat e FASH mbi drejtimet kryesore të arsimimit, stërviitjes dhe vlerësimit të personelit ushtarak; t'u krijojë atyre mundësi për një planëzim konkret dhe real, mbi bazën e strukturës së këtyre forcave e në përputhje me misionin kushtetues dhe Listën e Detyrave Themelore të Misionit (LDTHM).

Lexoçi, mësoçi dhe zbatoçi konceptet, parimet dhe proceset që përmban kjo Doktrinë. Stërviitja efektive, e mbështetur nga arsimimi ushtarak profesional, është çelësi për një betejë të suksesshme.

Gjeneral Brigade Maksim MALAJ
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH



HYRJE

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë hyrë në një proces rrënjësor ndryshimesh, reformash dhe modernizimi. Në këtë kuadër, në zbërthim të Politikës së Mbrojtjes dhe të Strategjisë Ushtarake, si dhe në përfaqje me objektivat e procesit të anëtarësimit me të drejta të plota në NATO, riformulohen dhe përcaktohen konceptet tona për stërvitjen, sistemin e drejtimit dhe rolin e tij në procesin e realizimit të saj, koncepte që jepen në këtë Doktrinë. Mbështetur në programet e mbrojtjes e të zhvillimit të Forcave të Armatosura, burimet e mundshme, përvojën e Forcave tona të Armatosura dhe të atyre të vendeve të NATO-s, janë bërë përpjekje për të ripunuar dhe përgatitur Doktrinën tonë të Arsimimit e të Stërvitjes. Kjo Doktrinë shpreh konceptet, parimet dhe filozofinë, nga të cilat do të orientohen të gjithë komandantët dhe drejtuesit ushtarakë në sistemin e FA, për plotësimin e misionit të tyre e për shndërrimin cilësor të sistemit tradicional të arsimimit e stërvitjes; duke synuar ndihmesën e nevojshme për të gjithë elementët e drejtimit në këtë proces e për të gjitha nivelet. Ajo përmbledh të gjithë veprimtarinë, nga planëzimi deri në realizimin e plotë të saj. Nisur nga misioni i FA, detyra themelore e stërvitjes është krijimi i njësisë me kohezion të lartë, që të jenë të afta të realizojnë me sukses të gjitha operacionet, si ato luftarake dhe ato në mbështetje të paqes e në ndihmë të popullsisë civile. Stërvitja është proces që i aftëson burimet njerëzore për të përmbushur kërkesat me ngarkesë të lartë fizike, psikologjike, morale e profesionale, që lindin në fushëbetë apo edhe gjatë kryerjes së operacioneve në mbështetje të paqes apo në ndihmë të popullsisë. Nëpërmjet saj rriten e konsolidohen vetëbesimi, gatishmëria individuale dhe e njësisë, si edhe shpirti luftarak i ushtarëve dhe drejtuesve. Një vend të veçantë në këtë Doktrinë zë arsimimi universitar dhe arsimimi profesional ushtarak. *Sistemi Arsimor Ushtarak duhet të arrijë një balancë relative ndërmjet koncepteve akademike, realiteteve operacionale dhe perspektivave historike.*

Përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve të mbështetjes, shtimi i informacionit dhe, në veçanti, modernizimi i metodave të shkëmbimit të tij, së bashku me zhvillimin teknologjik, do të ndryshojnë së tepërmi e në mënyrë thelbësore të gjithë stërvitjen në FA. Në këtë kuadër, objektivat që do të synohet të arrihen do të ndryshojnë, ndërkohë që procedurat teknike, metodat e drejtimit, të vlerësimit e të kontrollit do të evoluojnë vazhdimisht nëpërmjet filozofisë: stërvit - vlerëso - ristërvit. Vetëm kështu do të sigurohet vazhdimësia e këtij procesi thelbësor për FA.

Komandantët dhe shtabet ta planëzojnë e ta drejtojnë stërvitjen me nismë e krijimtari, në përshtatje me kushtet, mjedisin dhe misionin e njësisë apo të repartit të tyre. Stërvitja është treguesi kryesor për të vlerësuar aftësitë luftarake dhe operacionale të trupave, të komandave e shtabeve. Ajo është një veprimtari e organizuar, që drejtohet e zhvillohet në bazë të kërkesave doktrinare, të manualeve, rregulloreve, urdhrave e udhëzimeve.

Doktrina e Shtërvitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

Strategjia Ushtarake dhe Doktrina e Përbashkët e FA të RSH (DPU-10) përbëjnë dokumentet kryesore, nga të cilat burojnë idetë themelore për rishikimin dhe hartimin e kësaj Doktrine; kjo, në vetvete, përfaqëson një hap më të madh profesional e që disiplinon përgatitjen operacionale të trupave, drejtuesve, komandantëve e shtabeve të të gjitha niveleve.

KREU I: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STËRVITJES

- 1.1. Domosdoshmëria e stërvitjes
- 1.2. Objekti i stërvitjes
- 1.3. Kërkesat dhe karakteristikat e stërvitjes
- 1.5. Parimet e stërvitjes
- 1.5. Sistemi i stërvitjes në Forcat e Armatosura
- 1.6. Institucionet e planëzimit, drejtimit, realizimit të stërvitjes dhe përgjegjësitë e tyre
- 1.8. Komandantët dhe stërvitja
- 1.8. Përkufizime

1.1. Domosdoshmëria e stërvitjes

1.1.1. Stërvitja është veprimtari jetike e domosdoshme profesionale, fizike dhe formuese e efektivave të Forcave të Armatosura. Ajo kërkon përballimin e një ngarkese të lartë fizike, mjeshtëri veprimesh dhe kryerje detyrash e detyrime të tjera speciale. Stërvitja lidh individin dhe strukturat me objektivin që natyrshëm rrjedh nga misioni i forcave të armatosura. Nëpërmjet stërvitjes përgatiten individët dhe strukturat e armatosura dhe jo të armatosura për të kryer misione, që u ngarkohen. Stërvitja ndikon në formimin, përgatitjen dhe zhvillimin e drejtuesve të niveleve të ndryshme. Nëpërmjet saj formohen strukturat ushtarake dhe kompaktësohen ato. Stërvitja është formë e njësimi të veprimeve brenda strukturave të së njëjtës njësi, por edhe midis njësive bashkëvepruese në veprimtari të ndryshme luftarake apo jo luftarake.

Stërvitja e rrit individin profesionalisht, ngre moralin e tij dhe e bën atë të gatshëm për të hyrë në luftim me vendosmëri. Një individ i përgatitur fizikisht e profesionalisht, si nga ana taktike, ashtu dhe në përdorimin e armatimit, hyn në operacion me moral të lartë, i bindur se ia del të fitojë, pavarësisht nga vështirësitë.

Stërvitja, gjithashtu, synon aktin final që buron nga qëllimi i saj: aftësimin profesional e fizik në interes të realizimit të misionit e të detyrave. Me stërvitje synohet dhe arrihet niveli operacional, si treguesi bazë ky i gatishmërisë së strukturave të armatosura.

Stërvitja është përparësia numër një e strukturave të Forcave të Armatosura. Ajo është ÇFARË ne bëjmë dhe jo DIÇKA që ne bëjmë. Çdo ushtar, nënoficer dhe oficer ka një mision parësor: të jetë i përgatitur dhe gati për të luftuar dhe fituar në një konflikt luftarak të mundshëm. Suksesi në luftë nuk vjen rastësisht, ai është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e stërvitjes së vërtetë, reale dhe sfiduese. FA mbahen për të parandaluar luftën, dhe nëse kjo ndodh, të rivendosin paqen nëpërmjet fitores në luftë. Për të arritur këtë, FA duhet të jenë të afta të plotësojnë misionin e paracaktuar. Stërvitja është procesi që e

mundëson këtë. Stërvitemi me metodën si të luftojmë, sepse përvoja historike tregon lidhjen e drejtpërdrejtë mes stërvitjes reale dhe suksesit në luftë. Lidhja ndërmjet stërvitjes së fortë, reale e sfiduese, si edhe suksesit në betejë mbetet parësore.

1.1.2. Njësitë e stërvitura për misione luftarake apo për misione në mbështetje të paqes nga një trupë oficerësh dhe nënoficerësh të mirë përgatitur, me ushtarë që njohin mirë profesionin e tyre, që janë të përgatitur dhe besojnë në suksesin, mund të veprojnë si një organizëm i vetëm e me vendosmëri. Kjo u siguron atyre edhe kompetencë taktike dhe teknike për të përshtatur misionin edhe në kushte të vështira të terrenit e të motit, duke rezultuar të suksesshëm.

Ushtarakët stërviten, ashtu sikurse është planëzuar, për të luftuar dhe fituar. Suksesi vjen si rrjedhojë e zhvillimit të stërvitjes me theks nga realizimi i detyrave të betejës.

1.1.3. Përgatitja e plotë e Forcave të Armatosura për të mbështetur të gjitha misionet që përcaktohen nga Strategjia Ushtarake, kërkon krijimin dhe zbatimin e një direktive sistematike, ciklike, shumëvjeçare për menaxhimin e stërvitjes, direktivë e cila përmbledh konceptet e stërvitjes Individuale e Kolektive, stërvitjen e komandantëve e të shtabeve, edukimin etj.

1.1.4. Përgatitja e plotë e FA për të mbështetur të gjitha misionet që rrjedhin nga Strategjia Ushtarake, kërkon krijimin dhe vënien në veprim të një direktive sistematike, ciklike, shumëvjeçare për menaxhimin e stërvitjes. Kjo direktivë përmbledh konceptet e stërvitjes individuale dhe kolektive, stërvitjen e komandantëve dhe edukimin e tyre.

Strategjia e përbashkët e stërvitjes së FA të fokusohet në planëzimin, ekzekutimin dhe ndihmën që duhet të jepet për plotësimin e kërkesave që dalin nga stërvitja në kushte të ndryshme.

1.1.5. Stërvitja e efektshme inicion një proces që përmbledh 5 elementë bazë:

- Plane stërvitorë për të arritur nivelin e kërkuar të aftësive të individit apo repartit.
- Dhënien në mënyrë sistematike të burimeve monetare dhe të kohës së nevojshme për të mbështetur ekzekutimin e planeve të stërvitjes.
- Orientimi sipas misionit dhe stërvitja sipas standardeve të kërkuara e që bazohen në aftësitë bazë individuale apo të repartit.
- Vlerësimi periodik i stërvitjes të kryhet sipas standardeve të doktrinës dhe të japë mësim për përmirësimin e nivelit të stërvitjes në të ardhmen.
- Një sistem mbështetjeje dhe edukimi për drejtuesit, i cili e bën më të lehtë “prodhimin” e drejtuesve në nivel taktik, operacional dhe strategjik, të cilët duhet të jenë të aftë për drejtimin dhe zhvillimin e vartësve të tyre nga përmbushja e misionit.

1.1.6. Stërvitja efektive e FA duhet të konsistojë në tre elementë të ndarë, por që sinkronizohen me njëri-tjetrin.

- Stërvitja individuale.
- Stërvitja kolektive.
- Stërvitja e drejtuesve.

Këto lloj stërvitjesh konsistojnë në një kompleks elementësh të cilët përfshijnë:

- Aftësitë bazë të stërvitjes (ushtarake dhe të prirura).
- Aftësitë për stërvitje (në më shumë se një drejtim).
- Aftësitë për stërvitje në fusha specifike (të avancuara).
- Stërvitje speciale.
- Stërvitje për vendimmarrje apo leadership.
- Stërvitje bashkëvepruese ose komplekse.
- Mirëmbajtje apo stërvitje për mirëmbajtjen.
- Stërvitje për mbështetjen.

1.2. Objekti i stërvitjes

1.2.1. Çdo pjesëtar i FA të RSH, pavarësisht nga rangu i tij, ka një mision kryesor: të stërvitet dhe të jetë gati për të luftuar dhe fituar gjithmonë, sa herë që kjo do t'i kërkohet. Suksesi në betejë është rezultat i një stërvitjeje reale dhe të fokusuar nga misioni i ngarkuar.

FA të RSH janë formuar për të mbrojtur sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet parandalimit apo shmangies së luftës; në qoftë se parandalimi apo shmangia nuk arrihen, atëherë FA duhet të rivendosin paqen nëpërmjet fitores në luftim. Për të arritur këtë, FA duhet të jenë të afta të përmbushin misionet e tyre strategjike, operacionale dhe taktike.

Që parandalimi ose shmangia e luftës të jenë efektive, kundërshtarëve të mundshëm duhet t'u bëhet e qartë se FA të RSH kanë kapacitetet e duhura për t'u mobilizuar, vendosur, për të luftuar dhe se janë të afta të qëndrojnë dhe të FITOJNË.

Përgjegjësia e parë e Forcave të Armatosura në kohë paqeje është sigurimi i gatishmërisë së përshtatshme të dy komponentëve përbërës të saj, komponentit aktiv dhe atij rezervist.

Objekti i stërvitjes është edukimi, formimi dhe zhvillimi i cilësive më të mira të individit si pjesëtar i Forcave të Armatosura. Stërvitja përmbledh në mënyrë të plotë të gjithë spektrin e detyrave dhe të përgjegjësive që rrjedhin nga misioni që realizojnë Forcat e Armatosura. Për këtë arsye ajo duhet bërë sa më e

thjeshtë dhe praktike në detyrat dhe nivelin e ushtarit, aq më komplekse dhe e vështirë në ushtrimet stërvitore të shkallës së lartë.

1.2.2. Mësimi i përdorimit të armëve, i pajisjeve operacionale, i komunikimit, mirëmbajtja, mbështetja, furnizimi dhe ri furnizimi janë detyra të rëndësishme në të cilat përsosmëria arrihet vetëm nëpërmjet stërvitjes së fortë dhe me intensitet të lartë. Kombinimi i përdorimit të armëve e pajisjeve midis elementëve të luftimit dhe midis strukturave të tij është synim dhe objektivi tjetër i stërvitjes. Prej stërvitjes me temp të lartë burojnë aftësitë fizike, qëndrueshmëria dhe durimi për të ndjekur procedurat, për të ekzekutuar e aplikuar taktikat, si edhe për të ndërthurur të gjitha kapacitetet e armëve dhe shërbimeve.

1.2.3. Stërvitja është themeli i të gjitha veprimtarive të FA. Ajo është proces që aftëson burimet njerëzore për të përmbushur kërkesat që lindin në fushëbetejë dhe të veprimtarive të tjera, brenda kuadrit të misionit të FA, në kushtet e ngarkesës së lartë fizike, morale e profesionale.

1.2.4. Çdo ushtarak ose organizëm në sistemin e FA ka një mision të caktuar; ky përmbledh dhe përcakton detyrat që ato duhet të kryejnë. Kështu, çelësi për një stërvitje efektive në FA është përcaktimi i objektivave në bazë të mundësive dhe përmbushjes së misionit. Objektivat e stërvitjes në repartet apo njësitë e FA, duhet të jenë reflektuese, të qarta dhe të sakta për ato çka pritet të arrihen nga ai repart apo organizëm tjetër.

1.3. Kërkesat dhe karakteristikat e stërvitjes

1.3.1. FA stërviten për luftë, ndaj dhe fushëbeteja dikton synimet dhe objektivat e stërvitjes. Fushëbeteja kërkon aftësi e cilësi të larta fizike, psikologjike dhe morale. Ajo kërkon aftësi dhe gatishmëri në të luftuar, qëndrueshmëri, forcë, shkathtësi, zhdërvjelltësi, të kombinuara me mjeshtëri, njohuri të thella, krijimtari dhe imagjinatë të lartë. Disiplina, motivimi, nisma dhe kuraja janë thelbësore; puna në grup, shoqëria ushtarake, kohezioni dhe drejtimi janë jetësore; të gjitha këto cilësi janë esenciale në zhvillimin e shpirtit luftarak, aq të kërkuar për arritjen e suksesit. Lufta është e ashpër, ndaj stërvitja duhet t'i përgatisë ushtarët dhe drejtuesit fizikisht dhe mendërisht, që këta t'u mbijetojnë vuajtjeve, emocioneve të dobëta dhe rrezikut ekstrem. Stërvitja mëson mjeshtëritë, kultivon qëndrimin dhe mënyrat e mbijetesës në fushëbetejë.

1.3.2. Stërvitja për luftim duhet të jetë prioriteti i parë në kohë paqeje dhe luftime. "Kompetencat" në luftim lidhen me mundësitë për të luftuar duke u bazuar në doktrina të miratuara dhe ekzekutime taktike e teknike.

Vetëbesimi është ideja individuale dhe kolektive se FA të RSH janë më të afta dhe mund të realizojnë gjithçka më mirë se kundërshtari. Gjithashtu repartet e FA kanë dëshirën dhe besimin për përmbushjen e misionit të tyre.

1.3.3. Stërvitja duhet të jetë:

* E orientuar drejt arritjeve, që çojnë në rezultatin e dëshiruar. Njohuritë e fituara kanë për qëllim të përmirësojnë nivelin e arritur. Theksi në stërvitje vihet në “të mësuarin si” dhe jo në “të mësuarin çfarë”. P.sh., ushtari duhet të mësojë si të godasë objektivin në distancën 400m me armë automatike e jo thjesht të kuptojë që efektiviteti më i mirë i automatikut është në distancën 400m. Goditja e objektivit është detyra më e rëndësishme. Ushtarët duhet të mësojnë si të arrijnë këtë rezultat duke e kryer praktikisht dhe jo duke u thënë atyre se si ta bëjnë.

* Konkurruese. Ushtarët, drejtuesit dhe njësitë duhet të jenë në garë me njeri tjetrin, por ata duhet të jenë në garë për të arritur sa më mirë standardet. Me progresin e stërvitjes ata arrijnë standarde më të larta, në kushte sa më të ngjashme me ato të betejës. Në këtë mënyrë ata mësojnë si të luftojnë dhe të fitojnë në kushtet e vështira të fushëbetejës.

* Kërkuese drejt arritjes së përsosmërisë. Çdo ushtar, drejtues dhe njësi, i kanë të gjitha mundësitë për të arritur nivele të larta të mjeshtërive dhe efektivitetit. Arritja e përsosmërisë është ideale, ajo nuk arrihet plotësisht. Të përpqemi vazhdimisht që ti afrohemi sa më shumë asaj; suksesi në luftë do të varet nga sa i jemi afuar kësaj përsosmërie.

* Efektive. Programet e stërvitjes, manualet dhe materialet e tjera ndihmëse të stërvitjes, të vetme nuk mund të japin ushtarë dhe njësi të stërvitura, pa oficerë dhe nënoficerë të përgatitur e të aftë që të realizojnë stërvitjen. Kur drejtuesit janë të përgatitur, ata formojnë ushtarë dhe nënreparte të përgatitura dhe të efektshme në të gjitha kuptimet. Efektiviteti i plotë arrihet kur njësitë e shprehin fuqinë e plotë të armatimit të tyre, që ndërveprojnë lehtësisht dhe zbatojnë plotësisht doktrinën dhe taktikat.

1.4. Parimet e stërvitjes

Stërvitja përbën detyrën e parë të Forcave të Armatosura në kohë paqeje. Që të arrihet kjo, stërvitja duhet të zhvillohet e fortë, si në kushtet reale të luftës dhe sfiduese. Ajo duhet të kryhet për të arritur standardet e FA. Komandantët dhe drejtuesit e çdo hallke përdorin “Parimet e Stërvitjes” për të zhvilluar stërvitje efektive. Stërvitja të zhvillohet në atë mënyrë që të arrijë standardet e FA. Janë 12 principe bazë për drejtimin e stërvitjes, të cilat duhet të ndiqen nga efektivat e FA për të siguruar një stërvitje efektive. Përshtatja e vazhdueshme e principeve të drejtimit nga komandantët dhe drejtuesit e çdo hallke në zinxhirin komandues duhet të përshtatet me të gjitha procedurat dhe direktivat e stërvitjes aktuale dhe ato në të ardhmen në FA.

Parimet e stërvitjes janë:

1.4.1. Komandantët janë përgjegjës kryesorë për stërvitjen.

Drejtuesit janë përgjegjës për stërvitjen; ata integrojnë përgatitjen institucionale e operacionale me burimet për të stërvitur njësi të gatshme për realizimin e misionit. Komandantët janë përgjegjës për gatishmërinë operacionale të njësisë së tyre. Komandanti i repartit në FA të RSH është

përgjegjës për gjithçka që reparti i tij realizon ose nuk realizon. Kjo përgjegjësi përfshin edhe efektivitetin në stërvitje.

Komandantët janë përgjegjësit kryesorë për stërvitjen dhe rezultatet stërvitore të ushtarëve e të njësisë së tyre. Ata janë stërvitësit dhe drejtuesit e parë që angazhohen në procesin e stërvitjes në mënyrë aktive, por edhe që zbatojnë parimet e stërvitjes. Për të plotësuar përgjegjësinë e tyre stërvitore komandantët duhet:

- Të jenë të pranishëm në stërvitje në maksimumin e mundshëm.
- Të bazojnë stërvitjen në kërkesat e misionit.
- Të stërviten në nivelin e standardeve të FA.
- Të vlerësojnë vazhdimisht nivelin e aftësive operacionale e stërvitore.
- Të sigurojnë burimet e nevojshme për stërvitjen.
- Të hartojnë dhe realizojnë plane stërvitore që synojnë në individë, drejtues dhe njësi/reparte të afta.

Komandantët e delegojnë një pjesë të autoritetit të tyre tek nënoficerët, si stërvitësit kryesorë të individit, grupit dhe skuadrës. Komandantët u japin përgjegjësitë nënoficerëve për kryerjen e stërvitjes së individëve e grupeve.

1.4.2. Nënoficerët stërvitin strukturat e vogla.

Nënoficerët realizojnë procesin e transformimit të qytetarëve të mobilizuar rishtas në ushtarë. Ata fillojnë procesin e përgatitjes profesionale dhe janë përgjegjës për kryerjen e stërvitjes individuale të bazuar në standarde. Nënoficerët:

- Njohin veçantitë e çdo individit, grupi apo skuadre.
- Përgatisin, provojnë dhe realizojnë stërvitjen e individit.
- Vlerësojnë stërvitjen dhe kryejnë analizat pas stërvitjes për të siguruar besimin e komandantit për aftësitë e individit, grupit dhe skuadrës.

Nënoficerët me grada më të larta trajnojnë nënoficerët e rinj/me grada më të ulëta.

1.4.3. Stërvitja të bëhet për arritjen e mjeshtërisë së luftimit, si në kushtet reale të fushëbetejës.

1.4.3.1. Spektri i konflikteve, në të cilat mund të angazhohen FA apo pjesë të tyre në të ardhmen, përfshin gjithë fushën e operacioneve ushtarake. Këto operacione, veçanërisht ato në shkallë të vogël, përfshijnë partnerë ndërkombëtarë apo edhe anëtarë të NATO-s. Të gjitha këto operacione do të zhvillohen në bashkëpunim me forca të shteteve të tjera. Me qëllim kryerjen sa më mirë të këtyre operacioneve, FA duhet të stërviten për t'u përballur me një gamë të gjerë kërcënimesh që mund të shfaqen kudo në botë, kërcënime të cilat do ti vendosin FA para angazhimeve të niveleve të ndryshme. Strukturat e FA

duhet të stërviten për të qenë sa më të forta dhe të manovrueshme. Në të njëjtën kohë, ato duhet të jenë të organizuara dhe të pajisura më së miri.

1.4.3.2 Qëllimi i stërvitjes është arritja e standardeve, nëpërmjet të cilave ruhen dhe zhvillohen aftësitë luftarake. Për të arritur këtë, njësitë duhet të stërviten në kushte sa më afër realitetit të luftës. Komandantët, shtabet, drejtuesit e të gjitha niveleve duhet të përfshijnë kushte të tilla reale të stërvitjes si: zbulim jo i plotë, komunikim i reduktuar, tym, zhurmë, rregullat e betejës, ambiente të simuluar kimike, biologjike e bërthamore, betejë të pjesshme, humbjen e drejtuesve kyç, hyrjen e civilëve në fushëbetejë, kërkesat e operacioneve të bashkuar e të përbashkët, shumëkombësh e paqeruajtës, ndryshime ekstreme të kushteve të motit etj. Drejtuesit duhet të kapin çdo mundësi për të lëvizur efektivin nga klasa në terrenin e stërvitjes, në poligone, në rajonet kombëtare të stërvitjes, të përfshijnë masat mbrojtëse kundër veprimeve të armikut. Stërvitja e fortë nxit dhe motivon trupat. Stërvitja reale siguron kompetencat dhe besimin, zhvillon shpirtin luftarak, frymëzon cilësi të larta si nismën, entuziazmin dhe dëshirën për t'u stërvitur. Efektivat bëhen të afta në realizimin e detyrave dhe misioneve, duke i praktikuar ato vazhdimisht e në kushte të ndryshuara.

1.4.4. Stërvitja të përmbushë kërkesat e doktrinës së Forcave të Armatosura, si dhe të komponentit përkatës.

1.4.4.1. Doktrina e FA thekson rëndësinë e punës e të veprimit në grup. Në kushtet e luftimit, çdo repart duhet të jetë i përgatitur për të kryer operacione në bashkëpunim me armë dhe shërbime të tjera, pa pasur nevojën e stërvitjes shtesë ose kohës për përshtatje. Efektiviteti i të gjitha armëve dhe shërbimeve arrihet kur grupet stërviten së bashku. Komandantët të praktikojnë në mënyrë të rregullt stërvitjen e rotacionit në kushte reale, për trupat e luftimit, trupat në mbështetje të luftimit dhe trupat e shërbimit në mbështetje të luftimit.

1.4.4.2. Stërvitja kryhet për arritjen e standardeve; ajo mbështetet në Doktrinën, e cila jep bazat për një stërvitje të vazhdueshme. Kur kryejnë stërvitje të bashkuar, forcat zbatojnë doktrinën e përbashkët, e cila vendos themelet për zhvillimin e operacioneve dhe jep udhëzimet si duhet të veprojnë forcat. Manualët mbështetës të doktrinës së përbashkët dhe asaj të forcës i mundësojnë komandantit të bëjë në kohë rregullimet. Lidhja mes doktrinës operacionale dhe asaj të stërvitjes është e rëndësishme dhe ndikon ndjeshëm në arritjen e suksesit. Nëse detyrat e misionit janë të paparashikuara në doktrinë apo ato jepen pa standardet përkatëse, komandantët i vendosin vetë detyrat, kushtet dhe standardet, duke përdorur urdhrat dhe udhëzimet, mësimet e nxjerra nga operacione të ngjashme apo edhe nga gjykimi i tyre profesional. Komandanti më i lartë miraton vendosjen e standardeve për këto detyra. Njësitë stërviten në standardet e Forcave të Armatosura, pasi veprimet e tyre synojnë integrimin e strukturave në njëra – tjetrën.

1.4.4.3. Repartet e FA do të veprojnë dhe luftojnë, ashtu sikundër ato janë stërvitur. Ushtarët mbajnë mend mënyrën e fundit se si është kryer një veprim (mirë apo keq qoftë ai). Për të siguruar suksesin në luftim apo përmbushjen e

misionit, ushtarët/repartet duhet të jenë në gjendje për të arritur standardet, që janë kuptuar nga drejtuesit e tyre dhe u janë bërë atyre të ditura. Moti dhe terreni me të cilin do të përballet ushtari në mision është i paditur. Për këtë arsye stërvitja të kryhet në kushte dhe terrene të ndryshme dhe sa më afër atyre reale (ose më keq). Stërvitja e mirë është gjithmonë e vështirë, si nga ana intelektuale, ashtu edhe nga ajo fizike. Kjo lloj stërvitje i motivon ushtarët që këta të japin maksimumin e tyre, ajo i jep shtysë iniciativës, rrit entuziazmin dhe dëshirën për të mësuar.

1.4.5. Stërvitja të sigurojë përshtatjen e individëve dhe strukturave.

1.4.5.1 Të përdoren doktrinën e miratuara. Ushtarët nuk kanë kohë të mësojnë procedura të reja jostandarde. Kështu që repartet e FA duhet të stërviten në bazë të rregulloreve, publikimeve dhe doktrinës së miratuar.

1.4.5.2 Stërvitja të rezultojë në drejtues dhe njësi që dinë të përshtaten e që veprojnë në situata të ndryshme. Stërvitja e përsëritur, bazuar në standarde, siguron përvojën e nevojshme. Komandantët e zhvillojnë përvojën stërvitore duke ndryshuar kushtet e stërvitjes. Përvoja stërvitore, e lidhur ngushtë me besimin e ndërsjellë, me kohë ndërton kompetencë. Kompetenca, besimi dhe disiplina sigurojnë iniciativë dhe u mundësojnë drejtuesve të përshtaten shpejt me ndryshimin e situatave dhe të kushteve. Komandantët e të gjitha niveleve integrojnë ngjarjet stërvitore në planet e tyre të stërvitjes për të stërvitur dhe zhvilluar drejtues dhe njësi me imagjinatë dhe aftësi për t'u përshtatur.

1.4.5.3. Strategjia e përbashkët e stërvitjes në FA duhet të fokusohet në planëzimin, ekzekutimin dhe mbështetjen e kërkesave që dalin nga stërvitja në kushte të ndryshme. Doktrinën zhvillohen dhe ripunohen në mënyrë periodike për të mbështetur konceptet operacionale të misioneve aktuale dhe të atyre në të ardhmen. Kërkesat e stërvitjes të qëndrojnë të bazuara në misionin dhe detyrat e caktuara. Planet e stërvitjes të bazohen në një vlerësim të aftësive të FA me qëllim përmbushjen e kërkesave të misionit, ashtu siç është dokumentuar në Listën me Detyrat Themelore të Misionit, udhëzimet e Ministrit të Mbrojtjes, të Shtabit të Përgjithshëm dhe burimeve aktuale për mbështetjen e stërvitjes. Në vazhdim, KDS, forcat mbështetëse dhe agjencitë qeveritare integrohen në stërvitjen e përbashkët për të siguruar sukses në emergjencat kombëtare të së ardhmes.

1.4.6. Stërvitja t'u shërbejë veprimeve të përbashkëta. Në minimumin më të vogël, gjithë stërvitja e FA të RSH duhet të jetë në nivelin e standardeve të NATO-s, duke përdorur doktrinën e miratuara të FA të RSH.

1.4.6.1. Të përdoret stërvitja në bazë të aftësive. Ushtarët i përmirësojnë aftësitë e tyre duke zhvilluar stërvitje praktike sa më shpesh që të jetë e mundur. Kjo e bën praktikën faktorin kryesor në stërvitje. Togat dhe skuadrat duhet të praktikojnë në mënyrë të përsëritur detyrat që rrjedhin nga misioni i tyre me qëllim arritjen e përsosmërisë.

1.4.6.2. Stërvitja e forcës së bashkuar është përpjekja aktive për të përshtatur veprimet në fushën e luftimit në kohë, hapësirë me qëllim sigurimin e

efektivitetit më të madh të mundshëm të fuqisë luftarake, në vendin dhe kohën e duhur. Doktrina kërkon të punohet në grup, në të gjitha nivelet e drejtimit. Personeli i mirë stërvitur në kushte të tilla mund të veprojë lehtësisht në të gjitha llojet e operacioneve. Kur futet në betejë, çdo njësi/repart duhet të jetë i përgatitur për të kryer operacione pa pasur nevojë për stërvitje shtesë apo periudha të zgjatura rregullimesh. Drejtuesit, si rregull, praktikojnë mënyrat e veprimt të forcës së bashkuar operacionale, të atyre të mbështetjes luftarake të betejës, por edhe të mbështetjes me shërbime. Grupet që stërviten mund të arrijnë mjeshtërinë dhe kohezionin e forcës së bashkuar vetëm kur ata stërviten së bashku.

Në raste të rralla forcat do të veprojnë të veçuara. Stërvitja në repart/njësi është e ndërvarur nga individët, grupet dhe nënrepartet/repartet, ndaj kërkohet realizimi i saj me synim zhvillimin e drejtuesve të përshtatshëm e me përvojë, të ushtarëve dhe njërive të përgatitura e që të mund të veprojnë të bashkuar.

Edhe stërvitja e forcës së bashkuar bazohet në standarde. Standardi për stërvitje të efektshme të forcës së bashkuar kërkon kryerjen me radhë e në mënyrë të vazhdueshme të detyrave funksionale në drejtim të arritjes së "... fuqisë luftarake të kërkuar, në vendin dhe kohën e duhur (vendimtare)".

Forca e bashkuar kërkon komandantë dhe nënoficerë që të përfshihen aktivisht në të gjitha fazat e stërvitjes.

1.4.7. Stërvitja të sigurojë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e armës dhe teknikës.

1.4.7.1. Mirëmbajtja e armatimit dhe e pajimeve është pjesë po aq e rëndësishme e çdo programi stërvitor. Ushtarët dhe drejtuesit janë përgjegjës për mbajtjen e të gjitha pajimeve dhe mjeteve në gjendje të lartë gatishmërie, në mbështetje të stërvitjes dhe misioneve operacionale. Njësitë të jenë në gjendje të luftojnë për një kohë të gjatë me armët dhe pajimet organike. Ushtarët të bëhen ekspertë në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajimeve e të teknikës. Lidhja mes stërvitjes dhe mirëmbajtjes është jetësore në arritjen e suksesit të misionit operacional.

1.4.8. Stërvitja të bëhet duke përdorur teknika shumëshkallëshe. Stërvituni duke përdorur teknikat e stërvitjes shumëplanëshe të integruar dhe me kompleks të gjerë (ushtar, skuadër, kompani, batalion, regiment, brigadë).

1.4.8.1. Stërvitja shumëshkallëshe është mënyra më efektive e stërvitjes për të përballuar një gamë të gjerë detyrash me burime dhe kohë të kufizuar. Stërvitja të përfshijë ushtarët, drejtuesit dhe elementët vartës në të gjitha nivelet e repartit e në të njëjtën kohë.

Stërvitja shumëshkallëshe përdoret për të:

- stërvitur drejtuesit, shtabet luftarake, njësitë dhe individët e çdo niveli të organizimit, njëherësh;

- rritjen e përdorimit të burimeve të lejuara, në kohën e lejuar, pakësimin e efekteve shqetësuese për personelin.

Ngjarjet stërvitore me pjesëmarrje të madhe forcash sigurojnë një mundësi të shkëlqyer për stërvitjen e individëve, drejtuesve, grupeve dhe njësive të vogla. Stërvitja shumëshkallëshe realizohet në rastet kur një organizëm i plotë stërvitet në një detyrë të vetme të LDTHM apo kur hallka të ndryshme të një organizmi kryejnë stërvitje në disa detyra të LDTHM njëherësh. Stërvitja shumëshkallëshe kërkon:

- Planëzim dhe koordinim të detajuar nga komandantët e drejtuesit e të gjitha hallkave dhe niveleve.
- Ruajtjen e fokusit në betejë, duke lidhur detyrat individuale dhe kolektive të betejës me detyrat e LDTHM-ve të njësive në ngjarjet e mëdha stërvitore.
- stërvitjen njëherësh të paktën të dy hallkave.

1.4.9. Stërvitja të ruajë nivelin e arritur dhe ta zhvillojë më tej atë. Stërvitja në FA të sigurojë ruajtjen e nivelit dhe adaptimin me kushte të ndryshme, gjithashtu të përfshijë mësimet e nxjerra nga stërvitjet dhe misionet e mëparshme.

1.4.9.1. Ushtarët i ruajnë ato çka mësojnë vetëm duke i praktikuar shpesh ato. Gjatë përgatitjes së një plani stërvitor gjithmonë duhet lënë kohë për të praktikuar ushtrimet e mësuara më parë. Përdorni si udhëzues doktrinën stërvitore, për përgatitjen e një plani që lejon repartin për të arritur dhe ruajtur efektivitetin kolektiv dhe atë individual.

Kur një njësi apo individ i stërvitur ka arritur një nivel të kërkuar të aftësive, drejtuesit i duhet të strukturojë planet e stërvitjes individuale dhe kolektive në ri stërvitjen e trupës për detyrat më të rëndësishme, aq sa kjo të bëjë të mundur ruajtjen e këtij niveli. Stërvitja për të siguruar ruajtjen e aftësive të fituara është çelësi që mundëson gatishmërinë operacionale edhe gjatë lëvizjes së personelit apo shpërndarjes për detyra të tjera jo stërvitore; kjo është e rëndësishme sidomos për njësitë që kompletohen me ushtarë profesionistë dhe rezervistë. Stërvitjet e rralla dhe “pa bukë” nuk mund ta ruajnë dot aftësinë luftarake.

Stërvitja me qëllim ruajtjen e aftësive u mundëson njësive të veprojnë brenda aftësive operacionale të kërkuara, nëpërmjet përsëritjes së detyrave më të rëndësishme. Aftësi e kërkuar është niveli i arritur i aftësive, brenda të cilave njësia i ka të gjitha mundësitë që të realizojë misionet e saj të kohës së luftës. Stërvitja për ruajtjen e aftësive përfshin stërvitjen e drejtuesve, shtabeve dhe nënreparteve.

1.4.10. Stërvitja të zhvillojë me përparësi drejtuesit. Stërvitni dhe zhvilloni drejtuesit e së ardhmes në të gjitha nivelet. Sigurohuni që çdo nënoficer ose oficer merr stërvitjen dhe edukimin e duhur në kohën e duhur.

1.4.10.2. Komandantët të sigurojnë që planet e tyre stërvitore të konsistojnë në 3 elementë të veçantë, por të sinkronizuar me njëri-tjetrin:

- Stërvitjen individuale.
- Stërvitjen kolektive.
- Stërvitjen e drejtuesve.

Planet stërvitore të repartit të konsistojnë në një kompleks elementësh, të cilët përfshijnë:

- Stërvitje bazë.
- Stërvitje për aftësim në fusha të ndryshme.
- Stërvitje të avancuar.
- Stërvitje speciale.
- Stërvitje për vendimmarrje ose lider.
- Stërvitje shumëshkallëshe.
- Stërvitje për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e saj.
- Stërvitje për mbështetjen.

1.4.11. Stërvitu për të përmbushur kërkesat e doktrinës së FA dhe ato të një force tjetër, me të cilën mund të bashkëpunoni në të ardhmen.

1.4.11.1. Stërvitu për të përmbushur kërkesat e doktrinës së FA dhe ato të një force tjetër me të cilën mund të bashkëpunoni në të ardhmen.

1.4.12. Centralizoni gjithë procesin e planëzimit deri në një nivel të caktuar dhe decentralizoni ekzekutimin e stërvitjes.

1.4.12.1. Gjatë procesit të planëzimit të detyrave themelore të stërvitjes, komandanti fokuson planëzuesit në objektivat bazë të stërvitjes. Ky proces siguron që komandantët dhe planëzuesit të:

- Zhvillojnë aktivitete stërvitore që bazohen në standardet e kërkuara.
- Zhvillojnë teste që testojnë aftësitë bazë që kërkohen.
- Përdorin vlerësime të standardizuara për repartet.

1.4.12.3. Kur një organizëm i FA urdhërohet të fillojë planëzimin e një misioni të ndryshëm nga ata që i janë caktuar në kohë lufte (p.sh. operacionet në mbështetje të NATO-s ose koalicionit), procesi i menaxhimit të stërvitjes mbetet i pandryshuar. Misionet e urdhëruara mund të përmbledhin gjithë spektrin e operacioneve, duke përfshirë që nga operacionet luftarake në shkallë të gjerë deri në dhënien e ndihmës humanitare apo operacione të tjera mbështetëse. Duke përdorur si bazë misionin në kohë lufte, komandantët e FA, të cilët marrin një detyrë ndryshe nga misioni i tyre kryesor, duhet të kryejnë analizën e misionit, identifikimin e detyrave specifike dhe të bëjnë vlerësimin e nevojave

të shtërvitjes për përmbushjen e misionit që u është ngarkuar. Në këtë rast, analiza e misionit të ri mund të ndryshojë fokusin e shtërvitjes dhe strategjinë për realizimin e detyrave bazë që rrjedhin nga misioni kryesor.


Komandantët e kanë për detyrë të parë shtërvitjen e drejtuesve dhe zhvillimin profesional të tyre. Ata i mësojnë vartësit si të luftojnë dhe të shtërviten. Ata udhëheqin, udhëzojnë, bindin dhe gjykojnë së bashku me vartësit. Ata i shtërvitin drejtuesit që këta të planëzojnë shtërvitjen në detaje, të përparatiten seriozisht për shtërvitje, të zhvillojnë shtërvitjen me intensitet, të vlerësojnë aftësitë në shtërvitjen konkrete sipas parametrave që ata do të dëshironin për rezultatet afatgjata. Shtërvitja dhe zhvillimi profesional i drejtuesve është komponent që realizohet në çdo ngjarje shtërvitore. Asgjë nuk është më e rëndësishme se krijimi dhe përparatitja e drejtuesve kompetentë, të besueshëm dhe të përshatshëm për shtërvitjet dhe sfidat e së ardhmes.

1.5. Sistemi i shtërvitjes në FA

1.5.1. Sistemi i shtërvitjes në FA është bashkimi i përparjekjeve mes institucioneve shtërvitore, njërive dhe individëve për të arritur nivelin e kërkuar të aftësive operacionale të trupës dhe drejtuesve të tyre. Ai është një proces shumëshkallësh, në unitet dhe në marrëdhënie të brendshme e të ndërsjellë, i bazuar në zhvillimin e taktikave dhe teknologjive bashkëkohore. Sistemi i shtërvitjes synon të formojë ushtarakë të motivuar, të disiplinuar, të aftë të veprojnë si individë, në përberje të grupit, të njësisë dhe njëherësh të jenë të përparatitur mendërisht e fizikisht për të plotësuar kërkesat dhe cilësitë që karakterizojnë pjesëtarin e Forcave të Armatosura të RSH-së.

1.5.2. Sistemi i shtërvitjes në FA përpariqet vazhdimisht të kënaqë dy çështje, ndonjëherë në kundërshti: nevojën për të arritur kërkesat e momentit kur ajo zhvillohet, së bashku me objektivat e planëzuar, si edhe nevojën që e gjithë shtërvitja të përparëndrohet për betejën luftarake.

1.5.3. Sistemi i shtërvitjes mbështetet në dy kolona kryesore: në shtërvitjen individuale (institucionale) dhe në shtërvitjen kolektive (operacionale) apo shtërvitjen në njësi.



a. Stërvitja individuale, synon të përgatisë, të formojë dhe të edukojë individë të aftë për të vepruar në fushëbetejë. Stërvitja individuale është procesi që përgatit oficerët, nënoficerët dhe ushtarët për të plotësuar rolin individual në operacion, si pjesë e një grupi apo skuadre.

Ajo përfshin stërvitjen bazë (SB) dhe stërvitjen individuale të avancuar (SIA).

b. Stërvitja e kompaktësimit/njësimit (në njësi) synon që përmes një procesi të shumëllojshëm stërvitjeje individuale dhe kolektive, të përgatisë drejtuesit dhe efektivat me kërkesat e fushëbetejës. Ajo përfshin stërvitjen individuale përforcuese (stërvitjen në postin luftarak dhe kompaktësimin/njësimin e skuadrës), si dhe stërvitjen kolektive të repartit a njësisë. Në këtë lloj stërvitjeje marrin pjesë të gjithë elementët përbërës të luftimit, të mbështetjes në luftim dhe të mbështetjes me shërbime të luftimit. Stërvitja në njësi, në thelb, konsiston në zbatimin e doktrinës në formën e taktikave, teknikave dhe procedurave në mjedise operacionale reale. Stërvitja në njësi rilidh dhe ripërtërin stërvitjen individuale të pjesëtarëve me stërvitjen e drejtuesve të saj.

1.6. Institucionet e planëzimit, drejtimit, realizimit të stërvitjes dhe përgjegjësitë e tyre

1.6.1. Për konceptimin, planëzimin dhe realizimin e procesit të stërvitjes në FA, me qëllim që ajo të jetë e thjeshtë në të kuptuar dhe e lehtë në të zbatuar, është e domosdoshme ndarja dhe marrja e përgjegjësiwe institucionale.

1.6.1.1. Me qëllim menaxhimin e rritjes së gamës së operacioneve me hyrjen e Shqipërisë në NATO, drejtuesit dhe shtabet e MM, SHP e KFB, KM dhe KDS duhet të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me stërvitjen dhe menaxhimin e operacioneve. Komandantët e operacioneve të jenë të organizuar, stërvitur dhe pajisur në mënyrë të mjaftueshme për t'u përballur me sfidat e të ardhmes. Këta komandantë duhet të mbështeten nëpërmjet strategjive dhe politikave të duhura të planeve të stërvitjes.

Përcaktimi i qartë i detyrave, vlerësimi në mënyrë të drejtë, ndjekja me rreptësi dhe reflektimi i vazhdueshëm në përgjegjësitë institucionale të çdo hallke, mbetet detyrë kryesore për çdo autoritet përgjegjës në procesin e stërvitjes së personelit, të njësive dhe reparteve të FA. Çdo hallkë komandimi ka rolin, autoritetin dhe përgjegjësitë e veta për stërvitjen.

1.6.2. Organizmat kryesore përgjegjëse për planëzimin, drejtimin, kryerjen dhe vlerësimin e procesit të stërvitjes në FA janë:

- Shtabi i Përgjithshëm i FA.
- Komandat e Forcave (KFB, KDS dhe KM)
- Komandat e njësive e të reparteve.
- Institucionet stërvitore.

1.6.2.1. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, nën autoritetin e Shefit të SHP është përgjegjësi kryesor për sigurimin e forcave të stërvitura dhe të afta

për realizimin e misionit. Përgjegjësi e SHP, në mënyrë të veçantë e Drejtorisë së Operacioneve dhe Shtërvitjes (J3/7), është përcaktimi dhe zhvillimi i politikave të shtërvitjes; hartimi i strategjisë dhe koncepteve bazë të shtërvitjes, planëzimi dhe drejtimi i të gjithë procesit të shtërvitjes në Forcat e Armatosura; administrimi i kërkesave dhe i burimeve të mbështetjes së shtërvitjes; planëzimi, koordinimi dhe grafikimi i futjes së pajisjeve dhe metodave të reja shtërvitore. Shtabi i Përgjithshëm përcakton detyrat kryesore dhe synimet e shtërvitjes në FA, mënyrën, kur dhe ku do të përqendrohen përpjekjet për rritjen e profesionalizmit dhe të shkallës së aftësive operacionale të trupave. Ai programon edhe përgatitjen e komandantëve e të shtabeve, duke siguruar që të kryhen ushtrime shtërvitore për përvetësimin, përmirësimin dhe zhvillimin e Doktrinës e të procesit shtërvitor. Për SHP të FA mbështetja e shtërvitjes është përgjegjësi themelore, për të garantuar materialet dhe burimet e shtërvitjes, shërbimet mbështetëse, hapësirat poligonale dhe programimin e shtërvitjes në të gjitha strukturat. Për çështje specifike, SHP autorizon komunikim të drejtpërdrejtë midis Komandës së Forcës së Bashkuar, Komandës së Mbështetjes dhe KDS-së.

1.6.2.2. Komanda e Forcës së Bashkuar dhe Komanda Mbështetëse kanë përgjegjësinë parësore për procesin e shtërvitjes dhe për vendosjen e politikave shtërvitore në strukturat e tyre; dhënien dhe publikimin e udhëzimeve shtërvitore së bashku me kalendarin e ngjarjeve të mëdha shtërvitore; hartimin dhe publikimin e LDTHM KFB-së e KM-së; koordinimin e veprimtarisë me KDS-në për procesin e përgatitjes së personelit të tyre në SHT; mbështetjen e SHP gjatë programimit të veprimtarive shtërvitore; koordinimin, menaxhimin dhe sigurimin e shtërvitjes me pajisjet dhe metodat e reja shtërvitore; planëzimin dhe shpërndarjen e burimeve për realizimin e programeve shtërvitore; vlerësimin e njësive e të reparteve vartëse.

Komandat e forcave, si dhe komponentët e tyre përbërës, brenda orientimeve të Shtabit të Përgjithshëm, programojnë shtërvitjen e strukturave të veta dhe përmirësojnë e zbatojnë programet në përputhje me Doktrinën. Ato përqendrohen në realizimin e shtërvitjes kolektive për strukturat e vartësisë dhe janë përgjegjëse për integrimin e detyrave shtërvitore në një koncept të njësuar luftarak.

1.6.2.3. Komandat e njësive e të reparteve drejtojnë procesin e shtërvitjes në njësitë dhe repartet e tyre duke u përqendruar në realizimin e shtërvitjes kolektive. Ato janë përgjegjëse për përgatitjen e udhëzimeve shtërvitore dhe të kalendarit shtërvitor; hartimin e LDTHM të tyre; drejtimin e procesit të përgatitjes profesionale të vartësve; përcaktimin e detyrave shtërvitore në interes të betejës; përcaktimin e përparësive, planëzimin dhe shpërndarjen e burimeve të shtërvitjes; vlerësimin e reparteve dhe nënreparteve vartëse.

1.6.2.4. Komanda e Doktrinës dhe e Shtërvitjes realizon mbështetjen e nevojshme institucionale për përgatitjen e personelit të FA dhe zhvillimin e një procesi shtërvitor të standardizuar. Ajo është përgjegjëse për përgatitjen institucionale të oficerëve dhe nënoficerëve; për kryerjen e shtërvitjes bazë me të

gjithë personelin ushtarak të FA; për përgatitjen dhe kualifikimin e ushtarëve profesionistë/me pagesë; sigurimin e përgatitjes së drejtuesve të të gjitha niveleve, si dhe sigurimin e mbështetjes së nevojshme për vetëzhvillimin e tyre; zhvillimin e koncepteve, kërkesave, materialeve doktrinare, udhëzimeve stërvitore, manualeve etj. Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes, me autorizimin e SHP, jep rekomandime dhe nxjerr udhëzime për procesin stërvitor, për kurset dhe seminarët e ndryshme në interes të zhvillimit profesional të drejtuesve, për përpunimin e standardizuar të koncepteve e të programeve të stërvitjes e trajnimit të personelit të Forcave të Armatosura, si edhe për nxjerrjen e përfundimeve në procesin e rishikimit të planeve stërvitore. Nëpërmjet strukturave studimore ajo siguron të dhëna për ardhmërinë e procesit të stërvitjes, planëzimit të saj, hartimit të dokumentacionit, kriterëve të vlerësimit të personelit e të njësive, si edhe për përgjithësimin e arritjeve dhe rishikimin e të gjithë programeve të stërvitjes.

KDS bashkërendon procesin e stërvitjes të strukturave të veta me komandat e forcave, me njësitë e repartet e Forcave të armatosura.

1.6.2.5. Institucionet stërvitore (Brigada e Stërvitjes Bazë dhe Shkolla e Trupës), kryejnë përgatitjen profesionale fillestare për të gjithë pjesëtarët e FA; ato e pajisin personelin ushtarak me njohuritë bazë të nevojshme për të kryer detyrën në specialitetin e përcaktuar ushtarak, si pjesëtar i grupeve të vogla e kontribuese në realizimin e misionit të njësisë. Institucionet stërvitore parashtrajnë radhën e transformimit nga qytetar civil në qytetar me uniformë dhe në bërjen e tyre të aftë e të kualifikuar me njohuritë bazë të luftimit. Ato rrisin potencialin vetjak të njohurive, nismën dhe kompetencën në bërjen e luftës. Ato mbështesin të gjithë stërvitjen e ardhshme, si atë të kompaktësimit/njësimit edhe atë individuale, sigurojnë përgatitjen profesionale shtesë në specialitetet përkatëse të të gjithë personelit ushtarak dhe gjatë gjithë karrierës së tyre.

1.5. Komandantët dhe stërvitja

1.7.1. Komandantët dhe drejtuesit e FA janë përgjegjës për të siguruar efektivitetin e stërvitjes së trupave dhe reparteve të tyre. Komandantët apo drejtuesit nuk mund ta bëjnë këtë të vetëm, ata sigurojnë që gjithsecili, në repartet ose organizmat e tyre, të kuptojë qëllimin, objektivat, zhvillimin dhe standardet e stërvitjes brenda repartit ose organizmit të tyre.

1.7.2. Stërvitja efektive është përparësia numër një e komandantëve. Komandanti është stërvitësi i parë dhe njëherësh përgjegjës për gatishmërinë luftarake të formacionit të vet. Në kohë lufte, stërvitja vazhdon si përparësi e dytë, vetëm gjatë operacioneve luftarake, por edhe në operacione të mbështetjes së paqes. Stërvitja efektive kërkon energji dhe kohë të mjaftueshme nga komandantët për:

- Krijimin dhe komunikimin e një vizioni të qartë. Vizioni i drejtuesve të lartë për stërvitjen siguron drejtimin, qëllimin dhe motivimin e nevojshëm për të

përgatitur individët dhe organizmat për fitore në betejë. Ai bazohet në kuptimin e plotë të:

- Misionit, doktrinës dhe historisë.
 - Aftësive kërcënuese të armikut.
 - Ambientit operacional.
 - Anëve të forta dhe të dobëta të personelit.
 - Ambientit stërvitor.
- Stërvitjen e një hallke më poshtë dhe vlerësimin e dy hallkave më poshtë. Komandantët janë përgjegjës për stërvitjen e njësisë së tyre, si dhe të një hallke më poshtë; ata të vlerësojnë dy hallka më poshtë. Komandanti i brigadës stërvit komandantët e batalioneve dhe vlerëson kompanitë, komandanti i batalionit stërvit komandantët e kompanive dhe vlerëson togat.
 - Kërkesën ndaj vartësve, që këta të kuptojnë dhe luajnë rolin e tyre në stërvitje. Një stërvitje e mirë rezulton e tillë nga përfshirja e drejtuesve në të. Ndër rolet parësorë të komandantëve në stërvitje është të mësojnë drejtuesit vartës se si këta të stërvitin dhe të luftojnë. Komandanti siguron vazhdueshmërinë e drejtimit, që e fokuson njësinë nga misioni i kohës së luftës. Ai u cakton oficerëve përgjegjës të kryesore për stërvitjen e kompaktësimin dhe nënoficerëve për stërvitjen individuale, të grupit e skuadrës. Komandanti, si stërvitësi i parë, përdor teknika shumëshkallëshe për të ndërthurur stërvitjen e drejtuesve vartës, të shtabit dhe individit me kërkesat stërvitore, brenda ngjarjeve stërvitore kolektive. Komandantët mësojnë, trajnojnë dhe këshillojnë vartësit kurdoherë.
 - Stërvitjen e të gjithë elementëve që këta të jenë plotësisht të aftë për detyrat themelore të misionit. Komandantët integrojnë dhe stërvitin në standardet e FA të gjitha sistemet vepruese luftarake, brenda dhe në mbështetje të komandës së vet, në detyrat themelore të misionit të përcaktuar. Një kërkesë e rëndësishme për të gjithë drejtuesit është të projektojnë planet për të ardhmen dhe të sigurojnë e koordinojnë burimet e nevojshme për realizimin e tyre.
- Zhvillimi i vartësve. Drejtuesit kompetentë e të besueshëm ndërtojnë organizma kohezivë, me hallka të forta komandimi, me moral të lartë dhe disiplinë të fortë; për këtë arsye, komandantët duhet të hartojnë programe për drejtuesit, me synim që të zhvillojnë më tej njohuritë, aftësitë dhe profesionalizmin në bërjen e luftës. Ata zhvillojnë besimin e vartësve dhe i autorizojnë ata të jenë të pavarur, të marrin vendime, bazuar në situatat konkrete të fushëbetesës. Të sigurojnë që vartësve u jepen mundësitë për trajnim dhe edukim profesional ushtarak dhe në fushën e drejtimit.
- Përfshirjen e vetvetes në planëzimin, përgatitjen, kryerjen dhe vlerësimin e stërvitjes. Komandantët sigurojnë burimet për stërvitjen dhe kohën e stërvitjes së komandantëve vartës. Ata janë të përfshirë aktivisht në planëzimin e stërvitjes së ardhme. Krijojnë stabilitetin në njësinë e tyre duke mbrojtur planet

stërvitore të miratuara nga ndërprerjet e panevojshme. Komandantët e lartë mbrojnë kohën e komandantëve vartës duke i lejuar ata të jenë të pranishëm në stërvitje në maksimumin e mundshëm të kohës. Komandantët vartës janë përgjegjës për kryerjen e stërvitjes së miratuar sipas standardeve. Komandantët e lartë marrin pjesë në procesin e stërvitjes sa më shumë të mundën.

- Të kërkuar arritjen e standardeve stërvitore. Drejtuesit mund të presin që disa nga detyrat stërvitore të mos realizohen në standardin e kërkuar; për këtë ata parashikojnë kohë, në ngjarjet stërvitore, për të mundësuar stërvitje shtesë për detyrat e përcaktuara në standarde. Është më e rëndësishme të stërvitesh në standarde për një numër të kufizuar detyrash, se sa të dështosh në përpjekjet për të realizuar më shumë detyra, duke arsyetuar që do të ndërmerresh veprime ndreqëse më vonë, pas periudhës stërvitore.
- Të siguruar detyrat e përshtatshme për stërvitjen dhe disiplinën e saj. Drejtuesit duhet të sigurohen se planet e drejtuesve vartës janë në rregull me raportin detyrë - kohë. Planëzimi i shumë detyrave do të kërkojë kohë shtesë për realizimin e plotë të tyre, ndërkohë që ajo është një burim i kufizuar.
- Të edukuar klimën e komandimit, çka është e favorshme për stërvitje të mirë. Komandantët krijojnë një klimë që shpërblen vartësit që kryejnë stërvitje të fortë dhe novatore. Durimi dhe stërvitja janë përbërësit thelbësorë për arritjen e standardeve të FA.
- Eliminimin e humbjeve në stërvitje. Komandanti që ka planëzuar dhe ka dhënë burimet për një stërvitje, është përgjegjës për të siguruar pjesëmarrjen në maksimumin e mundshëm të ushtarëve. Ngarkesat administrative të mbështetjes nuk duhet të injorohen, sidoqoftë, ato mund të reduktohen duke përdorur një menaxhim efektiv të kohës në dispozicion. Komandantët dhe eprorët duhet të mbështesin përpjekjet e komandantëve vartës që këta të stërvitin me efektivitet efektivat, duke shmangur humbjet dhe duke forcuar kërkesën që i gjithë personeli i caktuar të jetë i pranishëm në stërvitje gjatë gjithë kohës.

1.7.4. Kur komandantët dhe drejtuesit e të gjitha niveleve, në mënyrë të vazhdueshme përdorin 12 principet bazë të stërvitjes dhe komandimit, u përmbahen 10 përgjegjësi të thëna më lart, atëherë ka për të rezultuar një proces koherent dhe sistematik stërvitjeje.

1.8. Përkufizime

1.8.1. Kuptimi i terminologjisë në vazhdim është kritik për të kuptuar stërvitjen me qëllim përmbushjen e misionit të FA.

1.8.2. *Menaxhimi i stërvitjes*: Është procesi që përdoret nga drejtuesit për identifikimin e kërkesave të stërvitjes dhe në të njëjtën kohë të planëzojnë, mbështesin, zhvillojnë dhe vlerësojnë stërvitjen.

1.8.3. *Stërvitja*: Instruktimi i personelit për rritjen e kapaciteteve për të kryer detyra specifike ushtarake dhe detyra shtesë si kolektiv dhe individ.

1.8.4. *Detyrat*: Një aktivitet i përcaktuar i cili kryhet nga individë ose institucione. Detyrat janë aktivitete specifike të cilat kontribuojnë në përmbushjen e misionit apo kërkesave të tjera që dalin prej tij.

1.8.5. *Kushtet*: Rrethanat dhe ambienti në të cilat do të kryhet një detyrë. Kushtet mund të ndryshojnë dhe në fakt duhen ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme.

1.8.6. *Standardet*: Minimumi i pranueshëm që kërkohet në përmbushjen e një detyre në kushte të caktuara. Standardi nuk ndryshon asnjëherë.

1.8.7. *Misioni*: Të shprehurit e komandantit për atë çka duhet të kryejë reparti dhe për çfarë arsye. Detyra kryesore që i caktohet një individ, reparti ose force.

1.8.8. *Detyra themelore e misionit*: Një detyrë kolektive, që një organizëm ushtarak duhet të jetë në gjendje të kryejë, si një pjesë e caktuar nga misioni i vet në kohë lufte.

1.8.9. *Lista e detyrave themelore të misionit (LDTHM)*: Një përpilim i detyrave bazë të misionit, që duhet të përmbushen në mënyrë të suksesshme nga një organizëm, me qëllim realizimin e misionit në kohë lufte.

1.8.10. *Stërvitja e orientuar*: Stërvitje reale, që realizon detyrat e stërvitjes sipas kushteve dhe në përputhje me standardet specifike të doktrinës.

1.8.11. *Stërvitja kolektive*: Është stërvitja në institucione apo reparte, që përgatit skuadra ose grupe kompakte e që janë në gjendje të përmbushin misionin e tyre në fushëbetejë dhe në operacione të tjera (përveç luftës).

1.8.12. *Analiza pas veprimit*: Diskutim profesional, i fokusuar nga objektivat që duhet të arrihen në vazhdim të stërvitjes ose në përfundim të saj. Rishikon një aktivitet stërvitor duke u bërë të mundur pjesëmarrësve të zbulojnë dhe informohen për çfarë ndodhi dhe përse ndodhi.

1.8.13. *Fokusi i misionit*: Koncept që përdoret për ndarjen e kërkesave të stërvitjes në kohë paqe nga misioni operacional i repartit në kohë lufte.

1.8.14. *Fokusi i misionit drejton*: planëzimin, përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e programit të stërvitjes së çdo organizmi ose reparti për të siguruar që pjesëtarët e atij organizmi apo reparti stërviten në kushte të ngjashme me ato të luftimit.

1.8.15. *Strategjia ushtarake*: Plani i FA të RSH për plotësimin e objektivave afatshkurtër dhe vizioni i FA për rolin e tyre vendimtar në të ardhmen.

1.8.16. *Ndërveprimi*: Mundësia e sistemeve të armatimit, reparteve ose forcave të FA, për të dhënë dhe marrë shërbime nga sisteme, reparte ose forca të tjera. Gjithashtu, të jenë në gjendje të përdorin sisteme të tjera për të bërë të mundur që ato të jenë në gjendje të operojnë me efektivitet së bashku.

1.8.17. *Stërvitja e përbashkët*: Stërvitja e FA, bazuar në doktrina, taktika dhe procedura të përbashkëta. Stërvitje që kryhet me qëllim krijimin e forcave ose shtabeve të përbashkëta për t'iu përgjigjur kërkesave operacionale apo

strategjike të Komandantit të Forcës së Përbashkët për përmbushjen e misionit të caktuar.

Kreu II: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E ARSIMIMIT USHTARAK

- 2.1 Domosdoshmëria e arsimimit
- 2.2 Arsimi i përgjithshëm
- 2.3 Arsimimi dhe kualifikimi ushtarak i oficerëve
- 2.5. Përgatitja e civilëve
- 2.6. Programet e zhvillimit të gjuhës së huaj
- 2.7. Përgjegjësia për arsimimin Ushtarak
- 2.8. Integrimi ndërmjet arsimimit dhe stërvitjes

2.1. Domosdoshmëria e arsimimit

2.1.1. Vështrim mbi arsimimin Ushtarak.

2.1.1.1. Qëllimi i sistemit të arsimimit Ushtarak është të prodhojë një trupë drejtuesish të përshtatshëm dhe që të mendojnë në mënyrë kritike, si oficerë dhe nënoficerë, të cilët të kenë vlerat e duhura, atributet dhe aftësitë për të kryer siç duhet detyrat e tyre dhe që t'i shërbejnë kombit. Këta drejtues duhet të dinë si operojnë Forcat e Armatosura, aleatët ushtarakë, partnerët e Shqipërisë dhe kundërshtarët e mundshëm. Për më tepër, këta drejtues duhet të tregojnë besnikëri, integritet, gjykim kritik dhe përgjegjësi, ndërsa veprojnë në një mjedis sigurie shumë kompleks, shpesh të dyshimtë dhe shumë shpejt të ndryshueshëm. Njëherësh, këta drejtues duhet të ndërtojnë ekipe efektive, plotësisht të afta të mbështesin operacionet e përbashkëta dhe shumëkombëshe, në mjedisin e një ndryshimi teknologjik dhe organizativ të shpejtë dhe të vazhdueshëm. Një program efektiv dhe i plotësuar i Arsimimit Ushtarak i përgatit drejtuesit për përgjegjësitë e shtruara dhe vendos kushtet për të aftësuar drejtuesit që këta të arrijnë rezultate të suksesshme në hierarkinë e komandimit.

2.1.1.2. Informacioni i marrë tani nga operacionet në vazhdim të koalicionit, në Afganistan dhe Irak tregon se Forcat e Armatosura duhet të ndërmarrin veprime për të përmirësuar aftësitë luftuese të trupës së saj të oficerëve dhe të nënoficerëve në mënyrë që të vazhdojnë të operojnë në mënyrë të efektshme në këta misione shumë të rrezikshëm, pra të operojnë në një mjedis lufte jo të zakonshëm. Kërcënimet ndaj sigurisë, të cilat janë më të ndryshme, më të vështira për t'u parashikuar dhe neutralizuar kërkojnë që institucionet që zhvillojnë Arsimimin Ushtarak të përshtatin programin e tyre për të prodhuar oficerë dhe nënoficerë, të përgatitur dhe të aftë të merren, si me luftën konvencionale, ashtu dhe me atë asimetrike.

2.1.1.3. Një element shumë i rëndësishëm në këtë lloj mjedisi, apo në çdo mision tjetër në mbështetje të Strategjisë Ushtarake, është aftësia e drejtuesve që të mendojnë në mënyrë analitike dhe në mënyra jo të zakonshme, kur ata operojnë në një mënyrë jo të centralizuar, larg vend-komandave të komandim-

kontrollit tradicional. Është pra shumë e rëndësishme që Forcat e Armatosura të stërvitin dhe të arsimojnë një trupë oficerësh dhe nënoficerësh me kulturë të balancuar, që të jetë e aftë, e ndërveprueshme dhe e mirëpërgatitur për të përmbushur misionet në një spektër të gjerë operacionesh.

2.1.2. Metodologjia e Arsimimit Akademik (universitar). Sistemi i duhur i Arsimimit Ushtarak të arrijë një balancë ndërmjet koncepteve akademike, realiteteve operacionale dhe perspektivave historike. Një prioritet i theksuar në konceptet akademike universitare mund të heqë vëmendjen nga objektivat arsimore që fokusohen tek operacionet, ndërsa një theksim i tepërt tek operacionet ushtarake mund të ulë nivelin e thellimit të koncepteve akademike. Arsimimi duhet të shtohet vazhdimisht, përvoja dhe mësimet e kaluara apo shembujt historikë duhet të përdoren për të ndriçuar objektivat për të ardhmen. Balanca e duhur mes koncepteve akademike universitare dhe realitetit operacional, që peshon mbi mësimet e së kaluarës, krijon programin arsimor më efektiv dhe të duhur për personelin e Forcave të Armatosura.

2.1.2.1. Arsimimi është procesi i dhënies së njohurive dhe aftësive intelektuale, me të cilat informacioni mund të përkthehet në një mënyrë të arsyeshme duke përdorur gjykimin e shëndoshë. Arsimimi është në thelb instruksioni formal, që kryhet zakonisht në mjedise klase, me njohuri të shtuara, aftësi, mendim kritik, me vendimmarrje të përmirësuar dhe/apo eksperiencë, si produkt i dëshiruar për studentin. Kjo metodologji është në kontrast me stërvitjen, ku një detyrë bazë apo stërvitje përdoret në kushte specifike dhe këtu standardet përdoren për të vlerësuar aftësitë e individit dhe të njësisë operacionale.

2.1.2.2. Arsimimi është gjithashtu procesi i dhënies së një grupi njohurish për t'i përgatitur nga ana intelektuale individët që këta të përballen me mjediset dinamike të sigurisë dhe të zgjidhin probleme të dyshimta, duke përdorur mendimin kritik dhe gjykimin e arsyetuar. Arsimimi përbëhet nga dy komponentë bazë dhe komplementarë: akademik dhe ushtarak. Së bashku, këta komponentë zmadhojnë dhe përpunojnë njohuritë bazë të individit dhe i ngrenë atij/asaj nivelin e njohurive. Nëpërmjet zhvillimit progresiv të edukimit të individit në institucionet civile dhe ushtarake, personeli ushtarak është në gjendje më të mirë të kuptojë profesionin që kanë zgjedhur.

2.1.2.3. Arsimimi është një përbërës i rëndësishëm i menaxhimit dhe përshtatjes së ndryshimit në çdo organizëm (strukturë) dhe në çdo zonë të përpjekjeve. Ndërsa mjediset dhe kërkesat e vëna mbi ta ndryshojnë, individët kanë nevojë të mësojnë faktet dhe mënyrat e reja të kryerjes së detyrës, mbase edhe mënyrat e reja të të menduarit rreth gjërave të cilat mund të ndihmojnë t'i pajisin ata për një botë të re dhe ndryshe. Në Forcat e Armatosura, rëndësia e arsimimit për të pajisur oficerët dhe nënoficerët për ndryshimet e ardhshme është më e madhe se sa është në çdo fushë tjetër. Ndërsa bota ecën me shpejtësi drejt një të ardhmeje të pasigurt, aftësia e oficerëve, nënoficerëve dhe profesionistëve ushtarakë të vërtetë për të menduar në mënyra të reja dhe strategjike, për të aplikuar aftësitë e

zhvilluara mirë dhe bazën e njohurive në çdo situatë, mund të jetë një shumëfishues i rëndësishëm i forcës gjatë veprimtarive luftarake.

2.1.2.4. Sistemi i Arsimit të Forcave të Armatosura varet nga programe të bashkuara dhe të integruara të kurseve të niveleve të ndryshme, që zhvillohen në institucionet stërvitore dhe arsimore të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes e që fillojnë nga edukimi universitar (niveli i parë “Bachelor” deri në Kursin e Lartë të Oficerit.

2.1.2.5. Në Forcat e Armatosura Shqiptare, Arsimimi Profesional Ushtarak (APU), i cili zhvillon drejtuesit e FA, oficerët dhe nënoficerët, fillon me arsimimin universitar. Ky trajnim është i vazhdueshëm, gjatë gjithë karrierës. Ai përfshin programe të strukturuar për instruksionin institucional dhe atë të mësimit jashtë institucionit. APU është progresiv dhe sekuencial. Ai jep bazën doktrinare dhe ndërton stërvitjen, arsimimin dhe eksperiencat e ardhshme. Jep njohuri teknike dhe taktike për të siguruar drejtues të përgatitur, në gjendje të promovohen në pozicione më të larta përgjegjësie.

2.1.2.6. Siç është treguar dhe më lart, një sistem i arrirë i APU i mëson drejtuesit si të mendojnë, jo vetëm çfarë të mendojnë. Është njëloj e rëndësishme që sistemi të mbetet i përdorshëm dhe i përgjegjshëm për kërkesat e sigurisë shqiptare. Një sistem APU që fokusohet nga e kaluara në mënyrë të paevitueshme bëhet i pa rëndësishëm për problemet e sigurisë, me të cilët do të përballen drejtuesit e ardhshëm të Forcave të Armatosura. Drejtuesit përgjegjës për zhvillimin e Arsimit Profesional Ushtarak duhet të sigurojnë që ai të përfshijë zona njohurish si veprimet policore, mbështetjen e paqes dhe operacione të tipit **ndëragjencish/të bashkuara/koalicionit**. Arsimimi Ushtarak Profesional siguron zhvillimin e aftësive apo kompetencat bazë në lidhje me njohuritë kulturore, operacionet e bashkëpunimit civilo - ushtarak, zbulimin dhe komunikacionet strategjike.

2.1.2.6.1. Sistemi i Arsimit Ushtarak Profesional, gjithashtu është themelore të vazhdojë të zhvillohet ku të përfshihen kurse dhe seminare mbi njohuritë kulturore, komunikimin përmes kulturave dhe kuptimin për t'u siguruar që drejtuesit në procesin e vendimmarrjes së tyre të përfshijnë ndryshimet kulturore. Arsimimi Ushtarak Profesional dhe kurrikula e tij duhet të kërkojë trajnimin në gjuhë të huaj dhe ekspozimin në klasat e tjera politike, marrëdhëniet ndërkombëtare apo zona të tjera, që përforcojnë ndjeshmërinë kulturore. Për më tepër, studentëve kandidatë për oficerë t'u jepet mundësia të përballen me kultura të ndryshme gjatë programeve verore të universitetit, të cilat mund të vendosin themelet e duhura dhe të përforcojnë ndjeshmërinë kulturore, të kërkuara për të operuar brenda një mjedisi sigurie kompleks të koalicionit.

2.1.2.6.2. Për të qëndruar faktor bazë, Arsimimi Profesional Ushtarak duhet të vazhdojë e të zhvillohet nga transmetimi pasiv drejt marrjes së informacionit në mënyrën aktive të ndërtimit të njohurive, nga njohuritë e mara në klasë në bashkimin e botës reale të teorisë dhe praktikës, nga orientimi i tekstit dhe të folurit në prezantimin e shumëfish të ideve dhe nga mësimi, si një akt

individual i izoluar në mësimin, në një akt bashkëpunues në kontekstin e ideve të tjera.

2.1.2.6.3. Arsimimi Profesional Ushtarak duhet të sigurojë një rol kritik, që studentët të kenë mundësi të ndryshojnë praktikën e vendosura dhe teorinë në klasë, por pa dëmtuar operacionet e përditshme. Institucionet Arsimore Ushtarake të jenë kullat e mendimit të pavarur, aty ku oficerët dhe nënoficerët të mund të prodhojnë ide që mund të çojnë në përmirësime në Forcat e Armatosura dhe në kryerjen e operacioneve ushtarake. Institucionet e Arsimimit Profesional Ushtarak të jenë në gjendje të mbrojnë dhe rritin individët që marrin rreziqe intelektuale. Një kurrikul ndërdisiplinore, liria akademike për fakultetin dhe konsiderata të një tufe idesh, nga secili apo të gjithë burimet intelektuale, duhet të jenë vultat e institucioneve arsimore të Forcave të Armatosura të së ardhmes.

2.1.2.6.4. Sistemi i duhur i Arsimimit Profesional Ushtarak të arrijë një balancë ndërmjet koncepteve akademike, realiteteve operacionale dhe perspektivës historike. Një mbështetje e madhe në konceptet operacionale mund të heqë vëmendjen nga objektivat arsimore dhe të fokusohet nga operacionet, ndërsa theksi i madh tek operacionet mund të ulë thellësinë e kuptimit të koncepteve akademike. Mësimi shtohet sa herë që mësimet e së kaluarës apo shembujt historikë mund të përdoren për të hedhur dritë mbi qëllimin. Balanca e duhur e koncepteve akademike dhe realitetit operacionel, që mban parasysht mësimet e së kaluarës, krijon programin e edukimit me efektiv dhe të duhur.

2.1.2.6.5. Programet e Arsimimit Profesional Ushtarak e rritin në maksimum efektivitetin kur këta programe e japin mësimin nëpërmjet përpjekjeve shitesë, si përshebull leksionet, diskutimet e udhëhequra nga studentët, mësimi i mbikqyrur dhe ushtrimet praktike të vendimmarrjes. Bashkimi i arritur nga kombinimi i metodave të ndryshme arsimore të përdorura e tejkalon rezultatin e secilit në mënyrë individuale. Programet arsimore shitesë përforcojnë konceptet kyçe, ofrojnë mënyra të reja të shikimit të problemeve dhe të përhapjes së aftësive logjike. Pa programet individuale profesionale, kjo mund të arrihet duke kërkuar mësim mbështetës dhe përgjegjësi të shtuara, si edhe mundësi arsimimi.

2.1.2.6.6. Sistemi i Arsimimit Profesional duhet të vazhdojë të qëndrojë i përdorshëm dhe i duhur, sepse nëse forcat ushtarake Shqiptare nuk e kuptojnë ashtu siç duhet mjedisin e sigurisë kombëtare dhe nuk kapin me intuitë pikat kyçe dhe implikimet e tyre në fushëbetë, pasojat mund të jenë të rënda. Këto dështime në nivelet e ulëta mund të jenë çështje për jetë apo vdekje dhe të mbijetesës kombëtare.

2.1.2.7. Arsimimi Universitar realizohet në Universitetin Ushtarak "Skënderbej" apo në universitete të tjera civile, brenda ose jashtë vendit. Programet arsimore kryhen në përputhje me kërkesat e Deklaratës së Bolonjës.

2.1.2.7.1. Arsimimi universitar në FA, në kurrikulën e tij, gjithashtu përfshin edhe modulet e edukimit, stërvitjes dhe të trajnimit ushtarak

deri në nivelin e togës (për të gjitha armët). Ai siguron vazhdimësinë e përgatitjes dhe ekzekutimin e programit të edukimit të oficerit të ri.

Arsimimi i personelit ushtarak në sistemin e FA realizohet nëpërmjet konsolidimit të vazhdueshëm të sistemit arsimor ushtarak, me qëllim përgatitjen e oficerëve të rinj me vizionin e kohëve të sotme, për t'i bërë ata të aftë të shërbejnë në strukturat e reja të FA dhe shtabet e NATO-s.

2.12.7.2. Oficerët e FA drejtojnë dhe luftojnë; ata të jenë teknikisht dhe taktikisht të aftë, me besim në aftësitë e tyre drejtuese; për të kuptuar se si FA shërbejnë dhe luftojnë, për të treguar besim, integritet, gjykim dhe përgjegjësi të lartë; për të vepruar në terrene të ndryshme, në situata komplekse dhe dinamike; për të ndërtuar bazat e ekipeve efektive ndërmjet ndryshimesh organizative dhe teknologjike; për të zgjidhur problemet në mënyrë krijuese. FA zhvillojnë oficerë të duhur e të ditur për të drejtuar njësitë e FA në përmbushjen me sukses të misionit të tyre.

2.2. Arsimi i përgjithshëm

2.2.1. Një vështirësi madhore për sistemin e Arsimimit Ushtarak është përfshirja e oficerëve dhe e nënoficerëve në një plan mësimor që është domethënës për të gjithë studentët. Pavarësisht specialitetit ushtarak apo edukimit të mëparshëm, nyjat e zakonshme, që lidhin të gjithë kurset e Arsimimit Ushtarak së bashku janë metoda e instruktimit të bazës së përbashkët. Metodologjia e bazës së përbashkët përbëhet nga konsolidimi i zonave të përbashkëta që përfshijnë, por nuk janë të limituara tek lidhësi, strategjia ushtarake, studimet e sigurisë, komunikimet efektive, të shkruara dhe me gojë, operacionet, planifikimi, zhvillimi i rregullores apo subjektet e drejtuara apo të detyruara, si të përshkruara me ligj dhe nga autoritetet kompetentë.

2.2.2. Baza e përbashkët përbëhet nga njohuritë dhe aftësitë, që drejtuesit pritët të kryejnë me sukses detyrat pavarësisht nga specialiteti ushtarak. Komandantët e shkollave identifikojnë fillimisht kërkesat stërvitore të fokusuara nga specialitetet ushtarake. Ata gjithashtu duhet të ndihmojnë KDS në identifikimin e kërkesave të përbashkëta arsimore dhe stërvitore për drejtuesit dhe studentët. Me këto detyra, komandantët të zhvillojnë materialet e duhura stërvitore për të mbështetur kurset institucionale apo arsimore që arrijnë këto kërkesa.

2.2.3. Arsimimi i përgjithshëm fillon në Universitetin Ushtarak dhe vazhdon në çdo nivel arsimor të oficerit dhe nënoficerit, në akademitë ushtarake, nëpërmjet kurseve të karrierës. Mësimi është progresiv, i ndërtuar mbi aftësitë dhe njohuritë e fituara nëpërmjet trajnimit të mëparshëm dhe detyrave operacionale. Për me tepër, për të qenë efektiv, instruksioni me bazë të përbashkët duhet të jetë i përshtatshëm për mjedisin dhe nivelet e eksperiencës së studentëve edhe pse këta kalojnë nëpërmjet një procesi përzgjedhjeje mjaft rigoroz përpara se të ndjekin Arsimimin Profesional

Ushtarak. Gjithsesi, instruktorët duhet fillimisht të vlerësojnë aftësitë, nivelin e eksperiencës dhe formimin kulturor të studentëve të tyre përpara se t'u paraqesin një numër të madh degësh. Instruktorët duhet të qëndrojnë të butë për të kaluar tek studentët kursin më të mirë të mësimin.

2.2.4. Tabela e mëposhtme përfaqëson një kurrikul me bazë të përbashkët, një "meny" që përmban temat e mundshme të arsimimit apo modulet, që mund të kombinohen për të formuar një kurrikul të plotë të Arsimimit Ushtarak në nivelin e studentëve, nënoficerëve dhe të oficerëve. Të gjitha këto lëndë kanë rëndësinë e tyre për misionet dhe operacionet e ardhshme të Forcave të Armatosura.

Lëndët e Arsimimit të Përgjithshëm Ushtarak

Historia Botërore
Historia Ushtarake
Teoria Ushtarake
Strategjia Ushtarake
Lidershipi
Mendimi dhe procesi i vendimmarrjes
Etika
Lufta jo vdekjeprurëse
Operacionet informuese
Legjislacioni
Përmirësimi i teknologjisë; dizenjimi dhe përdorimi i sistemeve të armëve
Aftësitë e komponentëve tokësorë, ajrorë dhe detarë.
Mbështetja logjistike dhe luftarake
Zbulimi, mbledhja dhe përdorimi i informacionit.
Blerjet dhe planifikimi i buxhetit
Puna dhe dinamika e grupit (ekipit)
Komunikimet strategjike
Lufta e parregullt, lufta kundër kryengritjeve
Krijimi dhe rinovimi

Shkrimi efektiv
“Vëzhgo, Oriento, Vendos, Vepro” (VOVV). Shumëfishuesit e tjerë të forcës mendore
Sistemet politike botërore dhe shqiptare
Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe studimet rajonale
Kultura dhe impakti i saj në luftë
Gjuhët e huaja (të rëndësishme, me përgjegjësi rajonale)
Operacionet në mbështetje të paqes

2.3. Arsimimi dhe kualifikimi ushtarak i oficerëve

2.3.1. Kursi Bazë i Oficerit (KBO) ofrohet për të gjithë oficerët që kanë përfunduar edukimin universitar. Kursi zhvillohet në Shkollën e Trupës për një kohëzgjatje gjashtë muaj deri në një vit akademik.

Programi synon në përgatitjen e kursantëve me njohuri të plota teorike e praktike për drejtimin dhe menaxhimin e togës në përmbushje me sukses të detyrave, në kohë paqe, krize e lufte, si dhe jep njohuri për kompaninë dhe përdorimin e teknikës luftarake në specialitetin përkatës.

2.3.2. Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO). Ky kurs realizohet me të gjithë oficerët me gradën toger dhe lejtënant, që kanë katër deri në shtatë vjet në shërbimin aktiv. Programi i kursit të jetë vijim i programit të Kursit Bazë të Oficerit, të përbëhet nga dy pjesë: nga programi i përgjithshëm i arsimimit ushtarak (pjesa teorike) dhe ai i trajnimit në llojin përkatës të trupës (pjesa praktike), me theks që të përgatitë togerët dhe lejtënantët për drejtimin dhe menaxhimin e kompanisë në zgjidhjen e detyrave taktike për operacionet kryesore luftarake dhe jo luftarake; të zgjidhë një detyrë për Operacionet në Mbështetje të Paqes dhe të japë njohuri për nivelin operacional të batalionit. Kursi i Avancuar i Oficerit shërben si kusht për marrjen e gradës "Kapiten" dhe zgjat jo me pak se 12 javë mësimore. Programi i këtij kursi përgatitet dhe realizohet nga Shkolla e Trupës.

2.3.3. Kursi Bazë i Oficerit të Shtabit (KBOS), kryhet në Akademinë e Mbrojtjes dhe zgjat tre muaj. Qëllimi i programit është arritja e njohurive bazë për punën në grup, njohuritë e përgjithshme për shtabin dhe detyrat që plotëson ky.

Kursi është përzgjedhës dhe ka si qëllim primar përzgjedhjen e oficerëve më të mirë për të vazhduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm (KOSHP). Në programin e këtij kursi përfshihet dhe synohet për një detyrë me zgjedhje në nivel batalioni për operacione luftarake ose jo luftarake.

Programi për këtë kurs të krijohet për oficerët e komponentëve tokësorë, detarë dhe ajrorë.

2.3.4. Kursi i Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm (KOSHP) kryhet në Akademinë e Mbrojtjes dhe ka një kohëzgjatje prej një viti akademik. Programi i tij është vazhdim i kursit Bazë të Oficerit të Shtabit; ky kurs të synojë të përgatisë oficerë të përzgjedhur karriere për të plotësuar detyra në pozicione kyçe në komandim kontroll të njërive kryesore të FA, në shtabet përbërës të forcave, në Shtabin e Përgjithshëm, në shtabet e NATO-s, apo në shtabe të ndryshme ndërkombëtare.

KOSHP duhet t'u japë oficerëve njohuri të thelluara për situatat ndërkombëtare, mbi konceptet bazë për rregulloret e sigurisë e të mbrojtjes (kombëtare dhe ndërkombëtare), për lidërshpin dhe procesin e planifikimit operacional, duke futur elementët e parë të stërvitjeve të përbashkëta etj.

Në këtë kurs qëllimi është që 10-15% e programit të zhvillohet në gjuhën angleze, si gjuhë operacionale e NATO-s, kryesisht lënda e Operacioneve në mbështetje të Paqes.

Programi, përveç komponentit tokësor, të përfshijë edhe module me qëllim përgatitjen e oficerëve të komponentit ajror dhe detar në të njëjtat nivele si edhe për oficerët e forcave tokësore, në funksion të konceptit "Joint".

2.3.5. Kursi i Lartë i Oficerit (KLO). Kursi i lartë i Oficerit do të kryhet në Akademinë e Mbrojtjes me një kohëzgjatje prej një viti akademik. KLO konsiderohet si vazhdim i njohurive të mara në Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjithshëm, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e përgatitjes profesionale dhe të njohurive kulturore të oficerëve të FA që kanë për të marrë detyra të rëndësishme në Shtabin e Përgjithshëm, në Forcat e Armatosura, në strukturat e përbashkëta apo ato ndërkombëtare.

Kursi i Lartë i Oficerit është niveli më i lartë i sistemit arsimor ushtarak. Programi i këtij kursi përfshin module rreth politikës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; ekonomisë dhe organizatave; mbrojtjes dhe sigurisë; planifikimit dhe realizimit të betejave (operacionet "Joint"); organizimin e duhur ushtarak; menaxhimin e burimeve të mbrojtjes (metodologjinë e planifikimit dhe ekzekutimit).

Përvetësimi i programit të KLO, me përfundimin e tij, siguron dhënien e gradës "Master" në fushën e mbrojtjes. Jo më pak se 30% e programit të këtij kursi të zhvillohet në gjuhën Angleze, kryesisht modulet e operacioneve shumëkombëshe.

2.3.6. Kursi i Lartë i Sigurisë dhe i Mbrojtjes (KLSM) do të kryhet në Akademinë e Mbrojtjes me një kohëzgjatje prej jo më pak se dy muaj. Programi i këtij kursi jep njohuri dhe trajnim analitik për probleme të mbrojtjes dhe të sigurisë, në nivelin kombëtar dhe rajonal, gjeopolitika, menaxhimi i krizave, ligji ndërkombëtar humanitar, konfliktet e armatosura, lufta kundër terrorizmit, etj. Kursi të kryhet 100% në gjuhën Angleze me pjesëmarrjen e autoriteteve civile dhe ushtarake të vendit, si edhe pjesëmarrjen nga vende të rajonit e të një fushe më të gjerë.

2.3.7. Kurse dhe seminare të tjerë. Përveç kurseve institucionale për zhvillimin karrierës së oficerëve, Akademia e Mbrojtjes, të përgatisë programe dhe organizojë kurse dhe seminare të tjerë sipas nevojave të Forcave të Armatosura. Në këto kurse të mundësohet pjesëmarrja për trajnimin e një kontingjenti të caktuar civil nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare, që janë në konsideratë për të shërbyer në misionet e Mbështetjes së Paqes.

2.3.8. Kurse specialiteti (shërbimi në shtab), të jenë orientuese e familjarizuese me strukturat e FA dhe ato të NATO-s; ato njëkohësisht të fokusohen edhe sipas llojeve të ndryshme të armëve dhe shërbimeve për rritjen e aftësive tekniko-profesionale.

Këto kurse, krahas aftësimit në fushën bazë përkatëse të drejtimit, të synojnë edhe zhvillimin e stërvitjeve të planëzimit për shtabe shumëkombëshe në Operacionet në Mbështetje të Paqes (OMP), planifikimin dhe detyra të zgjedhura që kanë të bëjnë me luftën kundër terrorizmit dhe trafikimin e paligjshëm.

2.3.9. Studime të Avancuara për grada shkencore.

2.3.9.1. Programi për gradën “Master” të përfshihet në Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) dhe të synojë fokusimin në zhvillimin e aftësive për menaxhimin dhe drejtimin e personelit ushtarak e civil për zgjidhjen e problemeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

2.3.9.2. Programi për gradën “Doktor” të synojë zgjidhjen dhe dhënien e kontributeve nga personeli ushtarak e civil, në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, sipas një programi temash të ofruara më parë nga SHPFA dhe që janë të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm dhe për të ardhmen e FA.

2.3.10. Kurset dhe kualifikimet ushtarake jashtë shteti. Shkollat dhe kurset e trajnimit në vendet partnere, zhvillohen mbi bazën e planit të bashkëpunimit që kanë FA me këto vende, në përputhje me Politikën e Arsimimit, nevojave të FA, të urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Mbrojtjes.

SHPFA, Komandat Kryesore dhe Institucionet Arsimore të planifikojnë personel për kualifikime dhe specializime të veçanta jashtë vendit, të cilat certifikohen dhe njihen sipas legjislacionit në fuqi.

Personeli Ushtarak i zgjedhur për të shkuar në shkollat dhe kurset e NATO-s të certifikohet në gjuhën e huaj, me qëllimin që ky personel të jetë i gatshëm të shërbejë në organizmat e NATO-s.

2.4.1. Arsimimi dhe trajnimi i nënoficerëve. Arsimimi dhe trajnimi i nënoficerëve të ketë si qëllim përgatitjen e mëtejshme dhe konsolidimin e vazhdueshëm të rritjes së tyre profesionale dhe krijimin e piramidës paralele të hierarkisë, si një kontingjent i rëndësishëm që në mënyrë të dukshme ndikon në rritjen e nivelit operacional dhe stërvitor të FA. Arsimimi profesional ushtarak i përgatit nënoficerët të drejtojnë dhe stërvitin ushtarë, grupe ushtarësh dhe nënoficerët vartës, të cilët punojnë apo luftojnë nën drejtimin e tyre. Ky sistem jep drejtim teknik

dhe aftësi për të siguruar që nënoficerët të jenë të përgatitur për arritjen e suksesit në emërimin e radhës, në nivele më të larta përgjegjësie. Institucionet arsimore dhe stërvitore janë rruga kryesore për arritjen e rritjes profesionale të nënoficerit. Roli i nënoficerit në FA, si ndihmës, këshilltar dhe përgjegjës për stërvitjen e individit dhe grupit është themelor. Ky rol gjithashtu përcakton konceptin e edukimit stërvitjes dhe rritjen e vazhdueshme të nivelit profesional të nënoficerit.

2.4.2. Programi i nënoficerit. Qëllimi i programit arsimor dhe stërvitor i nënoficerit në Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës është përgatitja e drejtuesve, zhvillimi i aftësive profesionale dhe intelektuale të tyre. Programi duhet të reflektojë rrjedhën natyrale ndërmjet përgatitjes së ushtarit profesionist dhe nënoficerit. Procesi arsimor në Akademinë e Nënoficerëve të integrohet me atë të Shkollës së Trupës dhe njësive e reparteve dhe gjithashtu të përputhet me kërkesat dhe përgjegjësitë e strukturave specifike të Forcave të Armatosura në operacione.

Përveç kurseve institucionale bazë që kryhen në Akademinë e Nënoficerëve, kurse afatshkurtër dhe seminare të ndryshëm do të vazhdohet të zhvillohen në bazë të nevojave të Forcave të Armatosura.

Akademia e Nënoficerëve të koordinojë programet e arsimimit, trajnimit dhe të stërvitjes me Shkollën e Trupës, për të krijuar një strukturë programore lineare dhe harmonike në përmbajtje.

2.4.3. Kurset arsimore dhe stërvitore për nënoficerët. Arsimimi i nënoficerëve të realizohet nëpërmjet kurseve në Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës, të përcaktuara si kohëzgjatje: Kursi Fillestar 5 javë në ANO; kursi Bazë, faza e parë 12 javë në ANO, faza e dytë 8 javë në Shkollën e Trupës; kursi i Avancuar, faza e parë 6 javë në ANO, faza e dytë 8 javë në Shkollën e Trupës; kursi i Lartë 8 javë dhe kursi i Kryekapterit jo më pak se 4 javë në Akademinë e Nënoficerëve.

2.4.4. Kurse funksionale. Të planifikohet dhe realizohet përgatitja e programeve dhe zhvillimi i këtyre kurseve afatshkurtra në Akademinë e Nënoficerëve dhe Shkollën e Trupës sipas nevojave të Forcave të Armatosura dhe të planifikuara nga Shtabi i Përgjithshëm i FA. Këto kurse të synojnë aftësimin profesional të personelit në funksion të shërbimit dhe detyrës organike.

2.4.5. Shkolla e Trupës luan një rol shumë të rëndësishëm në kuadrin e sistemit arsimor në FA. Në kuadrin e përgjithshëm, Shkolla e Trupës kualifikon personelin civil dhe ushtarak, në specialitetin specifik, në interes të detyrave funksionale. Shkolla e Trupës, në përputhje me rregulloren e Arsimimit do të zhvillojë Kurse Institucionale dhe kurse të tjerë afatshkurtër arsimore në interes të FA, si për shembull Brigada e Stërvitjes Bazë, Universiteti Ushtarak dhe Akademia e Nënoficerëve. Shkolla e Trupës të realizojë dhe sigurojë një nga kolonat bazë të edukimit: arsimimin profesional për oficerët, nënoficerët, ushtarët profesionistë dhe personelin civil në institucionin e mbrojtjes.

Në Shkollën e Trupës të zhvillohen edhe kurse Funkzionale, me qëllim që të përgatisin personelin e FA për detyra në reparte speciale apo detyra të specialitetit të veçantë sipas detyrave funksionale.

2.4.6. Kurse informuese dhe familjarizuese. Shkolla e Trupës të trajnojë personel në kurse afatshkurtra për njohjen e koncepteve të veçanta doktrinare, për informimin dhe familjarizimin e personelit me procedura standarde në planëzimin e stërvitjeve e operacioneve, për njohjen e armatimit, teknikës ose pajisjeve të reja që futen në FA, në përputhje me detyrën përkatëse dhe nevojat e njësive e të reparteve të FA.

Për këto kurse, programet dhe tematika e tyre hartohen nga Shkolla e Trupës mbi bazën e kërkesave të Komandave të Forcave, deri në dy muaj pas marrjes së kërkesës për një gjë të tillë. Realizimi i kurseve të kërkuara nga komandat të bëhet në vartësi të kapaciteteve që ofron shkolla dhe sipas planifikimit e miratimit nga SHP.

2.4.7. Programi i Shkollës së Trupës. Qëllimi i këtyre programeve është zhvillimi i njësive organizative të bashkuara; kontingjentet pjesëmarrëse janë edhe më shumë cilësorë se deri tani në aktivitetet e përbashkëta në kuadrin e aktiviteteve të NATO-s dhe Pfp, duke eliminuar tërësisht format standarde të planifikimit dhe realizimit të procesit të arsimimit dhe stërvitjes.

Këto programe do të jenë në përputhje me standardet e përcaktuara. Programet e kurseve që zhvillohen në shkollë të jenë vazhdimi i programeve që zhvillohen në institucionet e tjera.

Në hartimin e programeve mësimore të ruhen raportet e mëposhtme: 25 % për lëndët e formimit të përgjithshëm, 70 % për përgatitje speciale e metodike dhe 5% të jenë për testimin e tyre.

Në programin e përgatitjes speciale, qendra e rëndesës të anojë nga mësimi praktik për kurset e ushtarëve profesionistë dhe n/oficerëve, duke zënë mbi 50 % të programit.

Rishikimet për programet arsimore, stërvitore dhe trajnuese dhe ato të kualifikimit të personelit të Forcave të Armatosura në të gjitha komandat, institucionet, njësitë dhe repartet me qëllim arritjen e standardeve të larta të përgatitjes së trupës për aktivitete luftarake dhe jo luftarake, të jenë në përputhje me misionin e Forcave të Armatosura.

2.4.8. Shkolla e Trupës është përgjegjëse për zhvillimin me cilësi të arsimimit, stërvitjes dhe trajnimit të personelit ushtarak e civil dhe hartimin e programeve e materialeve mësimore deri në nivelin e KAO. Shkolla e Trupës përgjigjet edhe për hartimin dhe realizimin e programeve funksionale të ushtarëve profesionistë e nënoficerëve, për arsimimin special, sipas nevojave të paraqitura nga Komandat e Forcave kryesore. Komandat e Forcave kryesore përgjigjen për hartimin e realizimin e programeve të stërvitjeve me ushtarët profesionistë të cilat shprehen në pikën 2.4.8.1.

2.4.8.1. Programet stërvitore në Forcën e Bashkuar të fokusohen në stërvitjen kolektive dhe përgatitjen, krijimin dhe ruajtjen e aftësive luftarake operacionale; përmbushjen e operacioneve jo luftarake në mbështetje të popullatës që është përballur me katastrofa natyrore, brenda vendit; mbikëqyrjen dhe ruajtjen e hapësirës ajrore dhe detare; përgatitjen e trupave për pjesëmarrje në operacione të Mbështetjes së Paqes jashtë vendit, si edhe përgatitjen e drejtuesve në bazë të Listës së Detyrave Themelore të Misionit (LDTHM).

Temat e programit të përfshijnë module të cilat të:

- Mundësojnë përgatitjen e sinkronizuar ndërmjet specialiteteve.
- Sigurojnë stërvitjen e duhur dhe të mjaftueshme për detyrat e përbashkëta.
- Sigurojnë stërvitjen efektive të personelit për operacionet e bashkuara stërvitore (dypalëshe dhe shumëkombëshe).
- Sigurojnë përgatitjen e kontingjenteve për misionet në mbështetje të Operacioneve të Paqes.
- U përgjigjen nevojave për stërvitje në kushte të ndryshme terreni, moti dhe kohe, në kushte të ndryshme sigurie dhe mbrojtje.
- Sigurojnë planifikim të mirë për stërvitjet në terren për të arritur rezultatet e dëshiruara.
- Plotësojnë programin stërvitor të kërkuar nga kontingjentet specifike për misione jashtë vendit.
- Sigurojnë kohën e nevojshme për zhvillimin e qitjeve reale. Stërvitjeve në zona të banuara.
- Stërvitje e plotë të realizohet në det dhe në tokë për emergjencat civile.
- Ka në përmbytjen e vet dhe bën të mundur stërvitjen për aftësitë e shtuara të proceduarave të personelit dhe për procedurat e bordingut.

2.4.8.2. Programet stërvitore në komandën Mbështetëse të fokusohen nga: planifikimi i kohës së nevojshme për të kryer stërvitjen e trupave mbështetëse, të transportit, mirëmbajtjes, municion-armatimit, mbështetjes me komunikim/ndërlidhje, mbrojtje dhe siguri dhe të strukturave mjekësore e të komunikimit të Forcave të Armatosura, në interes të përmbushjes së misionit; koha dhe niveli i duhur të jepet për sigurimin e stërvitjes së gatishmërisë së trupës së mbështetjes; specifikat e stërvitjes së trupës me mënyrat e reja të menaxhimit; hapësira e duhur për përgatitjen e specialistëve të transportit.

Temat e programeve, që do të zhvillohen në Batalionin e Policisë Ushtarake:

- Sigurimi i stërvitjes së efektivave, i trupës dhe i drejtuesve me gjuhën dhe shprehitë e specialitetit përkatës. Një kurs njëjavor kundër terrorizmit të kryhet çdo tre muaj.

- Planifikimi dhe kryerja e një cikli të plotë stërvitor të ushtarëve për kontrollimin e turmave, të pikave të kontrollit, eskortën e autokolonave dhe autoriteteve.

2.5. Përgatitja e civilëve

2.5.1 Institucionet Arsimore dhe Stërvitore të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (Akademia e Mbrojtjes dhe Universiteti Ushtarak "Skënderbej" Akademia e Nënoficerëve dhe Shkolla e Trupës), të planëzojnë e realizojnë kurse speciale për arsimimin dhe kualifikimin e personelit civil që punon në administratën e mbrojtjes, në bazë të rangut dhe pozicionit të tyre.

2.5.2. KDS, nëpërmjet Akademisë së Mbrojtjes, të planëzojë pjesëmarrje të civilëve, për ndjekje të moduleve të caktuara, të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) apo Kurseve orientuese dhe familjarizues me strukturat e NATO-s.

2.5.3 Kursi i Lartë i Oficerit, me përfundimin e programit të miratuar dhe marrjen e krediteve të mjaftueshme sipas ligjit, të japë mundësinë për marrjen e gradës "Master" në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

2.6. Programet e zhvillimit të gjuhës së huaj

Qëllimi i trajnimit në gjuhën e huaj është mbikëqyrja e kualifikimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit, zhvillimin e karrierës, si edhe pjesëmarrja në misione të ndryshme për Operacionet në Mbështetje të Paqes.

Mbështetur në Politikën e Arsimimit për Programin e Gjuhës së Huaj, trajnimi i personelit të FA në gjuhën angleze, të bëhet sipas STANAG-ut 6001.

2.6.1. Zhvillimi i kurseve intensive të gjuhës angleze për nivelin 2/2/2/2, 3/2/3/2 dhe 3/3/3/3/ të bëhet në QGJH, ndërsa për nivelet 1/0/1/0, 1/1/1/1 dhe 2/1/2/1 të bëhet në Shkollën e Trupës dhe në njësitë e repartet parësore të FA, duke angazhuar në rolin e instruktorit të gjuhës, oficerët dhe n/oficerët e trajnuar për këtë qëllim.

2.6.2. Testimet për përcaktimin e shkallës së njohurive të Gjuhës së Huaj të bëhen në bazë të gjithë procedurave të "STANAG"-ut 6001 dhe ALCPT. Pasqyrimi i të dhënave në "database" të bëhet pas çdo faze testimi dhe ato të jenë të vlefshme për çdo kualifikim, trajnim, aktivitet brenda dhe jashtë vendit, për Komisionin e Gradave etj.

2.6.3. Shtabi i Përgjithshëm i FA do t'i kushtojë rëndësi planifikimit dhe hapjes së kurseve të reja afatshkurtër për trajnimin e personelit për terminologjinë operacionale, kryesisht për forcat që shkojnë në operacione jashtë vendit, me qëllim rifreskimin dhe ruajtjen e nivelit gjuhësor në bazë të nevojave të FA.

2.7. Përgjegjësia për arsimimin ushtarak

2.7.1 Në fund të fundit, oficerët dhe nënoficerët, individualisht janë përgjegjës për arsimimin e tyre ushtarak të vazhdueshëm. Programet formale të arsimimit japin mundësi për individët që ata të përmirësojnë ngritjen e tyre intelektuale, mendimin kritik, vendimmarrjen dhe njohuritë e përgjithshme të sistemeve

ushtarake dhe ato të sigurisë. Jashtë programeve formale individët të vazhdojnë zhvillimin e tyre nëpërmjet studimit profesional, studimit individual apo në grupe, gjatë diskutimeve me kolegët. Vetëm dedikimi personal për zhvillimin profesional mund të sigurojë të mirat maksimale të Arsimimit Ushtarak dhe të përgatisë individët për përballjet intelektuale dhe përgjegjësitë e punësimit në Forcat e Armatosura.

2.7.2. Ndërsa e kuptojmë se puna në grup mund të japë disa mundësi arsimimi, komandantët duhet të sigurohen që numrit maksimal të individëve t'u jepet mundësia e arritjes së arsimimit të duhur për gradën e tyre, përgjegjësitë apo momentin e arritur në karrierë. Komandantët japin drejtimin, qëllimin dhe motivimin themelor për individët, që ata të arrijnë qëllimet e tyre arsimore. Arritja e këtyre qëllimeve i përgatit Forcat e Armatosura dhe pjesëtarët e saj, për të udhëhequr organizma (struktura) dhe të menaxhojnë burime në një spektër të gjerë të operacioneve ushtarake. Për më tepër, komandantët mund t'i ndihmojnë vartësit e tyre nëpërmjet programeve ndihmëse, që plotësojnë programet e edukimit formal dhe duke nisur kështu një klimë që promovon zhvillimin profesional.

2.8. Integrimi ndërmjet arsimimit dhe stërvitjes

2.8.1. Natyra komplekse dhe dinamike e operacioneve ushtarake moderne i bën ato ndër veprimtaritë më të kërkuara dhe, njëherësh, më stresuese për njeriun. Vetëm nëpërmjet arsimimit të plotë dhe stërvitjes rigoroze për aftësimin individual, arrihen këto kërkesa. I gjithë personeli i Forcave të Armatosura duhet të jetë plotësisht i integruar në një program të vazhdueshëm arsimimi dhe stërvitjeje, me qëllim marrjen dhe ruajtjen e aftësive të punës, të kualifikimeve profesionale të shtuara, të gjykimit, por edhe përgatitjen e oficerëve dhe nënoficerëve për problemet mbikëqyrëse dhe ato drejtuese.

2.8.2 Arsimimi i përgatit Forcat e Armatosura dhe pjesëtarët e saj për rolet e planifikimit dhe të drejtimit dhe i bën ata me të përgjegjshëm për mjediset e sigurisë dhe luftimit në të cilat ata veprojnë, ndërsa stërvitja reale dhe praktike u jep aftësi të vazhdueshme profesionale për të gjitha rangjet, në të gjitha nivelet e komandimit. Arsimimi i bazuar, integruar dhe zbatuar me efektivitet, i shpreh ashtu siç duhet aftësitë e personelit ushtarak dhe i motivojnë ata për të arritur potencialin maksimal. Arsimimi dhe Stërvitja kombinohen për të formuar një Forcë të Armatosur shume efikase, që i siguron aleatët dhe kundërshtarët në mënyrë të barabartë që Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë të përgatitura për sukses. Për të arritur këto përfundime, programet arsimore dhe stërvitore të vendosen për të mundësuar individët që të plotësojnë misionin e Forcave të Armatosura.

2.8.3 Procesi i arsimimit dhe stërvitjes të fillojë që në programet fillestare. Ky proces, duke filluar me aftësitë bazë stërvitore dhe më vonë duke kaluar në stërvitje të shkallës së madhe të bashkuar dhe shumëkombëshe, është një vazhdimësi që ndjek ushtarin dhe detarin në të gjithë karrierën e tij/saj. Qëllimi përfundimtar i programeve arsimore dhe stërvitore është të zhvillojnë personel në Forcat e Armatosura të aftë për tu dislokuar kompetencat e tyre

bazë dhe të aplikojnë parime të bazuara dhe analizuara në situata jo të natyrshme. Thurja e hollësishme dhe e vështirë ndërmjet arsimimit dhe stërviçjes provon më tej personelin e Forcave të Armatosura dhe u jep atyre aftësitë për të përballuar kufizimet e natyrshme të stërviçjes në luftim në mjedisin e tanishëm.

2.8.4 Integrimi i programeve arsimore dhe stërviçore të Forcave të Armatosura është sa thelbësor aq dhe i kushtueshëm. Nevoja për të arsimuar dhe stërviçtur personelin e Forcave të Armatosura gjithmonë do të garojë me burime të limituara dhe kërkesa të tjera. Komandantët në të gjitha nivelet duhet të përpiqen të arrijnë një balancë të duhur për misionin, ndërmjet kërkesave të tjera dhe aftësive të marra nga arsimimi dhe stërviçja e personelit të tyre. Për të ndihmuar komandantin në këtë detyrë, ata që zhvillojnë e menaxhojnë programet institucionale të përdorin në mënyrën e duhur parimet e didaktikës, metodat dhe teknologjitë, të cilat bëjnë të mundur të arrihet niveli më i lartë i instruktimit me kosto minimale.

KREU III: PËRGATITJA PROFESIONALE DHE STËRVITJA

- 3.1. Zhvillimi profesional ushtarak
- 3.2. Metodologjia e zhvillimit profesional
- 3.3. Progresi në karrierën stërvitore në Forcat e Armatosura
- 3.4. Kategoritë dhe llojet e stërvitjeve
- 3.5. Llojet e ushtrimeve stërvitore
- 3.6. Nivelet e stërvitjes dhe të ushtrimeve stërvitore
- 3.7. Zhvillimi i drejtuesve

3.1. Zhvillimi profesional ushtarak

3.1.1. Zhvillimi profesional ushtarak është procesi sistematik, në të cilin qytetari shqiptar, që ka dëshirën apo detyrimin dhe përmbush kriteret, transformohet në ushtarak profesionist. Ky proces jep dhe integron njohuritë dhe aftësitë specifike për drejtimin dhe menaxhimin e Forcave të Armatosura në situata lufte dhe paqeje.

3.1.2. Njëpërmjet sistemeve të arsimimit dhe stërvitjes, Forcat e Armatosura u japin njësive të tyre profesionistë ushtarakë dhe drejtues të stërvitur, shumë të përshtatshëm, të gatshëm për të kryer misionet e tyre bazë operacionale dhe funksionale të kohës së luftës. Një sistem arsimor dhe stërvitor i mirë fokusuar dhe i organizuar “rrit” profesionistë ushtarakë për më tepër sukses në fushëbetejë. Ky sistem, gjithashtu, i përgatit profesionistët ushtarakë për detyra më komplekse dhe pozicione përgjegjësie gjithnjë e më të mëdha.

3.1.3. Zhvillimi profesional u jep njësive kompakte individë të kualifikuar, të cilët mund të përmbushin detyrat e caktuara. Akumulimi i eksperiencës gjatë kohës së shpenzuar në shërbim siguron që procesi, nga perspektiva e individit, të mos ndalet kurrë dhe gradualisht të rritet njëpërmjet përmbushjes së stërvitjes, arsimimit dhe eksperiencës në shërbim. Për këtë arsye zhvillimi profesional realizohet njëpërmjet një kombinimi të katër përbërësve të ndërlidhur:

3.1.3.1. Eksperiencat e fituara njëpërmjet stërvitjeve operacionale dhe detyrave të shtabit.

3.1.3.2. Arsimimi dhe stërvitja institucionale. Arsimimi dhe stërvitja institucionale në mënyrë primare përfshin bazat, qendrat stërvitore dhe shkollat, të cilat realizojnë stërvitjen fillestare dhe arsimimin e mëtejshëm profesional për oficerët dhe drejtuesit profesionistë.

3.1.3.3. Vetëzhvillimi.

3.1.3.4. Këshillimi i profesionistëve ushtarakë nga oficerët dhe nënoficerët me më shumë eksperiencë. Këshillimi është në thelb një instruksion informal kokë - më - kokë, dhe/ose i quajtur ndryshe ndihmë për zhvillimin profesional.

3.1.4. Zhvillimi profesional për oficerët, nënoficerët, ushtarët dhe detarët është një proces i qëllimshëm, i vazhdueshëm, i ndarë në faza dhe progresiv. Është proces, nëpërmjet të cilit ushtarët dhe detarët shndërrohen në profesionistë ushtarakë kompetentë dhe në drejtues të aftë për të kryer operacionet ushtarake, për të drejtuar ekipe dhe organizata në zbatimin e veprimeve vendimtare dhe në kohë. Zhvillimi profesional arrihet nëpërmjet sintezës së vazhdueshme të njohurive, aftësive dhe eksperiencës së fituar nëpërmjet trajnimit institucional dhe arsimimit, stërvitjes së organizuar, detyrave/eksperiencës operacionale, dhe vetëzhvillimit.

3.1.5. Më poshtë pasqyrohet progresi që kërkohet nga Qytetari Shqiptar për t'u transformuar nga një rekrut i thjeshtë apo kadet, në profesionist ushtarak bazë:

3.1.5.1. Individit të përmbushë të gjitha kërkesat e përgjithshme të pranimit fillestar apo të trajnimit akademik. (Aftësitë me Bazë të Përbashkët)

3.1.5.2. Individit të përmbushë të gjitha kërkesat specifike të Forcave të Armatosura (Aftësitë e Përgjithshme Ushtarake).

3.1.5.3. Individit të përmbushë të gjitha kërkesat unike të shërbimit të specifikuar (tokë, ajër apo det; “specialitetin e përgjithshëm, aftësitë speciale dhe kualifikimet speciale”).

3.1.6. Kërkesat bazë të mësipërme përshkruajnë aftësitë dhe njohuritë e dhëna të të gjithë personelit të Forcave të Armatosura. Kur individit ushtarak përfundon këto kërkesa, ai/ajo do të jetë një ushtarak profesionist, i aftë të kontribuojë në zhvillimet e FA dhe të forcës/njesisë përkatëse, ku bën pjesë.

3.1.7. Aftësitë e përgjithshme ushtarake të kërkuara përshkruajnë kërkesat e të gjithë personelit të FA, ndërsa kërkesat specifike të forcës u aplikohen atyre aftësive të nevojshme që duhet të kenë individë të caktuar në atë forcë. Specifikat e specialiteteve përshkruajnë kërkesat e profesionit individual apo të “specialitetit të përgjithshëm” që përshkruhet (p.sh., këmbësori, nënoficer i marinës apo i forcave ajrore). Ka gjithashtu aftësi dhe “kualifikime speciale”, që janë të nën vendosura në specialitetin e përgjithshëm. Për shembull, një këmbësor i nivelit bazë mund t'i mësojë aftësitë e kërkuara nga një tjetër që përdor mortajën, një artiljer, apo një ushtar i zbulimit. Është e rëndësishme të mos harrohet që misionet e tanishme dhe të së ardhmes do të diktojnë se cilët “specialitete të përgjithshme” dhe “aftësi e kualifikime speciale” janë më të kërkuara brenda FA.

3.1.8. Natyra e profesionit ushtarak është e tillë që, aftësitë e pjesëmarrësve rriten të bazuara në rritjen e kërkesës dhe në përgjegjësinë më të madhe, të cilat vijnë më gradën më të lartë. Sistemet e zhvillimit profesional përcaktohen nga nevoja për të arritur zhvillimin uniform dhe progresiv të të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve. Sistemi profesional i zhvillimit siguron që oficerët, nënoficerët dhe ushtarët profesionistë janë të stërvitur, të edukuar dhe të përgatitur për t'u bërë drejtues të suksesshëm.

3.1.8.1. Oficerët. Oficerët janë grupimi më esencial për Forcat e Armatosura. Oficerët komandojnë njësi, hartojnë rregulloret dhe menaxhojnë burimet, duke balancuar rreziqet dhe duke u kujdesur për njerëzit në varësi të tyre. Atyre u kërkohet të plotësojnë një sërë detyrash dhe të mbështesin një spektër të gjerë misionesh gjatë gjithë karrierës së tyre. Edhe pse oficerët dhe nënoficerët janë drejtues, vetëm oficerëve u janë besuar privilegji, përgjegjësia dhe autoriteti i komandimit. Si të tillë, oficerët duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe të përshtatshëm faktikisht dhe ekspertë teknike, drejtues luftimi, stërvitës, ekspertë të shtabit dhe këshilltarë. Drejtimi i varfër nga oficerët komandues është një produkt i keq për përfundimin e misionit dhe për programin e zhvillimit të drejtuesve. Në këtë rast i hiqet mundësia për të shërbyer në Forcat e Armatosura Shqiptare.

3.1.8.2. Nënoficerët. Nënoficerët drejtojnë ushtarët dhe marinarët në operacionet e përditshme të Forcave të Armatosura. Ushtarët mbështeten tek nënoficerët dhe oficerët e tyre për përgjigje, për zgjidhje, për drejtim dhe për inspirim. Ushtarët mund t'i kuptojnë nënoficerët, duke qene së nënoficerët promovohen nga vetë ata. Ata presin të marrin prej oficerëve informacion të rëndësishëm dhe t'u japin atyre udhëzime të përditshme, që nevojiten për kryerjen e detyrës.

3.1.8.3. Ushtari profesionist. Ushtarët profesionistë shikojnë tek nënoficerët dhe oficerët njerëzit që drejtojnë dhe japin udhëzime. Është shumë e rëndësishme që këta ushtarë dhe detarë të marrin drejtim të mirë, sepse shumica syresh do të bëhen drejtuesit e njërive të vogla në të ardhmen.

3.1.8.4. Një Forcë profesioniste për të Ardhmen. Forcat e Armatosura kanë nevojë për drejtues të njërive të vogla, që të jenë profesionistë dhe të aftë të veprojnë në zona shumë larg njëra - tjetrës, në mjedise të ndryshme dhe të integruara në forca operacionale të bashkuara, shumëkombëshe dhe të integruara, si edhe me forcat e operacioneve speciale dhe organizatat joqeveritare. Këta drejtues dhe ushtarë profesionistë duhet të jenë më karakter të fortë moral, të jenë të vetëdijshtëm dhe të përshtatshëm, të qetë në situata të pasigurta, të aftë të presin urdhra të dytë e të tretë, që rrjedhin nga veprimet e tyre, të dedikuar në profesionin e ushtarakut dhe shumë funksional për të përdorur armët e kombinuara.

3.2. Metodologjia e zhvillimit profesional

3.2.1. Zhvillimi profesional është proces i vazhdueshëm, i cili u jep oficerëve nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë të të gjitha niveleve mundësinë për t'u përgatitur që të japin maksimumin në të gjitha nivelet e karrierës ushtarake. Procesi merr në konsideratë që, së pari, drejtuesit ushtarakë dhe profesionistët janë ushtarë dhe marinarë, që të jenë teknikisht dhe taktikisht të aftë në kompetencat e tyre bazë, të jenë të përshtatshëm për ndryshimin. Mbyllja e ndryshimit ndërmjet stërvitjes reale dhe operacionale apo performancës së fushëbetëjës është e vështirë.

3.2.2. Në një kohë të kërkesave të shumanshme të sigurisë kombëtare, përgjegjësitë strategjike të Forcave të Armatosura përmbledhin një spektër më të gjerë misionesh që prezantojnë vështirësi më të mëdha për Forcat e Armatosura. Këta operacione më spektër të plotë përfshijnë të gjitha llojet e trupave, shumëkombëshe, të bashkuara dhe në kuadër të NATO-s. Zhvillimi profesional dhe stërvitja përqendrohen në krijimin e njësive relevante, të gatshme dhe të mirë stërvitura, të drejtuara nga drejtues kompetentë, me besim dhe karakter. Koncepti pranon një ndërveprim të rëndësishëm që i stërvit ushtarët dhe marinarët tani dhe zhvillon drejtuesit dhe profesionistët ushtarakë për të ardhmen.

3.2.3. *Fushat e zhvillimit profesional.* Ka katër fusha të Zhvillimit Profesional, të cilat japin eksperiencën kritike të mësimit nëpërmjet karrierës së ushtarëve dhe drejtuesve. Ato janë: (1) Arsimimi dhe stërvitja institucionale. (2) Stërvitja, arsimimi dhe eksperiencia në punë, e fituar gjatë detyrave operacionale dhe të shtabit. (3) Vetëzhvillimi (4) Këshillimi. Këto katër fusha ndërlidhen duke përdorur informacionin e marrë dhe vlerësimet nëpërmjet burimeve dhe metodave të ndryshme. Qëllimi përfundimtar i zhvillimit profesional në të katër zonat është formimi i drejtuesve kompetentë dhe i ushtarëve profesionistë. Këta drejtues dhe ushtarë profesionistë do të japin shumë qartë qëllimin, drejtimin, motivimin dhe një vizion për vartësit e tyre ndërsa ekzekutojnë misionet funksionale të kohës së luftës dhe operacionet e kohës së paqes.

3.2.3.1. *Arsimimi dhe Stërvitja Institucionale.* Stërvitja institucionale dhe arsimimi mbështeten në aftësi, eksperiencia dhe ekspertizë, që drejtuesit e fitojnë në shkollat formale, si në Shkollën e Trupës, Universitetin Ushtarak, Akademinë e Nënoficerëve, Akademinë e Mbrojtjes dhe kurset e mbrojtjes apo ato ushtarake, të kryera në vendet partnere dhe ato të NATO-s. Gjatë stërvitjes dhe arsimimit institucional, drejtuesit dhe ushtarët profesionistë marrin njohuri të qëndrueshme dhe stërviten për të kryer detyra kritike ndërsa mësojnë vlerat, karakterin, aftësitë dhe veprimet thelbësore për drejtimin me cilësi të lartë dhe profesionalizëm. Kur të njëjtat dimensione të drejtimit testohen, aplikohen dhe përforcohen, forcohen nga kërkesat operacionale në vazhdimësi dhe programet e mira të vetëzhvillimit, drejtuesit fitojnë dhe ruajnë kompetencën e vërtetë në profesionin e tyre.

Stërvitja dhe arsimimi profesional gjithashtu jep bazën solide, mbi të cilën mbështetet i gjithë zhvillimi profesional i së ardhmes. Ai realizon një arsimim dhe stërvitje progresive dhe me faza, të kërkuar për zhvillimin e kompetencës taktike dhe teknike, si edhe dimensionet qendrore të udhëheqjes. Format i ideal për procesin e zhvillimit të drejtuesve brenda arsimimit dhe trajnimit institucional është në grupin e vogël, ku theksi vihet në pjesëmarrjen e studentit dhe kontributin e procesit mësimor. Ushtrimet taktike, operacionale dhe strategjike, seminarët e lidhshëm dhe ushtrimet e planifikimit të shtabit për momentet e krizave, janë disa shembuj të arsimimit dhe stërvitjes efektive të grupeve të vogla.

3.2.3.2. Stërviija, arsimimi dhe eksperiencia e punës së fituar gjatë detyrave operacionale dhe të shtabit. Mbas përfundimit të trajnimit institucional, ushtarakët profesionistë të caktohen menjëherë në pozicione operacionale në njësi dhe organizma (struktura) ushtarake. Kjo eksperiencë operacionale u jep drejtuesve mundësinë për të përdorur, përmirësuar dhe ndërtuar mbi atë çka ata kanë mësuar nëpërmjet procesit formal të arsimimit.

Eksperiencia e fituar nëpërmjet trajnimit në punë, në një varietet detyrash të rëndësishme dhe detyra të tjera, i përgatit nënoficerët dhe oficerët për të udhëhequr dhe stërvitur ushtarët, si në fushim edhe në repart. Drejtuesit madhorë e prezantojnë oficerin, nënoficerin dhe ushtarin profesionist tek njësia e tyre dhe vendosin për zhvillimin e drejtuesit dhe programet e zhvillimit profesional; ata u shpjegojnë, si njësisë ashtu edhe individit, standardet e domosdoshme; shpjegojnë si standardet individuale dhe të njësisë dhe përfundimisht japin vlerësime periodike dhe informacion për të zhvilluar, si oficerin ashtu dhe nënoficerin.

3.2.3.3. *Vetëzhvillimi.* Ushtarakët profesionistë të çdo lloj rangu të përpiqen që të vazhdojnë zhvillimin e tyre profesional gjatë gjithë karrierës së tyre. Drejtuesit madhorë të Forcave të Armatosura e realizojnë këtë nëpërmjet stërvitjes dhe arsimimit institucional, si edhe nëpërmjet detyrave operacionale, të cilat të vetme nuk mund të sigurojnë që drejtuesit dhe profesionistët ushtarakë do të marrin gradën e duhur sipas hierarkisë për të kryer misionet e tyre të ndryshme.

Në program, vetëzhvillimi i planifikuar me kujdes, kërkues dhe i disiplinuar, lidh hapësirën institucionale me detyrën operacionale nëpërmjet zhvillimit profesional të drejtuesve. Vetëzhvillimi është urë lidhëse ndërmjet arsimimit/trajnimit institucional dhe operacionalitetit për të qenë kontribues i mirë në rritjen profesionale.

Vetëzhvillimi përcaktohet si një program progresiv, me faza, i planifikuar dhe i ndjekur nga ushtarakët profesionistë për të përmirësuar dhe mbështetur kompetencat e tyre ushtarake. Vetëzhvillimi përbëhet nga studimi individual, kërkimi, leximi profesional, praktika dhe vetëvlerësimi.

Vetëzhvillimi përmbushet në mënyra të ndryshme (p.sh., studimi, vëzhgimi dhe eksperiencia), të gjitha përmbahen nga plani vetjak i një profesionisti ushtarak për vetëzhvillim dhe qëllimet e tij të profesionalizmit. Vetëzhvillimi është çelësi i kualifikimit të ushtarit profesionist, nënoficerit dhe oficerit, i cili përforcon procesin e zhvillimit profesional.

3.2.3.4. *Këshillimi.* Këshillimi është anë e rëndësishme e zhvillimit profesional. Këshillimi i mundëson drejtuesit të kalojnë nëpërmjet mësimeve të vështira të mësuar gjatë operacioneve në Bosnjë, Irak dhe Afganistan.

Këshillimi është vullnetar, një marrëdhënie e zhvilluar që ekziston ndërmjet një drejtuesi me më shumë eksperiencë dhe një personi me më pak eksperiencë, që karakterizohet nga besimi dhe respekti i dyanshëm. Këshillimi ofron mjaft

mundësi për të përmirësuar drejtimin e përgjithshëm, ndër personal dhe aftësitë teknike, si edhe të arrijë objektivat profesionale të karrierës.

Komandanti apo drejtuesi i njësisë luan një rol shumë të rëndësishëm në këshillimin. Veçanërisht komandantët dhe drejtuesit e tjerë madhorë janë të përgjegjshëm për këshillimin e oficerëve dhe të nënoficerëve vartës dhe në një shkallë më të ulët për ushtarët profesionistë, nëpërmjet shembullit të tyre personal.

Sistemi i zhvillimit profesional, gjithashtu, kërkon ndërtimin e komponentëve të tjerë kyç. Sistemi i zhvillimit profesional për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët profesionistë përfshin rregullat kyçe, të cilat përshkruajnë sesi një individ përparon në periudha të caktuara. Rregulloret e zhvillimit përmbajnë kërkesat e përgjithshme për menaxhimin e karrierës, fizike dhe kushtet shëndetësore të shërbimit, por edhe të detyrave specifike. Rregulloret e zhvillimit profesional përcaktohen nga Ministri i Mbrojtjes me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Përparimi në karrierë bëhet nëpërmjet periudhave të zhvillimit dhe përcaktohet nga grada. Në këtë mënyrë, arsimimi dhe stërvitja institucionale, stërvitja, arsimimi dhe eksperiencën në punë, të fituara gjatë detyrave operacionale apo në shtab kërkesat për vetëzhvillim dhe këshillimi, janë të gjitha të përcaktuara shumë qartë gjatë zhvillimit profesional. Sistemi i zhvillimit profesional siguron që kompetencat profesionale të mbeten në përputhje me kërkesat e gradës së individit.

3.2.4. Ka pesë periudha të zhvillimit profesional për forcat aktive, për oficerët dhe nënoficerët. Çdo periudhë përfshin kërkesa të përbashkëta dhe specifike, të cilat shumë qartë përcaktojnë stërvitjen dhe arsimin institucional; stërvitjen, arsimimin dhe eksperiencën në punë, të fituara gjatë detyrave të shtabit dhe operacionale; kërkesat për vetëzhvillim dhe kërkesat për këshillim, të cilat duhet të arrihen nga individ, oficer apo nënoficer. Stërvitja dhe arsimimi institucional stërvitja, arsimimi dhe eksperiencën e punës, të fituara gjatë detyrave operacionale apo në shtab, kërkesat për vetëzhvillim dhe këshillimi realizohen në mënyrë progresive. Jo të gjithë individët do të vazhdojnë në mënyrë të suksesshme në të gjitha periudhat, por edhe kështu, mundësitë për zhvillimin profesional do të vazhdojnë të jepen gjatë periudhave specifike të zhvillimit.

3.2.3.8.2. Periudhat e zhvillimit profesional.

Për oficerin:

- Kursi Bazë i Oficerit (KBO) K2
- Kursi i Avancuar i Oficerit (KAO) K3
- Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH) K4
- Kursi i Oficerit të Shtabit (KOSH) K5
- Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) K6

Për nënoficerin:

- Kursi Fillestar i Nënoficerit (KFNO) L3
- Kursi Bazë i Nënoficerit (KBNO) L4
- Kursi i Avancuar i Nënoficerit (KANO) L5
- Kursi i Lartë i Nënoficerit të Shtabit (KLNOSH) L6
- Kursi i Kryekapterit (KKNO) L7

3.2.3.10. Roli i ushtarakëve profesionistë si drejtues. Ushtarakët profesionistë duhet të zotërojnë kompetencë taktike dhe besim në moralin dhe drejtimin ushtarak. Pa zotërimin e plotë të këtyre cilësive oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e FA nuk do të jenë në gjendje të arrijnë qëllimet e tyre në përpjekjet e së ardhmes.

Zhvillimi profesional ushtarak krijon një Forcë të Armatosur Profesioniste, të plotësuar më drejtues efektivë dhe ushtarë profesionistë. Drejtuesit zhvillohen në rolet apo në marrjen e tyre apo të përgjegjësisë së caktuar për të inspiruar, mundësuar dhe ndikuar tek të tjerët, brenda Forcave të Armatosura dhe për të plotësuar qëllimet Organizative. Zhvillimi profesional formon drejtues të Forcave të Armatosura, të cilët motivojnë njerëzit, si brenda edhe jashtë zinxhirit të komandimit për të ndjekur veprimet. Si rezultat, profesionistët ushtarakë, të të gjitha gradave dhe pozicioneve të fuqizohen në plotësimin e misioneve, arrijnë e rezultateve, të qëllimeve dhe objektivave më shpejt dhe në një nivel më të lartë cilësor, duke justifikuar besimin që u është dhënë Forcave të Armatosura nga Populli Shqiptar.

3.3. Progresi në karrierën stërvitore në FA

3.3.1. Siç është theksuar më lart, procesi i zhvillimit profesional për Forcat e Armatosura Profesioniste rezulton në ushtarakë, të cilët kuptojnë dhe përmbushin normat dhe moralin e ushtrisë dhe që respektojnë edhe etikën civile. Ushtari profesionist kalon një stërvitje shumë stresuese mendore dhe fizike për të arritur performancën e lartë profesionale të detyrave të tyre dhe të kultivimit të dëshirës për sakrificë dhe përballimit të vështirësive në të gjithë misionet ushtarake, luftarake apo jo luftarake.

3.3.2. Zhvillimi profesional i një ushtari kalon nëpërmjet tre periudhave të mëdha stërvitore: (1) Stërvitja Bazë (SB); (2) Stërvitja Individuale e Avancuar (SIA); (3) Stërvitja në njësi.

Ky zhvillim i jep individit aftësitë, njohuritë dhe kompetencat në detyrat bazë për t'u bërë ushtar dhe pastaj në arritjen e suksesit, si një pjesëtar i grupeve të vogla dhe deri në kontributin për plotësimin e misionit të njësisë. Ky progresion në të tri fazat e stërvitjes është themeli i zhvillimit për të gjithë rekrutët në FA. Ky proces lehtëson transformimin e individit nga civil në pjesëtar të FA dhe i jep atij forcën shtytëse për t'u bërë një pjesëtar i motivuar dhe produktiv i FA, që të jete një ushtar i kualifikuar me njohuritë bazë të luftimit. Zhvillimi profesional dhe stërvitja ndërtojnë një bazë njohurish për FA në shoqërinë

demokratike, frymëzojnë karakterin luftarak të FA dhe mbjellin një respekt jetëgjatë për vlerat e besimit, detyrës, respektit, shërbimit vetëmohues, nderit, vendosmërisë, integritetit dhe kurajës morale.

3.3.2.1. Stërvitja Bazë (SB). Stërvitja Bazë është ajo stërvitje fillestare e personelit ushtarak për të gjitha strukturat e FA, e cila ka si mision të parë fillimin e ndryshimit të kadetëve dhe rekrutëve nga qytetarë civilë në personel ushtarak të disiplinuar, të motivuar dhe të aftë fizikisht e që besojnë e mbështesin të gjitha veprimet e tyre ditore në bazë të vlerave më të mira të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3.3.2.2. Stërvitja Individuale e Avancuar (SIA). Stërvitja Individuale e Avancuar kryhet nga personel i përcaktuar në mënyrë specifike në kursin e stërvitjes bazë, në vartësi të sistemit të armës, dhe/ose specialitetit, në të cilin do të shërbejë individi. Misioni i kësaj periudhe është stërvitja e ushtarëve në specialitetin e ngushtë ushtarak dhe zhvillimi i tyre në marrjen e pozicionit të përcaktuar në njësitë apo repartet e FA.

3.3.2.3. Stërvitja në njësi. Mbas përfundimit të stërvitjes individuale të avancuar ushtarët fillojnë stërvitjen në njësi. Stërvitja në njësi është faza më komplekse e zhvillimit profesional të stërvitjes, sepse kjo stërvitje duhet: (1) të integrojë dhe përfshijë stërvitjen për luftim dhe jo luftim individual, (2) të japë mundësitë e duhura për stërvitjen kolektive për të siguruar kohezionin e njësisë dhe (3) të realizojë stërvitje specifike të fokusuar nga misioni dhe mundësi për stërvitje mbështetëse, që të sigurohet së njësia do të ketë sukses në misionet e luftimit dhe ato jo luftarake.

3.3.3. *Stërvitja e ushtarit profesionist.* Stërvitja e ushtarit profesionist të sigurojë rritjen e aftësive profesionale të kërkuara për të operuar në të gjithë spektrin e operacioneve ushtarake, në nivel grupi, skuadre, toge dhe kompanie. Programi për zhvillimin e ushtarit profesionist realizohet pas plotësimit me sukses të stërvitjes bazë.

3.3.3.2. Komandat kryesore, për stërvitjen e këtyre ushtarëve bazë, hartojnë programe stërvitore afatshkurtër (njëvjeçar). Stërvitja të kryhet në tri periudha të veçanta, për të siguruar në këtë mënyrë një menaxhim më të mirë të kohës, përdorim më efikas të burimeve dhe poligoneve stërvitore dhe një planifikim më efektiv për koordinimin e stërvitjes së ushtarit profesionist me objektivat stërvitore të njësisë.

3.3.3.3. Në periudhën e stërvitjes individuale (SIA) Qëllimi është mësimi gradual i aftësive teknike nga ushtari profesionist deri sa ky të mund të realizojë këto aftësi teknike në mbështetje të detyrave themelore të misionit të njësisë. Përparësi është zhvillimi i çdo ushtari në pozicione të ndryshme dhe i aftësive gjatë zbatimit të detyrave të tyre bazë në njësi.

3.3.3.4. *Stërvitja Kolektive (skuadër dhe togë).* Në periudhën e stërvitjes kolektive të skuadrës dhe togës qëllimi arrihet në tri faza “ndërtuese”: (1) Rritja e mëtejshme e aftësive të ushtarit profesionist në specialitetin e tij specifik ushtarak; (2) zhvillimi i veprimeve të njësuara në lëvizjet e skuadrës; (3)

zhvillimi i veprimeve kompakte të togës në plotësimin e detyrave themelore të misionit të saj. Procesi i stërvitjes kolektive të sigurojë integrimin e qëllimit ushtarak më funksionet specifike të organizmit ushtarak. Përparësi është zhvillimi i njësitit brenda njësisë, skuadrës apo togës mes ushtarëve në kryerjen e aftësive të tyre të ndryshme ushtarake gjatë ekzekutimit të misionit të njësisë, detyrave dhe funksioneve.

Kjo periudhë stërvitore me ushtarët profesionistë të përfundojë me një ushtrim fushor kompleks të fokusuar nga misioni, ku individi dhe veprimet kolektive të ushtarëve profesionistë të vlerësohen brenda standardeve të performancës së pranuar të misionit të skuadrës dhe togës.

3.3.3.5. Stërvitja kolektive (kompani dhe batalion). Në periudhën e stërvitjes kolektive të kompanisë dhe batalionit qëllimi është rritja e mëtejshme e aftësive të ushtarëve profesionistë në specialitetin e tyre përkatës ushtarak dhe në zhvillimin e njësitit të kompanisë/batalionit në plotësimin e detyrave themelore të misionit.

Kjo periudhë stërvitore me ushtarët profesionistë të përmbillet me një ushtrim kompleks në fushim dhe të fokusuar nga misioni në kushte reale, ku individi dhe veprimet kolektive të ushtarëve profesionistë të vlerësohen dhe gjykohen brenda standardeve të performancës së pranuar të kompanisë dhe batalionit.

3.3.3.6. Temat speciale ushtarake. Për subjekte specifike ushtarake si: Gjeografia Ushtarake (leximi i hartave), orientimi në terren, Mbrojtja nga ADM, stërvitja xheniere, stërvitja mjekësore (shpëtimi i jetës në betejë apo ndihma e shpejtë), stërvitja e komunikimit, menaxhimi i emergjencave civile, etj., të zhvillohen programe 2-3 javore, në vartësi të specialitetit të repartit apo njësisë. Këto lëndë speciale ushtarake të kryhen gjatë së njëjtës periudhë kohore njëvjeçare.

3. 4. Kategoritë dhe llojet e stërvitjeve

3.4.1. Dy kategoritë e stërvitjes janë stërvitja individuale (e cila përfshin Stërvitjen Bazë [SB] dhe Stërvitje Individuale e Avancuar [SIA]) dhe stërvitja kolektive.

3.4.1.1. Stërvitja Individuale është stërvitja që përgatit çdo oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist për plotësimin e rolit të tij/saj në mision, operacion, detyrë apo funksion, si pjesë e një grupi apo skuadre. Qëllimi i stërvitjes individuale është të përgatisë ushtarët dhe drejtuesit me besim në vetvete, të cilët janë të disiplinuar, të aftë fizikisht, shumë mirë të motivuar dhe që zotërojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përmbushur detyrat e tyre edhe pa mbikëqyrje të drejt për drejte.

3.4.1.2 Stërvitja kolektive përgatit ushtarët të operojnë më aftësi brenda kërkesave të misionit luftarak apo jo luftarak dhe kjo stërvitje siguron që ata të jenë mjaft të përgatitur për të përmbushur misionet e luftimit dhe ato në mbështetje të paqes, pavarësisht nga kushtet. Stërvitja kolektive kryhet në

përputhje më doktrinën e FA dhe taktikën e miratuar, teknikën dhe procedurat.

3.4.1.3. Të dyja kategoritë stërvitore janë të vazhdueshme dhe kanë si qëllim të praktikojnë dhe të ngrenë në nivele më të larta aftësitë e fituara në stërvitjen individuale dhe kolektive, por të parashikojnë edhe humbjen e këtyre aftësive.

3.4.2. Brenda këtyre dy kategorive kryesore stërvitore ka dhjetë lloje të dallueshme të stërvitjes. Secila prej tyre kontribuon në zhvillimin profesional të ushtrisë dhe në aftësitë operacionale të njësisë.

3.4.2.1 Stërvitja për të arritur standardet kualifikuese. Stërvitja për të arritur standardet kualifikuese është elementi kryesor i sistemit të stërvitjes individuale. Qëllimi i saj është të sigurojë që ushtarët dhe drejtuesit që stërviten të jenë plotësisht të aftë dhe të arrijnë standardet e vendosura të FA. Plotësimi i trupës më individë të aftë, të kualifikuar në standarde profesionale, është thelbësore për të pasur njësi plotësisht të afta për betejë dhe të gatshëm për të plotësuar standardet e kërkuara të performancës së misionit. Stërvitja për standardet kualifikuese prodhon aftësi, njohuri dhe shprehje të reja për individët, duke siguruar kualifikimet e kërkuara.

Stërvitja për standardet kualifikuese përfshin kurset e stërvitjes bazë për drejtuesit dhe komandantët në FA. Kjo stërvitje është pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit profesional dhe është e lidhur drejt për së drejti me përparimin nga një periudhë zhvillimi në tjetrën. Oficerët komandues kanë përgjegjësinë të drejtojnë vartësit, në mënyrë të tillë që ata të jenë të përgatitur në stërvitjen për standardet kualifikuese dhe që ata të bëhen të aftë në këtë lloj stërvitje. Kur kjo stërvitje të ketë përfunduar, individët kanë çdo mundësi të plotësojnë një detyrë tjetër, ku ata të përdorin aftësitë dhe njohuritë e reja të fituara.

3.4.2.2. Stërvitja për zhvillimin e personelit në njësi. Stërvitja dhe arsimimi profesional kanë dy aspekte: institucional dhe funksional. Trajnimi institucional dhe arsimor japin zhvillimin intelektual për zgjidhjen e problemeve të dhëna dhe vendimmarrjen. Ndërkohë, zhvillimi funksional përfshin stërvitjen për standardet kualifikuese për drejtim dhe karrierë, gjithashtu është dhe kërkesë për stërvitjen brenda njësisë që kryhet për zhvillimin e ushtarëve e të drejtuesve.

Një shembull për zhvillimin e personelit është stërvitja e komandës dhe e shtabit në procesin operacional të vendimmarrjes. Kjo stërvitje kryhet për të përgatitur komandantët dhe shtabet, për t'i aftësuar ata që të drejtojnë në mënyrë të suksesshme operacionet dhe në të gjitha kushtet. Stërvitja e komandës dhe e shtabit përbëhet nga komponentët kyç të stërvitjes individuale dhe asaj kolektive.

Stërvitja individuale e komandës dhe e shtabit. Për individët, komandën dhe shtabin stërvitja siguron aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u sjellë në situata të ndryshme, me të cilat komanda dhe shtabi përballen në kryerjen e funksioneve të tyre. Gjithashtu, ajo edukon individët më kulturën e

komandimit, siç është e stërvitur me stërvitjen për standardet kualifikuese dhe stërvitjen kolektive për detyrat e fushëbetejës.

Stërvitja kolektive e komandës dhe e shtabit. Veprimtaritë në komandën kolektive dhe stërvitja e shtabit synojnë rritjen në aftësitë vendimmarrëse. Kjo stërvitje përfshin çdo pjesëtar të shtabit për të siguruar që ata të jenë plotësisht të kualifikuar për pozicionin që do të zenë në shtab.

Forma të tjera të stërvitjes për zhvillimin e personelit në njësi përfshijnë mësimet e aktualitetit në rrafshin moral, marrëdhëniet me komunitetin, përdorimin e medias dhe të historisë ushtarake. Për realizimin në maksimum të këtyre mësimëve drejtuesit mund të organizojnë vizita informuese në fushëbetejat që studiohen, ushtrime stërvitore taktike pa trupën dhe ditë studimi, në mënyrë që të stimulohet interesi profesional tek pjesëmarrësit, për të rritur në këtë mënyrë kuptimin real të luftës dhe për të zgjeruar horizontin e tyre ushtarak.

Stërvitja e zhvillimit të personelit në njësi ka si qëllim të përgatisë drejtuesit, të cilët, nëpërmjet shembullit të tyre moral dhe personal, ndikojnë dhe frymëzojnë vartësit e tyre për të bërë përpjekje maksimale në plotësimin e detyrave komplekse dhe shpesh të rrezikshme në fushëbetejë. Një stërvitje e ngjashme fokusohet në zhvillimin dhe rritjen e cilësive, të etikës dhe karakterit, të cilat së bashku më entuziazmin ushtarak sigurojnë drejtues të besueshëm. Përzgjedhja e kandidateve të duhur për këtë lloj stërvitje është një përgjegjësi thelbësore e komandës.

3.4.2.3. Stërvitja për vetëzhvillim. Komandantët kanë përgjegjësinë për zhvillimin e vartësve të tyre. Ata duhet të sigurojnë kushtet e nevojshme edhe për vetëzhvillimin e tyre. Ky zhvillim është pjesë e arsimimit në kurset akademike por përfshin edhe pjesëmarrjen në stërvitjen dhe arsimimin së bashku me ushtritë e vendeve të tjera.

Kjo pjesë e zhvillimit profesional synon të stimulojë rritjen intelektuale, por edhe forcimin e karakterit. Mund të menaxhohet më mirë nga individët nën mbikëqyrjen e komandantëve, por edhe kështu është e rëndësishme që ajo të mos harrohet. Vetëzhvillimi të përfshijë të gjithë oficerët dhe nënoficerët. Ata e ndajnë përgjegjësinë për zhvillimin e drejtuesve në çdo nivel.

Kur objektivat e vetëzhvillimit arrihen nga individët, njësia e kupton rëndësinë dhe vlerën e punës së këtyre individëve, duke u siguruar që aftësitë dhe njohuritë, tashmë të rritura të këtyre individëve, të mund të përdoren. Më në fund është e rëndësishme të kuptojmë se programet e vetëzhvillimit duhet të jenë të reflektojnë ndaj mjedis rrethues, duke përfshirë disa faktorë si për shembull Ligjin Shqiptar, rregulloren e mbrojtjes, burimet, strukturën e forcës, situatën rajonale e botërore, zhvillimin teknologjik dhe profesional.

3.4.2.4. Stërvitja për ruajtjen e aftësive fizike. Stërvitja për ruajtjen e aftësive fizike ka një përfitim të dyfishtë. Kjo stërvitje rrit aftësitë fizike dhe shëndetësore të individit, ndërkohë që rrit dhe krijon më shumë besim në aftësitë e ushtarëve dhe besimin në vetvete.

Zhvillimi fizik është një element i rëndësishëm i aftësive të individit për t'u përballur me pengesat fizike dhe mendore që prezanton fushë beteja. Personeli ushtarak i aftë fizikisht ka më shumë aftësi operacionale.

Stërvitja fizike është edhe një mjet i shkëlqyer për krijimin e njësive kompakte. Pjesëmarrja kolektive në zhvillimin fizik që është gjithnjë e më kërkues, si edhe plotësimi i standardeve të një niveli të lartë fizik nga e gjithë trupa, prodhon një ndjenjë të fortë identiteti me grupin. Komandantët të rritin kërkesat për arritjen e standardeve dhe të sigurojnë që stërvitja fizike të kryhet në mënyrë korrekte gjatë stërvitjes individuale dhe kolektive, për të përforcuar këto standarde.

3.4.2.5. Stërvitja për detyrat individuale të betejës. Detyrat individuale stërvitore përfshijnë ato veprimtari stërvitore që japin njohuri të mjaftueshme dhe aftësitë për të përmbushur detyrat, që gjithnjë kërkohen nga çdo ushtar për të kontribuar në përmbushjen e misionit dhe për të siguruar mbijetesën në fushëbetejë. Standardet që duhet të arrihen, përsëritja dhe ritmi i përsëritjes së tyre, burimet e kërkuara për ekzekutimin e detyrës të jenë në përputhje me objektivat e përcaktuar.

Kushtrimet e betejës janë shumë efektive në mësimin e detyrave individuale të betejës. Kushtrimet për betejë janë një grup aftësish që zbatohen dhe shfrytëzohen për t'ju mësuar individëve brenda njësisë të reagojnë dhe mbijetojnë sulmeve kimike, të evakujnë të plagosurit, të evakujnë personelin e plagosur nga një automjet. Kryerja e përsëritshme e kushtimeve për betejë forcon te ushtaraku besimin se ai do të kryejë me shpejtësi dhe ashtu siç duhet detyrën në një mjedis luftimi.

3.4.2.6. Stërvitja për detyrat kolektive të betejës. Stërvitja për të arritur standardet e detyrave kolektive të betejës është procesi që ndërton një grup, që ka aftësitë e duhura për të kryer detyrat individuale të betejës në një njësi kompakte. Stërvitje në standardet e detyrave të betejës përgatitin njësitë e disiplinuar, ato që kanë kuptim të përbashkët të një qëllimi më të madh. Detyrat e betejës dhe standardet duhet të arrihen për stërvitjen në mjedise të ndryshme, ku kushtet shpesh ndryshojnë dhe që mund të rafinohen me kalimin e kohës nga drejtuesit e stërvitjes.

3.4.2.8. Stërvitja në ushtrimet stërvitore. Ushtrimet stërvitore i vendosin ushtarët së bashku për të përballuar vështirësitë në mjedise të ndryshme, ku formimi i veprimeve të grupit është themelor dhe vetëbesimi, dituritë dhe aftësitë e individëve rriten. Me planifikim të kujdesshëm kjo lloj stërvitje mund të jete një mënyrë e shkëlqyer për të forcuar bashkimin e njësisë dhe rritjen e drejtuesve të këtyre niveleve.

Ushtrimet stërvitore ndihmojnë në mënyrë efektive zhvillimin e moralit të drejtuesve, ndërtimin e punës në ekip dhe zhvillimin e karakterit për t'u përballur në mjedise të ndryshme. Ushtrimet stërvitore kërkojnë nga individët që këta t'i përdorin aftësitë e fituara dhe mësimet e mësuara në kurset akademike që, nëpërmjet një përdorimi më të gjerë, t'u përgjigjen situatave të

paparashikuara në mjedise të paparashikuara. Komandantët të shikojnë çdo mundësi për të planifikuar dhe realizuar këtë lloj stërviitjeje.

3.4.2.9. Stërviitja për misionin specifik. Stërviitja për një mision specifik përfshin detyra të tilla si rregullat e mbijetesës, aftësitë në mjedise të caktuara dhe aftësitë jo luftuese si teknikat e negociatave dhe gjuha e huaj. Misioni dhe mjedisi, diktojnë specifikat e kësaj lloj stërviitjeje.

Stërviitja e ngjashme është normalisht e fokusuar në përshtatshmërinë, detyrat specifike shtesë për operacionin në fjalë (duke përfshire punën me organizatat joqeveritare) dhe familjarizimin kulturor, si edhe kuptimin e politikave dhe të kushteve sociale të vendit ku misioni në mbështetje të paqes po zhvillohet. Gjithashtu, përbëhet nga mbajtja në vëmendje e faktorëve të tillë si nxehtësia apo i ftohti ekstrem, faktori i lartësisë dhe që është zbatuar në stërviitje, në përputhje më kërkesat e manualeve.

Disa shembuj të stërviitjes për misionin specifik do të ishin një kompani që kryen një mision sigurie me një automjet tip autobлиндë apo një mision sigurie i një toge në një terren të urbanizuar. Stërviitja do të përbëhej nga ushtrime stërviitore të planifikuara e të paplanifikuara për t'i treguar njësisë aftësinë për t'u dislokuar ashtu siç duhet:

- Reagim ndaj kontaktit: (vizual, minë e improvizuar, zjarr i drejtpërdrejtë (ku të përfshihet sulmi me armë kundërtanke) dhe shkëputja e kontaktit.
- Reagim ndaj kurthit (afër dhe larg) dhe evakuimi i një të plagosuri (me dhe pa automjet).
- Reagim ndaj zjarrit indirekt dhe kryerja e thirrjes për mbulim me zjarr nga forcat tona në zjarrin indirekt.
- Vendosje e sigurisë së autokolonës, kur ajo është e ndaluar.
- Kryerja e operacioneve të postbllokut të sigurisë në hyrje të aerodromeve.

3.4.2.10. Shtërvitja në operacione. Shtërvitja në operacione është shumë e rëndësishme. Shtërvitja nuk ndalon edhe kur kanë filluar operacionet. Aftësitë individuale dhe kolektive humbasin, kështu që shtërvitja në operacione duhet të fokusohet gjithmonë në ruajtjen dhe rritjen aftësive. Shtërvitja në operacione parandalon mërzinë, rrit moralin dhe kohezionin e njësisë, si edhe efektivitetin operacional. Gjithashtu, në operacionet në mbështetje të paqes, shtërvitja e drejtuar nga pikëpamja e forcës ndërvepruese, veçanërisht shtërvitja më zjarr të vërtetë me përdorimin e plotë të të gjitha armeve të zjarrit, do të kenë një efekt pozitiv.

Shtërvitja të vendoset në bazë të qëllimit të komandantit epror, kohës operacionale në kohën e shtërvitjes dhe burimeve shtërvitore të mundshme. Për të ulur mundësinë e rënies së aftësive, simulimet duhet të përdoren sa më shpesh të jetë e mundur. Është përgjegjësia e komandantit të operacionit të vlerësojë se kur do të ndodhë një ulje në aftësitë dhe të zbatojë masa shtërvitore për të minimizuar rrezikun.

Shtërvitja për operacionet në mbështetje të popullatës. FA duhet të reagojnë gjithmonë në kërkesat për ndihmë nga autoritetet kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, edhe pse operacionet e këtij lloji nuk janë objektivi i tyre parësor. Drejtuesit në sistemin e FA duhet të planifikojnë shtërvitje të njëjtë dhe personeli duhet të shtërvitet për përfundimin e suksesshëm të këtyre operacioneve. Qëllimi dhe sasia e kësaj shtërvitjeje varet në shumicën e kohës nga realitetet e vendit, kjo lloj shtërvitje konsiderohet si shtërvitje me një mision specifik.

Operacione të ngjashme kërkojnë që komandantët e të gjitha niveleve të mbajnë kontakt të ngushtë me autoritetet civile (dhe përfaqësuesit e tjerë të administratës në bazë të kërkesave) dhe të koordinojnë planet për ruajtjen e marrëdhënieve të ngushta me komunitetin dhe operacionet ndihmëse.

3.5. Llojet e ushtrimeve shtërvitore për shtabet dhe komandat

3.5.1. Ushtrimet shtërvitore të komandës dhe të shtabit janë ushtrime të bashkuara që mbështesin integrimin e LDTHM në kërkesat shtërvitore të shtabit. Të përfshira në planifikim, ushtrimet shtërvitore formojnë tablonë për përdorimin e burimeve dhe të sigurimit të udhëzimeve shtërvitore të hershme për komandantët dhe shtabet vartës.

3.5.2. Drejtuesit kompletojnë strategjitë shtërvitore me plane për plotësimin e shtërvitjes, duke zhvilluar një matricë të ushtrimeve shtërvitore. Gjatë planifikimit, komandantët dhe shtabet e tyre bëjnë një vlerësim në ekip për numrin, llojin, kohëzgjatjen e ushtrimit shtërvitor të kërkuar për një përmbushje të suksesshme të LDTHM. Ushtrimet shtërvitore në vetvete janë një vegël për arritjen e qëllimit dhe ruajtjen e aftësive në plotësimin e LDTHM, brenda kërkesave të gatishmërisë operacionale.

3.5.3. Njëpërmjet ushtrimeve shtërvitore të komandës e të shtabit arrihen:

3.5.3.1. Zhvillimi i skenarëve të adaptuar për misionin dhe përmbushjen e tij.

3.5.3.2. Fokusimi i të gjithë organizmit në detyrat që lidhen me LDTHM.

3.5.3.3. Integrimi i të gjithë sistemeve të fushëbetejës brenda stërvitjes së forcës apo forcës së bashkuar.

3.5.4. Duke zhvilluar dhe koordinuar ushtrimet stërvitore, organizmi është i aftë të sigurojë integrimin e duhur të vendeve stërvitore, burimeve, mbështetjes më produkte dhe shërbime me mbështetjen e luftimit, “forcat kundërshtarë”, vëzhgues/kontrollorët, vlerësuesit dhe burime të tjera, që krijojnë stërvitjen e fokusuar në mjedisin e luftimit. Vlera e stërvitjes me një nivel të lartë të pjesëmarrjes të mbështetjes së ushtrimit dhe kontrollit të ushtrimit, rritet kur komandat dhe shtabet e “mbështetura” marrin pjesë në hartimin e objektivave dhe të skenarëve.

3.5.5. Më tipikët nga këta ushtrime stërvitore të komandës dhe shtabit janë:

3.5.5.1 Stërvitja e shtabit.

3.5.5.1.1. Stërvitja e shtabit është ushtrim stërvitor për rritjen e aftësive të shtabit për të planifikuar e mbështetur misionet e luftimit dhe ato të paqes. Kjo stërvitje është përgjegjësi e drejt për drejtë e komandantëve dhe ka për mision stërvitjen e shtabit, si një organizëm kompakt, familjarizimin me procesin e vendimmarrjes, rritjen e vlerësimit, gjykimit, argumentimit dhe diskutimit të aftësive të kurseve të veprimit, si edhe të zbatimit të urdhrave dhe dokumenteve të tjera.

3.5.5.1.2. Stërvitja e shtabit zhvillohet në një klasë apo në fushim dhe është e planifikuar ose pa lajmërim, në nivel batalioni apo më lart. Kur zhvillohet në terren, në të marrin pjesë edhe elemente të sigurisë së shtabit dhe shërbimit të shtabit. Kjo stërvitje mund të zhvillohet edhe duke përdorur një rrjet kompjuterik dhe pajisje simulimi.

3.5.5.2. Stërvitja për procesin e planëzimit të shtabit.

3.5.5.2.1. Si ushtrim stërvitor, misioni i tij është aftësimi i shtabit për një situatë të dhënë luftimi në funksion të aftësimit për zhvillimin e planeve të luftimit. Misioni i këtij ushtrimi stërvitor është të përgatisë shtabin si njësi kompakte, për të kuptuar më mirë procedurat e planifikimit, për të rritur aftësitë e gjykimit, argumentimin dhe diskutimin nga pjesëmarrësit mbi rreziqet dhe kërcënimet, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit etj. Këto ushtrime stërvitore mund të kryhen për të rishikuar planet e luftimit, të përgatitura më parë apo të përgatisin plane të reja në përballjen më kërcënime të reja apo një situatë të jashtëzakonshme që mund të pritët.

3.5.5.2.2. Stërvitja gjatë planifikimit të shtabit organizohet dhe zhvillohet në nivel batalioni dhe më lart, shtabi i nivelit komandues dhe shtabet vartëse, si edhe elementet mbështetës marrin pjesë. Zhvillohet në mjedise të parapërgatitura apo në kushte fushimi, me ose pa përdorimin e rrjetit kompjuterik. Stërvitja e planifikimit të shtabit mund të jetë e njëanshme apo e

dyanshme, e bashkuar apo individuale, e hapur apo e mbyllur dhe e lirë apo e drejtuar.

3.5.5.3. Lojëra luftarake.

3.5.5.3.1. Lojërat luftarake janë në një nivel më të lartë zhvillimi sesa planifikimi i shtabit. Lojërat luftarake planifikohen dhe zhvillohen në nivele më të larta komande dhe kontrolli, si rregull, nga ShP dhe Komandat e Forcave.

3.5.5.3.2. Qëllimi i lojërave luftarake është të rrisin aftësitë vendimmarrëse të këtyre formacioneve nga shtabet përkatëse, si organizma kompakte për drejtimin, koordinimin dhe kontrollin efektiv të operacioneve, në kushte shumë të përafërta me luftën. Kjo lloj stërvitje forcon metodat dinamike të zhvillimit të luftimit duke ruajtur zinxhirin komandues gjatë fazave të zhvillimit të luftimit.

3.5.5.3.3. Loja luftarake është në thelb simulim i një operacioni ushtarak që përfshin dy apo më shumë forca kundërshtarë, duke përdorur rregulla të dhëna dhe procedura të dizenuara për të përshkruar një situatë aktuale apo të imagjinuar të situatës së vërtetë. Nëpërmjet aplikimit të skenarëve të lojës luftarake, strategjitë koherente dhe konceptet e së ardhmes mund të testohen në se mund të jenë praktike apo të pamundur për t'u vlerësuar apo hedhur poshtë.

3.5.5.4. Stërvitja e komandës dhe e shtabit. Stërvitja e komandës dhe e shtabit ka si mision të sajin aplikimin praktik të aftësive të komandanteve dhe shtabit në organizmin përkatës dhe realizimin e operacioneve luftarake dhe atyre jo luftarake. Kjo mund të jetë stërvitje shumëshkallëshe, me pjesëmarrje të kufizuar të trupave, që zbaton në praktikë efektivitetin e vendimmarrjes dhe të vendimeve të komandantëve të tyre për realizimin e operacioneve. Organizohet nga një komandë më e lartë dhe pjesëmarrja në këtë stërvitje shkon deri në nivel kompanie.

3.5.5.5. Stërvitja me trupën.

3.5.5.5.1. Stërvitja me trupën, është mënyra më e mirë dhe më komplekse që zhvillon komandën dhe shtabin. Ajo siguron aftësitë e komandantëve e të shtabit për të planëzuar, organizuar, drejtuar dhe për të kryer operacione luftimi dhe jo luftimi, me përdorimin e manovrimit të forcave, të mbështetjes me zjarr, forcave të mbështetjes, por edhe të verifikojnë në praktikë përpikërinë e vendimeve të tyre.

3.5.5.5.2. Kjo stërvitje u jep mundësinë pjesëmarrësve të vlerësojnë aftësitë e tyre dhe të verifikojnë planifikimin e bërë më përpara si edhe t'u japë atyre mundësinë për ta përmirësuar atë. Në stërvitjen me trupën realizohet zbatimi i diturive të fituara në të gjitha format e zhvillimit profesional të kryera më parë. Stërvitja me trupën siguron efektivitet të lartë kur realizohet nga të dyja anët.

Si rregull, kjo stërvitje udhëhiqet nga niveli komandues i dy shkallëve më lart se sa ai që merr pjesë.

3.6. Nivelet e stërvitjes dhe ushtrimet stërvitore

3.6.1. Nivelet e ushtrimeve stërvitore, në bazë të niveleve të pjesëmarrjes të forcave në to dhe të objektivave që ato duhet të arrijnë, ndahen në tre nivele: strategjike, operacionale dhe taktike.

3.6.1.1. Ushtrimet stërvitore janë në nivelin strategjik kur Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura kërkon për një numër të specifikuar njësisish, repartesh dhe institucionesh të trajnohen për të arritur një objektiv të sigurisë kombëtare në nivelin strategjik. Kjo stërvitje projektohet, planëzohet, organizohet dhe drejtohet nga vetë Shtabi i Përgjithshëm i FA ose nga strukturat e autorizuar prej tij, në funksion të plotësimit të objektivave strategjike. Gjatë kësaj stërvitjeje përdoren burime strategjike (të ShP të FA) për plotësimin e misionit.

3.6.1.2. Ushtrimet stërvitore në nivelin operacional janë ato që projektohen, planifikohen dhe organizohen në terren dhe në vendndodhje të rëndësishme operacionale. Gjatë kësaj stërvitjeje njësitë dhe repartet formojnë dy apo më shumë lloje forcash dhe marrin pjesë në të. Komandimi dhe drejtimi i stërvitjes kryhet nga Komanda e Forcës së Bashkuar.

3.6.1.3. Ushtrimet stërvitore janë të nivelit taktik kur ato projektohen, organizohen dhe planifikohen për të përmbushur objektiva taktike dhe me pjesëmarrjen e njësisive apo të reparteve taktike. Në këtë stërvitje njësitë dhe repartet marrin pjesë nga një deri në më shumë lloje forcash dhe zgjidhin detyra specifike të shkallës taktike. Ushtrimet stërvitore, si operacionet në këtë nivel, shpesh organizohen në një "Task Force".

3.7. Zhvillimi i drejtuesve

3.7.1. Kur formulohen opsionet stërvitore për zhvillimin profesional të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë, zhvillimi i drejtuesve duhet të jetë një konsiderim kyç. Zhvillimi i drejtuesve është një element i pamënjanueshëm i procesit të përgjithshëm të menaxhimit të stërvitjes së FA. Si zhvillimi profesional, ashtu edhe zhvillimi i drejtuesve ndodh nëpërmjet një kombinimi të katër përbërësve të ndërlydhur: (1) eksperiencia e fituar nëpërmjet stërvitjes operacionale dhe detyrave operacionale dhe të shtabit, (2) trajnimi institucional dhe arsimimi, (3) vetëzhvillimi dhe (4) këshillimi.

3.7.2. Integrimi i zhvillimit të drejtuesve brenda arsimimit dhe stërvitjes prodhon drejtues me karakter dhe kompetentë të cilët janë në gjendje të shfrytëzojnë potencialin e tyre të plotë si drejtues. Zhvillimi i drejtuesve gjithashtu kultivon edhe stërvitjen e drejtuesve, që këta të veprojnë si pjesë e një shtabi shumëkombësh dhe të bashkuar. Zhvillimi i drejtuesve të shtabit dhe i aftësive të tyre realizohet edhe në bashkëpunim me partnerët rajonalë, nëpërmjet ushtrimeve të kombinuara, kontakteve të vazhdueshme, dhe ndihmës së ndërsjellë.

3.7.3. Ka pesë parime të zhvillimit të karrierës e të menaxhimit të karrierës. Në vetvete, këto parime shërbejnë njëloj për oficerin nënoficerin dhe ushtarin profesionist dhe komandantin.

3.7.3.1. Programet e zhvillimit të drejtuesve të jenë të përgjegjshëm për mjedisin rrethues, duke përfshirë faktorë të tillë si ligjin, rregulloren, strukturën e forcës, situatën përreth, teknologjinë dhe zhvillimin profesional.

3.7.3.2. Suksesi i një drejtuesi të matet në terma të kontributit. Qëllimet profesionale të një drejtuesi duhet të lidhen drejt për së drejti me kuptimin prej tij/saj të suksesit, si një profesionist në profesionin e armëve.

3.7.3.3. Ushtarët cilësorë meritojnë drejtues cilësorë. Ky parim është në zemër të zhvillimit të drejtuesve.

3.7.3.4. Drejtuesit mund të zhvillohen. Ky në vetvete, në mënyrë të pandashme lidhet me filozofinë e përgjegjësive të ndara ndërmjet drejtuesve, shkollave, degëve dhe institucioneve në Forcat e Armatosura dhe komandantëve në terren.

3.7.3.5. Zhvillim i drejtuesve të përfshijë të gjithë oficerët dhe nënoficerët. Ata ndajnë përgjegjësinë e zhvillimit të drejtuesve në çdo nivel.

3.7.4. Tre nivelet e drejtimit

3.7.4.1 Ka tre nivele të ndara të drejtimit brenda Forcave të Armatosura: direkt, organizacional dhe strategjik. Paragrafët e mëposhtëm shpjegojnë secilin nivel në marrëdhënie me procesin e zhvillimit të drejtuesve.

3.7.4.2. Drejtuesit e nivelit të drejtpërdrejtë, zakonisht mbikëqyrin nga disa deri në dhjetëra vartës. Këta drejtues janë mësuar duke qenë në praninë e vartësit gjatë gjithë kohës. Oficerët më gradë të ulët dhe nënoficerët janë në marrëdhënie të drejt për drejtë më shpesh se sa oficerët madhorë dhe janë në zhvillimin e rëndësishëm të përditshëm dhe përkujdesjen e ushtarëve. Drejtuesit e drejt për drejtë u japin vartësve udhëzime dhe drejtojnë direkt.

3.7.4.3. Shembuj të pozicioneve të drejtimit direkt janë:

- Komandantët e grupeve.
- Komandantët e skuadrës.
- Shefat e sektorit/drejtuesit.
- Shefat e ekuipazhit.
- Kapterët e togës/komandantët.
- Komandantët e kompanisë/baterisë.
- Oficerët e dokut.
- Pilotët e Forcës Ajrore dhe Mekanikët.

3.7.4.4 Drejtuesit organizativë.

3.7.4.4.1. Drejtuesit organizativë të Forcave të Armatosura, si për shembull Komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, Komandanti i Komandës së Doktrinës e Shtërvitjes, Komandanti i Forcës së Bashkuar dhe Komandanti i Komandës Mbështetëse ndikojnë mbi disa qindra deri në disa mijëra njerëz. Këta drejtues kanë drejtues vartës dhe/ose shtabe që i ndihmojnë ata në drejtimin e burimeve të organizmit përkatës. Këta drejtues organizativë ndikojnë mbi personelin e tyre përtej spektrit të operacioneve ushtarake, nëse ata drejtojnë kriza në kohe lufte apo paqeje, apo nëse janë duke punuar për arritur gatishmërinë në shtërvitjet e kohës së paqes.

3.7.4.4.2. Drejtuesit organizativë duhet të jenë në gjendje të përkthejnë koncepte të vështira në vendime, plane taktike dhe operacioni. Drejtuesit organizativë zhvillojnë programet, planet dhe sinkronizojnë sistemet e duhura, në mënyrë që t'u mundësojnë ushtarëve në njësi të vogla të kthejnë modelet operacionale dhe taktike në veprime.

3.7.4.4.3. Zhvillimi i drejtuesve organizativë të mbështetet nga një sistem zhvillimi i fokusuar i drejtuesve. Drejtuesit organizativë duhet t'i përdorin njohuritë dhe aftësitë e fituara në nivelin direkt, të kombinuara më eksperiencat e tyre në mësimet funksionale dhe/ose të shtabit, dhe ta transferojnë këtë ekspertizë dhe eksperiencë në një perspektivë më të gjerë në terma të qëllimit, të objektivave të afërta dhe të largëta, por edhe të rrjedhëve.

3.7.4.4.4. Një drejtues organizativ duhet të drejtojë vartësit e tij për të plotësuar misionet e dhëna nga drejtuesit strategjik, ushtarak dhe civil. Drejtuesi organizativ duhet qartësisht ta transmetojë qëllimin e tij tek drejtuesit vartës, direkt nën komandën dhe kontrollin e tij dhe duhet që gjithashtu të menaxhojë me efektivitet burimet dhe personelin për të plotësuar misionin.

3.7.4.4.5.1. Nëpërmjet udhëheqjes me shembullin vetjak, rrezatimit të njohurive të gjera dhe aplikimit të kompetencave të drejtuesve, këta drejtues organizativ ndërtojnë ekipet e duhura e të fokusuara nga misioni me disiplinë, kohezion, besim dhe aftësi në detyrat e tyre bazë. Këta drejtues fokusohen në përhapjen e një qëllimi të qarte, të koncepteve të shëndosha operacionale, por edhe të një mënyrë sistematike për zbatim.

3.7.4.5 Drejtuesit e nivelit strategjik.

3.7.4.5.1. Drejtuesit e nivelit strategjik janë të përgjegjshëm për organizmat e mëdhenj dhe ndikojnë mbi disa mijëra njerëz. Ata përfaqësojnë një kombinim shumë fin të mendimtarëve të një niveli të lartë dhe shumë kritik, të drejtuesve ushtarakë të kompletuar me eksperiencë të provuar operacionale, institucionale, organizative dhe ekspertizë gjeopolitike. Këta drejtues dallojnë nga vendosmëria dhe kontributi për cilësinë e jetës së veprimeve të tyre dhe të dedikimit të qëndrueshëm për popullin Shqiptar.

3.7.4.5.2. Shembuj të pozicioneve të nivelit të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë:

- Ministri i Mbrojtjes
- Pozicionet në Shtabin e Mbrojtjes
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
- Pozicionet në Shtabin e Përgjithshëm
- Përfaqësuesit Ushtarakë në NATO

3.7.5. Zhvillimi i Drejtuesve-Kombinim i Arsimimit dhe Stërvitjes.

3.7.5.1. Lëvizja dhe tranzicioni nga e drejtpërdrejta tek organizativja në drejtimin e nivelit strategjik, brenda Forcave të Armatosura, kërkon drejtues të aftë, të stërvitur, që vetë zhvillohen, të arsimuar më arsimin përkatës, dhe të aftë për të sinkronizuar të gjitha nivelet e drejtimit dhe të aplikojnë në këtë mënyrë eksperiencën e tyre të gjerë në një spektër shumë të gjerë operacionesh. Në mënyrë ideale drejtuesit madhorë dhe zhvillimi i tyre duhet të përbëhet nga vendosja e drejtuesve premtues në detyra kyçe, për t'i ekspozuar ata në piramidën e eksperiencave arsimore, përpara se të marrin role si drejtues të nivelit strategjik.

3.7.5.2. Kur drejtuesit mbërrijnë në nivelin strategjik, ata duhet të vazhdojnë të mprehin aftësitë e tyre menaxhuese dhe drejtuese me çdo mundësi, ku të përfshihet pjesëmarrja në seminarët e drejtuesve madhorë, konferenca të mbrojtjes dhe kurset arsimore, për të studiuar tema të tilla si siguria kombëtare, lidershipi, marrëdhëniet ligjore, marrëdhëniet më median, etika, menaxhimi i blerjes së sistemeve, siguria dhe marrëdhëniet civilo - ushtarake.

KREU IV: HARTIMI I LISTËS ME DETYRAT THEMELORE TË MISIIONIT (LDTHM)

- 4.1. Detyrat themelore të misionit dhe lista e tyre
- 4.2. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e LDTHM
- 4.3. Analiza e komandantit
- 4.4. Parimet dhe kërkesat themelore të zhvillimit të LDTHM
- 4.5. Hartimi i LDTHM për misionet në mbështetje të paqes
- 4.6. Hartimi i LDTHM të Forcës së Bashkuar (LDTHMFB)

- 4.7. Zhvillimi i LDTHM të reparteve e nënreparteve mbështetëse
- 4.8. Strategjia e stërvitjes, e lidhur me LDTHM
- 4.9. Përmbledhja e Procesit të Zhvillimit të Listës së Detyrave Themelore të Misionit.

4.1. Detyrat themelore të misionit dhe lista e tyre

Detyra themelore e misionit është një detyrë e përbashkët, në të cilën organizmi ushtarak aftësohet për të përmbushur me sukses misionin e tij gjatë operacioneve luftarake. Komandanti i njësisë a i repartit duhet të identifikojë ato detyra themelore, të cilat ndikojnë dhe mundësojnë realizimin e suksesshëm të misionit të tij luftarak. Të gjitha këto detyra duhet të përmbliidhen në një listë, e cila emërtohet Lista e Detyrave Themelore të Misionit (LDTHM). Ajo përbën dokumentin bazë, mbi të cilën do të planëzohet dhe programohet puna e komandantit dhe e shtabit të tij për stërvitjen e përgatitjen e efektivave.

Procesi i zhvillimit të LDTHM është një proces, që ka të bëjë me përzgjedhjen e detyrave më të rëndësishme që një organizëm ushtarak duhet të përgatitet për t'i realizuar në kuadrin e një operacioni luftarak të mundshëm.

Nëpërmjet procesit të zhvillimit të LDTHM efektivat e Forcave të Armatosura ndihmohen të përqendrojnë përpjekjet e tyre në planëzimin dhe zhvillimin e atyre stërvitjeve që garantojnë realizimin e suksesshëm të misionit në operacionet luftarake.


4.1.1. Procesi i zhvillimit të LDTHM përfshin veprimtaritë e mëposhtme:

- Shtrirja e detyrave themelore të misionit në programin stërvitor të njësisë a repartit.
- Zhvillimi i diskutimit profesional me pjesëmarrjen e komandantëve të të gjitha niveleve të organizmit ushtarak, për të gjetur lidhjen më të mirë të mundshme ndërmjet stërvitjes dhe misionit.
- Krahasimi, sinkronizimi dhe bashkërendimi i detyrave individuale e të përbashkëta të komandantëve dhe nënoficerëve vartës në përputhje me kërkesat e misionit të njësisë a repartit.
- Ngritja e ndjenjës së përgjegjësisë dhe e përkushtimit të komandantëve për realizimin e programit stërvitor të njësisë a repartit.

Figura në vijim paraqet procesin që përdorin komandantët për të identifikuar dhe përzgjedhur detyrat themelore të misionit.

4.1.2. Identifikimi dhe zgjedhja e Detyrave Themelore të Misionit

Misioni në
operacionet
luftarake
dhe
planet



4.2. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e LDTHM

Komandantët, gjatë zhvillimit të LDTHM duhet të mbështeten në vlerësimin e pesë faktorëve që ndikojnë drejtpërdrejt në proces. Ata janë si më poshtë:

4.2.1. *Misioni në operacionet luftarake dhe Planet Operacionale.* Misionet konkrete të operacioneve luftarake dhe planet operacionale të njësisë a repartit përbëjnë faktorin më të rëndësishëm për zhvillimin e LDTHM.

4.2.2. *Sistemet bazë të veprimit në fushën e luftimit.* Objektivi kryesor i njësisë a repartit është fuqizimi dhe sinkronizimi në shkallën më të lartë të veprimtarive të shtatë sistemeve bazë të veprimit luftarak si manovra, zbulimi, mbështetja me zjarr, mbrojtja ajrore, qëndrueshmëria e lëvizshmëria, komandimi e kontrolli dhe mbështetja logjistike, të cilët garantojnë realizimin e suksesshëm të çdo operacioni të ngarkuar.

4.2.3. *Mjedisi Operacional.* Komandantët kanë për detyrë të përgatisin forcat për realizimin dhe mbështetjen e një game të gjerë misionesh që imponon mjedisi kompleks dhe modern i fushëbetejës.

Mjedisi i sotëm, në të cilin do të zhvillohen operacionet luftarake, ka gjashtë dimensione që ndikojnë ndjeshëm dhe duhet të merren në konsideratë gjatë organizimit të bashkëveprimit dhe sinkronizimit të veprimeve luftarake. Këta dimensione janë:

- **Menaxhimi i kërcënimeve:** Kërcënimi është ngjarja që kërkon një vlerësim të saktë të rreziqeve të mundshme dhe marrja e vendimit të duhur për t'u përgjigjur ushtarakisht. Kërcënimi mund të jetë i drejtpërdrejtë, si për shembull një sulm kufitar ose jo i drejtpërdrejtë, si për shembull një incident apo një kryengritje e mbështetur nga terroristët.
- **Qëllimi politik.** Qëllimi politik ndikon drejtpërdrejt në përcaktimin e objektivave të operacionit luftarak që do të kryhet, si dhe në përcaktimin e burimeve të nevojshme për arritjen e suksesit

- Operacionet e përbashkëta. Në kushtet e mjedisit të sotëm të sigurisë dhe kuadrit strategjik, FA të RSH veprojnë si një forcë e bashkuar me aftësi të plota integruese dhe ndërvepruese për realizimin e operacioneve të përbashkëta. Prandaj politikat rekrutuese dhe përgatitja luftarake e efektivave duhet të bëhet në përputhje me kontekstin e mësipërm.
- Operacionet luftarake tokësore. Operacionet luftarake tokësore përbëjnë bazën e përgatitjes luftarake të FA dhe pjesën kryesore të LDTHM. Këta operacione zakonisht përfshijnë shkatërrimin e forcave të armikut dhe realizimin e objektivave, si në operacionet mbrojtës ashtu dhe në ata mësymës.
- Informacioni. Në kushtet e sotme informacioni dhe menaxhimi i tij përbën një nga faktorët më të rëndësishëm për arritjen e suksesit në operacionet luftarake dhe jo luftarake. Termi informacion ka një dimension mjaft të gjerë, por për Forcat e Armatosura është shumë e rëndësishme që ai të vlerësohet në kontekstin e fushëbetesës dhe të marrëdhënieve me median.

Për shkak të rëndësisë së informacionit në teatrin e operacionit dhe varësisë së tij nga përdorimi i sistemeve të informacionit, një administrim më i mirë i informacionit se sa kundërshtari bën të mundur fitimin e luftës për komandimin e kontrollin dhe si pasojë realizimin e suksesshëm të operacionit. Për këtë arsye informacioni dhe procedurat e menaxhimit të tij duhet të zënë një vend të rëndësishëm në programet e stërvitjes së trupës dhe të shtabeve, në veçanti.

Media ushtron një ndikim të madh në të gjitha nivelet e komandimit, pasi do të jetë e pranishme gjatë gjithë procesit të përgatitjes e të realizimit të operacioneve ushtarake dhe në sajë të mjeteve të sofistikuar të komunikimit, i bën ngjarjet të njohura për një publik shumë të gjerë dhe brenda një kohe shumë të shkurtër. Efektet e medias mbi operacionet, si dhe organizimi e mbajtja e marrëdhënieve korrekte me të, përbën një nga detyrat e përgatitjes luftarake në të gjitha nivelet e saj.

Zhvillimi teknologjik në fushën ushtarake është një tjetër aspekt i rëndësishëm i përgatitjes dhe i zhvillimit të operacioneve ushtarake, në përgjithësi dhe i modernizimit të FA, në veçanti. Në këtë aspekt komandantët duhet të marrin në konsideratë dhe të zgjidhin sfidat e integritetit të impakteve të zhvillimit teknologjik gjatë përgatitjes luftarake të efektivave.

4.2.4. Misione të tjera të veçanta. Efektivat e FA shpesh do t'u ngarkohet për detyrë të realizojnë misione, të cilët nuk kanë lidhje me misionet luftarake ose siç quhen ndryshe misione jo luftarake. Të tillë janë operacionet humanitare, të kërkim shpëtimit, në ndihmë të rendit publik, të antidrogës, ndihma ushtarake, evakuimi jo luftarak etj. Komandantët e njëjësive, reparteve a nënreparteve duhet të planëzojnë dhe programojnë detyra konkrete për përgatitjen e efektivave në realizimin e këtyre misioneve të mundshme.

4.2.5. Udhëzime dhe detyra shtesë. Tashmë është një praktikë e njohur në zinxhirin e komandimit që komanda eprore të përgatitë e të shpërndajë për vartësit udhëzime dhe detyra shtesë për përgatitjen luftarake të efektivave. Në disa raste ato mund të identifikohen me planet a urdhrat e partnerëve të

koalicionit, udhëzime apo detyra shtesë mbi misionin e operacionit aktual a të radhës.

4.2.6. Shembull i Detyrave Themelore të Misionit. Shembuj të detyrave të nivelit të Brigadës, të mbështetur në pesë faktorët e mësipërm të LDTHM, mund të jenë si më poshtë:

Mobilizimi dhe vendvendosja e brigadës.

- Tërheqja dhe ngarkimi i furnizimeve bazë (ushqim, municion etj).
- Kontrolli i para lëvizjes.
- Organizimi dhe kryerja e përnjohjes së rrugëve të lëvizjes.
- Organizimi dhe kryerja e lëvizjes për në rajonin e ripërqendrimit a pozicionet e luftimit.

Organizimi i operacionit mbrojtës.

- Organizimi i mbrojtjes pozicionale.
- Organizimi i mbrojtjes së lëvizshme.

Organizimi i operacionit mësymës.

- Kryerja e kundërsulmit.

Organizimi dhe zhvillimi i operacioneve të stabilitetit.

- Operacionet paqeruajtëse
- Luftimi kundër terrorizmit.

Organizimi dhe zhvillimi i operacioneve të mbështetjes.

- Operacionet e mbështetjes të vendit pritës.
- Ndihma e huaj humanitare.

Organizimi dhe kryerja e operacioneve të tjera të mbështetjes.

- Organizimi dhe kryerja e evakuimit dhe trajtimit mjekësor.
- Organizimi i transportit ajror dhe tokësor.
- Riparimi i pajisjeve të dëmtuara.

Ndërsa komandanti analizon dhe vendos detyrat themelore të misionit, që duhet të kryhen nga njësia e tij, është e rëndësishme të mos harrohet që një lloj i tillë organizimi mund të krijohet dhe të kërkojë një LDTHM krejt ndryshe, në varësi të ndryshimeve në mision apo në vendvendosje. Për shembull, një njësi që vendoset shpejt e alokuar me forcën e Reagimit të NATO-s, mund të identifikojë “mobilizimin” dhe “vendvendosjen” si detyra themelore të misionit kritikisht të rëndësishme, ndërsa një organizëm ushtarak në vijën e parë, si njësi që është e caktuar në Operacionin Liria e Irakut, mund të identifikojë kërkesa taktike të tilla si për shembull “reago me kontaktin” dhe “vër në punë mbështetjen me zjarr të koalicionit”, si detyra themelore të misionit. Gjeografia gjithashtu mund

të ndikojë në detyra të ndryshme themelore të misionit për njësi me misione në mjediset tropikale, të ftohta apo rrethana shkretëtire.

4.3. Analiza e komandantit

4.3.1. Është detyra e komandantit të identifikojë detyra kritike të rëndësishme, të nevojshme për përmbushjen e misionit. Kjo bëhet duke identifikuar misione të tjera të veçanta, specifike, të kuptuara dhe të nënkuptuara. Misionet e veçanta përfshijnë detyra, të cilat nuk janë normalisht pjesë e misionit të njësisë, por urdhërohen nga komandat më të larta. Për shembull, njësi mund të urdhërohet të marrë pjesë në operacione të mbështetjes humanitare. Ky është një mision i veçantë jo luftarak. Misionet e veçanta mund të shtrihen në të gjithë spektrin e veprimtarisë ushtarake.

Misionet specifike dalin nga misioni bazë i njësisë. Për shembull: Kryeni misione mbrojtëse.

Misionet e kuptuara burojnë nga misionet specifike. Për shembull: një mision që rrjedh nga një mision i specifikuar “Kryej operacione mbrojtëse” mund të jetë: Kryej operacione mbrojtëse në zona të populluara.

Misionet e nënkuptuara rrjedhin nga misionet e specifikuara dhe ato të kuptuara. Për shembull: misioni i specifikuar është: “Kryeni operacione mbrojtëse”, misioni i rrjedhur është “kryeni misione mbrojtëse në zona të banuara” dhe një mision i nënkuptuar që rrjedh nga këta të dy mund të jetë: ndërtoni pozicione mbrojtëse brenda ose përreth një ndërtese.

Komandantët e niveleve më të larta japin udhëzime për të ndihmuar komandantët e tyre vartës në procesin e analizës e të vlerësimit. Komandantët duhet edhe të koordinojnë rezultatet e analizës së misionit të tyre me komandantët e të njëjtit rang dhe atyre vartës. Komandanti i nivelit më lartë miraton LDTHM të përgatitur nga komandanti i njësisë vartëse. Ky proces siguron koordinimin, lidhjen dhe integrimin e misionit luftarak të njësisë a repartit në LDTHM të organizmit ushtarak.

Shembulli në vijim është dhënë për të treguar procesin e zhvillimit të LDTHM të komandantit të njësisë:

Misioni i luftarak i brigadës formon pikën fillestare për përcaktimin e detyrave më të rëndësishme stërvitore të saj:

Misioni luftarak i brigadës: “Brigada e Reagimit të Shpejtë të mobilizohet, vendoset dhe të ndërmarrë operacione mbrojtëse për të mbrojtur linjat parësore të komunikimit ndërmjet Tiranës dhe Durrësit.”

Fillimisht, Komandanti i Brigadës rishikon misionin dhe përcakton faktorët e tjerë që mund të ndikojnë në detyrat e njësisë (shikoni më lart); pesë faktorët, ndikimet bazë të shënuara më lart shërbejnë për të gjeneruar të gjitha detyrat stërvitore specifike, mundësisht të drejtuara.

Mbi bazën e analizës së tij, Komandanti i Brigadës identifikon të gjitha detyrat e mundshme stërvitore. Komandanti më pas e zvogëlon listën vetëm në ato detyra

që janë tejet të rëndësishme për përmbushjen e misionit. Kjo listë përfundimtare përbën LDTHM të Brigadës. Për shembull, brigada duhet të:

- Mobilizohet dhe vendoset në vend.
- Kryejë operacione mbrojtëse.
- Kryejë operacione mësymëse.
- Kryejë kundërsulm.
- Kryejë operacione qëndrueshmërie.
- Kryejë operacione taktike komandimi dhe kontrolli.

4.3.2. Zhvillimi i LDTHM për misionet e tjera të veçanta. Kur një organizëm merr për detyrë ose urdhërohet të kryejë një mision të veçantë, i cili mund të shtrihet gjatë gjithë spektrit të operacioneve, përveç misionit për një operacion luftarak

Për Komandën e Forcës së Bashkuar, misionet e veçanta të urdhëruara mund të përfshijnë operacione luftarake deri në operacione për dhënien e ndihmës humanitare ose lloje të tjera të operacioneve të stabilitetit dhe operacioneve të mbështetjes.

Komandantët, që detyrohen ose urdhërohen të ndryshojnë misionin e tyre, duhet të kryejnë një analizë të misionit të ri, të identifikojnë detyrat e LDTHM dhe të vlerësojnë aftësinë stërvitore për misionin e veçantë. Analiza e misionit të sapo dhënë mund të ndryshojë LDTHM e njësisë, fokusin mbi stërvitjen dhe strategjinë për të arritur aftësimin në detyrat e LDTHM.

4.3.2.1. Detyrat shembull që mbështesin një mision të veçantë e që përfshin një operacion stabiliteti tregohen më poshtë.

Stërvitja kolektive

- Operacionet e autokolonave.
- Lëvizje me shina/ajër.
- Siguria e rrugës.
- Siguria e zonës.
- Patrullimi.
- Vendosja dhe operimi i postbllloqeve

Stërvitja e drejtuesve

- Ushtrime të kontrollit të zjarrit
- Evakuimi i të plagosurve
- Ushtrime të mobilizim/vendvendosjes
- Rregullat e luftimit.

- Marrëdhëniet me median

Stërvitja individuale

- Informimi për minat/mjetet eksplozive
- Rregullat e luftimit
- Marrëdhëniet me median
- Shpëtimi i jetës në luftë/njohuritë mjekësore
- Orientimi kulturor/vendas
- Mbrojtja e forcës/Siguria Operacionale

Pas rivendosjes, komandantët duhet të kryejnë një analizë të misionit aktual, në përputhje me ciklin e menaxhimit të stërvitjes, për të rivendosur aftësitë luftarake të efektivave në LDTHM e misionit operacional të kohës së luftës. Komandantët eprorë duhet të llogarisin kohën shtesë të nevojshme për procesin e integritimit. Më pas vëmendja përqendrohet në ndjekjen e planit, përgatitjen, ekzekutimin dhe vlerësimin e programit stërvitor të çdo organizmi vartës.

4.4. Parimet dhe kërkesat themelore të zhvillimit të LDTHM

4.4.1. Gjatë zhvillimit të LDTHM duhet të mbahen parasysh pesë parime kryesore:

- LDTHM e njësisë apo repartit burojnë nga planet, detyrat dhe udhëzimet e komandës eprorë, në përputhje me planet dhe urdhrat operacionale.
- Detyrat themelore të misionit duhet të zbatohen nga të gjitha komandat vartëse.
- LDTHM e çdo njësie apo reparti duhet të mbështetë dhe plotësojë LDTHM e përcaktuara nga komanda eprorë.
- Mungesa e burimeve nuk e prek zhvillimin e LDTHM. LDTHM është një vlerësim i pakushtëzuar i detyrave të kërkuara për të përmbushur misionet luftarake.
- Komandantët drejtojnë operacionet dhe integrojnë shtatë sistemet e veprimit në fushëbetejë nëpërmjet planeve dhe urdhrave.

4.4.2. Sistemet bazë të veprimit luftarak janë funksionet e luftimeve me armë të kombinuara dhe përfshijnë:

- *Zbulimi.* Sistemi i zbulimit planifikon, drejton, mbledh, përzgjedh, prodhon dhe shpërndan informacion rreth kërcënimit e mjedisit dhe kryen zbulimin paraprak të fushës së luftimit (përgatit një tablo të asaj se çfarë po bën armiku). Zbulimi zhvillohet si pjesë e një procesi të vazhdueshëm të menaxhimit të informacionit dhe është thelbësor për operacionet e Forcave të Armatosura.

- *Manovra.* Manovra përfshin lëvizjen e forcave e të mjeteve tona për të

marrë pozicione avantazhi në lidhje me forcat armike. Komandantët manovrojnë ose lëvizin forcat për të krijuar kushtet e nevojshme për sukses në nivelin operacional dhe taktik. Nëpërmjet manovrës krijohen mundësitë për të shkatërruar armikun, ose për të penguar lëvizjen e armikut nëpërmjet përdorimit të zjarrit të armëve.

- *Mbështetja me Zjarr.* Mbështetja me zjarr përfshin koordinimin dhe vënien në punë të gjitha sistemeve të armëve në mbështetje të forcave tokësore, detare, ajrore, speciale, në përballimin me armikun dhe lehtëson në arritjen e objektivave taktike dhe operacionale.

- *Mbrojtja Ajrore.* Mbrojtja ajrore përfshin mënyrën e mbrojtjes së forcave tona nga sulmi ajror dhe kontrollin e hapësirës ajrore. Kjo parandalon sulmet e kundërshtarit ndaj forcave tona, ndërkohë që i liron komandantët e këtyre forcave për të sinkronizuar dhe manovruar fuqinë e zjarrit të forcave të tyre. Kërcënimi i që vjen nga armët e shkatërrimit në masë dhe përhapja e teknologjisë së raketave me rreze të gjatë, e ngrenë rëndësinë e sistemeve të mbrojtjes ajrore.

- *Qëndrueshmëria dhe lëvizshmëria.* Operacionet e lëvizshmërisë mundësojnë lirinë e lëvizjes së forcave tona. Misionet e lëvizshmërisë përfshijnë thyerjen ose kalimin e pengesave, përmirësimin e qarkullimit në fushëbetejë, përmirësimin apo ndërtimin e rrugëve, dhënien e ndihmës në kalimin e lumenjve me trap apo ndërtimi i urave dhe identifikimin e rrugëve përreth zonave të ndotura. Operacionet kundër lëvizshmërisë nuk i lejojnë armikut lirinë në lëvizje. Operacionet e mbijetesës i mbrojnë forcat tona nga efektet e sistemeve të armëve të armikut dhe kushteve të këqija të motit e të mjedisit. Masat mbrojtëse kimike, biologjike dhe bërthamore janë detyra thelbësore të mbijetesës.

- *Mbështetja logjistike.* Objektiv i mbështetjes logjistike është të ruajë dhe të sigurojë rritjen e fuqisë luftarake të forcave të luftimit dhe të forcave të mbështetjes së luftimit.

- *Komandimi dhe Kontrolli.* Komandimi dhe kontrolli (C2) ka dy komponentë bazë: komandantin dhe sistemin K2. Sistemi K2 e ndihmon komandantin që ai të planifikojë, të marrë vendime të sakta, të delegojë autoritetin dhe të sinkronizojë veprimet e njësisë. Për më tepër, sistemi K2 e ndihmon komandantin, ndërsa ai rregullon planet për operacionet e së ardhmes, ndërkaq ai është i fokusuar në operacionet e momentit. Sisteme komunikimi të besueshme janë qendrore për një sistem efektiv K2. Shtabet e përdorin sistemin K2 për të implementuar qëllimin e komandantit dhe për të lëshuar urdhrat dhe direktivat e nevojshme, për të caktuar dhe shpërndarë detyrat dhe burimet e nevojshme për arritjen e objektivave të misionit. Komandantët e përdorin sistemin K2 për të integruar të gjitha sistemet e veprimit në fushëbetejë drejt një qëllimi të përbashkët, realizimit të misionit.

4.5. Hartimi i LDTHM për misionet në mbështetje të paqes

4.5.1. Kur një njësi urdhërohet të kryejë një mision tjetër nga misionet e caktuar për kohën e luftës (të tillë si operacionet e stabilitetit apo të mbështetjes së paqes), cikli i stërvitjes vazhdon të zbatohet. Misionet në mbështetje të paqes apo në ndihmë të popullsisë mund të përfshihen në të gjithë spektrin e operacioneve. Për organizmat me tabelë organizimi dhe pajisje të modifikuar, misione të tilla mund ta ndryshojnë këtë tabelë sipas operacioneve në sigurimin e ndihmës humanitare apo realizimit të operacioneve të tjerë të stabilitetit dhe në operacione të mbështetjes.

4.5.2. Duke përdorur LDTHM e kohës së luftës si themel, komandantët që janë urdhëruar të ndryshojnë misionin e tyre, kryejnë analizën e misionit, përcaktojnë detyrat e LDTHM dhe vlerësojnë aftësitë stërvitore për misionin e ri të urdhëruar. Analiza e misionit të ri mund të ndryshojë LDTHM e njësisë, fokusimin e stërvitjes dhe strategjinë për arritjen e aftësive në detyrat e LDTHM.

Një shembull i detyrave, duke u mbështetur në përfshirjen e një misioni të urdhëruar, si operacioni i stabilitetit është:

Stërvitja kolektive	
<ul style="list-style-type: none"> • Operacionet e lëvizjes • Sigurimi i rrugëve • Stërvitje për lëvizjen 	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi nga ajri • Operacionet e patrullimit • Vendosja/funksionimi i pikave të kontrollit
Stërvitja e drejtuesve	
<ul style="list-style-type: none"> • Ushtrimet e kontrollit të zjarrit • Vlerësimi i ngjarjeve • Ushtrimet e shpërndarjes • Menaxhimi i rrezikut 	<ul style="list-style-type: none"> • Aftësia në rregullat e takimeve • Karburant/lubrifikantet ushtarake. • Bashkëveprimi me median
Stërvitja individuale	
<ul style="list-style-type: none"> • Informimi për minat • Aftësia në rregullat e takimeve • Bashkëveprimi me median 	<ul style="list-style-type: none"> • Informimi mjekësor • Orientimi sipas vendit • Mbrojtja e forcave

Figura 3-3. LDTHM në operacion stabiliteti.

4.5.3. Në rastet kur misioni përfshin detyra që nuk janë parashikuar në doktrinë apo janë detyra jostandarde, komandantët vendosin detyra, kushte dhe standarde duke përdorur urdhrat dhe udhëzimet për mision, mësimet e dala nga operacione të ngjashme dhe gjykimin e tyre profesional. Komandantët e lartë miratojnë standardet e vendosura për këto detyra si pjesë normale të procesit të miratimit të LDTHM. Nëse koha lejon, njësitë duhet të kryejnë ushtrime provë të misionit me të gjitha forcat pjesëmarrëse.

4.6. Hartimi i LDTHM të Forcës së Bashkuar (LDTHMFB)

4.6.1. Organizimi i FA shpesh parasheh forca brenda rendimit të forcës së bashkuar. Misionet dhe LDTHMFB për të tilla operacione burojnë nga lista e

detyrave të përgjithshme, të përbashkëta, të vëna nga komandanti i forcës së bashkuar dhe komandantët pjesëmarrës, që janë miratuar nga eprori i tyre.

4.6.2. Elementët e shtabit në çdo komandë zhvillojnë një LDTHM për të adresuar detyrat themelore të misionit në zonat e tyre specifike të përgjegjësisë. Këto quhen LDTHM e shtabit. Organizmat, gjithashtu, mund të zhvillojnë një LDTHM për çdo vendkomandë të veçantë (për shembull taktike, kryesore dhe prapavije). Një komandant njësie ose organizëm apo, në qoftë se përgjegjësia delegohet, Shefi i Shtabit, miraton LDTHM e shtabit. Shembuj të Detyrave Themelore të Misionit të Shtabit tregohen më poshtë.

- J-1 – Jepni operacione mbështetëse me personel.
- J-2 – Zhvilloni një plan rikonicioni dhe mbikëqyrjeje.
- J-3 – Planifikoni operacionet duke përdorur Procesin Ushtarak të Vendimmarrjes.
- J-4 – Zhvilloni një plan të mbështetjes logjistike.

Komandantët e lartë duhet të llogarisin kohën shtesë, që ky proces mund të kërkojë.

4.6.3. Një shtab i zgjedhur mund të caktohet si shtab “Task Force” apo shtab i forcës operacionale. Kjo kërkon që ky shtab duhet të hartojë LDTHM. Komandanti dhe shtabi ratifikon LDTHMFB me shtabet ekzistuese të FA dhe me LDTHM-të e njësisve vartëse. Manualët e përbashkëta sigurojnë kornizën e përgjithshme dhe ndihmojnë në:

- Hartimin e kërkesave të stërvitjes së Forcës së Bashkuar.
- Planëzimin e stërvitjes së Forcës së Bashkuar.
- Kryerjen e stërvitjes së Forcës së Bashkuar.
- Vlerësimin e aftësive operacionale e stërvitore të Forcës së Bashkuar.

4.7. Zhvillimi i LDTHM të reparteve e nënreparteve mbështetëse

4.7.1. Organizmat ushtarake që kryejnë funksione ndihmëse (mbështetëse), gjithashtu, përgatisin një LDTHM. LDTHM duhet të adresojë ndryshimet ndërmjet kushteve operacionale në kohë luftime dhe atyre në kohë paqeje. Për shembull, një batalion i ndihmës së shërbimit të luftimeve mund të operojë nga një vendndodhje e përhershme e kohës së paqes, me disa furnizime të mëdha që kryhen nga një transportim i kontraktuar civil dhe mund të përdorë sisteme të automatizuara që operohen nga një kompani telefonike komerciale.

4.7.2. Për ato njësi që normalisht bashkëveprojnë në operacion, LDTHM duhet të koordinohet me të gjitha njësitë e tjera brenda detyrës organizative, gjatë procesit të zhvillimit të LDTHM. Kjo kërkesë përforcon parimin e stërvitjes që “ekipe armësh të kombinuara stërviten ashtu siç luftojnë”. Një përbërës kyç i procesit të miratimit të LDTHM së komandantit epror është sinkronizimi i LDTHM të komandave vartësve. Një organizëm bashkëveprues

duhet të identifikojë armët e kombinuara dhe LDTHM e bazuar në detyrat e organizmit mbështetës dhe t'i përfshijë ato në planet e veta stërvitore.

4.8. Strategjia e stërvitjes, e lidhur me LDTHM

4.8.1. LDTHM jep bazën e parë për planet stërvitore të njësisë. Pasi të miratohet LDTHM e njësisë, komandanti i njësisë është përgjegjës për zhvillimin e planit stërvitor, nëpërmjet të cilit do të arrihen standardet dhe aftësitë e njësisë për të gjitha detyrat që drejtohen si themelore për misionin.

4.8.2. Komandantët përfshijnë komandantë vartës dhe nënoficerët e tyre madhorë në zhvillimin e LDTHM, për të krijuar një këndvështrim ekipi për stërvitjen e fokusuar nga beteja. Pjesëmarrjet e vartësve zhvillojnë një kuptim të përbashkët të kërkesave esenciale të organizmit në kohë luftë, kështu që LDTHM në të gjithë organizmin mbështetin njëra tjetrën. Si rrjedhim, komandantët vartës mund të aplikojnë eksperiencën e fituar në zhvillimin e LDTHM së komandës eprorë, për zhvillimin e LDTHM së tyre. Nënoficerët eprorë dhe nënoficerët të tjerë kyç duhet të kuptojnë LDTHM kolektive të organizmit, kështu që ata mund të integrojnë detyrat individuale në detyrat e përditshme stërvitore të njësisë.

4.8.3. Mbasi komandanti të miratojë LDTHM merr masa që të organizojë stërvitjen me qëllim që reparti a nënreparti të aftësohet sa më mirë për të përmbushur dhe realizuar misionin në operacionin luftarak. Për këtë qëllim, oficerët dhe nënoficerët vartës zhvillojnë një listë të detajuar individuale në mbështetje të çdo detyre themelore të misionit.

4.8.4. Të gjitha detyrat e LDTHM janë njëlloj të rëndësishme për të siguruar përmbushjen e misionit. Megjithatë, jo të gjitha detyrat e LDTHM kërkojnë një sasi të barabartë kohe stërvitje apo burimesh. Komandanti përcakton burimet e stërvitjes për të siguruar që aftësitë e bazuara në LDTHM të qëndrojnë të pranueshme. Kur koha stërvitore dhe burimet shpërndahen, komandantët e dinë dhe e kuptojnë që ka disa kërkesa që nuk janë të kohës së luftës, që janë kritike për shëndetin, mirëqenien, gatishmërinë individuale dhe bashkëpunimin e një njësie të mirë stërvitur. Komandantët, të mbështetur nga vartësit e tyre oficerë dhe nënoficerë, vendosin këto kërkesa shtesë stërvitore. Gjithsesi, ata vazhdimisht theksojnë përparësinë e stërvitjes së bazuar në LDTHM dhe gjejnë mundësinë për të përfshirë kërkesa që nuk kanë lidhje me misionin në planin stërvitor të njësisë.

4.8.5. Komandantët zhvillojnë strategji efektive stërvitore kur ata krahasojnë detyrat individuale, kolektive dhe për drejtuesit e çdo detyrë të bazuar në LDTHM, duke koordinuar në çdo rast me komandantët vartës, oficerët kryesorë dhe nënoficerët.

4.8.6. *Objektivat dhe detyrat stërvitore:* mbasi janë identifikuar Detyrat Themelore të Misionit, komandantët, gjithashtu, vendosin mbështetjen e objektivave të çdo detyrë stërvitore. Objektivit stërvitor përbëhet nga:

- *Detyra.* Një veprimtari shumë e qartë, e përcaktuar dhe e matshme, që

përmbushet nga organizma dhe individë (Shembull: Shkëput kontaktin me armikun).

- *Kushti.* Rrethanat dhe mjedisi, në të cilat një detyrë duhet të plotësohet. Kushtet mund të ndryshojnë. (Shembull: Skuadra po lëviz ose është në vend. Armiku qëllon mbi skuadrën. Komandanti i skuadrës jep urdhrin: shkëputni kontaktin).

- *Standardi.* Aftësia, minimalisht e pranuar, në plotësimin e një detyre të caktuar. Standardi nuk ndryshon kurrë! (Shembull: skuadra lëviz në një vend ku armiku nuk mund ta shohë apo të vendosë mbi të zjarr të drejt për drejtë. Komandanti i skuadrës kërkon mbështetje me zjarr).

- 4.8.7. Detyrat e Betejës. Pas rishikimit dhe miratimit të LDTHM të efektivave vartëse, komandanti epror zgjedh detyrat e betejës. Një “detyrë betejë” (një detyrë shtabi apo një detyrë organizmi) është kaq shumë e rëndësishme, sa që përmbushja e saj do të vendosë suksesin e njësisë tjetër eprorë dhe plotësimin e detyrës themelore të misionit.

Detyrat e betejës i lejojnë komandantët eprorë të përcaktojnë detyrat stërvitore për njësitë vartëse, të cilat:

- Integrojnë funksionet e luftimit të armëve të kombinuara dhe mundësitë që ato ofrojnë.

- Kërkojnë një vlerësim më të lartë si për shembull municionin, zonat e stërvitjes dhe godinat (ku përfshihen simulatorë të vërtetë dhe virtualë, si edhe simulime konstruktive), materiale dhe fonde.

- Kanë përparësi për komandantët eprorë.

Në vazhdim është një shembull që tregon detyrat e betejës të dhëna nga një brigadë për repartet a nënrepartet vartëse të saj:

Detyra themelore: Kryerja e operacionit mbrojtës.

Detyrat e Betejës:

- Kryeni përnjohjen e rrugës – Batalioni i 1^{rë}, 2^{të} dhe i 3^{të}
- Kryeni mbrojtje të zonës – Batalioni i 1^{rë}, 2^{të} dhe i 3^{të}
- Realizoni mbështetje me zjarr për operacionet e luftimit – Batalioni i Artilerisë
- Ndërtoni pozicione mbijetese – Batalioni i xhenios
- Ofroni dhe menaxhoni mbështetje logjistike për operacionet luftarake – Batalioni i Logjistikës.

4.9. Përmbledhja e Procesit të Zhvillimit të Listës së Detyrave Themelore të Misionit.

4.9.1. Fokusimi nga misioni jep bazën për zhvillimin e kërkesave të duhura stërvitore dhe të planeve. Komandanti është përgjegjës për identifikimin e të

gjitha detyrave që janë themelore për përmbushjen e misionit operacional të kohës së luftës së organizmit. Ai i harton këto detyra në një Listë të Detyrave themelore të Misionit (LDTHM).

4.9.2. Procesi i zhvillimit të LDTHM ul numrin total të detyrave të mundshme dhe fokuson përpjekjet stërvitore të organizmit në detyrat më të rëndësishme kolektive, që kërkohen në përmbushjen e misionit.

Ka pesë faktorë kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e LDTHM:

- Misioni i operacioneve luftarake dhe planet e operacioneve.
- Aftësitë e qëndrueshmërisë në luftime.
- Mjedisi operacional.
- Misionet e veçanta.
- Udhëzime të tjera.

Kërkesat e mëposhtme zbatohen gjatë zhvillimit të LDTHM:

- LDTHM buron nga urdhrat, planet e operacionit luftarak.
- Detyrat themelore të misionit i zbatojnë të gjithë efektivat e repartit a nënrepartit brenda një organizmi ushtarak.
- LDTHM e çdo organizmi duhet të ndihmojë dhe të përshtatet me LDTHM e komandës eprorë.
- Pasja e burimeve nuk ndikon në zhvillimin e LDTHM. LDTHM është një formulim që nuk pengohet nga detyrat e kërkuara për të përmbushur misionet për operacionet luftarake.
- Komandantët drejtojnë operacionet dhe përfshijnë funksionet e kombinimit të armëve nëpërmjet urdhrave dhe planeve.
- Planet stërvitore, ndarja e kohës dhe e burimeve bazohet në LDTHM e njësisë.

4.9.3. LDTHM sigurojnë bazat për planet stërvitore të organizmit. Komandantët kanë përgjegjësinë e përpunimit të një strategjie për stërvitjen, që të sigurojnë e garantojnë një nivel gjithnjë e në rritje të nivelit operacional, nëpërmjet stërvitjes së organizuar e gjithëpërfshirëse, në interes të misionit. Ata i përfshijnë vartësit dhe nënoficerët në hartimin e LDTHM, për të krijuar një grup koheziv që arrin kërkesat. Pjesëmarrja e vartësve zhvillon kuptimin e përbashkët të kërkesave kryesore. Stërvitja, e orientuar dhe realizuar sipas LDTHM-së në kohë paqeje, siguron aftësitë operacionale të Forcave të Armatosura për kohën e luftës. Sa më drejt të përcaktohen LDTHM-të, aq më të saktë e realë do të bëhen programet e stërvitjes në të gjitha nivelet. Thelbësore është kuptimi i LDTHM-ve në mënyrë që aty të integrohen detyrat individuale brenda çdo detyre gjatë stërvitjes që bazohet mbi LDTHM.

4.9.4. Programi i stërvitjes duhet t'u përgjigjet detyrave të përcaktuara në Listë. Kjo sjell integrimin e programeve me njeri tjetrin, si edhe çon në aftësimin e strukturave në pikëpamje operationale. Programet për stërvitjen e ushtarëve shërbejnë si dokumente burimorë kryesorë në përzgjedhjen e detyrave individuale të përshtatshme. Nuk duhen bërë përpjekje për t'u dhënë përparësi detyrave brenda LDTHM. Të gjitha detyrat e përcaktuara në LDTHM janë të baras vlefshme dhe esenciale për plotësimin e misionit. Të gjitha detyrat nuk do të kërkojnë kohë apo burime të baras vlefshme për arritjen e tyre. Kjo do të ndikojë dhe në programimin e realizimin e detyrave stërvitore të përcaktuara në listë.

4.9.5. Komandantët ndërhyjnë në program, megjithëse lejojnë kohën dhe burimet stërvitore për modifikimin e disa detyrave të pashprehura në mision apo nëse ka detyra të dëmshme për shëndetin, mbarëvajtjen, gatishmërinë e individëve dhe kohezionin e njësisë. Ata theksojnë përparësinë e stërvitjes për LDTHM dhe gjejnë mundësinë e përfshirjes së detyrave të pashprehura në mision në planet stërvitore.

4.9.6. Komandantët hartojnë strategji stërvitore të efektshme kur ata ndërthurin detyrat e stërvitjes kolektive, individuale dhe të drejtuesve në çdo detyrë të LDTHM me komandantët vartës. Një detyrë luftarake është detyrë themelore misioni e shtabit apo e një organizmi ushtarak vartës, që identifikohet nga komandanti epror dhe është aq e rëndësishme sa që plotësimi i saj do të vendosë suksesin e detyrës themelore të misionit të komandës eprorë. Detyrat luftarake bëhen pjesë e kërkesave të stërvitjes për njësinë a repartet vartëse.

Kreu V: PLANËZIMI I STËRVITJES

- 5.1. Procesi i planëzimit të stërvitjes
- 5.2. Udhëzimet e komandantit
- 5.3. Udhëzimet stërvitore të komandantit


- 5.4. Planet stërvitore të njësisë/organizmave ushtarakë
- 5.5. Planet e stërvitjes
- 5.6. Formati i planit stërvitor
- 5.7. Përgjegjësia e komandantit për planin stërvitor
- 5.8. Planet stërvitore të njësisë
- 5.9. Planet e mbështetjes së stërvitjes

5.1. Procesi i planëzimit të stërvitjes.

5.1.1. Objektivi i stërvitjes është të rritë aftësinë e individëve e të njësive për të kryer detyra specifike ushtarake, në përputhje me standardet e miratuara. Stërvitja është përgjegjësi e komandantit. Komandantët janë të përgjegjshëm për planifikimin e stërvitjes. Komandantët marrin fokusin e misionit dhe LDTHM-në e njësisë, i lidhin ato së bashku me planëzimin, përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e ushtrimeve stërvitore, gjatë procesit të planëzimit. Procesi i planëzimit të stërvitjes përfshin koordinimin e vazhdueshëm të drejtimit dhe aktivitetin nga planëzimi afatgjatë, në atë afatmesëm dhe afatshkurtër. Ky proces përfundimisht çon në ekzekutimin e bazuar në vlerësimin e standardeve nga rezultatet e stërvitjes.

5.1.2. Është detyrë e komandantit të vlerësojë në vazhdimësi gatishmërinë e njësisë së tij. Ky vlerësim jep drejtimin dhe fokusin për procesin e planëzimit të njësisë. Komandanti përgatit dhe jep udhëzimet për stërvitjen e njësisë së vet (qëllimet e stërvitjes dhe përparësitë). Udhëzimet e tij, të lidhura me LDTHM-në e njësisë dhe procesin e vlerësimit të stërvitjes, japin planet stërvitore të njësisë dhe organizmave ushtarakë.

5.1.3. Procesi i planëzimit të stërvitjes prej katër hapash për programet stërvitore të organizmave ushtarakë. Një proces prej katër hapash përdoret për të prodhuar plane efektive stërvitore të fokusuara nga misioni. Këta hapa zbatohen në çdo nivel drejtimi të Forcave të Armatosura dhe tregohen më poshtë:



5.1.4. Komandanti përdor dy elemente të rëndësishme në fillim të procesit të planëzimit të stërvitjes: LDTHM-në dhe vlerësimin e statusit aktual të stërvitjes.

Hapi 1: Në fillim komandanti identifikon të gjitha detyrat që mbështesin përmbushjen e LDTHM-së. Kreu 3 i këtij dokumenti përshkruan këtë proces në detaje të plota.

Hapi 2: Hapi i dytë i procesit të planëzimit të stërvitjes – vlerësimi i gjendjes ekzistuese të stërvitjes – krahason nivelin ekzistues të aftësisë stërvitore të njësisë me nivelin e dëshiruar të mjeshtërive luftuese.

5.1.5. Komandantët marrin vendime të ndërjegjeshme, të bazuara në rezultatet e vlerësimit të stërvitjes. Ata mund të vendosin ta ndryshojnë stërvitjen shtesë në lidhje me disa detyra të LDTHM-së, për të cilat njësia është e mirë stërvitur.

5.1.6. Komandantët, të ndihmuar nga oficerët dhe nënoficerët e njësive, vendosin nivelet ekzistuese të aftësive stërvitore duke analizuar të gjithë informacionin e mundshëm stërvitor. Ky përfshin të gjitha të dhënat e vlerësimit, si objektive dhe subjektive, për të lejuar zhvillimin e një tabloje të qartë të aftësive të përgjithshme të organizmave ushtarakë për të përmbushur çdo detyrë të misionit të renditur në LDTHM.

Aftësitë e projektuara të kthimit të personelit apo fushimi i pritshëm i pajisjeve të reja mund të godasin në mënyrë thelbësore në vlerësimin komandantit për aftësitë e njësisë së tij. Komandantët duhet të përditësojnë vlerësimin e stërvitjes në fillimin e çdo cikli planëzues afatgjatë dhe afatmesëm dhe mbas një stërvitjeje apo vendvendosjeje.

5.1.7. Komandanti duhet të marrë në konsideratë nivelin e ekspertizës dhe të njohurive të vartësve të tij kryesorë, për ta ndihmuar atë në vlerësimin e aftësive stërvitore të njësisë. Gjithashtu, vartësit duhet të inkurajohen që të japin të dhëna për vlerësimin e aftësive të stërvitjes, vetëm komandanti merr vendimin final në lidhje me statusin e aftësive stërvitore të njësisë.

Shembull: Brigada e Reagimit të Shpejtë mund të vendosë që zëvendëskomandanti, shefi i shtabit, personeli tjetër kyç dhe komandantët vartës të vlerësojnë aftësitë e brigadës për të realizuar detyra themelore të misionit dhe të mbështesin detyrat e betejës. Për të ndihmuar vlerësimin e komandantit, brigada ka nevojë për përdorimin e nënoficerit më të lartë të operacioneve dhe nënoficerët vartës të batalioneve për të vlerësuar aftësitë në lidhje me detyrat individuale, pastaj mbështesin përmbushjen e detyrave kolektive. Këta nënoficerë duhet të jenë ekspertë në përmbushjen e detyrave të veta, (menaxhimi operacional dhe drejtimi) të rishikojnë informacionin e vlerësimit të njësisë dhe atë individual, duke u mbështetur fort në vëzhgimet personale. Pastaj ata krahasojnë detyrat e aktuale të organizmit dhe sa i aftë është ky me standardet e nevojshme të lidhura me LDTHM-në.

Thelbi i përdorimit të nënoficerëve të kualifikuar madhorë në këtë hap të procesit të planëzimit të stërvitjes nuk mund të mbitheksohet – këta individë janë zakonisht ushtarët më me përvojë dhe eksperiencë në organizmin përkatës.

5.1.8. Komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë i përdor vartësit e tij në vendosjen e të dhënave dhe në marrjen e vendimit final, në lidhje me aftësitë stërvitore të brigadës, në funksionet e luftimit me armët e kombinuara dhe aftësitë (zbulim, manovër, mbështetje me zjarr, xhenio, mbrojtje ajrore, mbështetje e luftimeve dhe komandim - kontrolli) për çdo detyrë të LDTHM-së.

Të gjithë komandantët të vlerësojnë LDTHM e njësisë, bazuar në vlerësimin e detyrave, duke vlerësuar çdo detyrë në mënyrë individuale e duke përdorur shenjat e mëposhtme:

"S" (stërvitur): Njësia është plotësisht e stërvitur dhe ka treguar aftësitë e saj në përmbushjen e detyrës, në përputhje me standardet doktrinare.

"P" (ka nevojë për praktikë me stërvitje shtesë): Njësia ka nevojë për të praktikuar detyrën e caktuar në LDTHM. Performanca e njësisë ka treguar se njësia nuk e arrin standardin doktrinar pa vështirësi, ose nuk e ka kryer një nga detyrat e LDTHM-së në përputhje me standardet e specifikuar.

"E" (e pa stërvitur): Njësia nuk mund të tregojë aftësitë për të kryer detyrën në përputhje me standardin doktrinar.

Vlerësimi i stërvitjes është një element i rëndësishëm i procesit të planëzimit të stërvitjes dhe diskutohet më i detajuar në kreun 5 të këtij libri.

5.2. Udhëzimet e komandantit

5.2.1. Gjatë hapit të tretë të procesit të planëzimit të stërvitjes, komandanti, i ndihmuar nga stafi i tij, zhvillon një strategji fillestare për të arritur dhe ruajtur aftësitë në Detyrat Themelore të Misionit. Kjo strategji përfshin një metodologji në përmirësimin e aftësive, në lidhje me disa detyra dhe përmbajtjen e performancës së kualifikuar në mision, në lidhje me të tjerët.

Përpara se të zhvillojë strategjinë, gjithsesi, komandanti vendos nivelin e stërvitjes së dëshiruar që arrihet me zhvillimin e vizionit stërvitor të komandantit. Ky është një koncept i gjerë i nevojave të domosdoshme për të arritur dhe ruajtur aftësitë e performancës së detyrave të kohës së luftës.

Elementët thelbësorë që formojnë vizionin stërvitor të komandantit janë një kuptim i mirë i stërvitjes dhe i doktrinës operacionale, i vlerësimin të nivelit të aftësive të LDTHM-së dhe i kuptimit të mundësive potenciale që zotërojnë oponentët potencialë, i ashtuquajtur "kërcënim". Vizioni stërvitor i komandantit është komplementar dhe bëhet pjesë e qëllimeve të organizmit që japin drejtim të përgjithshëm për të gjithë programet e njësisë dhe sistemet e menaxhimit.

E bazuar në vizionin stërvitor të komandantit, strategjia stërvitore zhvillohet për t'i mundësuar komandantit që ky të vendosë përparësitë më të mirë menduara. Këto përparësi vendosin në fund sasinë e kohës, që një detyrë themelore e misionit do të kryhet gjatë periudhës stërvitore në vazhdim. Strategjia stërvitore, gjithashtu, përfshin udhëzime të gjera që lidhin LDTHM-në me stërvitjet që vijnë.

5.2.2. Komandantët eprorë përfshijnë stafin dhe komandantët vartës të tyre në zhvillimin e qëllimit të stërvitjes për të siguruar një kuptim të përbashkët në të gjithë organizmin dhe për të krijuar një këndvështrim ekipi. Shembuj të qëllimeve stërvitore të organizmit mund të përfshijnë:

- Vendosjen e kushteve mbështetëse brenda njësisë, që janë të nevojshëm për zhvillimin në një nivel të lartë prej drejtuesi të individit dhe të aftësive që kërkon koha e luftës (pra kushtet që lindin në forcimin e miqësisë, në shtimin e rregullit e disiplinës së mirë dhe kështu, në përçarjen e krenarisë së përgjithshme për njësinë).
- Kryerja e stërvitjeve me armët e mbështetjes dhe të kombinuara duke mbajtur në vazhdimësi gatishmërinë e organizmit.
- Zhvillimin dhe integrimin e Proceduarve Standarde të Operimit, të kërkuara për të vendosur ekipe me armë të kombinuara që në mënyrë efektive të vendosim ato dhe pastaj të luftojmë dhe fitojmë në fushëbetejën moderne.
- Rekrutimi dhe mbajtja e ushtarëve dhe drejtuesve të një cilësie të lartë.

Nëpërmjet hapit të tretë të procesit të planëzimit të stërvitjes, zhvillimit të udhëzimeve të komandantit për stërvitjen (që përmban vizionin stërvitor, qëllimet e stërvitjes dhe përparësitë e saj) kombinohet me LDTHM-në dhe rezultatet e një vlerësimi të një stërvitjeje të mëparshme, për të zhvilluar dhe menaxhuar planet stërvitore vjetore të njësisë.

5.3. Udhëzimet stërvitore të komandantit

5.3.1. Në qoftë se nuk janë gjithëpërfshirëse, planet stërvitore të fokusuar nga misioni, zhvillohen në nivelin strategjik, operacional dhe taktik të komandës. Procesi i përgjithshëm stërvitor do të jetë jo efikas dhe joproduktiv. Udhëzimet stërvitore të komandantit publikohen në nivel strategjik (Shtabi i Përgjithshëm), operacional (Komandën e Forcës së Bashkuar) dhe taktik (Brigadë dhe batalion), të Forcave të Armatosura. Këto dokumente janë të vazhdueshme, pra ato rrjedhin nga shkallët më të larta në ato më të ulëta në të gjithë sistemin e FA. Udhëzimet stërvitore të komandantit përmbledhin planet stërvitore afatgjatë.

5.3.2. Udhëzimet stërvitore të komandantit, që jepen nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, shërbejnë si bazë e planeve të luftës së Forcave të Armatosura. Ato shërbejnë edhe si bazë për udhëzimet operacionale të stërvitjes, që jepen nga Komanda e Forcës së Bashkuar, Komanda Mbështetëse dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, dhe duhet të lexohen dhe kuptohen nga të gjithë organizmat dhe komandantët e njësisë, oficerët e shtabit dhe nënoficerët madhorë.

5.3.3. Udhëzimet stërvitore të komandantit në çdo shkallë të Forcave të Armatosura do të shërbejnë si baza për planifikimin, përgatitjen, ekzekutimin dhe vlerësimin e stërvitjes gjatë gjithë periudhës së planifikimit afatgjatë.

Një shembull i udhëzimeve stërvitore të Komandantit të Forcave të Armatosura:

5.3.1. Filozofia e Stërvitjes së Komandantit:

a. Stërvitja është përparësia më e lartë e Forcave të Armatosura. Stërvitja kompetente dhe e bazuar në standarde, siguron që ushtarët, marinarët dhe aviatorët shqiptarë të të gjitha gradave të jeni të gatshëm kur t'u kërkohet për të kryer misionet dhe detyrat e ngarkuara.

b. Ky dokument është baza e filozofisë së stërvitjes së Forcave të Armatosura. Ajo përshkruan modelin e stërvitjes së Forcave të Armatosura në detaje dhe tregon objektivat e përvitshme stërvitore. Ky dokument është burim i rëndësishëm për komandantët dhe ata që kryejnë stërvitjen në Forcat e Armatosura. Udhëzimet e përvitshme do të jetë baza për udhëzimet tremujore të Forcave të Armatosura.

c. Filozofia e stërvitjes së FA është të “stërvitet për të luftuar dhe të luftojë për të fituar”. Doktrina e stërvitjes gjendet në MP3-4, Stërvitja në Forcat e Armatosura. Burimet tona më kritike janë koha, zonat e duhura stërvitore të kombinuara me Armë, manovra dhe mbështetja logjistike e fondet stërvitore. Prandaj duhet të marrim çdo çast për t'u stërvitur ashtu siç edhe presim të luftojmë. E gjithë stërvitja të kryhet sipas standardeve të miratuara doktrinare.

d. Stërvitja në Forcat e Armatosura është e fokusuar nga Strategjia Ushtarake, që na kërkon të mobilizohemi dhe të vendosemi shpejt, për të kryer operacione luftimi, për të ruajtur aftësitë tona luftarake, për të ndërvepruar me aleatët dhe forcat e koalicionit dhe për të qenë të suksesshëm në fushëbetejë. Këto misione përfshijnë mbështetje të vazhdueshme për luftën botërore kundër terrorizmit, përgatitjen për anëtarësim të plotë në NATO, mbajtjen e transformimit të mbrojtjes në një forcë komplet vullnetare në fund të 2010 dhe përpjekjeve për modernizim, duke përfshirë blerjen e pajisjeve dhe sistemeve të reja të armatimit dhe modifikimin e vazhdueshëm të Doktrinës Ushtarake.

e. Për të përmbushur misionet tona, stërvitja e njësisë në Forcat e Armatosura në çdo shkallë do të jetë:

- Kërkuese, reale, sfiduese dhe e bazuar në standardet e miratuara doktrinare.
- Me shumë shkallë dhe e orientuar nga performanca.
- E planëzuar mirë dhe e koordinuar me kujdes.
- E bazuar në integrimin e grupit kolektiv dhe të detyrave individuale të ushtarëve.
- E ekzekutuar me forcë dhe e vlerësuar me përpikëri.

f. Të gjithë ushtarakët Shqiptarë – gjeneralët, oficerët, nënoficerët dhe ushtarët – të pranojnë dhe përshtatin sjelljen që *Stërvitja është veprimtaria më e rëndësishme që zhvillojmë*. Të gjitha funksionet e tjera si riparimi dhe mirëmbajtja, janë pjesë e punës së përgjithshme stërvitore, që rrit gatishmërinë luftarake. Programi stërvitor i Forcave të Armatosura është një reflektim i cilësisë së udhëheqjes së saj. Ajo kërkon që të kuptojmë si të stërvitemi, të

luftojmë në çdo nivel deri në detaje, që të qëndrojmë të fokusuar nga detyrat themelore të misionit e të përqendrohemi në misionet e kohës së luftës, për të garantuar gatishmëri të vazhdueshme.

g. Zonat e rëndësisë: Të gjitha aspektet e stërviitjes dhe programet e menaxhimit të stërviitjes kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në gatishmërinë luftarake të Forcave të Armatosura, si rrjedhim përparësitë për stërviitjen gjatë 2008 janë:

- Një zhvillim i kompletuar i LDTHM i nivelit të njësisë për të gjithë organizmat.
- Kryerja e vlerësimeve të detajuara të statusit të stërviitjes në lidhje me LDTHM, duke futur në punë shenjat “S” (komplet i Stërviitur), “P” (i Pa Stërviitur) dhe “N” (ka nevojë për praktikë/stërviitje shtesë).
- Detyrat e betejës së Komandës së Forcës së Bashkuar.
- Batalioni i 2-të i BrRSH përgatitje për certifikimin nga NATO.
- Stërviitja kolektive, individuale dhe e komandave që mbështet LDTHM.
- Stërviitja e kombinuar me llojet e armëve.
- Vlerësimet e stërviitjes dhe informacioni i fituar.
- Përdorimi i mësimave të nxjerra gjatë procesit për të përmirësuar stërviitjet e ardhshme.
- Integrimi i konceptit të menaxhimit të mirëmbajtjes totale.

Çdo drejtues komandant dhe çdo oficer e nënoficer në njësi të udhëzohet të studiojë e kuptojë udhëzimet e komandantit për stërviitjen.

5.4. Planet stërviitore të njësisë/organizmave ushtarakë

5.4.1. Hapi i katërt në procesin e planëzimit të stërviitjes rezulton në zhvillimin e njërit prej dokumenteve ushtarake më shpesh të prodhuara, atë të planit stërviitor të njësisë/organizmit.

5.4.2. *Parimet e zhvillimit të planit stërviitor.* Për të ndihmuar në zhvillimin e planeve stërviitore të fokusuar nga misioni, që janë të kuptueshëm, komandantët dhe planëzuesit të zbatojnë shtatë parimet udhëzuese të mëposhtëm të zhvillimit të planit stërviitor.

5.4.2.1. *Planet stërviitore të mbajnë gjithmonë fokusin nga misioni.* Çdo komandë i përfshin komandat vartëse në zhvillimin e planeve stërviitore. E bazuar në planet e komandave më të larta, komandantët vartës përgatitin plane që janë konsistente me fokusin nga misioni.

5.4.2.2. *Planet stërviitore të koordinohen me organizmat ndihmës të organizuar me detyrat e zakonshme.* Komandantët e brigadave dhe batalioneve planifikojnë stërviitje me armë të kombinuara për detyrat e organizmit të vet në kohë lufte. Koordinimi dhe kohezioni ndihmohet duke lidhur zakonisht njësitë luftarake

me të njëjtat njësi të mbështetjes. Kjo krijon marrëdhënie të organizuara nga detyrat, që më pas ndihmon në zhvillimin e planeve stërvitore të njësisë. Njësitë e lidhura, zakonisht (të organizuar me detyra), koordinojnë planet stërvitore me njera tjetrën.

- Komandanti i Forcës së Bashkuar kërkon zhvillimin dhe dorëzimin e planeve të integruara të stërvitjes dhe monitoron koordinimin e përpjekjeve gjatë gjithë procesit të planëzimit.

5.4.2.3. Planet stërvitore të fokusohen në horizontin e duhur kohor.

- Planet afatgjatë stërvitorë në Forcat e Armatosura shtrihen të paktën në dy vjet në rastin e Komandës së Forcës së Bashkuar, Komandës Mbështetëse dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

- Brigada e Reagimit të Shpejtë, Regjimenti Komando, Brigada Ajrore dhe Brigada Detare, planet afatgjatë do t'i shtrijnë në një minimum prej një viti.

- Planet afatshkurtër të stërvitjes së njësisë fokusohen normalisht në tre mujorin e ardhshëm.

- Planifikimet për situatat stërvitore afatshkurtra fillojnë rreth 8 javë përpara ekzekutimit të situatës së planifikuar stërvitore.

5.4.2.4. Planet stërvitore të lidhen me aftësitë individuale dhe kolektive të njësisë.

- Planet stërvitore të fokusohen në rritjen ose ruajtjen e aftësive të njësisë në lidhje me ekzekutimin e detyrave themelore të misionit, sipas standardeve doktrinare të vendosura.

5.4.2.5. Planet stërvitore të jenë të konceptuar me limitimin e rrezikut.

- Kombi i beson djemtë dhe vajzat e tij Forcave të Armatosura dhe ne u kërkojmë atyre t'i shërbejnë vendit të tyre në një profesion disa herë të rrezikshëm.

- Në të njëjtën kohë, vetë natyra e profesionit ushtarak është në vetvete e rrezikshme; komandantët duhet të stërvitin njësitë e tyre në standardet e vendosura, në kushtet më reale të mundshme.

Menaxhimi i rrezikut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe kontrollit të rrezikut për ushtarët, pajisjet apo godinat, që lind nga faktorët operacionalë apo stërvitorë dhe përfshin vendime të qarta, që balancojnë rrezikun potencial, me të mirat e përfituara nga stërvitja

- Aplikimi i procesit të menaxhimit të rrezikut nuk duhet të tërheqë vëmendjen nga qëllimet stërvitore, por të përforcojë ekzekutimin e stërvitjeve reale dhe shumë efektive. Drejtuesit dhe ushtarët e të gjitha shkallëve e përdorin menaxhimin e rrezikut për të ruajtur fuqinë luftuese dhe burimet.

- Drejtuesit dhe shtabet vazhdimisht identifikojnë rreziqet dhe vlerësojnë aksidentet dhe rreziqet taktike, ata zhvillojnë dhe koordinojnë masa kontrolluese për të mënjanuar apo eliminuar këto rreziqe.
- Menaxhimi i rrezikut është i vazhdueshëm dhe një element thelbësor për stërvitjen dhe realizimin e misionit.
- Duhet të jetë pjesë përbërëse e vendimeve ushtarake, i lidhur në çdo plan stërvitor dhe të bëhet pjesë e vazhdueshme e përgatitjes për stërvitje.

5.4.2.6. Planet të vendosin dhe të mbajnë gjithmonë stabilitetin e organizmit.

- Ndryshimet e çrregullojnë stërvitjen dhe i mërzhisin ushtarët dhe drejtuesit vartës.
- Planifikimi i duhur dhe konsiderata e rëndësishme të kohës i lejon organizmat të paraprijnë e të përfshijnë ndryshimet në mënyrë të koordinuar.
- Stabiliteti dhe parashikueshmëria janë rezultat i ngërçit në planet stërvitore.
- Komandantët eprorë janë të përgjegjshëm për mbrojtjen e njësive vartëse nga ndryshimi!

5.4.2.7. Planet gjithmonë t'i përdorin burimet në mënyrën më efektive të mundshme.

- Procesi i Planëzimit jep kohë dhe burime të tjera të limituara për stërvitjen, që kontribuon më shumë për arritjen dhe ruajtjen e niveleve të aftësive të kohës së luftës.

5.4.3. Pasi zhvillohen planet stërvitore, njësitë zhvillojnë stërvitjen dhe përgatiten edhe për kryerjen e vlerësimeve pas stërvitjes dhe mirëmbajtjen. Procesi vazhdon me vlerësimet e stërvitjes që japin të dhëna nga lart poshtë për vlerësimin organizativ. Këto vlerësime u japin njohuritë e duhura komandantëve eprorë dhe i ndihmojnë në përgatitjen e vlerësimit të stërvitjes.

5.5. Planet e stërvitjes.

5.5.1. Një tjetër dokument i zakonshëm ushtarak, i përfshirë në procesin e planëzimit të stërvitjes është edhe plani i stërvitjes së njësisë. Edhe pse përdorimi më i madh për planin e stërvitjes është në nivelin taktik të procesit të stërvitjes, planet strategjike dhe operacionale prodhohen nga Shtabi i Përgjithshëm, Shtabi i KFB, KDS dhe KM, për t'u dhënë ndihmë njësive vartëse.

5.5.2. Metodologjia që përfshihet në planifikimin efektiv të afërt rezulton në zhvillimin e një plani stërvitor të detajuar. Ky dokument rrjedh nga teknikat dhe parimet e përshkruara më poshtë për të prodhuar plane stërvitore të kuptueshme nga njësia, të fokusuara nga misioni dhe të vlefshme në rafshin operacional:

E para, Planifikimi përdoret për të siguruar që të gjitha detyrat mund të ekzekutohen me kohën në dispozicion dhe detyrat që mbështeten në

ekzekutimin e mëparshëm të kryhen në afatin e duhur. Planifikimi në kahe e kundërt është një proces, i cili lejon shtabin të mbajë në konsideratë të gjithë elementët e arritshëm të procesit të planëzimit gjatë kohës dhe fillon me vendosjen e rezultatit të dëshiruar final. Planifikimi në kahe të kundërt përdoret kur konsiderohet koha e kërkuar dhe detyrat specifike që lidhen me logjistikën, por edhe me kërkesat e tjera mbështetëse, si në luftim edhe gjatë llogaritjes së ngjarjeve stërvitore.

Një plan stërvitor i prodhuar pa përdorimin e planifikimit në kahe të kundërta nuk do të jetë efektiv.

E dyta, Planet e stërvitjes prodhohen në koordinim të ngushtë me vartësit, ato njësi që janë të njëllajta dhe me ato të rangut më të lartë. Komandantët e niveleve më të larta, duhet të miratojnë e të mbështesin ngjarjet e stërvitjeve të planifikuara në nivelet më të ulëta në të gjithë zinxhirin komandues. Kështu, për shembull, komandantët e togave përgatitin planet stërvitore dhe ia japin ato komandantit të batalionit për miratim. Pasi komandanti i batalionit të miratojë planin stërvitor, çdo ndryshim që i bëhet këtij plani stërvitor gjithashtu duhet të miratohet nga komandanti i batalionit. Ai është i vetmi që mund të miratojë ndryshime në planin tashmë të miratuar. Në një shembull të dytë, komandantët e batalioneve përgatisin në çdo tre muaj ose çdo muaj planet stërvitore dhe ia paraqesin ato komandantit të brigadës apo regimentit, i cili gjithashtu e miraton planin stërvitor, një akt i cili tregon përkushtimin e tyre në mbështetjen e stërvitjes me burimet e duhura.

E treta, qëllimi i planit stërvitor nuk është vetëm për t'i mbajtur ushtarët të zënë me punë. Çdo situatë stërvitore e planifikuar në planin stërvitor duhet të ketë një qëllim përfundimtar. Gjithashtu komandantët duhet të sigurohen që planet stërvitore të përfshijnë të gjithë ditën normale të punës të planifikuar në repart dhe që ato të përfshijnë ndodhi gjatë gjithë ditës së detyrës, gjatë ushtrimeve fushore. Komandantët të qëndrojnë larg termave si “Koha e komandantit”, “Koha e rreshterit” ose “Koha administrative” për të mbushur hapësirat bosh brenda planit stërvitor.

5.6. Formati i planit stërvitor

5.6.1.1. Planet stërvitore të prodhohen duke përdorur udhëzimet bazë të treguara më poshtë. Plani stërvitor do të:

5.6.1.1. Specifikojë kur fillon stërvitja, periudhën kohore të stërvitjes, ku do të kryhet stërvitja, kushtet, në të cilat do të kryhet stërvitja dhe qëllimin e stërvitjes.

5.6.1.2. Jepni kohë të mjaftueshme për stërvitjen e planifikuar dhe stërvitjen shtesë ashtu siç kërkohet, për të korrigjuar mangësitë në stërvitje (mos harroni, stërvitja kryhet sipas standardeve të vendosura dhe jo kohës).

5.6.1.3. Specifikoni individët, drejtuesit, kolektivin dhe detyrat e shtabit për të cilët duhet stërvitje.

5.6.1.4. Përfshini referencat për doktrinën, taktikën, teknikat dhe procedurën për detyrat që duhet stërvitur.

5.6.1.5. Përfshini ngjarjet e tanishme shtesë stërvitore, për të siguruar përdorim efikas të kohës stërvitore në dispozicion. (Ndodhitë stërvitore shpesh përfshijnë një kohë të konsiderueshme “pushimi”, e cila mund të përdoret me efikasitet për t’u përqendruar në kërkesat e tjera stërvitore, si ndihma e shpejtë, armët, etj).

5.6.1.6. Specifikoni drejtuesin e përgjegjshëm për drejtimin e ngjarjes stërvitore dhe individin (-ët), të cilët do të bëjnë stërvitjen dhe ata që do të vlerësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e stërvitjes (të ashtuquajtur vlerësues, apo vëzhgues-kontrollues).

5.6.1.7. Të jepni informacion administrativ në lidhje me formacionin e njësisë, uniformën e kërkuar, armët, pajisjet e nevojshme, municionin, ndihmat për stërvitje, transportin, ushqimin, fjetoret, manualët, frekuencat e komunikimit dhe të specifikoni masat e mara të sigurisë që do të përdoren (menaxhimin e rrezikut).

5.6.1.8. Të përfshini dhe të jepni planet shoqëruese stërvitore, që detajojnë dhe përcaktojnë nivelin e ndihmës (ushqimin, karburantin, fjetoret, transportin, etj) që kërkohen dhe u jepet të gjitha stërvitjeve të mëdha.

5.6.1.9. Specifikoni kodet e stërvitjes që do të regjistrohen në të dhënat individuale apo të njësisë për stërvitjen, pas përfundimit të suksesshëm të stërvitjes në bazë të standardeve.

5.6.1.10. T’i jepni kohën e duhur në plan për mirëmbajtjen pas stërvitjes, pastrimin e armëve, dhe lëvizjen për në fjetore.

5.6.1.11. Specifikoni zonën e planifikuar për t’u përdorur, ku të përfshihen orët në poligon dhe ndalesat aty ku duhet. Plani stërvitor të specifikojë personin e përgjegjshëm për koordinimin me zyrtarët e poligonit përpara stërvitjes.

5.6.1.12. Specifikoni stërvitjen alternative që do të kryhet në rast të përkeqësimit të motit apo në faktorë të tjerë të kohës.

5.6.1.13. Specifikoni se si përdoret metodologjia për të kryer stërvitjen (mësime në klasë, simulime të zjarrit, aplikime praktike, ushtrime të vendimmarrjes, ushtrime fizike apo një kombinim të njërës apo të të gjitha llojeve të stërvitjes).

5.6.1.14. Tregoni ndonjë ngjarje themelore që mund të ketë impakt mbi ta apo të krahasohet me planin stërvitor të njësisë.

5.7. Përgjegjësia e komandantit për planin stërvitor

5.7.1. Përveç përmbytjes së udhëzimeve të përkruara më lart, komandantët eprorë të vendosin rregulloren për të minimizuar ndryshimet në planin stërvitor të miratuar. Duke miratuar, firmosur, publikuar dhe shpërndarë planin

stërvitor, komandantët japin kështu një përkushtim të fortë për të kryer stërvitjen e planifikuar, në kohë dhe në bazë të standardeve të vendosura.

5.7.2. Shembujt e përgjegjësitë brenda hierarkisë së Forcave të Armatosura në përgatitjen, rishikimin, miratimin, mbikëqyrjen dhe vëzhgimin e planit stërvitor përfshijnë:

5.7.2.1. Komandanti i Kompanisë bën një draft të planit stërvitor të kompanisë, i cili i dorëzohet komandantit të batalionit dhe miratohet prej tij; ky e firmos dokumentin dhe siguron mbështetjen e duhur administrative dhe logjistike.

5.7.2.2. Komandanti i Brigadës/Regjimentit rishikon dhe miraton planin stërvitor të çdo batalioni për njësitë në komandën e tij dhe siguron mbështetjen e duhur administrative dhe logjistike, që të jetë e planifikuar dhe në gjendje për t'u dhënë.

5.7.2.3. Komandanti i Forcës së Bashkuar rishikon dhe miraton planet stërvitore të nivelit të brigadës dhe jep, sipas kërkesës, mbështetjen e duhur administrative dhe logjistike.

5.7.2.4. Komandanti i Forcës së Bashkuar rishikon dhe miraton planin stërvitor të KFB, që përmban stërvitjet e mëdha në të gjithë KFB. Ky plan stërvitor zhvillohet nga shtabi i KFB.

5.7.2.5. Komandantët eprorë, nëpërmjet oficerëve të tyre të operacioneve dhe me ndihmën e nënoficerëve madhorë dhe personelit, zhvillojnë një plan për të vëzhguar dhe kryer vlerësime joformale të stërvitjes në njësitë vartëse.

5.7.2.6. Komandanti i Forcës së Bashkuar zhvillon një inspektim të “pa lajmëruar” vjetor për planin stërvitor, për të garantuar periodikisht që stërvitja kryhet aktualisht dhe përmbushet në bazë të planit stërvitor të publikuar dhe miratuar.

5.8. Planet stërvitore të njësisë

5.8.1. Plani stërvitor është mjeti i parë për menaxhimin e njësisë, për të siguruar që stërvitja të kryhet në kohë dhe nga stërvitës të kualifikuar e me burimet e duhura. Matrica e mëposhtme e planit stërvitor të njësisë jep një shembull të tipave të stërvitjeve që një Batalion i Këmbëorisë së Lehtë mund të kryejë në një vit. Ngjarjet që përfundimisht duken në planet stërvitore vjeçare, tre mujore, mujore dhe javore duhet të përputhen me Udhëzimet e Komandantit për Stërvitjen dhe të mbështesin një stërvitje cilësore dhe të fokusuar tek misioni.

Stërvitjet e Njësisë Batalion i Këmbëorisë së Lehtë					
Kur	Ushtarë	Grup/Skualet/ Seksion	Logje	Kompania	Batalioni
Ditor	Përgatitje Fizike	Stërvitja MOS (Standardi Minimal i	Stërvitja MOS	Formacioni	Mbështetje e Misionit

Doktrina e Shtërvitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

		Operimit)			
Javor	Stërvitje e drejtuesve Stërvitje gjuhësore	Stërvitje individuale për betejë Stërvitje me mortaja dhe mitraloz	Stërvitje DTM	Stërvitje Malore për DTM	Takim stërvitor për formacionin dhe planifikimin e misionit
Mujor	Stërvitje qitjeje kundër-terrorizmit	Stërvitje me mitraloz dhe mortaja	MAPEX MOUT	Alarme Kolektive për Betejë	Stërvitja malore TOC Stërvitja
Tremujor	Orientimi në terren (ditën dhe natën) Ndihma e Shpejtë	Mortaja/mitraloz re/manovra STX-MET Stërvitja	STX-Mbështetja e paqes	TEËT-Ofensive FTX-Mbrojtëse STX-humanitare	CPX
Gjashtëmujor	Test i aftësive fizike Testimi i gjuhës Njohuri mbi minat	Vlerësimi për aftësitë ne Betejë	Vlerësimi i aftësive të betejës	Ushtrimi i dislokimit	TEËT/FTX STAFFEX
Vjetor	Test i qitjes Test i aftësive të betejës	Kualifikimi për armët me shumë personel	Kualifikimi për armët me shumë personel	CALFEX	CREVAL

Figura e mëposhtme përshkruan një plan stërvitor të përditshëm të njësisë që mund të përdoret duke stërvitur personelin për të ndihmuar në zhvillimin e planeve stërvitore të njësisë.

DTG	Vendndodhja dhe uniforma	Detyra	Detyrë e mbështetur nga LDTHM	Standardet/Referencat	Stërvitës	Vlerësues	Detyrat paralele
-----	--------------------------	--------	-------------------------------	-----------------------	-----------	-----------	------------------

Shembull: Plan stërvitor dyditor
Kompania e 1^{te}, Batalioni i 2^{te}, Brigada e Reagimit të Shpejtë

310400 Tetor	Koordinatat e Zonës Lokale të Stërvitjes 1234 6789 Uniformë beteje IAË TAC SOP	Kryeni rikonicionin e rrugës (duke mbështetur detyrat individuale dhe të komandantit në lidhje me FM 1-23 dhe POS Taktik të Kompanisë së Parë)	Vendosuni në Pozicionet fillestare të mbrojtjes	FM 1-23	Togeri Kanata	Kapiteni Jetërson	POS Taktikë Detyrat e Betejës Reago ndaj kontaktit
-----------------	---	--	---	---------	---------------	-------------------	--

Doktrina e Shtërvitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

311700 Tetor	Post Komanda Kompania 1	Pastroni, mirëmbani, dhe jini të përgjegjshëm për pajisjet personale	Mbani/Vazhdo ni operacionet	FM 3-45, FM 6-78 TM 9-1150-25-- 12	Kapteri Kokona	Kapiteni Kolb	Asnjë
010600 Nëntor	Post Komanda Kompania 1	Formacioni i parë dhe stërvitja fizike	Mbani/vazhdon i operacionet	PSO Kompania 1	Kapteri Kokona	Kapiteni Kolb	Detyrat e banjës për profilet Fizike

5.9. Planet e mbështetjes së stërvitjes

5.9.1. Planet e mbështetjes së stërvitjes janë mjete, që përdoren për të mbështetur procesin e planëzimi të stërvitjes. Planet e mbështetjes së stërvitjes janë shumë të detajuara për të siguruar që të gjitha burimet e kërkuara të mbështesin ekzekutimin e stërvitjes dhe të jenë aty të identifikuar dhe të konsideruara. Kjo lejon një koordinim të duhur për poligonet, municionin dhe pajisjet e tjera që kërkohen për mbështetje.

Shembull i një plani mbështetës të stërvitjes.

PMS Nr: OT O. 4 (orientimi në terren, ora 4)

Orë: 8

Titulli: Orientimi në terren – periudha IV (ushtrime praktike)

Qëllimi: Kjo pako mbështetëse e stërvitjes i jep instruktorit me kërkesa të standardizuara për secilën nga detyrat e mëposhtme.

5.9.2. Detyrat e stërvitura

Për standarde: Këtu detajohen detyrat për të cilat duhet stërvitur:

Titulli i Detyrës:	Kursi i orientimit në Terren, Ditën dhe Natën
Kushtet:	Ditën duke iu dhënë një kurs kompasit me një terren të ndryshëm
Standardet:	Kalon me sukses kursin e kompasit në 4 orë

Titulli i Detyrës:	Kursi i Orientimit në Terren Natën
Kushtet:	Natën duke iu dhënë një kurs kompasit
Standardet:	Kalon me sukses kursin e kompasit brenda 4 orësh

Detyra e mësuar apo e mbështetur: Siç është filluar më lart.

Detyra e përforcuar: Ky leksion përforcon detyrat e renditura në tabelën e mëposhtme:

Doktrina e Sdtërvitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

Titulli i detyrës
Identifikoni simbolet topografike, ngjyrat, dhe informacionin dytësor në një hartë ushtarake
Identifikoni të dhënat e terrenit në një hartë ushtarake
Vendosni koordinatat e kuadratit në një hartë ushtarake
Matni distancat në hartë
Vendosni Azimutin duke përdorur një kompas
Ktheni Azimutin

Orët: Mësimi ka nevojë për këto orë akademike duke përdorur përkthyes:

Akademike:

Në klasë	0.0 orë
Ushtrime Praktike	8.0 orë
Qitje	0.0 orë
Totali orët	8.0 orë

Mësimet e kërkuara: LN PD 1 – 3 (Periudha 3 e orientimit në terren)

Referencat: Tabela e mëposhtme rendit referencat amerikane për këtë mësim.

Numri	Titulli	Data
STP 21-1-SMCT	Manuali i detyrave normale të ushtarit	Tetor 1990
FM 3-25.26(FM 21-16)	Leximi i hartës dhe orientimi në terren	Korrik 2001

Kërkesat për Instruktor: Një për 45 studentë.

Kërkesa shtesë personeli: Një ndihmës instruktor (preferohet nga vendi mik) për çdo ushtar

Pajisjet e kërkuara për mësim: Asnjë

Materialet e kërkuara për çdo ushtar që po stërvitet: uniformë me kamuflazh, helmetë, jelek me xhepa, armët individuale të serisë “Kallashnikov”, hartë dhe kompas për çdo pesë ushtarë.

Kërkesat për klasën/zonën stërvitore/poligonin:

Kursi i orientimit në terren në zonë të pyllëzuar (5 x 5) km.

Kërkesat për municion:

Asnjë

Instruksiione:

Asnjë

Kreu VI: REALIZIMI I STËRVITJES

- 6.1. Realizimi i mbikëqyrjes së stërvitjes
- 6.2. Ushtrimet stërvitore dhe detyrat
- 6.3. Procesi i realizimit të stërvitjes
- 6.4. Roli i komandantëve dhe drejtuesve
- 6.5. Roli i nënoficerëve

- 6.6. Përgatitja për stërvitje
- 6.7. Ekzekutimi i stërvitjes
- 6.8. Procesi i mirëmbajtjes pas stërvitjes

6.1. Realizimi i mbikëqyrjes së stërvitjes

6.1.1. Stërvitja më efektive për Forcat e Armatosura është stërvitja e orientuar nga performanca/rezultatet e kryera në kushte reale dhe taktikisht kërkuese. Për të gjitha njësitë operacionale kjo përfaqëson stërvitjen apo ushtrimet stërvitore të kryera në një mjedis taktik. Përparësia më e lartë që kërkohet është individi i orientuar nga misioni, stërvitja kolektive dhe drejtuesit për detyrat dhe ngjarjet që fokusohen në kompetencat bazë të kërkuara për të përgatitur ushtarët për luftë.

6.1.1.1. Qëllimi gjatë realizimit të detyrave stërvitore dhe ushtrimeve është të arrihen standardet e Forcave të Armatosura. Për të arritur këto standarde, të gjitha njësitë operacionale duhet të stërviten në kushte reale. Arritja e standardeve kërkon shumë punë nga komandantët e njësive, oficerët e shtabit, nënoficerët dhe ushtarët.

6.1.2. Komandantët dhe drejtuesit duhet të jenë të gatshëm të pranojnë më pak rezultate në fillim dhe të kërkojnë realizëm në zhvillimin e stërvitjes. Komandantët dhe drejtuesit e trupave të zbulojnë faktorët që ndikojnë gjatë veprimeve në fushën e stërvitjes dhe t'i integrojnë ata në kushte reale si komunikimet e dobëta, tymrat, zhurmat, rregullat e konfliktit, mjediset e simuluarat bërthamore, biologjike dhe kimike, mbetjet në fushën e betejës, humbjet e drejtuesve kryesorë, prania e civilëve në fushën e betejës dhe kushtet e ndryshme të motit. Komandantët dhe drejtuesit të mundësojnë lëvizjen e ushtarëve jashtë klasave dhe t'i vendosin në fushime; të bëjnë qitje me armët e tyre; të manovrojnë si një ekip i konsoliduar dhe të përfshijnë masat mbrojtëse kundër veprimeve të armikut.

6.2. Ushtrimet stërvitore dhe detyrat

6.2.1. Ka ushtrime stërvitore të njësive që formojnë blloqet e zakonshëm të ndërtimit dhe që mbështetin një grup të ndërthurur të Listës së Detyrave Themelore të Misionit dhe të kërkesave stërvitore. Komandantët të vlerësojnë përdorimin e ushtrimeve stërvitore të mëposhtme kur zhvillojnë planet stërvitore dhe matricat stërvitore të njësisë.

6.2.1.1. Stërvitja e zakonshme ushtarake: Ushtrimet e detyrueshme stërvitore janë thelbësore për ruajtjen e gatishmërisë së individit dhe njësisë. Kjo stërvitje është e përbashkët për të gjithë pjesëtarët e njësisë, pa marrë parasysh specialitetin apo gradën. Të gjitha programet stërvitore të njësisë duhet t'i përfshijnë këto kërkesa. Këto kërkesa nuk duhet të ndikojnë në stërvitjen individuale, në stërvitjen fizike, në trajnimin e drejtuesve, në stërvitjet kundër terrorizmit dhe në stërvitjen për mbrojtjen e forcave.

6.2.1.2. Thirrjet për betejë: Veprimet kolektive të zbatuara shpejt, pa aplikimin e një procesi vendimmarrjeje të qëllimtë, kërkojnë të zbatohen këto detyra: (1) urdhra minimale nga drejtuesit për t'u përmbushur; (2) të jenë të standardizuara; (3) reagime të menjëhershme ndaj veprimeve të armikut (4) hapat e kujdesshëm që duhen ndjekur për veprimet mësymëse dhe mbrojtëse në stërvitje dhe në luftim. Kushtrimet për betejë sjellin veprime të standardizuara, që i lidhin ushtarët dhe detyrat kolektive në nivelin e togës, por edhe më poshtë.

6.2.1.3. Ushtrim stërvitor i situatës: Një ushtrim i kufizuar, i lidhur me misionin e planifikuar për t'u stërvitur për një detyrë kolektive të listës së detyrave themelore të misionit, mund të jetë për shembull "sulmoni një objektiv, konsolidoni forcat mbi objektiv dhe përgatitni një mbrojtje të shpejtë".

6.2.1.4. Ushtrimet me zjarr të vërtetë: Një ushtrim, në të cilin përdoret municion i vërtetë, përdoret nga pjesëmarrësit në një situatë luftarake të krijuar realisht. Ushtrimet me zjarr të vërtetë japin avantazhe të theksuara, ku përfshihen:

- Këto ushtrime u japin ushtarëve mundësinë për t'u mësuar me armët e tyre, kështu që ushtarët do të dinë se si të përdorin në mënyrën e duhur armët e tyre në luftim.
- Ushtarët kanë një mundësi për të qëlluar me municion të vërtetë pa u trembur se armiku do t'u përgjigjet me zjarr.
- Ushtarët riaftësohen me ndjenjën dhe kohën e përdorimit e të mbarimit të municionit.
- Zhvillon besimin tek vetja dhe shpirtin e skuadrës (ekipit) tek njësia.
- Ushtarët mësohen me një eksperiencë reale të rrezikut, të konfuzionit e të shpejtësisë së veprimeve luftarake.

6.2.1.5. Ushtrimet e postëkomandës: Aty, ku forcat armike dhe mike simulohen, këto ushtrime mund të kryhen nga vendndodhjet e repartit/garnizonit. Njësia apo njësitë që stërviten, duhet të ta realizojnë këtë me të gjithë Listën e Detyrave Themelore të Misionit ose në detyra specifike të misionit.

6.2.1.6. Ushtrimet e komandës në fushim: është një ushtrim në fushim, me trupë më të vogël dhe me fuqi motorike, por me njësi të plota të mbështetjes së luftimit e të komandim kontrollit. Njësia stërvitet apo mund të stërvitet me të gjithë Listën e Detyrave Themelore të Misionit apo në detyra specifike të misionit, si ato mbrojtëse.

6.2.1.7. Ushtrim stërvitor në fushim: Një ushtrim i kryer në kushte të simuluar luftimi për një periudhë të shtrirë kohore. Ky ushtrim ushtron komandim kontrollin në të gjitha njësitë brenda organizmit ushtarak, në funksione betejë, kundër forcave kundërshtarë aktuale apo të simuluar.

Njësia stërvitet me të gjithë Listën e Detyrave Themelore të Misionit apo në detyra specifike të misionit.

6.3. Procesi i realizimit të stërvitjes.

6.3.1. Realizimi i suksesshëm i stërvitjes nuk është i thjeshtë. Është i bazuar në planifikimin e detajuar nëpërmjet përgatitjes për stërvitje, kryerjes së stërvitjes, ku në të përfshihet vlerësimi (shih kreun 5), në përputhje me standardet doktrinare të Forcave të Armatosura dhe mirëmbajtjen pas stërvitjes (personelit, pajisjeve dhe furnizimit), shihni figurën më poshtë.




Figura 6.3. Procesi i realizimit të stërvitjes.

Ky proces i realizimit të stërvitjes aplikohet në të gjitha nivelet e një organizmi ushtarak, që nga Komanda e Forcës së Bashkuar apo shtabi pjesëmarrës i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, që merr pjesë në një ushtrim të bashkuar stërvitor, deri tek drejtuesi i linjës së parë (Nënoficer apo oficer), tek stërvitja individuale e ekipit të tij.

6.4. Roli i komandantëve dhe drejtuesve.

6.4.1. Komandantët janë të përgjegjshëm për të gjitha aspektet e stërvitjes. Komandantët japin udhëzime stërvitore; miratojnë planet stërvitore; sigurohen që e gjithë përgatitja e kërkuar të jetë e kompletuar; marrin pjesë dhe vlerësojnë kryerjen e stërvitjes dhe, më në fund, sigurohen që të gjitha mirëmbajtjet në repart të kryhen. Komandantët fillojnë të planifikojnë ciklin tjetër stërvitor të bazuar në rezultatet e vlerësimeve të stërvitjes.

6.4.1.1. Planifikimi për stërvitjen duhet të jetë relativisht i centralizuar. Përparësitë stërvitore vendosen në të gjithë nivelet e një organizmi ushtarak. Realizimi i stërvitjes është i decentralizuar. Decentralizimi i përshtatet ekzekutimit të stërvitjes me burimet e stërvitjes, të lidhura me fuqitë dhe dobësitë e secilit individ, drejtues, dhe njësi nga elementet më të ulët deri tek ata më të lartë.

6.4.2. Komandantët duhet të vëzhgojnë personalisht, marrin pjesë dhe vlerësojnë realizimin e stërvitjes në maksimumin e mundshëm. Nëpërmjet vëzhgimit personal dhe pjesëmarrjes në stërvitje, komandantët i komunikojnë njësisive dhe drejtuesve vartës rëndësinë e stërvitjes.

6.4.3. Komandantët janë drejtuesit e stërvitjes për komandant e tyre dhe vlerësojnë veprimet e drejtuesve dhe ushtarëve të tyre. Të bazuar mbi vlerësimet e tyre, komandantët japin informacionin e mbledhur në zinxhirin komandues, për stërvitësit dhe për ata që stërviten. E rëndësishme për komandantët është të kryejnë një vlerësim të drejtë të stërvitjes së njësisë, të bazuar në vëzhgimet personale dhe informacionin e marë nga drejtuesit e njësisë dhe ushtarët. Vëzhgimet personale dhe pjesëmarrja i lejon komandantët që të:

- Mbikëqyrin dhe vlerësojnë cilësinë e stërvitjes në të gjitha nivelet e organizimit ushtarak, deri në nivelet më të ulëta.
- Të marrin informacion nga vartësit dhe ushtarët gjatë vizitave stërvitore.
- Të identifikojnë dhe zgjidhin të gjitha problemet në planifikimin e stërvitjes, drejtimin, menaxhimin, mbështetjen dhe funksionet e tjera.
- Të kontrollojnë përpikërinë e mbështetjes së stërvitjes nga jashtë dhe të kërkojnë veprim të menjëhershëm dhe korrigjues.
- Të njohin dhe menaxhojnë rreziqet potenciale të operacioneve nëpërmjet realizimit të stërvitjes.

6.4.4. Vizitat e komandantit dhe të shtabit për stërvitjen nuk lajmërohen, ato janë me afat të shkurtër. Komandantët duhet ta shikojnë stërvitjen me syrin se si ajo është përjetuar nga ushtarët dhe të parandalojnë përgatitjet e tepërta nga organizmat ushtarake vartëse (kjo, në vetvete mund të bëhet shkak për heqjen e vëmendjes nga stërvitja). Komandantët madhorë ia lejojnë koordinimin e mbështetjes së stërvitjes njësisive vartëse, si një përparësi dhe kërkesë për shtabet organizative. Mbështetja e stërvitjes dhe koordinimi i burimeve të stërvitjes janë të rëndësishme për realizimin me sukses të saj. Komandantët eprorë kontrollojnë përputhshmërinë e mbështetjes së jashtme të stërvitjes me vizitat dhe të kërkojnë veprime të menjëhershme dhe ndreqëse për të zgjidhur mangësitë në mbështetje.

6.5. Roli i nënoficerëve

6.5.1. Nëpërmjet një koordinimi të ngushtë dhe bashkëpunimi me komandantët dhe oficerët e tyre, nënoficerët kryejnë stërvitjen individuale të ushtarëve në detyra specifike që mbështesin detyrat themelore të misionit të njësisë. Nënoficerët janë në radhë të parë të përgjegjshëm për:

- Stërvitjen individuale të ushtarëve, grupeve të vegjël dhe skuadrave.
- Kryerjen e stërvitjes së orientuar nga performanca dhe bazuar në standardet.

- Stërvitjen e shumëfishtë për të siguruar që aftësitë më të mira luftarake të jenë brenda njësisë.
- Shpjegimin e detyrave individuale të ushtarëve, që lidhen me detyrat themelore kolektive të misionit të njësisë.
- Planifikimin, përgatitjen, realizimin e stërvitjes, dhe dhënien e informacionit nga poshtë lart.

6.5.2. Nënoficerët duhet të kujdesen për stërvitjen individuale të ushtarëve, skuadrave dhe ekipeve të vogla, nëpërmjet një koordinimi të ngushtë dhe bashkëpunimi me oficerët e tyre. Nënoficerët duhet t'i stërvitin ushtarët në detyra specifike që mbështesin detyrat themelore të misionit të njësisë. Nënoficerët janë shumë të vlefshëm për drejtuesit në të gjithë procesin stërvitor. Komandantët miratojnë detyrat e zgjedhura dhe mbikëqyrin e vlerësojnë stërvitjen me oficerët dhe nënoficerët në të gjithë procesin e realizimit të stërvitjes.

6.5.3. Nënoficerët janë të përgjegjshëm për integrimin e ushtarëve të rinj të sapo ardhur në njësi. Nënoficerët janë mjaft përcaktues për zhvillimin profesional të ushtarëve të rinj të sapo mobilizuar. Në njësi, stërvitja për aftësitë individuale prezantohet nga drejtuesi kryesor i stërvitjes. Drejtuesi kryesor i parë është normalisht një nënoficer dhe oficer në gradë të ulët, që ka përgjegjësitë e drejtpërdrejta mbikëqyrëse për ushtarët dhe detarët në organizmat ushtarakë. Drejtuesi kryesor i stërvitjes është i përgjegjshëm për stërvitjen në detyrat individuale të ushtarëve, skuadrave dhe grupeve të vegjël.

6.5.4. Drejtuesi kryesor dhe nënoficerët me grada të larta paraqesin objektivat e stërvitjes, të orientuara sipas standardeve të doktrinare të miratuara të Forcave të Armatosura. Nënoficerët drejtues kryejnë stërvitjen e shumëfishtë për të siguruar që aftësitë bazë luftarake të jenë brenda njësisë. Nënoficerët me grada më të larta i mësojnë nënoficerët me gradë më të ulët për një gamë të gjerë të detyrave individuale. Komandantët i lejojnë kohë stërvitore nënoficerëve për të kryer stërvitjen individuale dhe kërkojnë që detyrat individuale të përmbushen në bazë të LDTHM. Nënoficerët janë të përgjegjshëm për kryerjen e stërvitjes individuale në standardet e miratuara doktrinare dhe duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë, se si stërvitja për detyrat individuale lidhet me detyrat themelore kolektive të misionit.

6.5.5. Grupet e vogla, skuadrat dhe individët në detyrat e tyre për stërvitje bazohen në vlerësimin e drejtuesit të njësisë. Këto detyra janë të dhëna, ndërsa nënoficerët japin informacion në takimet e përjavshme, të miratuara nga komandanti, të përfshira në planet stërvitore të njësisë dhe në matricat e ardhshme stërvitore. Nënoficerët drejtues planifikojnë, përgatisin, përsërisin dhe kryejnë vëzhgime pas veprimeve për stërvitjen e miratuar dhe e japin informacionin në takimet e përjavshme stërvitore. Komandantët mund të miratojnë kryerjen e stërvitjes që nuk mund të këtë një fokus shumë të ngushtë taktik, por i përmbahet gatishmërisë së ushtarëve.

6.6. Përgatitja për stërvitje

6.6.1. Planifikimi formal afatshkurtër për stërvitjen përfundon me publikimin e matricës stërvitore të njësisë. Përgatitja për stërvitje është hapi vital ndërmjet planifikimit dhe kryerjes së stërvitjes. Përgatitja është e rëndësishme për sigurimin më të mirë të burimeve dhe për zhvillimin e stërvitjes cilësore, në përputhje me standardet e miratuara doktrinare. Gjatë përgatitjes për stërvitje, komandantët identifikojnë dhe eliminojnë shpërqendrimet e mundshme në stërvitje. Komandantët, gjithashtu, duhet të mbrojnë stërvitjen e njësisë së tyre nga shpërqendrimet e krijuara nga organizmat ushtarake më të larta. Komandantët i venë theksin përgjegjësive personale për të siguruar pjesëmarrjen maksimale në stërvitje.

6.6.2. Drejtuesit vartës, duke përdorur informacionin e marrë nga takimet periodike stërvitore, identifikojnë dhe zgjedhin detyrat individuale dhe kolektive të nevojshme për të arritur objektivat stërvitore.

6.6.3. Komandantët identifikojnë kërkesat burimore për stërvitjen përgatitore, për vazhdimësinë e stërvitjes dhe kryerjen e stërvitjes. Në minimum, komandanti duhet të adresojë kërkesat e mëposhtme burimore të stërvitjes:

- Konfirmimi i zonave dhe vendeve të stërvitjes.
- Municioni stërvitor, luftarak dhe manovër, si edhe shpërndarja.
- Baza materiale e nevojshme, në mbështetje të stërvitjes dhe të dhënat e mundshme mbi terrenin.
- Simulimet e stërvitjes dhe mundësia e simulatorëve.
- Kërkesat për transport.
- Pajisjet për mbështetjen e ushtarit.
- Vlerësimi i menaxhimit të rrezikut.
- Vlerësimi i përgjegjësive stërvitore.
- Përcaktimi i stërvitësve të përgjegjshëm për stërvitjen.
- Dhënia e kohës dhe burimeve të tjera për të mbështetur stërvitjen e nevojshme.

6.6.4. Përgatitja për stërvitje përmban:

6.6.4.1. Zgjidh detyrat, Identifiko dhe zgjidh detyrat stërvitore si rezultat i informacionit të marrë nga nivelet më të ulëta tek më të lartat e organizimit ushtarak dhe të vlerësimit të komandantit.

6.6.4.2. Planifiko stërvitjen dhe lidh objektivat stërvitore me LDTHM, si edhe me detyrat kritike kolektive të ushtareve dhe grupeve.

“Kush”, identifiko njësitë, shtabet, drejtuesit dhe ushtarët për t’u stërvitur.

“Çfarë”, specifiko objektivat stërvitore, llojet e ushtrimeve stërvitore dhe detyrat stërvitore për të cilat të stërvitesh.

“Kur”, specifiko fazat e detyrave stërvitore dhe ushtrimeve, për më tepër, konsidero fazat më të ulëta të stërvitjes dhe të nevojave stërvitore individuale të ushtarëve, të kërkuara më përpara dhe hapave më të avancuar të ngjarjeve stërvitore.

“Ku”, koordino poligonet, zonat stërvitore, simulimet dhe simulatorët dhe pajisjet e tjera thelbësore për të mbështetur detyrat e identifikuar stërvitore dhe ushtrimet.

“Përse”, sigurohuni që të gjithë në organizmat ushtarake dhe në komandat më të larta të kuptojnë rëndësinë e kësaj.

6.6.5. Në brifingun e komandantit më të lartë në ushtrimet e mëdha stërvitore.

- Jepni një brifing për komandën eprore për ngjarjet e mëdha (ushtrimet fushore stërvitore, ushtrimet e postëkomandës etj.).
- Jepni objektiva të detajuar, skenarë, kërkesa mbështetëse dhe vija kohore.
- Japin vlerësim për menaxhimin e rrezikut fillestar të operacionit.
- Marrin fjalën e komandantit epror për të minimizuar apo eliminuar shpërqendrimet stërvitore.

6.6.6. Stërvit stërvitësit.

6.6.6.1. Identifiko drejtuesit, stërvitësit, vlerësuesit, kontrollorët, vëzhguesit dhe forcën kundërshtare, në përputhje me standardet dhe realizo përsëritjen përpara kryerjes së stërvitjes.

- Përgatit drejtuesit, stërvitësit vlerësuesit, kontrollorët, vëzhguesit dhe forcën kundërshtare për të vlerësuar drejtuesin, njësinë, shtabin dhe performancën individuale të ushtarëve, në përputhje me standardet specifike doktrinare.
- Përgatit drejtuesit e forcës kundërshtare dhe njësitë për të përcaktuar kërcënimin e mundshëm dhe situatat; drejtuesit e dizenuar të forcës kundërshtare dhe njësitë, të cilët duhet të përdorin standarde specifike doktrinare.

Jepini kohë matricës stërvitore për përgatitjen e detyrave të mëvonshme.

6.6.6.2. Kryeni një përnjohje të zonës stërvitore apo poligonit.

- Kryeni përsëritje për lëvizjen në terren për stërvitësit, vlerësuesit, kontrollorët, vëzhguesit dhe forcën kundërshtare, sipas dëshirës.
- Kryeni një vlerësim të menaxhimit të rrezikut të operacionit.

6.6.6.3. Japin planin stërvitor.

- Identifikoni qartë përgjegjësitë për kryerjen e stërvitjes.
- Jepeni planin stërvitor si urdhër operacioni, si një udhëzim stërvitor apo si një matricë.

6.6.6.4. Përsëritni.

- Kryeni përsëritje për stërvitësit, vlerësuesit, kontrollor vëzhguesit dhe forcën kundërshtare.
- Përcaktoni kohën në orarin stërvitor për përsëritjet e duhura.

6.6.7. Kryeni kontrolle përpara ekzekutimit.

- A janë ushtarët të stërvitur në detyrat e kërkuara përpara kryerjes së stërvitjes?
- A janë kërkuar poligonet dhe ambiente ndihmëse; a është kryer përnjohja e terrenit?
- A janë drejtuesit të certifikuar për të vepruar në rrezen e operacioneve?
- A janë miratuar dhe dhënë kërkesat për autokolonën?
- A janë identifikuar dhe kërkuar materialet stërvitore mbështetëse, simulatorët?
- A janë koordinuar racionet e kërkuara, vajrat, karburantet, municionet dhe a janë koordinuar oraret e mbërritjes së tyre?
- A është kërkuar transportimi?
- A ka vlerësime të rrezikut për secilin ushtrim stërvitor?
- A është koordinuar zhvillimi i brifingut më pas për zinxhirin komandues?
- A është vënë kohë në dispozicion për ristërvitje?

6.7. Ekzekutimi i stërvitjes.

6.7.1. Stërvitja e orientuar nga performaca dhe e bazuar në standarde është rezultat i një planifikimi dhe përgatitjeje të detajuar. Ekzekutimi i duhur i stërvitjes në përputhje me standardin doktrinar është një proces shumë i vyer. Ekzekutimi i duhur i stërvitjes vendos një ngarkesë të madhe për stërvitësin në termin e përgatitjes dhe vlerësimit të performancës.

6.7.2. Komandanti i Forcës së Bashkuar dhe Komandanti i Brigadës/Regjimentit dhe shtabet e tyre të përfshihen në mënyrë aktive në stërvitjen e batalioneve dhe kompanive. Një njësi e realizon stërvitjen në të njëjtën mënyrë që plotëson edhe një mision luftimi. Zinxhiri komandues është i pranishëm, në krye të detyrës dhe i përgjegjshëm.

6.7.3. Komandantët sigurojnë që stërvitja e realizuar si duhet është e mirëstrukturuar, e sigurt, dhe efektive. Konsiderata të tjera të rëndësishme përfshijnë edhe sa më poshtë:

Fokusimi nga gjërat themelore. Njësitë duhet të jenë të afta në detyrat themelore përpara se të vazhdojnë në detyrat më komplekse.

Stërvitja natën dhe në kushte të vështira. Stërvitja natën dhe në kushte të vështira janë çelësi për suksesin në luftë. Të gjitha njësitë e Forcave të

Armatosura, jo vetëm ato që shkojnë në luftime, duhet të jenë të afta për të vepruar natën dhe në kushte të vështira moti.

Stërvitje e vështirë, reale. Stërvitja duhet të jetë e strukturuar për të nxjerrë në pah ushtarët dhe drejtuesit për situata të papritura, si të favorshme dhe jo të favorshme.

Konkurrimi. Stërvitja efektive të jetë konkurruese. Edhe pse ushtarët, drejtuesit dhe njësitë disa herë mund të konkurrojnë me njeri tjetrin, ata duhet gjithmonë të konkurrojnë për të arritur standardet doktrinare të miratuara.

Metodologjia. “Ngadalë-Më Shpejt-Stërvitja me Shpejtësinë e Luftimit”

Stërvitja realizohet duke përdorur teknikën “Shpejt-më shpejt-shpejtësi e luftimit”. Kjo lejon dhe promovon një mënyrë objektive të të vështuarit të stërvitjes, që bazohet në standardet doktrinare të miratuara.

6.7.3.1. Stërvitja fillon në nivelin bazë. Ngjarjet e ngadalta janë relativisht të thjeshta për t’u kryer dhe kërkojnë një mbështetje minimale nga njësia. Në fazën më të shpejtë, stërvitja bëhet gjithnjë e më e vështirë dhe kërkon më shumë burime nga njësia dhe nga reparti bazë, si edhe një nivel të shtuar realizmi. Në fazën e shpejtësisë së luftimit, niveli i vështirësisë për ushtrimin stërvitor intensifikohet. Faza e shpejtësisë së luftimit kërkon burime optimale dhe në mënyrë ideale i përafrohet nivelit real të kërkuar në luftë. Progresi drejt shpejtësisë më të madhe në luftim për një detyrë të veçantë mund të ndodhë gjatë një ushtrimi stërvitor njëditor apo mund të kërkojë disa periudha stërvitore me kalimin e kohës. Arritja e standardeve doktrinare të miratuara të Forcave të Armatosura vendos kalimin në nivelet e tjera.

Në shpejtësitë stërvitore ngadalë - më shpejt - shpejtësi luftimi, detyrat dhe standardet mbeten të njëjtë, gjithsesi, kushtet nën të cilat ata stërviten ndryshojnë. Komandantët mund të ndryshojnë kushtet, për shembull, duke shtuar vështirësinë e kushteve, nën të cilat detyrat kryhen, duke shtuar tempin e detyrës për të cilën stërviten, duke shtuar numrin e detyrave për të cilat stërviten apo duke shtuar numrin e personelit të përfshirë në stërvitje. Cilado mënyrë të përdoret, është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit dhe ushtarët e përfshirë të kuptojnë se për cilën fazë ata janë duke u stërvitur dhe të kuptojnë standardin doktrinar të miratuar të Forcave të Armatosura.

Ngadalë - Më shpejt - Stërvitja me shpejtësinë e luftimit

Ngadalë	Shpejt	Shpejtësia e Luftimit
Ushtarët	Ushtarët	Ushtarët
▪ Stërviten për çdo hap të detyrës	▪ Stërviten në standardin objektiv për stërvitjen	▪ Stërviten kolektivisht për të arritur dhe ruajtur aftësitë.
▪ Stërviten për hapat e detyrës me radhe	▪ Stërviten me shumë realizëm	▪ Stërvituni nën kushte që simulojnë luftimin e vërtetë.
▪ Stërviten për detyrën e kompletuar deri sa të kryhet në rregull	▪ Mësojnë aftësi të transferuara që lidhen me detyrat e tjera.	▪ Zhvillojnë marrëdhënie efektive ekipi.

- Punojnë si ekipe apo njësi të vogla

Drejtuesit/Stërvitësit	Drejtuesit/Stërvitësit	Drejtuesit/Stërvitësit
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Flisni dhe tregoni çdo detyrë. ▪ Mbikëqyrni praktiken hap pas hapi ▪ Mësoni shpesh. ▪ Kontrolloni ambientin. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kryeni detyrën duke përdorur me shumë realizëm. ▪ Shtoni kompleksitetin. ▪ Tregoni fushimet e autorizuara. ▪ Merrni pjesë si drejtuesi I një ekipi apo të një skuadre të vogël. ▪ Vëreni, mësoni dhe rishikoni. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shtoni realizmin dhe kompleksitetin. ▪ Kombinoni detyrat. ▪ Rishikoni performancën e ushtarëve dhe atë kolektive. ▪ Praktikoni detyrat e drejtuesit. ▪ Punoni me ushtarët si një ekip i vetëm. ▪ Mësoni dhe drejtoni drejtuesit vartës.

Figura 6.7. Plotësimi i stërvitjes.

Një Rishikim pas veprimit (AAR) duhet të kryhet përherë, menjëherë pas stërvitjes dhe mund të tregojë që një stërvitje tjetër shtesë është e nevojshme. Çdo detyrë që nuk është plotësuar në standard duhet të ristërvitet. Ristërvitja të kryhet në momentin e parë të mundshëm.

6.7.4. Komandantët të programojnë kohë dhe burime të tjera për ristërvitjen, si pjesë përbërëse e ciklit të tyre planifikues afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër. Stërvitja është e papërfunduar deri sa detyra të stërvitet në përputhje me standardin doktrinar të miratuar. Ushtarët e mbajnë mend gjithmonë standardin stërvitor të përjetuar dhe jo atë të diskutuar.

6.7.5. Komandantët përdorin të njëjtën mënyrë, duke venë në punë simulimet virtuale dhe konstruktive, për të stërvitur shtabet e tyre të betejës dhe organizmat vartës. Komandantët mundohen të arrijnë dhe mbajnë një nivel mjaft të lartë të aftësive të tyre taktike.

6.7.6. Stërvitësit përdorin mënyrën e duhur të kombinimit të demonstrimeve, konferencave, diskutimeve dhe aktiviteteve të praktikuarra për të prezantuar stërvitjen. Duke përdorur mënyrën ngadalë - më shpejt - shpejtësi luftimi, ata informojnë individët që stërviten për objektivat stërvitore (detyrat, kushtet dhe standardet) dhe metodat e duhura të vlerësimit.

Stërvitësit menjëherë ndjekin prezantimin me praktikën, për të kthyer informacionin në detyra të përdorshme individuale dhe kolektive. Sasia e detajeve të përfshira në praktikë varet nga niveli i eksperiencës. Nëse individët apo organizatat po marrin stërvitjen fillestare në një detyrë themelore të misionit, stërvitësit theksojnë kushtet bazë. Ndërsa ata që po mësohen janë duke kryer stërvitje mbështetëse në një detyrë, stërvitësit rrisin nivelin e të dhënave dhe realizimit deri sa kushtet të provohen në mjedise luftimi sa më

shumë të jetë mundur. Shtërvitësit kërkohen nga ata me eksperiencë të konsiderueshme për të kryer detyra të shumta shtërvitore, brenda një skenari të dhënë shtërvitor.

6.7.7. Shtërvitja e realizuar dhe e prezantuar ashtu si duhet është reale, e sigurt, e përpiktë, e mirëstrukturuar, efikase dhe efektive.

6.7.7.1. Shtërvitja reale kërkon që organizmat ushtarake të shtërviten ashtu si do të luftojnë apo të mbështeten brenda të gjitha dimensioneve të fushëbetesës. Shtërvitja reale përfshin të gjithë elementet e mundshëm të grupeve me armë të kombinuara dhe si duhet, me ekipe ndër agjencish, shumëkombëshe e "Joint". Shtërvitja reale përmirëson përdorimin e mjeteve shtërvitore, simulatorëve dhe simulimeve për të eliminuar streset, zhurmat dhe kushtet e luftimit.

Shtërvitja e sigurt është rezultati i parashikueshëm i kryerjes së standardeve të vendosur teknike dhe taktike. Njëpërmjet procesit të menaxhimit të rrezikut, drejtuesit e të gjitha shkallëve sigurohen që kërkesat për sigurinë të jenë integrale dhe jo konsiderata shtesë për të gjitha aspektet e planëzimit, realizimit dhe vlerësimit të shtërvitjes.

6.7.7.2. Shtërvitja e duhur përputhet me doktrinën operacionale dhe shtërvitore të Forcave të Armatosura dhe është teknikisht korrekte. Shtërvitja dhe publikimet doktrinare japin informacionin aktual për shtërvitësit për të lehtësuar kryerjen e shtërvitjes, për të drejtuar shtërvitësit vartës dhe për të vlerësuar rezultatet e shtërvitjes.

6.7.7.3. Shtërvitja e mirëstrukturuar përmban një përzierje të shtërvitjes fillestare dhe asaj mbështetëse. Gjithashtu, përbëhet nga një përzierje e detyrave individuale dhe të drejtuesve, që janë të integruara në detyrat kolektive të LDTHM. Ushtarët dhe drejtuesit rrisin aftësinë në detyrat individuale ndërsa shtërviten për detyrat themelore kolektive të misionit.

6.7.7.4. Shtërvitja efikase siguron që burimet shtërvitore të përdoren ashtu si duhet. Shtërvitja e ekzekutuar me efikasitet ve në përdorim të plotë kohën e çdo pjesëmarrësi. Komandantët monitorojnë burimet financiare dhe fizike. Ata përdorin këtë informacion të marrë gjatë këtyre formave për të rregulluar burimet brenda komandave të tyre, për të mbështetur efikasitetin e LDTHM. Avantazhet e vazhdueshme në teknologjitë shtërvitore rrisin aftësitë e komandantit për të përmirësuar aftësitë luftuese dhe kërkohen gjithnjë e më shumë për të balancuar mangësitë në shtërvitje, si mbrojtja ndaj elementeve dhe konsideratat e pasjes së poligoneve dhe zonave shtërvitore. Në mënyrë të njëjtë, ndihmësit shtërvitorë, mjetet, simulatorët dhe simulimet jo vetëm që japin një mundësi për mbajtjen fillestare të shtërvitjes në bazën e saj të kryerjes së luftimit, por japin edhe një mënyrë relativisht pak të kushtueshme për përgatitjen e burimeve dhe ushtrimet shtërvitore intensive. Nuk ka asnjë zëvendësim për eksperiencën më të mirë të shtërvitjes së drejt për drejtë.

6.7.7.5. Shtërvitja efektive ndërton aftësitë, punën në ekip, besimin, dhe ngjitjen. Shtërvitja efektive është konkurruese. Edhe pse individët dhe organizmat, disa herë mund të konkurrojnë kundër njeri tjetrit, ata gjithmonë

duhet të arrijnë standardin e duhur. Nëse ata nuk arrijnë fillimisht standardin doktrinar të përshkruar, stërvitësit ndërmarrin veprime korigjuese në mënyrë që nivelet e duhura të performancës të arrihen.

6.7.7.5.1. Konsiderata të tjera për kryerjen e stërvitjes efektive janë.

Stërvitja dhe vlerësimi. Stërvitjet efektive të drejtuesve dhe ato individuale drejtohen nga përdorimi i linjave të stërvitjes dhe vlerësimit. Kjo mënyrë e vlerësimit dhe e stërvitjes jep të dhëna përmbledhëse në lidhje me objektivat kolektive stërvitore, si edhe për detyrat individuale e të drejtuesve, që mbështesin objektivat kolektive stërvitore. Ata gjithashtu japin informacion në lidhje me kërkesat e burimeve dhe standardeve të vlerësimit, që u aplikohen situatave stërvitore. Dokumentet kryesore burimore për stërvitjen dhe vlerësimin janë doktrina e publikuar dhe e miratuar taktike dhe publikimet e tjera për stërvitjen e ushtarëve. Në qoftë se kushtet në këto publikime mund të ndryshojnë, stërvitësit i rregullojnë dhe i shtojnë stërvitjet dhe vlerësimet, kushtet për t'i konfirmuar me faktorët e misionit, armikut, terrenit dhe kohës, trupave dhe mbështetjes së mundshme, kohës në dispozicion dhe konsideratave civile, që janë në planet operacionale të organizmit ushtarak.

Stërvitja individuale. Thelbësore për përshtatjen e forcës është zhvillimi dhe mirëmbajtja e aftësive individuale, që nxjerrin ushtarë teknikisht dhe taktikisht të aftë, të cilët kanë besim në aftësitë e tyre. Individualiteti i ushtarit është zemra e aftësisë së njësisë për të kryer misionin e saj. Aftësia për të kryer detyrat e miratuara individuale/drejtuesit në standardin doktrinar i gjejnë në bazën stërvitore institucionale, por përmirësohet dhe mirëmbahet nga detyra periodike të përsëritura. Mjetet stërvitore, simulatorët dhe stërvitja me bazë në internet mund të përdoren për të lehtësuar stërvitjen e detyrave individuale.

Stërvitja e drejtuesve. Drejtuesit shpenzojnë gati të gjithë kohën në dispozicion për stërvitje, duke mbikëqyrur stërvitjen e vartësve. Shpesh, ata nuk e shtojnë kuptimin e tyre se si të luftojnë, si drejtues luftimi apo drejtues në mbështetje. Prandaj, komandantët eprorë duhet të vëzhgojnë stërvitjen e drejtuesve, si një proces të vazhdueshëm, që përfshin më shumë se një klasë të zhvillimit profesional për oficerët apo nënoficerët. Komandantët eprorë vendosin një mjedis pozitiv stërvitor që inkurajon vartësit të bëhen drejtues, të përshtatshëm, të aftë për të menduar në lëvizje dhe për të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur, të bazuar në drejtimet dhe qëllimet e gjera të urdhrave të misionit dhe një vizioni të përbashkët për fushëbetejën. Drejtuesit në rritje dhe maturim janë pjesa jetësore e një programi efektiv stërvitor. Stërvitja e drejtuesve, kur kryhet ashtu si duhet, prodhon drejtues që dinë të përshtaten, konfident dhe kompetentë. Si përfundim, ata përgatitin ushtarë që kanë besim në aftësitë e drejtuesve të tyre.

Listat e betejës. Listat e betejës mbahen në batalion dhe më poshtë, për të pasur të dhënat e informacionit kyç në sistemet e disa mjeteve themelore të misionit (si për shembull këmbësoria, makinat e luftimit, topat, sistemet e automatizuara të komandim kontrollit, etj.). Ato mbajnë të dhëna si stabiliteti i ekipeve dhe nivelet operacionale, ashtu edhe statusin e kualifikimit. Një aspekt

kryesor i listës së betejës është planifikimi i zëvendësve të kualifikuar të operatorëve apo mekanikëve të caktuar në pozicione të tjera në organizmin ushtarak. Gjatë realizimit të stërvitjes, pjesëtarët e ekipit me emrin në listën e betejës stërviten me ekipet e tyre normale në mundësitë e dhëna. Komandantët duhet të disiplinonë sistemin e listës së betejës.

Stërvitja për shtabin e betejës. Stërvitja për shtabin e betejës zhvillon dhe mbështet planifikimin, koordinimin, ekzekutimin dhe funksionet e tjera të shtabit, të lidhura me kërkesat e misionit të kohës së luftës. Stërvitja për shtabin e betejës del nga LDTHM e shtabit. Komandantët i stërvitin shtabet e betejës në mënyrë parësore, nëpërmjet një përzjerje të simulimeve virtuale dhe konstruktive. Ata çojnë në maksimum përdorimin e teknologjisë së informacionit, për të zhvilluar aftësitë e drejtuesve, për të zhvilluar aftësinë e nevojshme të të përshtaturit dhe për të zhvilluar teknologjinë e informacionit. Shtabet e betejës stërviten për të integruar dhe koordinuar funksionet e luftimit me armë të kombinuara brenda për brenda komandave të tyre, horizontalisht me shtabet e tjera në të njëjtin nivel organizativ dhe vertikalisht me shtabet më të larta e ato vartëse. Rezultati i këtij procesi stërvitor prodhon komandantë dhe shtabe të aftë për të sinkronizuar funksionet luftarake me armë të kombinuara në të gjithë spektrin e operacioneve. Një shtab beteje i mirëstërvitur është një shumëfishues luftimi.

Stërvitja e bashkuar, ndër agjencish dhe shumëkombëshe.

Kjo stërvitje kërkon konsiderata të ndryshme. Stërvitja e bashkuar kryhet duke përdorur doktrinën dhe taktikën e duhur të përbashkët, teknikat dhe procedurat dhe duhet të jetë konsistente me misionet dhe përparësitë e përbashkëta të caktuara. Kur i jepen një force të bashkuar, komandantët e Forcave të Bashkuara vendosin objektiva dhe plane të bashkuara, ekzekutojnë dhe vlerësojnë stërvitjen e bashkuar dhe vlerësojnë aftësitë stërvitore të bashkuara. Stërvitja shumëkombëshe përmirëson kontributet e pjesëtarëve të forcës, duke i përputhur misionet e tyre me aftësitë e tyre dhe duke përdorur stërvitjen e duhur dhe programet e asistencës. Ushttrimet e mëdha në fushim mund të kompletohen duke përdorur simulimet për të shtuar stërvitjen shumëkombëshe. Publikimet e stërvitjes së bashkuar janë të gatshme për partnerë shumëkombësh. Stërvitja ndër agjencish është me një rëndësi në rritje. Kur misionet e forcave të armatosura përfshijnë agjencitë e qeverive të vendeve të tjera, stërvitja duhet të kryhet me organizmat dhe njerëzit që kanë mundësi të përfshihen në misionet e caktuara. Kjo lloj stërvitjeje është aq e fortë sa edhe çdo mision tjetër i Forcave të Armatosura. Kjo stërvitje gjithashtu rezulton në vlerësimin e përbashkët për aftësitë e tjera dhe zhvillimin e marrëdhënieve të vlefshme personale dhe profesionale ndërmjet atyre që operojnë së bashku.

6.8. Procesi i mirëmbajtjes pas stërvitjes

6.8.1. Procesi i mirëmbajtjes pas stërvitjes është një shtesë e stërvitjes dhe pasi të plotësohet, do të thotë përfundimi i procesit stërvitor. Mirëmbajtja pas stërvitjes përfshin kryerjen e stërvitjes mirëmbajtëse, kthimin e materialeve

stërvitore dhe kryerjen e rishikimeve pas stërvitjes me efektshmërinë e përgjithshme të stërvitjes.

6.8.2. Stërvitja mirëmbajtëse është kryerja e veprimeve pas stërvitjes, e kontrollit të mirëmbajtjes dhe shërbimeve, llogaritja e pajisjeve individuale të organizmit ushtarak dhe inspektimet përfundimtare të të gjitha materialeve mbështetëse të llogaritura, të kthyer, vendet stërvitore dhe ambientet e mbyllura.

6.8.2.1. Rishikimet pas stërvitjes që kryhen gjatë kësaj faze fokusohen në performancën e detyrave individuale dhe të drejtuesve, në planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e stërvitjes. Rishikimet e veprimeve të njësisë në performancën e detyrave individuale dhe kolektive, identifikojnë mangësitë dhe stërvitjen që duhet për të korrigjuar mangësitë. Rishikimet, pas veprimeve të kryera me drejtuesit, fokusohen në gjykimin taktik. Këto i japin mësimit të drejtuesve mundësinë për zhvillimin e tyre. Rishikimet pas veprimit, që kryhen me stërvitësit, vlerësuesit, vëzhgues kontrollorët dhe forcat kundërshtarë, japin më shumë mundësi për zhvillimin e drejtuesve.

6.8.2.2. Rishikimet pas veprimeve të kryera gjatë mirëmbajtjes pas stërvitjes së bashku me rishikimet pas stërvitjes që bëhen gjatë kryerjes së stërvitjes, përmirësojnë stërvitjet e tjera në të ardhmen. Ato japin informacionin e nevojshëm, që kontribuon për zhvillimin e planeve të stërvitjes, për të korrigjuar mangësitë e identifikuar. Si përfundim, këto rishikime pas veprimeve, kontribuojnë në vlerësimin e përgjithshëm të komandantit për efektshmërinë e stërvitjes dhe vlerësimin e njësisë. Gjithsesi, ato nuk janë në vetvete gjendja finale e mirëmbajtjes së kryer pas stërvitjes. Mirëmbajtja e kryer pas stërvitjes është e kompletuar, kur njësia është përsëri e përgatitur për të kryer misionin e saj të caktuar.

Kreu VII: VLERËSIMI DHE GJYKIMI I STËRVITJES

- 7.1. Procesi i vlerësimit të stërvitjes
- 7.2. Procesi i gjykimit të stërvitjes
- 7.3. Organizimi i vlerësimit dhe gjykimit
- 7.4. Llojet e vlerësimit
- 7.5. Vlerësimi i stërvitjes
- 7.6. Rishikimi pas veprimit (AAR)

- 7.7. Mësimet e nxjerra
- 7.8. Vlerësuesit
- 7.9. Stërviitja e vlerësuesve
- 7.10. Planifikimi për vlerësimet
- 7.11. Vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës dhe i planëzuar
- 7.12. Roli i komandantëve dhe i drejtuesve eprorë

7.1. Procesi i vlerësimit të stërviitjes.

7.1.1. Vlerësimi i Stërviitjes është përgjegjësi e komandantit. Ky proces përdoret nga komandanti për të aftësuar organizmin ushtarak të përmbushë misionet e veta operacionale në kohë paqe, krizash dhe luftime. Procesi i vlerësimit të stërviitjes është njëherësh fillimi dhe fundi i ciklit të menaxhimit të stërviitjes. Rezultatet e vlerësimit të stërviitjes së njësisë i japin komandantit vizionin që ai të hartojë dhe zhvillojë planin e ardhshëm stërvitor.

7.1.2. Vlerësimi i stërviitjes përfshin një larmi të dhënash. Këto të dhëna japin lidhjen ndërmjet performancës së njësisë dhe standardit doktrinar të miratuar të Forcave të Armatosura. Vlerësimet e stërviitjes i japin komandantit informacion mbi aftësinë e treguar në stërviitje të ushtarëve, drejtuesve, shtabit të betejës dhe njësisve. Komandantët nuk mund të vëzhgojnë të gjithë stërviitjen në organizmin (strukturën) ushtarakë të tyre, prandaj marrin informacion nga komandantët e vet vartës dhe oficerët, nënoficerët e shtabit.

7.2. Procesi i gjykimit të stërviitjes.

7.2.1. Procesi i gjykimit të stërviitjes plotëson procesin e vlerësimit të stërviitjes dhe është një vlerë përbërëse e të gjithë sistemit të menaxhimit të stërviitjes. Gjykimi është subjektiv dhe objektiv në natyrë. Gjykimi i stërviitjes është një proces i vazhdueshëm që përfshin përgatitjen, vlerësimin e stërviitjes, si dhe kryerjen e gjykimit të organizmit ushtarak (strukturës). Komandanti përdor eksperiencën e tij, informacionin e marrë nga organizmat ushtarakë vlerësues, vlerësimet e tjera, si edhe raportet për të mbërritur në gjykimin e tij përfundimtar. Si vlerësimi i stërviitjes edhe gjykimi i saj ndodhin në fund dhe në fillim të ciklit të menaxhimit të stërviitjes. *Gjykimi lidh stërviitjen e sapo kryer dhe të vlerësuar me planet e mëvonshme stërvitore të komandantit.*

7.2.2. Gjykimi i stërviitjes është më shumë se thjesht vlerësimi i stërviitjes. Ai përbëhet nga një varietet i zgjeruar të dhënash. Gjykimet përfshijnë sisteme kaq të ndryshme si stërviitja, logjistika, mbështetja me infrastrukturë dhe personeli. Këto sisteme japin lidhjen ndërmjet performancës së njësisë dhe standardit të Forcave të Armatosura. Vlerësimet e stërviitjes i japin komandantit informacionin e nevojshëm në lidhje me aftësitë stërvitore të ushtarëve, drejtuesve, shtabit të betejës dhe njësisve.

7.3. Organizimi i vlerësimit dhe gjykimit.

7.3.1. Komandanti i Batalionit, Brigadës dhe i niveleve më të larta duhet të kenë një vizion të gjerë të objektivave vlerësuese stërvitore. Në bazë të tyre ata kryejnë vlerësimet që kombinojnë një numër të konsiderueshëm gjykimesh. Këta komandantë vendosin një vlerësim institucional dhe një program gjykimesh që:

- Të caktojë përgjegjësitë brenda shtabit dhe njësive vartëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të vlerësimit dhe përgatitjen e rekomandimeve.
- Të përqendrohet në efektshmërinë e stërvitjes së drejtuesve dhe të organizmit ushtarak.
- Të përdorë këshilltarin dhe nënoficerët e tjerë për të mbledhur informacion mbi stërvitjen Individuale, të grupeve dhe skuadrave.
- Lejon komandantin epror të monitorojë informacionin që del dhe të ndër marrë hapa për të rivendosur përparësitë, rregulloret apo planet për të eliminuar mangësitë e vërejtura dhe për të ruajtur fuqitë e treguara.

7.3.2. Disa burime të rëndësishme të informacionit të marrë për vlerësimin e komandantit epror dhe gjykimin e aftësive të organizmit ushtarak për të plotësuar misionet e kohës së luftës janë:

- Disa vërejtje personale të mara gjatë pjesëmarrjes në stërvitje.
- Vlerësimi dhe informacioni i marrë nga komandat më të larta.
- Raportimet e vizitave të shtabit.
- Statusi i njësisë/raportet e gatishmërisë.
- Brifingjet stërvitore.
- Vlerësimet vendore stërvitore.

7.3.2.1. Rishikimi pas veprimeve në ushtrimet fushore, me armë apo ushtrimeve të tjera specifike.

- Rishikimi pas veprimeve dhe raportet që dalin nga aktivitetet stërvitore.
- Mobilizimi/vendvendosja dhe raportimet e ushtrimeve.
- Mirëmbajtja dhe vlerësimet logjistike dhe rezultatet e inspektimeve teknike.
- Inspektimet nga inspektori i përgjithshëm dhe inspektimet speciale.
- Rezultatet e testimeve të aftësive fizike.
- Të dhënat në kualifikimin e armëve.
- Rezultatet individuale të ushtarëve në detyrat testuese të zakonshme.
- Programi i inspektimit të komandantëve.

7.4. Llojet e vlerësimit

7.4.1. Vlerësimet mund të jenë informale, formale, të brendshme, të jashtme apo një kombinim i tyre.

Vlerësimet informale bëhen kur një drejtues kryen stërvitjen me njësinë e tij, për shembull, kur një komandant skuadre e stërvit skuadrën e tij për të vendosur një postbllok automjetesh dhe vlerëson performancën e skuadrës në përputhje me standardin doktrinar. Një shembull tjetër do të ishte, kur një drejtues vëzhgon stërvitjen që po kryhet, për shembull kur një komandant batalioni vëren stërvitjen e kompanisë dhe i jep informacion të drejt për drejt komandantit të kompanisë. Ky lloj vlerësimi jep informacion të menjëhershëm në mjedisin stërvitor dhe në aftësitë që rezultojnë nga stërvitja.

Vlerësimet Formale janë burime që dalin nga vlerësues me eksperiencë, të stërvitur, të dedikuar dhe në mënyrë të përgjithshme ato planifikohen në planet stërvitore afatgjatë ose afatshkurtër. Vlerësimet formale normalisht nënvizohen gjatë brifingjeve të një kohe të shkurtër. Në sasinë më të madhe të mundshme, komandat dy shkallë më lart kryejnë vlerësime formale të jashtme; për shembull, komandanti i KFB vlerëson batalionet; komandant i Brigadës ose i Regjimentit vlerësojnë kompanitë; komandantët e batalioneve vlerësojnë togat dhe komandantët e kompanive vlerësojnë skuadrat. *Për më tepër, Shtabi i Përgjithshëm vlerëson KFB, KDS, KM dhe BrRSH gjatë të gjitha vlerësimeve formale.*

Vlerësimet e brendshme planifikohen, plotësohen me burime dhe kryhen nga organizmat (strukturat) ushtarake, ku po kryhet vlerësimi. Vetëvlerësimet konsiderohen vlerësime të brendshme dhe mund të jenë formale ose informale.

Vlerësimet nga jashtë janë të planifikuara, të plotësuara me burime dhe kryhen nga një komandë e një shkalle më lart në zinxhirin komandues, se sa njësi që është duke u vlerësuar apo një komandë jashtë zinxhirit komandues. Një vlerësim i NATO-s konsiderohet një vlerësim i jashtëm formal.

7.4.2. Vlerësimi i individëve dhe stërvitja e njësive të vogla normalisht përfshin çdo ushtar dhe drejtues të përfshirë në stërvitje. Për ushtrimet e mëdha stërvitore, vlerësuesit marrin një numër të mjaftueshëm individësh kryesorë dhe të strukturave ushtarake vartëse për të vendosur nëse i tërë organizmi (struktura) ushtarake është në gjendje të kryejë detyra specifike për misionin në standardin e kërkuar.

7.4.3. Gjatë dhe pas vlerësimit formal, vlerësuesit përgatitin përfundimet dhe rekomandimet e veta. Ata menjëherë i dërgojnë këto raportime tek komandanti i njësisë që po vlerësohet dhe në komandat më të larta, siç kërkohen nga komandantët që drejtojnë vlerësimin. Dokumentacioni i vlerësimit gjatë një vlerësimi të jashtëm mund të shtrihet nga një përshkrim i Stërvitjes dhe Vlerësimit, deri në një raport gjithëpërfshirës në njësitë. Procesi i raportimit të vlerësimit formal nuk duhet të jetë shumë i gjerë apo i shtrirë në kohë të gjatë, sepse humbet rëndësia dhe aktualiteti i vlerësimit.

7.5. *Vlerësimi i stërvitjes.*

7.5.1. Vlerësimet e stërvitjes janë një komponent i rëndësishëm i çdo programi stërvitor dhe i sistemit të menaxhimit të stërvitjes. Vlerësimi “mat” aftësinë e treguar të ushtarëve, komandantëve, drejtuesve, shtabit të betejës dhe njërive me standardin doktrinar. Vlerësimi i stërvitjes së duhur e të standardizuar është pjesë përbërëse për konceptin e stërvitjes dhe guri themeltar për stërvitjen dhe zhvillimin e drejtuesve.

7.5.1.1. E gjithë stërvitja të vlerësohet në mënyrë sistematike, për të matur nivelet e performancës së vendosur nga doktrina. Vlerësimi i stërvitjes duhet të jetë i vazhdueshëm për të qenë i efektshëm dhe vlerësimi mund të jetë sa i rëndësishëm, aq edhe joformal, aq sa vlerësimi i brendshëm i kryer nga drejtuesi që po drejton stërvitjen.

7.5.2. Vlerësimi kryhet në mënyrë specifike për të bërë të mundur që njësia, shtabi, drejtuesi apo individ i që po kryejnë stërvitjen të dinë në mënyrën e duhur nëse standardi stërvitor është arritur. Komandantët duhet të vendosin një klimë komandimi të tillë që të marrin një informacion të drejtë e të sinqertë mbi qëllimin e zhvillimit të drejtuesve dhe të njësive që janë stërvitur.

7.5.3. Vlerësimi i stërvitjes nuk është një test; nuk përdoret për të gjetur arsye për të përshkuar drejtuesit dhe ushtarët për mangësitë në stërvitje. Vlerësimi është një instrument themelor i stërvitjes që informon njësinë apo ushtarët nëse ata kanë arritur standardin doktrinar apo jo dhe në këtë mënyrë i ndihmon ata të vendosin efektshmërinë maksimale të planeve të tyre stërvitore. Stërvitja pa vlerësim dhe stërvitja me një sistem të pa standardizuar vlerësimi janë shpërdorim i kohës dhe i burimeve.

7.5.4. Drejtuesit duhet të përdorin vlerësimin si një mundësi për të drejtuar dhe mësuar vartësit e tyre. Një element i rëndësishëm në zhvillimin e drejtuesve është informacioni i menjëhershëm dhe i drejtë që i drejton vartësit nga arritja e standardit doktrinar. Vlerësimet stërvitore të kryera siç duhet janë mënyra të testuara e të provuara për të zhvilluar drejtues të përshtatshëm, të besueshëm dhe kompetentë.

7.6. Rishikimi pas veprimit (AAR)

7.6.1. Rishikimi pas veprimit (AAR), formal apo joformal, jep informacion të rëndësishëm e të nevojshëm për të gjithë stërvitjen. AAR është një proces rishikimi i strukturuar, i cili lejon ushtarët pjesëmarrës, drejtuesit, shtabet dhe njësitë të zbulojnë vetë se çfarë ka ndodhur gjatë stërvitjes, përse ndodhi dhe se si stërvitja mund të kryhet më mirë në të ardhmen. AAR është diskutim me dy anë, profesional, ndërmjet vlerësuesve dhe të vlerësuarve, çka kërkon pjesëmarrjen aktive të atyre që po stërviten. AAR e organizuar dhe e kryer ashtu siç duhet nuk është një kritikë dhe ka avantazhet në vazhdim mbi një kritikë, por:

- Fokusohet drejt për drejt në LDTHM kyçe të dala nga objektivat stërvitore.

- Thekson standardet doktrinare në vend që të japë vendim mbi suksesin apo zhgënjimin.

- Përdor “Pyetje testuese” për të inkurajuar pjesëmarrësit të zbulojnë vetë mësimet e rëndësishme nga ushtrimi stërvitor, për shembull: “përse njësia juaj pati vështirësi në arritjen e objektivit gjatë sulmit të parë?”.

- Lejon një numër të madh individësh dhe drejtuesish të marrin pjesë, kështu që shumë nga aspektet planëzuese qendrore mund të rishikohen dhe më shumë mësimet të mësuara mund të ndahen.

7.6.1.1. Rishikimi pas veprimit përbëhet nga katër pjesë:

a. Një rishikim përmbledhës se çfarë duhej të ndodhte (planet stërvitore dhe matricat). Vlerësuesi, së bashku me pjesëmarrësit, rishikon se çfarë duhej të kishte ndodhur, duke u bazuar në qëllimin e komandantit për ushtrimin stërvitor, për planin stërvitor të njësisë, objektivat stërvitore dhe vijat e përgjithshme që i përkasin Stërvitjes dhe Vlerësimit.

b. Vendos se çfarë ka ndodhur në fakt. Vlerësuesi dhe pjesëmarrësit vendosin se çfarë ka ndodhur në të vërtetë gjatë kryerjes së detyrës stërvitore. Një ngjarje faktike dhe e padiskutueshme është jetësore për efektshmërinë e diskutimit që vjen më vonë. Për stërvitjen forcë mbi forcë, pjesëtarët e Forcës Kundërshtare ndihmojnë në përshkrimin e rrjedhjes së ngjarjeve stërvitore dhe diskutojnë ato që kanë dalë nga stërvitja, nga këndvështrimi i tyre. Gjatë një vlerësimi të ngjarjeve në një stërvitje forcë mbi forcë, është e rëndësishme fokusimi në ngjarjet e ndodhura stërvitore, si nga vëzhgues-kontrollori, edhe nga pikëpamja e pjesëmarrësve.

c. Vendosni se çfarë ishte e drejtë dhe çfarë ishte e gabuar në atë që ndodhi. Pjesëmarrësit vendosin pikat e dobëta dhe të forta të performancës së tyre. Vlerësuesi luan një rol kritik në udhëheqjen e diskutimit, kështu që konkluzionet që arrihen nga pjesëmarrësit të jenë të sakta nga ana doktrinare dhe të kenë rëndësi për misionet funksionale apo operacionale të kohës së luftës.

d. Vendosni nëse, apo si, detyra duhet të kryhet ndryshe herën tjetër. Nëse ka tregues të mjaftueshëm, atëherë vlerësuesi ndihmon zinxhirin komandues që po ndërmerret stërvitjen të drejtojnë grupin në marrjen e rekomandimeve për atë se si pjesëmarrësit do të sillen ndryshe herën tjetër që do të kryhet detyra. Këto rekomandime duhet të prodhojnë motivime individuale dhe të organizmit ushtarak për të kryer stërvitje shtesë në të ardhmen, në përputhje me standardet doktrinare.

7.6.2. Drejtuesit të kuptojnë që jo të gjitha detyrat do të kryhen domosdoshmërisht në standardin e duhur dhe në planifikimin e tyre fillestar duhet t’u japin kohë të mjaftueshme dhe burime të tjera për ristërvitjen. Ristërvitja lejon pjesëmarrësit të aplikojnë mësimet e mësuara gjatë AAR dhe të implementojnë veprimet korigjuese. Ristërvitja duhet të kryhet në rastin e

parë të mundshëm, për të përmirësuar vërejtjet dhe vlerësimet në stërvitje dhe sjelljen e tyre në standardin e kërkuar.

7.6.2.1. Komandantët të sigurohen që njësitë të kuptojnë se stërvitja është e paplotësuar deri sa të arrihet standardi doktrinar.

7.6.3. AAR realizohet “me shkallë”, si një teknikë zhvillimi e drejtuesve me shumë shkallë. Pas një AAR me të gjithë pjesëmarrësit, drejtuesit eprorë të stërvitjes e përdorin AAR për një diskutim të zgjatur profesional me drejtuesit e zgjedhur. Këto diskutime zakonisht përfshijnë një AAR më specifike të kontributit të drejtuesve, se sa rezultatet e vëzhguara stërvitore. *Komandantët e përdorin këtë proces si hallkë lidhëse ndërmjet stërvitjes së drejtuesve dhe zhvillimit të tyre.*

7.7. Mësimet e nxjerra

7.7.1. Forcat e Armatosura Shqiptare vazhdojnë të rriten profesionalisht e të përmirësohen. Është e nevojshme për të qenë të saktë në doktrinë, për të vazhduar e dhënë kontributet e duhura për mbrojtjen e vendit dhe aleatët. Duhet të këtë një proces për mbledhjen, gjykimin, përhapjen dhe integrimin e vërejtjeve, mësimëve dhe taktikave, teknikave e procedurave të mësuara gjatë ushtrimeve stërvitore dhe vendosjeve operacionale.

7.7.2. Komandantët dhe drejtuesit e tjerë mund të vërejnë çështje, të cilat duhet të përhapen në Forcat e Armatosura, ndërsa ata kryejnë gjykimet e stërvitjes dhe vlerësimet. Produktet nga AAR, si për shembull, çfarë shkoi mirë dhe çfarë nuk shkoi mirë, janë mësimet e nxjerra. Në shumë raste, këto mësimet mund të jenë thelbësore përtej njësisë së përfshirë në stërvitje apo operacion dhe duhet të ndahen në të gjithë Forcat e Armatosura.

7.7.2.1. Kryerja e AAR dhe integrimi i mësimëve të nxjerra, si dhe taktikat, teknikat dhe procedurat e mësuara nga këto AAR në stërvitjet dhe operacionet në vazhdim, është përgjegjësi e komandantit.

7.7.2.2. Zhvillimi i koncepteve në drejtim të zhvillimit të strukturës, modernizimit e të trajnimit të personelit në FA brenda dhe jashtë vendit. Për këtë të planifikohen edhe eksperimentime të ndryshme duke llogaritur koston financiare, në kuadrin e planifikimit të buxhetit të mbrojtjes .

7.7.2.3. Për çdo veprimtari komandat bëjnë vlerësimin e realizimit të detyrave sipas Misionit dhe LDTHM dhe përcaktojnë rrugët, mënyrat dhe mjetet për përmirësimin e mëtejshëm të punës së tyre. Kjo është ajo që në terminologjinë e punës sonë e kemi quajtur “Mësime të Nxjerra”.

7.7.2.4. Mësimet e nxjerra shërbejnë si një proces i pandërprerë në zinxhirin planëzim – zhvillim – vlerësim - ristërvitje, për zbatimin sa më korrekt të tyre në të ardhmen, në përputhje me standardet e përcaktuara dhe me qëllim rritjen e shkallës së ndërveprueshmërisë e të aftësive operacionale të FA.

Nëpërmjet përfundimeve dhe vlerësimeve nga veprimtari e ngjarje të ndryshme që zhvillojmë në kuadrin e stërvitjeve të ndryshme të FA dhe ato me NATO-n,

duhet të sigurojmë dhe zhvillojmë më tej konceptin dhe eksperimentimin. Realizimi i procesit të administrimit të mësimave të nxjerra mund të parashikohet në disa faza:

a) **Faza e evidentimit.** Kjo fazë ka të bëjë me sigurimin e informacionet fillestar. Në këtë fazë informacioni i evidentuar specifikohet si një mësim i nxjerrë, por jo i përpunuar dhe i vlerësuar. Ky informacion sigurohet nga pjesëmarrësit direkt në aktivitetet ose nëpërmjet sistemeve “online”.

b) **Faza e përpunimit.** Kjo fazë bazohet në analizimin dhe shqyrtimin e informacionit për të nxjerrë çfarë është e nevojshme për t'u zbatuar në Forcat tona të Armatosura. KDS, nëpërmjet Qendrës së Analizës së Mbrojtjes, bën përpunimin dhe menaxhimin e të gjithë këtij informacioni. Hapat bazë të procesit janë analiza dhe vlerësimi i këtij informacioni si “mësime të nxjerra”.

c) **Faza e implementimit.** Pasi informacioni është përpunuar dhe është vlerësuar për t'u implementuar në FA, institucionet përkatëse duhet të bëjnë shpërndarjen e “mësimeve të nxjerra” dhe të mbajnë në vëzhgim të gjithë procesin e implementimit. Implementimi i mësimeve të nxjerra duhet të përmbajë masa për rritjen e cilësisë për sigurimin e kapaciteteve më cilësore të njësive dhe reparteve të përfshira në proces.

7.8. Vlerësuesit

7.8.1. Komandantët duhet të planifikojnë për vlerësimet formale dhe të sigurohen që vlerësuesit e tyre të jenë të stërvitur, me eksperiencë dhe të standardizuar. Vlerësuesit duhet gjithashtu të stërviten si moderatorë për të kryer AAR, që kërkojnë pjesëmarrjen maksimale nga ata që stërviten dhe ta mbajnë AAR të fokusuar. Vlerësuesit e jashtëm të jenë të certifikuar në detyrat që ata vlerësojnë dhe nuk do të jenë pjesëmarrës në stërvitjen që realizohet dhe vlerësohet. Ata përgatiten dhe kryejnë AAR, vlerësuesit efektivë gjithashtu duhet të:

- Jenë tërësisht të familjarizuar me LDTHM e organizmit (strukturës) që po vlerësohet.
- Të jenë tërësisht të stërvitur (të aftë teknikisht dhe taktikisht) dhe të kenë përsëritje të detyrave që po vlerësojnë.
- Të dinë tërësisht, të kuptojnë dhe të aplikojnë në mënyrë konsistente standardet e vlerësimit.
- Të ndjekin POS taktike, të shtabit e të fushimit për strukturën që është duke u vlerësuar.
- Të aplikojë informacionin e duhur rreth njësisë që po vlerësohet, si për shembull gjendjen operacionale në kohë lufte dhe të misioneve funksionale, shkurtimeve në personel apo situatave të paqarta, të caktuar nga drejtuesit dhe të autorizuar nga zëvendësit, gjendjen e pajimeve dhe burimet e mbështetjes së stërvitjes dhe mangësitë.

7.8.2. Drejtuesit e njësisë, oficerët dhe nënoficerët, duhet të jenë të stërvitur shumë mirë për të kryer vlerësime të brendshme informale. Këta drejtues të jenë në gjendje të planifikojnë, përgatitin dhe kryejnë AAR të brendshme në mënyrë efektive.

7.8.2.1. Kjo do të thotë që ata duhet të:

- Jenë të familjarizuar me LDTHM e njësisë së tyre dhe të dinë sesi LDTHM e tyre mbështet LDTHM e komandave të tyre eprorë.

- Të jenë teknikisht dhe taktikisht të aftë në detyrat që po vlerësohen. Të kryejnë stërvitje efektive dhe kuptimplotë për ushtarët, drejtuesit, shtabet dhe njësitë, përgatitja e përpiktë është thelbësore. Vetë drejtuesit duhet të jenë në gjendje të kryejnë detyrën përpara se të përpiqen të mësojnë të tjerët.

7.8.2.2. Jo vetëm duhet që individët dhe njësitë që e marrin stërvitjen të mësojnë nga vlerësuesi, por edhe vlerësuesi duhet të mësojë ndërsa vëzhgon njësinë që vlerësohet.

7.9. Stërvitja e vlerësuesve.

7.9.1. Vlerësuesit duhet të jenë të stërvitur në mënyrë rigoroze në përputhje me standardet doktrinare të Forcave të Armatosura përpara se të kryejnë vlerësimet. Stërvitja e vlerësuesve të planifikohet dhe ekzekutohet gjatë fazës së përgatitjes së stërvitjes dhe fazës së ekzekutimit të stërvitjes. Komandantët të certifikojnë me shkrim që vlerësuesit e komandës vlerësuese janë stërvitur në përputhje me standardin e Forcave të Armatosura. Stërvitja e vlerësuesve të përfshijë të paktën një minimum të elementëve si:

- Doktrinën e duhur të Forcave të Armatosura.
- Konsideratat e sigurisë e të mjedisit.
- Kryerjen e përsëritjeve të nevojshme të vlerësuesve.
- Arsyeja dhe qëllimi i ushtrimit stërvitor.
- Objektivat stërvitore.
- Linjat e vlerësimit e të stërvitjes.
- Ushtroni situatat e zbulimit dhe të armikut në përputhje me urdhrin operacional.
- Organizimi i forcës kundërshtare.
- Organizimi i detyrave të njësisë që po vlerësohet dhe LDTHM të përfshijë edhe se si e mbështet LDTHM-në e komandës më të lartë.
- Procedurat operacionale në forcë për njësinë që po vlerësohet.
- Plani i komunikimeve.
- Përgjegjësitë dhe kontrollet.
- Rregullat e ndërhyrjes.

- Ushtroni procedurat operative.
- Ushtroni procedurat kontrolluese.
- Përnjohja.
- Të dhënat dhe raportet e kërkuara.
- Procedurat e gjykimit të të lënduarve dhe të dëmeve.
- Rishikimi pas veprimit (AAR)

7.10. Planifikimi për vlerësimet

7.10.1. Vlerësimi i stërvihtjes kolektive është i rëndësishëm për gjykimin e komandantit në lidhje me aftësinë e njësisë së tij për të kryer detyrat e saj themelore të misionit, në përputhje me standardin e kërkuar të Forcave të Armatosura. Është e rëndësishme për gjykimin e tij të vlerësojë aftësitë e njësisë së vet që kjo të kryejë misionin e saj të kohës së luftës.

7.10.1.1. Vlerësimet të jenë të planifikuara deri në detaje dhe të realizuara me rigorozitet për të qenë efektive. Komandantët dhe drejtuesit kërkojnë të sigurohen që vlerësuesit të stërvihten dhe përgatiten për të kryer vlerësimet.

7.10.1.2. Informacioni i mëposhtëm kërkohet për të lehtësuar planifikimin afatgjatë të një vlerësimi:

- Llojet e ushtrimeve stërvihtore (shih kapitullin 5, ushtrime stërvihtore të batalionit në fushim, ushtrime stërvihtore të kompanisë në fushim, dhe ushtrimi stërvihtor i varur nga situata e kompanisë).
- Data (t) e ushtrimit stërvihtor.
- Llojet e vlerësimit.
- Mbështet kërkesat (e brendshme dhe të jashtme).
- Koordinimi për mbështetjen e vlerësimit të jashtëm.

7.10.1.3. Informacioni në vazhdim kërkohet për të lehtësuar planifikimin afatshkurtër të një vlerësimi:

- Qëllimi dhe fokusi i komandanti për ushtrimin stërvihtor.
- Detyrat specifike individuale, kolektive e të drejtuesve që duhet të vlerësohen.
- Një listë para ekzekutimit. (shihni kapitullin 5 për shembuj të listave të kontrollit të para ekzekutimit).
- Niveli i vlerësimit, p.sh. togë këmbësorie.
- Datat për stërvihtjen e vlerësuesve.
- Plani për kryerjen e stërvihtjes së vlerësuesve.

7.11. Vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës dhe i planëzuar

- Qëllimin e ushtrimit dhe vlerësimin.
- Skenarin e ushtrimit stërvitor.
- Objektivat stërvitore.
- Shpërndarja e burimeve dhe përdorimin e udhëzimeve.
- Koordinimi i kërkuar dhe i autorizuar.
- Udhëzime në rolin e vlerësuesit në siguri, për të përfshirë kriteret e “Vazhdimit” dhe “jo të vazhdimit”.
- Rregullat e ndërhyrjes.
- Procedurat operuese të ushtrimit, nëse janë të ndryshme nga procedurat e zakonshme operacionale (POS).
- Referencat doktrinare të kërkuara e të përdorura.
- Lista e vlerësimit dhe linjat e përgjithshme të Stërvitjes e të Vlerësimit.
- Udhëzime për kryerjen e rishikimit pas veprimit.

7.12. Roli i komandantëve dhe i drejtuesve eprorë.

7.12.1. Komandantët eprorë të sigurojnë që vlerësimet të bëhen rregullisht, në çdo shkallë në organizmin ushtarak. Komandantët e përdorin këtë informacion të marrë nga vlerësimi për të mësuar, treguar dhe instruktuar vartësit e tyre. Ata sigurohen që çdo ushtrim stërvitor të vlerësohet, si pjesë e ekzekutimit të stërvitjes dhe që çdo stërvitës të kryejë vlerësime të standardizuara. Komandantët eprorë e përdorin vlerësimin për të fokusuar vëmendjen komanduese, duke kërkuar vlerësime të detyrave specifike të misionit dhe detyrave të betejës. Ata edhe përfitojnë nga informacioni i vlerësimit për të zhvilluar mësimet e duhura të mësuara, si për shembull ndryshimet në rregullore dhe procedurat për përhapje në të gjitha komandat. Komandantët eprorë duhet të sigurohen që një grup vlerësuesish të stërvitur, me eksperiencë dhe të standardizuar është në gjendje të kryejë si vlerësime të brendshme edhe të jashtme.

7.12.2. Përdorimi i duhur i të dhënave të vlerësimit mund të ketë një efekt shumë të fortë pozitiv në klimën komanduese të organizmit. Prandaj komandantët eprorë duhet të kryejnë korrigjime të çastit, të mbështesin gabimet e ndershme dhe të krijojnë një mjedis për veprime agresive për të korrigjuar mangësitë stërvitore nëpërmjet stërvitjes.

7.12.3. Komandantët eprorë i përdorin vlerësimet e stërvitjes si një komponent të sistemit informues. Për ta mbajtur sistemin e menaxhimit të stërvitjes dinamik, ata përdorin informacionin e marrë për të vendosur efektshmërinë e planifikimit, ekzekutimit dhe pjesë të vlerësimeve të ciklit të menaxhimit të stërvitjes. Për të qenë efektiv, ky informacion rrjedh ndërmjet komandantëve dhe komandave eprorë, brenda çdo niveli komandimi dhe ndërmjet një rrjeti

stërvesish të kualifikuar me eksperiencë, të cilët mund të kalojnë disa linja komanduese.

7.12.3.1. Disa burime të informacionit të stërvesitjes përfshijnë:

- Vlerësimet e planit stërvesitor.
- Brifingjet stërvesitore tremujore.
- Brifingu stërvesitor vjetor.
- Konferencat e poligoneve.
- Të dhënat e vlerësimit.
- Vizitat e shtabit.
- Diskutimet e zhvillimit të drejtuesve.
- Vëzhgimet personale.
- Fluturimet standardizuese të pilotëve.

7.13.3.2. Për të kryer një program efektiv stërvesitor, të gjithë komandantët dhe drejtuesit duhet të jenë stërvesitës dhe vlerësues të stërvesitjes!!

Frekuenca optimale formale e vlerësimit të stërvesitjes.

Niveli i njësisë	Frekuenca	Kryer nga...	Raportoni te...
Skuadër/seksioni	Çdo tre muaj	Komandanti Kompanisë	Komandanti i Batalionit
Toga	Dy herë në vit	Komandanti i Batalionit	Komandanti i Brigadës
Kompania	Vjetore	Komandanti i Brigadës	Komandanti i KFB
Batalioni	Vjetore	Komandanti i KFB	Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
Brigada	Vjetore	Komandanti i KFB	Shefi i Shtabit të Përgjithshëm

Figura 7.1. Frekuenca optimale formale e vlerësimit të stërvesitjes.

Aneksi 1: VLERËSIMET SIPAS KONCEPTIT TË AFTËSIVE OPERACIONALE (OCC)

- A. Programi i vlerësimit dhe i reagimit sipas Konceptit të Aftësive Operacionale (OCC).
- B. Kushtet dhe masat e programit të vlerësimit dhe reagimit të OCC - së.

- C. Veprimtaritë e programit të vlerësimit dhe reagimit të OCC.
- D. Standardet e vlerësimeve të OCC-së.
- E. Shpeshësia dhe vlefshmëria e vlerësimeve.
- F. Lidhja e programit të OCC-së me programe të tjera të NATO-s

A. PROGRAMI I VLERËSIMIT DHE REAGIMIT SIPAS KONCEPTIT TE AFTËSIVE OPERACIONALE (OCC).

A.1. Koncepti i Aftësive Operacionale (Operational Capability Concept) u hodh për herë të parë si iniciativë në Samitin e NATO-s, të zhvilluar në **Washington** në Prill të vitit 1999 dhe u zhvillua brenda konceptit të rritjes dhe shtimit të Operacionalitetit të Partneritetit për Paqe, për të forcuar dimensionin ushtarak të iniciativës së PFP.

Në Samitin e Pragës u theksua rëndësia e mbështetjes dhe e avancimit të kësaj iniciative.

Në Samitin e Stambollit, Koncepti i Aftësive Operacionale nga Kryetarët e shteteve të NATO-s, u pa si një mundësi më e madhe për t'u siguruar Vendeve Partnere të NATO-s, rritjen e kontributeve të tyre për të marrë pjesë në Operacionet në Përgjigje të Krizave, të udhëhequra nga NATO.

*“.....**We intend, therefore, to provide our Partners with increased opportunities to enhance their contributions to NATO-led operations, and to help transform their defences in keeping with NATO's own evolving operational roles and capabilities, including through enhancement of the Operational Capabilities Concept.....**”*

A.1.1. Mbi këtë arsye Komandat Strategjike të NATO-s (NATO Strategic Command) morën si detyrë hartimin e planit për zbatimin e këtij programi, me qëllim përfshirjen e ndryshimeve në zhvillimin e lidhjeve me programin e Konceptit të Aftësive Operacionale (OCC), për vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të niveleve të ndërveprueshmërisë dhe aftësive operacionale të forcave partnere, të deklaruara për pjesëmarrje në operacionet në përgjigje të krizave, të udhëhequra nga NATO.

A.1.2. Ky program siguron drejtimit dhe udhëzimet e nevojshme për zbatimin e ndryshimeve në zhvillimin e Konceptit të Aftësive Operacionale (OCC), për të shërbyer si një katalizator ndërmjet planëzimit të forcës dhe planëzimit operacional të procesit të trajnimit, stërvitjes dhe certifikimit të NATO-s, ku do të reflektohen kontributet e vendeve partnere, që përfshijnë mbështetjen e ndërveprimit të mundshëm me Forcën Reaguese të NATO-s (NATO Reaction Force).

Nga të gjitha forcat partnere njihet tashmë nevoja e të qenit minimalisht të ndërveprueshëm, ndaj në këtë drejtim rezultatet e eksperiencës operacionale të NATO-s, të fituara nëpërmjet stërvitjeve të përzgjedhura dhe të hapura për Partneret, duke paraparë kontributet tyre për të plotësuar Forcën Reaguese të

NATO-s (NRF) kanë një theks të vetëm, rëndësinë e matjes së aftësive ushtarake të tyre.

A.1.3. Kusht paraprak për zhvillimin e suksesshëm të operacioneve të bashkuara e multinacionale është ndërveprueshmëria, por programi i Konceptit të Aftësive Operacionale (OCC), përveç vlerësimit të nivelit të ndërveprueshmërisë, është zgjeruar nëpërmjet përfshirjes së masave për vlerësimin e nivelit të aftësive operacionale të partnerëve, prandaj ai është fokusuar kryesisht në forcat dhe aftësitë e partnerëve. Vendimi i NATO-s për rifokusimin e Pfp-së drejt partnerëve të Kaukazit dhe Azisë Qendrore, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit me vendet e Dialogut Mesdhetar (MD) kërkon mbështetjen e OCC-së.

B. KUSHTET DHE MASAT E PROGRAMIT TË VLERËSIMIT DHE REAGIMIT TË OCC

B.1. Kushtet dhe masat e programit të vlerësimit dhe reagimit të OCC-së. Programi i vlerësimit dhe i reagimit sipas Konceptit të Aftësive Operacionale është një proces i strukturuar për ekzaminime kritike të çdo aktiviteti dhe/ose aftësie, përkundrejt standardeve dhe kriterëve të përcaktuara të NATO-s.

B.1.1. Ky program ka si qëllim që, përmes vlerësimit dhe reagimit, të përmirësojë nivelin e ndërveprueshmërisë dhe efikasitetit operacional të partnerëve. Në mënyrë indirekte programi konfirmon vlerat dhe seriozitetin e sistemeve, procedurave, programeve dhe të objektivave të stërvitjes. Pjesëmarrja në këtë program fokusohet kryesisht në forcat dhe aftësitë e partnerëve. Megjithatë, bazuar në drejtimin politik, mund të aplikohet edhe për vendet e Dialogut Mesdhetar dhe vendet e tjera që do t'i bashkohen iniciativës së Pfp-së.

B.1.2. Programi aplikohet vetëm në njësitë partnere të deklaruara në grupimin e forcave të OCC-së. Me deklarimin e tyre, vendet partnere duhet të stërvitin dhe pajisin këto forca për të qenë të ndërveprueshme me forcat e NATO-s.

C. VEPRIMTARITË E PROGRAMIT TË VLERËSIMIT E TË REAGIMIT TË OCC.

C.1. Programi i vlerësimit dhe reagimit, sipas Konceptit të Aftësive Operacionale përfshin dy nivele vlerësimi dhe secili prej tyre ka dy vlerësime; vetëvlerësimin dhe vlerësimin e NATO-s.

a. *Niveli 1.* Fokusohet në vlerësimin e ndërveprueshmërisë (Interoperability). Ai vlerëson ndërveprueshmërinë e trajnimit, edukimit, organizimit, strukturës dhe pajisjes së një partneri. Vlerësimet e nivelit të 1-rë janë më fleksibël në trajtimin e tyre. Qëllimi i vlerësimit negociohet ndërmjet njësisë partnere dhe autoriteteve të NATO-s, që përfshihen në ndihmën apo realizimin e vlerësimit.

b. *Niveli 2.* Fokusohet në vlerësimin e aftësive ushtarake (Military Capability). Ai vlerëson aftësinë ushtarake dhe përmbushjen e misionit të një njësie partnere. Vlerësimet e nivelit të 2-të ndjekin një format e qëllim standard të vlerësimit, të drejtuar nga autoritetet e NATO-s, që ndihmojnë apo zhvillojnë vlerësimin.

Të dy këto nivele vlerësimi përfshijnë veprimtari të shumta, nga Vizitat Këshilluese deri në realizimin e plotë të standardeve të vlerësimit.

C.1.1. *Vizitë këshilluese (Advisory Visit)*. Është shumë e rëndësishme që partnerët të kuptojnë plotësisht procesin e vlerësimit dhe kërkesat e NATO-s para një Veprimtarie, për të shmangur përshtypjen e “dështimit”. Për të ndihmuar partnerët që të arrijnë këtë kuptim dhe ndihmuar ata për arritjen e statusit të ndërveprueshmërisë dhe aftësive operacionale, nga NATO për vendet partnere ofrohen vizita këshilluese (AV).

Qëllimi i një vizite këshilluese (AV) nuk është që të trajnojë partnerët, por të familjarizojë ata me procesin para një veprimtarie brenda programit. Një veprimtari e tillë zhvillohet vetëm pas kërkesës zyrtare të një vendi partner për një vlerësim. Ajo mund të kërkohe në mbështetje të një vetëvlerësimi apo një vlerësimi të NATO-s.

Synimi është që vizita këshilluese (AV) të zhvillohet mjaft përpara, për të patur kohën e mjaftueshme, në mënyrë që të bëhen të mundura përshtatjet e nevojshme para veprimtarive.

Thellësia e vizitave këshilluese (AV) bazohet në analizën e të dhënave ekzistuese në grupimin e forcave të OCC-së dhe fokusohet në standardet e duhura të NATO-s, ndaj të cilave do të vlerësohet njësia partnere.

Për nivelin e 1-rë standardet janë detyrat ushtarake për ndërveprim (MTI) ose lista e detyrave të NATO-s (NTL) e janarit 2006.

Për Nivelin e 2-të standardet bazohen në vëllimin e përshtatshëm të standardeve të forcës së Komandës së Aleancës për Operacionet (Alliance Command Operation Force Standart).

C.1.2. *Vetëvlerësimi*. Çdo veprimtari e tillë është vlerësim i një njësie partnere nga vetë vendi partner. Planëzimi dhe përgatitja e veprimtarisë, si edhe ngritja e Ekipit të Vlerësimit, janë përgjegjësi të vendit partner. Megjithatë, nëse burimet e përshtatshme nuk janë të mundshme, NATO mund të sigurojë ndihmë për partnerin. Kështu që vendi partner duhet të informojë sa më shpejt të jetë e mundur J-7-të në SHAPE për veprimtarinë, nëse kërkon ndihmën e NATO-s. Si minimum që veprimtaria të konsiderohet e vlefshme brenda programit, vendi partner duhet të përdorë një “checklist” të siguar nga NATO. Gjithashtu, NATO ftohet të dërgojë vëzhgues gjatë zhvillimit të veprimtarisë. Të gjitha vetëvlerësimet janë subjekt i NATO-s, përpara se të pranohen dhe futen në të dhënat e programit të OCC-së.

C.1.3. *Vlerësimet e NATO-s*. Këto janë vlerësime të një njësie partnere, që kryhet nga autoritetet e NATO-s, me kërkesën e vendit partner. Vendi partner përgjigjet për identifikimin e stërvitjes ku do kryhet vlerësimi, ndërsa NATO përgjigjet për kryerjen e Vlerësimit në koordinim të ngushtë me vendin partner, sipas standardeve për nivelet 1 & 2 të vlerësimit.

Nga NATO-ja pritet që vendet partnere të arrijnë progres përmes vetëvlerësimit, niveli 1; vlerësimit të NATO-s, niveli 1; vetëvlerësimit, niveli 2 dhe së fundmi, vlerësimit të NATO-s, niveli 2.

Një vlerësim i NATO-s kryhet pas përfundimit me sukses të çdo vetëvlerësimi.

C.1.4. *Programimi i veprimtarive të OCC-së.* JFC HQs (Shtabet e Komandave të Bashkuara), në bashkëpunim me CC HQs (Shtabet e Komponentëve të Komandave) të NATO-s, do të programojnë dhe koordinojnë veprimtaritë e OCC-së. Përparësia në veprimtaritë bazohet në balancimin e nevojave të NATO-s me të dhënat e Grupimit të Forcave të OCC-së. (OCC Pool of Forces). Por mundësitë për financimin, mundësitë e vlerësimit dhe vlerësuesve janë ato që do të ndikojnë në programimin e veprimtarive. Vendet partnere që kërkojnë veprimtari të OCC-së, duhet të mbështesin procesin duke lajmëruar më përpara (p.sh. një vit para) në PCC (Partnership Coordination Cell) dhe J-7 në SHAPE, duke rekomanduar veprimtarinë e përshtatshme brenda Programit të Punës së Partneritetit Euro-Atlantik (**EAPWP**), siç janë listuar me poshtë.

C.1.5. *Fleksibiliteti.* Duke parë numrin dhe llojshmërinë e forcave dhe të aftësive të deklaruara, kyçi kryesor për suksesin e Programit të OCC-së është fleksibiliteti. Kështu që do të jetë e mundshme një hapësirë e gjerë veprimtarish, gjatë të cilave mund të kryhet një Vlerësim. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a. "LIVEX" të NATO-s, të hapura për partnerët.
- b. Shtërvitje "Cooperative".
- c. Shtërvitje "në shpirtin e PFP".
- d. Shtërvitje bilaterale/multilaterale.
- e. Shtërvitje kombëtare

D. STANDARDET E VLERËSIMEVE TË OCC-së.

D.1. Vlerësimi i nivelit 1. Standardet për vlerësimet e këtij niveli bazohen në detyrat ushtarake për ndërveprim (Military Task for Interoperability), të cilat janë nxjerrë nga lista e detyrave të NATO-s. (NATO Task List). Njësia e një vendi partner, që do të vetë vlerësohet dhe më pas vlerësohet nga NATO (NATO cakton si përgjegjës për vlerësimet e të dy niveleve një nga shtabet e komandave të bashkuara) përgjigjet për zhvillimin e veprimtarive, por do të negociojnë së bashku mbi çështjet që do të vlerësohen nga MTI/NTL.

JFC HQ (Shtabi i Komandës së Bashkuar) ndërton një "checklist" (Listë Kontrolli) me qëllim vlerësimi, e bazuar kjo në MTI/NTL.

Klasifikimi i nivelit 1, sipas programit OCC E&F. Për nivelin 1 (ndërveprueshmëria) ka 3 nivele vlerësimi për çdo çështje që vlerësohet, të cilat janë:

D.1.1. *Ndërveprueshëm.* Të gjitha procedurat dhe veprimtaritë janë plotësuar në një mënyrë të krahasueshme me MTI/NTL. Burimet në përgjithësi i

plotësojnë kërkesat. Mungesat, mospërputhjet dhe shkeljet e vogla të sigurisë, gabimet apo vonesat, nuk pengojnë apo ndikojnë në aftësinë e njësisë së vlerësuar, për të kryer operacione të integruara me njësitë e NATO-s. Mbrojtja dhe siguria, si e njësive të vlerësuara, po ashtu edhe e njësive të NATO-s, nuk do të kompromentohej.

D.1.2. *Pjesërisht i ndërveprueshëm.* Jo të gjitha procedurat dhe veprimtaritë janë plotësuar në mënyrë të krahasueshme me MTI/NTL.

Mungesat, mospërputhjet dhe shkeljet e sigurisë, gabimet apo vonesat ndikojnë, por nuk do të pengojnë aftësinë e njësisë së vlerësuar për të kryer operacione të integruara me njësitë e NATO-s. Mbrojtja dhe siguria, si e njësive të vlerësuara, po ashtu edhe e njësive të NATO-s, do të pakësohej. Mund të rezultojnë dëmtime të pakta në personel. I NDERVEPRUESHEM. Jo të gjitha procedurat dhe veprimtaritë janë plotësuar në një mënyrë të krahasueshme me NTL.

Numri i mungesave, mospërputhjeve dhe i shkeljeve të sigurisë, i gabimeve apo vonesave, e frenojnë apo e degradojnë njësinë e vlerësuar për të kryer operacion të integruar me njësitë e NATO-s. Mund të rrezikohet përmbushja e misionit. Mbrojtja dhe siguria, si e njësive të vlerësuara, po ashtu edhe e njësive të NATO-s, do të jetë një shqetësim i madh. Dëmtimet në pajisje dhe personel përbëjnë një shqetësim të qartë.

Komentet. Në disa rrethana, një detyrë apo nën detyrë nuk mund të vlerësohet, megjithëse mund të jetë planëzuar si e tillë. Në raste të tilla detyra apo nëndetyra do të shënohet jo e vlerësuar.

D.1.3. Jo e Vlerësuar. Detyra apo nën detyra nuk vlerësohet apo nuk i caktohet një nivel ndërveprueshmërie për shkak të një kufizimi politik apo sipas gjykimit të Shefit të Ekipit. Arsyeja duhet shpjeguar në raportin final.

D.2. Vlerësimi i Nivelit 2. Ky Vlerësim do të bazohet në volumin e përshtatshëm të AFS-së (Aliance Force Standart) vetëm për vendet partnere, që kanë deklaruar forca në Grupimin e Forcës së OCC-së, që kanë kryer me sukses Vlerësimin e Nivelit 1 dhe që kanë shprehur dëshirën për të proceduar në Nivelin 2.

NATO HQ përgjigjet për kryerjen e Vlerësimit, duke përdorur një "checklist" që bazohet në AFS. Çështjet e vlerësimit janë të pa negociueshme. "Checklist" i dërgohet njësisë që vlerësohet, të paktën një muaj përpara vlerësimit.

PCC (Partnership Coordination Cell) në SHAPE do të kërkojë dhënien e dokumenteve të duhura për pjesëmarrjen në OCC. Është parashikuar që, minimumi një vit, do të kërkohej që vendi partner të asimilojë informacionin dhe të stërvitet sipas standardit. Pas kësaj, vendi partner mund të jetë gati për të plotësuar një vetëvlerësim të nivelit 2.

Në përgjithësi, vlerësimet e nivelit 2 të OCC-së përdorin të njëjtat standarde dhe klasifikime, si dhe programi i vlerësimeve përkatëse të NATO-s, p.sh. TACEVAL, CREVAL apo MAREVAL. Përkufizimet e mëposhtme do të përdoren

në raportet që lëshohen për çdo rast në lidhje me nivelin e aftësisë për mision (Mission Capability). Për vlerësimin e nivelit 2 të OCC-së ka 5 nivele të aftësisë për mision, për çdo çështje që vlerësohet:

D.2.1. Aftësi Superiore për mision (Superior Mission Capable, SMC). Njësia arrin standardet dhe kërkesat e AFS-së në çdo fushë, kryen operacione të mbështetura dhe përmbush misionin e saj në një mënyrë superiore. Nuk ekzistojnë mungesa.

D.2.2. Aftësi për mision (Mission Capable, MC). Njësia arrin kërkesat e AFS-së në të gjitha fushat, kryen operacione të mbështetura dhe përmbush misionin e saj në mënyrë kompetente. Nuk ekzistojnë mungesa të mëdha.

D.2.3. Aftësi e Kufizuar për Mision (Limitet Mission Capable, LMC). Përcaktohet si aftësi për mision me rrezik. Njësia në përgjithësi arrin kërkesat e AFS-së në çdo fushë, kryen operacione të mbështetura dhe përmbush misionin e saj në mënyrë kompetente, megjithatë një klasifikim nën standard në një nga aftësitë esenciale për mision do ta kufizonte njësinë.

D.2.4. Pjesërisht aftësi për mision (Partial Mission Capable, PMC). Njësia në përgjithësi i arrin kërkesat e AFS-së, kryen operacione të mbështetura dhe përmbush misionin e saj. Megjithatë, një apo disa klasifikime nën standard në aftësitë esenciale për mision, tregojnë se njësia do ta ketë të pamundur për të mbështetur dhe/ose zbatuar si duhet misionin e caktuar.

D.2.5. Jo Aftësi për mision (Not Mission Capable NMC). Numri apo serioziteti i një apo më shumë mungesave do ta ndalonte njësinë për të zbatuar me efektivitet misionin e caktuar.

Komente. Në disa rrethana, një detyrë apo nëndetyrë nuk mund të vlerësohet, megjithëse mund të jetë planëzuar si e tillë. Në raste të tilla detyra apo nën detyra do të shënohet:

a. *Jo e klasifikuar.* Detyra apo nëndetyra është vlerësuar, por nuk i caktohet një nivel aftësie për mision, për shkak të një kufizimi politik apo për shkak të gjykimit të Shefit të Ekipit të Vlerësimit. Arsyetja duhet shpjeguar në raportin final.

b. *Jo e vlerësuar.* Përdorimi i këtij komenti kufizohet në ato raste kur detyra apo nëndetyra që klasifikohet nuk është vlerësuar gjatë kryerjes së vlerësimit. Mungesa e pajisjes dhe/ose aftësisë së kërkuar nuk e justifikon përdorimin e këtij komenti, në çdo detyrë apo nëndetyrë. Në rastet kur ky koment përdoret, do të shpjegohet arsyeja në raportin përfundimtar.

E. SHPESHËSIA DHE VLEFESHMËRIA E VLERËSIMEVE.

E.1. Për të ruajtur vlefshmërinë e të dhënave dhe për të siguruar krahasimin e qartë me standardet e NATO-s, njësitet do të vlerësohen periodikisht, çdo 3 vjet. Nga vendet partnere që deklarojnë forca në grupimin e forcave të OCC-se, pritet që t'i trajnojnë këto forca në përputhje me standardet dhe kriteret e NATO-s.

Minimumi i kohës, që një vend partner duhet të kryejë një vetëvlerësim të nivelit 1 të njësive të deklaruara, është 3 vjet nga deklarimi. SHAPE mund të ekzaminojë vlefshmërinë e kësaj periudhe dhe ta përshtatë atë rast – pas – rasti.

E.1.1. *Raportet “feedback”*. “Feedback” është një pjesë themelore e programit të vlerësimit sipas Konceptit të Aftësive Operacionale dhe nëse partnerët duan të fitojnë avantazhin maksimal nga vlerësimet e tyre. Vetëm raportet e detajuara të “feedback” do të mundësojnë që partnerët të përmirësojnë efektshmërinë e njësive të tyre të deklaruara. Një “feedback” zyrtar do t’u sigurohet partnerëve dhe rezultatet e detajuara do të ruhen në të dhënat e OCC-së. Programi përfshin raportet e mëposhtme:

a. Raporti fillestar fushor (IFR). IFR do të jetë një raport verbal nga Shefi i Ekipit të Vlerësimit të Oficeri Komandues, përpara se ekipi të largohet nga vendi i veprimtarisë. Raporti do të bazohet vetëm në vëzhgimin e dokumentuar, të marrë gjatë veprimtarisë. Një IFR do të kryhet pas çdo vlerësimi të OCC-së.

b. *Raporti final i “feedback” (FFR)*. FFR është një raport i shkruar, që lëshohet nga JFC HQ (Shtabi i Komandës së Bashkuar) që kryen vlerësimin. I dërgohet çdo njësie/reparti/nënreparti pjesëmarrës, në J-7 SHAPE dhe PCC, si dhe JFC HQ e caktuar përgjegjëse për vëzhgim dhe monitorim, brenda 60 ditëve nga kryerja e vlerësimit. Ky raport duhet të jetë një analizë e detajuar e veprimtarisë që të analizojë të gjitha fushat e aplikueshme, standardet e përdorura dhe rezultatet. FFR do të përfshijë çdo mësim të nxjerrë për t’u dërguar Qendrës së Bashkuar të Analizave dhe Mësimeve të Nxjerra (JALLC). Një FFR bëhet pas çdo vlerësimi të OCC-së.

c. *Raporti vjetor (Annual Report, AR)*. Çdo vit, në fund të marsit, J-7 SHAPE do të bëjë një raport vjetor për Veprimtaritë e OCC-së. Vëzhgime të përgjithshme dhe mësimet e nxjerra do të bëhen për një qarkullim të gjerë. Vlerësimet individuale nuk do të publikohen.

E.1.2. *Klasifikimi dhe shpërndarja*. Të gjitha raportet e OCC-së do të kenë një minimum klasifikimi të “NATO + vendi partner që vlerësohet) RESTRICTED (e lëshueshme të PSE)” dhe do të ruhet në baza “nevojitet që të njihet”. Shpërndarja më e gjerë e raportit të vendeve anëtare ose partnere mund të konsiderohet me miratimin e Partnerit dhe të Aleatëve.

E.1.3. *Ekipet e vlerësimit*. Ekipet e vlerësimit ndërtohen nga oficerë dhe n/of të NATO-s dhe vendeve Partnere, që marrin pjesë në OCC. Ekipet përfshijnë normalisht edhe përfaqësues të vendit që vlerësohet. Përbërja e ekipit përcaktohet nga JFC ose CCs HQ (Shtabi ose Komanda përgjegjës). Para se të marrin pjesë në vlerësimin sipas niveleve 1 e 2, vlerësuesit duhet të kenë kryer kursin përkatës të vlerësuesit.

a. *Grupi i vlerësuesve të trajnuar*. Një grup vlerësuesish të trajnuar duhet të jetë i mundshëm në baza kohore për të zhvilluar vlerësime të OCC-së. Vendet partnere, që marrin pjesë në program, duhet të kontribuojnë me personel të trajnuar dhe të gatshëm për grupin e vlerësuesve. Në ndryshim nga kjo,

Vetëvlerësimet do të zhvillohen nga një ekip kombëtar vlerësuesish të trajnuar për nivelet 1&2 të vetë vendit partner, por ata do të kryejnë vlerësim nën vëzhgimin e ekipeve vëzhguese nga JFC HQ të NATO-s, të cilët kanë përgjegjësinë për ndihmë dhe ndjekje të këtyre veprimtarive.

b. Kurset e trajnimit të vlerësuesve (Evaluator Training Course, ETC). Siguron trajnimin dhe certifikimin e personelit vlerësues me metodologjinë dhe standardet e vlerësimit, si dhe mjetet për gjenerimin e një grupimi vlerësuesish të kualifikuar. Në kuadrin e Pfp-së, pjesëmarrësit kanë mundësi të mësojnë rreth programit të vlerësimit dhe reagimit të OCC-së, si dhe procedurave e standardeve të NATO-s për vlerësimin.

F. LIDHJA E PROGRAMIT TË OCC-së ME PROGRAME TË TJERA TË NATO-s

F.1. NATO, për njësitë e deklaruara në OCC, ka krijuar një “database”, grupim vlerësuesish të trajnuar dhe të gjitha të dhënat e duhura nga vlerësimet e OCC-së. “Database” është i aftë të prodhojë “checklist” dhe afate kohore për të ndihmuar në zhvillimin e vlerësimit. Përmes SHAPE funksionimi i të gjithë kapaciteteve është i mundshëm për partnerët në mbështetje të Vetëvlerësimeve. Checklist-at e vlerësimit të nivelit 2 janë në volumet e duhura të AFS-së (Standardet e Forcës së Aleatëve).

F.1.1. Programet e vlerësimit të NATO-s (TACEVAL, CREVAL, MAREVAL). Programi OCC është një element integral i programeve të vlerësimit, që përdoret nga NATO dhe kërkon t'i pasqyrojë ato sa më shumë të jetë e mundur.

F.1.2. Grupi i trajnimit/grupi i punës për trajnimin dhe edukimin për operacionet e mbështetjes së paqes (NTG/**WG TEPSO**).

Ky është plotësisht i pavarur nga programi i OCC-së, megjithatë SHAPE ruan një lidhje të ngushtë me të dhe po krijon manuale procedurash të Operacioneve në Mbështetje të Paqes (PSO). Këta manuale do t'u ofrojnë vendeve partnere informacionin e kërkuar për të rritur Ndërveprueshmërinë në teknikat e PSO (Peace Support Operation) dhe i përgatit ato për Vlerësim brenda OCC-së.

F.1.3. Qendra e Bashkuar e Analizës dhe Mësimeve të Nxjerra (JALLC). JALLC kryen analiza dhe identifikon mësimet e nxjerra nga operacionet dhe stërvitjet e NATO-s. SHAPE mban një lidhje të ngushtë me JALLC për të siguruar që mësimet e nxjerra nga vlerësimet e OCC-së të përfshihen në “database” të mësimeve të nxjerra të Pfp-së, që mbahen nga JALLC.

F.1.4. PARP. Nëse raporton një njësi në PARP, kjo nuk përfshihet automatikisht në OCC. Për forcat e deklaruara në PARP e gjithashtu në OCC, rezultati i shqyrtimit të PARP-it mund të përdoret si një element i Vetëvlerësimit të vendit Partner. Kjo do të bëhet pas një kërkesë zyrtare dhe duke siguruar informacionin e duhur për PG-në përkatëse të njësisë. Nga ana tjetër, forcat që nuk janë deklaruar në PARP, mund të deklarohen në OCC.

F.1.5. Certifikimi. NATO kryen një certifikim të një force partnere para dërgimit në një operacion, jo të udhëhequr nga NATO - Artikulli 5 (CRO).

Vlerësimet e nivelit 1 dhe 2 mund të formojnë një pjesë të procesit të certifikimit.

F.1.6. Hyrja dhe integrimi. Programi OCC-së është një mjet i vlefshëm për vendet e MAP-it, vendet e tjera që aspirojnë të futen në NATO dhe anëtarët e rinj. Për vendet aspiruese elementet e programit mund të përdoren për të monitoruar dhe përmirësuar aftësitë e tyre të veprimit të përbashkët, e gjithashtu për të vlerësuar nivelin e aftësive operacionale. Kurset e trajnimit të vlerësuesve mund të përdoren për të siguruar që vlerësuesit janë të trajnuar, të kuptojnë dhe ndoshta të përshtatin metodat e NATO-s për vlerësimin dhe raportimin.

F.1.7. Programi i vlerësimit dhe reagimit sipas Konceptit të Aftësive Operacionale është pjesë esenciale e dimensionit ushtarak të vendeve të nismës PfP dhe një instrument shumë i rëndësishëm në rritjen e ndërveprueshmërisë në të gjitha nivelet. Ai ndikon ndjeshëm në rritjen e nivelit në veprimet e përbashkëta të forcave tona me ato të NATO-s, si dhe në njohjen dhe zhvillimin e aftësive operacionale të tyre.

Aneksi 2: DOKUMENTET E PLANËZIMIT NË STRUKTURAT OPERACIONALE, ARSIMORE DHE STËRVITORE TË FORCAVE TË ARMATOSURA

- A. Të përgjithshme.
- B. Dokumentet e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura
- C. Dokumentet e komandave kryesore/operative
- D. Dokumentet në nivel brigade
- E. Dokumentet në nivel batalioni
- F. Dokumentet e institucioneve të veçanta

A. Të përgjithshme

Për të drejtuar dhe menaxhuar sa më mirë veprimtarinë arsimore e stërvitore të strukturave të Forcave të Armatosura në periudha të ndryshme kohore hartohen dokumentet e planëzimit, të cilat mbahen në dosje të veçanta. Kur themi “dokumente të planëzimit” nuk themi “dokumente referuese ligjore”, por plane e grafikë që përcaktojnë sasinë e detyrave që një strukturë ushtarake do të realizojë në një kohë të caktuar (njëvjeçare, dyvjeçare, katërvjeçare etj.). Kjo do të thotë se bëhet me kohë plani i masave që duhen marrë, duke përcaktuar edhe afatet për çdo punë e veprimtari në përputhje me misionin dhe përgjegjësitë. Koha e hartimit përcaktohet me urdhra të veçantë të komandantëve dhe drejtuesve të strukturave, të cilët drejtojnë, kontrollojnë dhe miratojnë gjithë procesin.

Dosja e planëzimit në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, zakonisht përbëhet nga 3 pjesë:

- Dokumente të komandës/strukturës eprore.
- Dokumente të komandës/strukturës.
- Dokumente të veçanta.

Dokumentet e arsimimit, stërvitjes, dokumentet operacionale dhe ato të veprimtarive të tjera ndihmojnë komandantët, shtabet dhe drejtuesit për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me detyrat dhe detyrimet që rrjedhin nga misioni.

Planëzimi hartohet nga struktura më e lartë në atë më të ulëtën. Po në këtë drejtim realizohet zberthimi i objektivave e detyrave, ndërsa raportimi për realizimin e detyrave sipas planëzimit bëhet nga poshtë – lart dhe në afatet e përcaktuara nga eprori. Çdo strukturë (arsimore apo stërvitore) e Forcave të Armatosura e harton planëzimin vjetor, afatshkurtër apo afatgjatë mbi bazën e

detyrimeve që rrjedhin nga planëzimi për të njëjtën periudhë i strukturës eprorë, duke shtuar masat e veta të veçanta.

Komandantët dhe drejtuesit përcaktojnë detyrimet, i shtrijnë ato në afate kohore, pastaj përcaktojnë masa shtesë për të plotësuar në ngarkesë maksimale periudhën kohore, për të cilën planëzohet veprimtaria e strukturave.

Ndër periudhat kohore, që janë bazë e planëzimit, kryesore është periudha njëvjeçare. Në planëzimin vjetor të të gjitha strukturave të Forcave të Armatosura mbahen parasysh planet afatshkurtra dhe afatgjata, veçse ato zbërthehen më gjerësisht, duke i kthyer objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë në objektiva vjetore vit pas viti.

Dokumentet e planëzimit janë pjesë e “tavolinës”, janë “menu” e përditshme e komandantëve, drejtuesve dhe shtabeve. Ato janë referencë e përhershme për të bërë funksionimin unik të strukturave, për të bërë atë që çdo strukturë të integrohet në të përgjithshmen, që strukturat të funksionojnë si një e tërë në interes të misionit të Forcave të Armatosura.

Dokumentet e planëzimit nuk janë “copy paste” nga dokumentet e planëzimit të eprorit, por dërgim/delegim i masave të planëzuara nga lart te strukturat poshtë.

B. Dokumentet e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

- Dokumente të komandës/strukturës eprorë.
- Dokumente të komandës/strukturës.
- Dokumente të veçanta.

B.1. Të gjitha drejtoritë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura hartojnë dokumentet e planëzimit për periudha të ndryshme kohore në varësi të veçorive dhe misionit të çdo drejtorie.

Për veprimtari të përbashkëta të të gjitha drejtorive, Drejtoria Operacionale dhe e Stërvitjes harton planëzimin e përbashkët. Kjo Drejtori është ajo që ndjek veprimtaritë kryesore të përbashkëta të Shtabit të Përgjithshëm për veprimtaritë operacionale, të arsimimit dhe stërvitjes. Njëkohësisht, Drejtori i Drejtorisë së operacioneve dhe të Stërvitjes është koordinatori i të gjitha veprimtarive të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

A.2. Dokumentet kryesore të planëzimit të drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

B.2.1. Dokumente të komandës/strukturës eprorë.

- Direktiva afatgjatë/afatshkurtër/vjetore e Ministrisë të Mbrojtjes.
- Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

- Plani afatshkurtër i zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Plani i mbështetjes buxhetore të strukturave të Forcave të Armatosura.

B.2.2. Dokumente të komandës/strukturës.

- Plani i veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura të RSH.
- Udhëzimet vjetore të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërvitjen (të gjitha drejtoritë).
- Plankalendari/matrica i/e veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura (të gjitha drejtoritë).
- Plani i veprimtarive vjetore të drejtorisë (sipas drejtorisë përkatëse).
- Plani i kualifikimeve dhe punës shkencore në Drejtori (sipas drejtorisë përkatëse).
- Plani i mbështetjes materiale të arsimimit, stërvitjes, operacioneve dhe gatishmërisë së Forcave të Armatosura (Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes).
- Plani i mbështetjes materiale dhe me shtypshkrime për Drejtorinë përkatëse.
- Plani i mbështetjes materiale sipas strukturave të Forcave të Armatosura.
- Plani i veprimtarive të përbashkëta të Drejtorisë me aleatët/partnerët.
- Plani i pjesëmarrjes në stërvitjet dhe veprimtaritë ndërkombëtare.
- Plani i veprimtarive sportive të Forcave të Armatosura.
- Plani i botimeve.
- Plani i garave të qitjes me armët e këmbësorisë ndërmjet strukturave të Forcave të Armatosura.
- Plani i qitjeve.
- Plani i harxhimit të municionit.
- Plani i testimeve të strukturave operacionale dhe të personelit të Forcave të Armatosura.
- Plani i bashkëveprimit dhe i aktiviteteve me vendet e aleancës/vendet partnere.
- Plani i arsimimit, kualifikimit dhe testimit të personelit.
- Plani i analizave, inspektimeve, informacioneve dhe thirrjeve në raport.
- Plani i lejeve të zakonshme.

B.3. Dokumente të veçanta.

- Plani i vlerësimeve operacionale për strukturat e deklaruara PfP dhe në NATO.
- Plani i provave të kushtimit.
- Plani i inspektimeve.
- Plani i bashkëpunimit ndërministror, si dhe me strukturat e Pushtetit Lokal e Qendror.
- Plani i përballimit të emergjencave.

C. Dokumentet e komandave kryesore/operative

C.1. Dokumente të komandës/strukturës eprore.

- Direktiva afatgjatë/afatshkurtër/vjetore e Ministrit të Mbrojtjes për Mbrojtjen.
- Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Plani afatshkurtër i zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Plani i veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura të RSH.
- Udhëzimet vjetore të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërvitjen.
- Plankalendari/matrica i/e veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura (të gjitha drejtoritë)..
- Plani i mbështetjes buxhetore të strukturave të Forcave të Armatosura.

C.2. Dokumente të komandës/strukturës.

- Udhëzimet e Komandantit për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërvitjen.
- Plani/matrica i/e veprimtarive kryesore.
- Plani i kualifikimeve dhe punës shkencore.
- Plani i mbështetjes materiale të arsimimit, stërvitjes, operacioneve dhe gatishmërisë.
- Plani i mbështetjes materiale dhe me shtypshkrime.
- Plani i mbështetjes materiale sipas strukturave.
- Plani i pjesëmarrjes në stërvitjet dhe veprimtaritë ndërkombëtare.
- Plani i veprimtarive sportive.
- Plani i botimeve.
- Plani i garave të qitjes me armët e këmbësorisë.
- Plani i harxhimit të municionit.

- Plani i testimeve të strukturave operacionale dhe të personelit të Forcave të Armatosura.
- Plani i arsimimit, kualifikimit dhe testimit të personelit.
- Plani i analizave, inspektimeve, informacioneve dhe thirrjeve në raport.
- Plani i lejeve të zakonshme.

C.3. Dokumente të veçanta.

- Plani i vlerësimeve operacionale për strukturat e deklaruara PfP dhe në NATO.
- Plani i provave të kushtrimit.
- Plani i inspektimeve.
- Plani i bashkëpunimit ndërministror, si dhe me strukturat e Pushtetit Lokal e Qendror.
- Plani i përballimit të emergjencave.

D. Dokumentet në nivel brigade/regjimenti

D.1. Dokumente të komandës/strukturës eprore.

- Udhëzimet vjetore komandantit të njësisë eprore për operacionet, gatishmërinë dhe stërvitjen.
- Plani i veprimtarive kryesore të njësisë eprore.
- Plankalendari/matrica i/e veprimtarive kryesore të njësisë eprore.
- Plani i buxhetit.

D.2. Dokumente të komandës/strukturës.

- Udhëzimet e Komandantit për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërvitjen.
- Plani/matrica i/e veprimtarive kryesore.
- Plani i kualifikimeve dhe punës shkencore.
- Plani i mbështetjes materiale të arsimimit, stërvitjes, operacioneve dhe gatishmërisë.
- Plani i mbështetjes materiale dhe me shtypshkrime.
- Plani i mbështetjes materiale sipas strukturave.
- Plani i pjesëmarrjes në stërvitjet dhe veprimtaritë ndërkombëtare.
- Plani i veprimtarive sportive.
- Plani i botimeve.
- Plani i garave të qitjes me armët e këmbësorisë.

- Plani i testimeve të strukturave operacionale dhe të personelit të Forcave të Armatosura.
- Plani i harxhimit të municionit.
- Plani i arsimimit, kualifikimit dhe testimit të personelit.
- Plani i analizave, inspektimeve, informacioneve dhe thirrjeve në raport.
- Plani i lejeve të zakonshme.

D.3. Dokumente të veçanta.

- Plani i vlerësimeve operacionale për strukturat e deklaruara PfP dhe në NATO.
- Plani i provave të kushtimit.
- Plani i inspektimeve.
- Plani i bashkëpunimit ndërministror, si dhe me strukturat e Pushtetit Lokal e Qendror.
- Plani i përballimit të emergjencave.

E. Dokumentet në nivel batalioni.

E.1. Dokumente të komandës/strukturës eprore.

- Direktiva afatgjatë/afatshkurtër/vjetore e Ministrit të Mbrojtjes.
- Plani afatgjatë/afatshkurtër i Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Plani i veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura të RSH.
- Udhëzimet vjetore të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërvitjen.
- Plankalendari/matrica i/e veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura.
- Plani i mbështetjes buxhetore të strukturave të Forcave të Armatosura.

E.2. Dokumente të komandës/strukturës.

- Udhëzimet e Komandantit për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërvitjen.
- Plani/matrica i/e veprimtarive kryesore.
- Plani i kualifikimeve dhe punës shkencore në Drejtori.
- Plani i mbështetjes materiale të arsimimit, stërvitjes, operacioneve dhe gatishmërisë.
- Plani i mbështetjes materiale dhe me shtypshkrime.
- Plani i mbështetjes materiale sipas strukturave të vartësisë.
- Plani i pjesëmarrjes në stërvitjet dhe veprimtaritë ndërkombëtare.

- Plani i veprimtarive sportive.
- Plani i botimeve.
- Plani i garave të qitjes me armët e këmbësores.
- Plani i testimeve të strukturave operacionale dhe të personelit të Forcave të Armatosura.
- Plani i arsimimit, kualifikimit dhe testimit të personelit.
- Plani i analizave, inspektimeve, informacioneve dhe thirrjeve në raport.
- Plani i lejeve të zakonshme.

E.3. Dokumente të veçanta.

- Plani i vlerësimeve operacionale për strukturat e deklaruara Pfp dhe në NATO.
- Plani i provave të kushtimit.
- Plani i inspektimeve.
- Plani i bashkëpunimit ndërministror, si dhe me strukturat e Pushtetit Lokal e Qendror.
- Plani i përballimit të emergjencave.

F. Dokumentet e institucioneve të veçanta

Në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë ngritur dhe funksionojnë struktura të veçanta të arsimimit dhe stërviçjes, të cilat kombinojnë në planëzimin e tyre planëzimin me theks ushtarak me atë civil. Atyre ju duhet të koordinojnë në planëzim dokumentacionin që buron nga Ministria e Mbrojtjes/Shtabi i Përgjithshëm dhe dokumentacionin që buron nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

F.1. Dokumente të komandës/strukturës eprore.

- Ligji për arsimimin e Lartë në RSH (në Universitetin Ushtarak “Skënderbej”).
- Direktiva e Ministrisë të Mbrojtjes.
- Plani afatgjatë/afatshkurtër i Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- Udhëzimet vjetore të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërviçjen.
- Plankalendari/matrica i/e veprimtarive kryesore të Forcave të Armatosura.
- Plani i mbështetjes buxhetore të strukturave të Forcave të Armatosura.

F.2. Dokumente të komandës/strukturës.

- Udhëzimet e Komandantit për operacionet, gatishmërinë, arsimimin dhe stërviçjen.

- Plani/matrica i/e veprimtarive kryesore për periudhën për të cilën bëhet planëzimi.
- Plani i kualifikimeve dhe punës shkencore në Drejtori.
- Plani i mbështetjes materiale të arsimimit, stërvitjes, operacioneve dhe gatishmërisë.
- Plani i mbështetjes materiale dhe me shtypshkrime.
- Plani i mbështetjes materiale sipas strukturave në vartësi.
- Plani i pjesëmarrjes në stërvitjet dhe veprimtaritë ndërkombëtare.
- Plani i veprimtarive sportive.
- Plani i botimeve.
- Plani i garave të qitjes me armët e këmbësisë.
- Plani i testeve të strukturave operacionale dhe të personelit të Forcave të Armatosura.
- Plani i arsimimit, kualifikimit dhe testimit të personelit.
- Plani i analizave, inspektimeve, informacioneve dhe thirrjeve në raport.
- Planet mësimore të fakulteteve dhe programet.
- Plani i aktiviteteve jashtë kurrikulave.
- Plani i lejeve të zakonshme për personelin e Universitetit Ushtarak “Skënderbej”.
- Planet mësimore të fakulteteve.
- Plan kalendari i mësimave të çdo pedagogu.
- Ngarkesa mësimore e fakultetit për çdo departament, seksion dhe pedagog.
- Lista e pedagogëve të jashtëm të Fakultetit, për çdo departament dhe seksion.
- Lista e pedagogëve të jashtëm të Universitetit Ushtarak “Skënderbej” për çdo fakultet dhe departament.
- Plani i lejeve të zakonshme.

F.3. Dokumente të veçanta.

- Plani i bashkëpunimit me institucionet arsimore e stërvitore të vendit.
- Plani i përballimit të emergjencave.

SHKURTESA

AV	Advisory Visit (Vizitë Këshilluese)
AFS	Aliance Force Standart (Standard i Forcës Aleancës)
AR	Annual Report (Raporti vjetor)
APV	Analiza Pas Veprimit
APU	Arsimim Profesional Ushtarak
Br.SB	Brigada e Stërviitjes
CC HQs	Shtabet e Komponentëve të Komandave
C2	Komandim Kontroll
C3I	Komandim, Kontroll, Komunikim dhe Zbulim.
C4I	Komandim, Kontroll, Komunikim, Kompjuter dhe Zbulim
DG	Detyrë Gazerme
DPU	Doktrina e Përbashkët Ushtarake
DS	Drejtues Stërviitje
DSI	Dokument I Stërviitjes Individuale
DTHM	Detyrë Thelbësore e Misioni
EAPËP	Programi i Punës së Partneritetit Euro-Atlantik
ETC	Evaluator Training Course (Kursi I trajnimit të vlerësuesit)
FA	Forca të Armatosura
FD	Forcat Detare
FAj	Forcat Ajrore
FB	Forcë e Bashkuar
FFR	Raporti final i “feedback”
FT	Forcat Tokësore
RFF	Raporti fillestar fushor

Doktrina e Stërviçjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

IP	Inspektim i Përgjithshem
JALLC	Qendra e Bashkuar e Analizës dhe Mësimeve të Nxjerra.
JFC HQ	Shtabi i Komandës së Bashkuar
J/G/S3	Ndihmës i Shefit të Shtabit për Operacionet dhe Planet
KA	Komponent Aktiv
KFB	Komandant i Forcës së Bashkuar
KSK	Kursi Stërviçjes Kuadrit
KR	Komponent Rezerv
KML	Komanda e Mbështetjes Logjistike
KFB	Komandanti i Forces së Bashkuar
KDS	Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes (TRADOC)
K	Kompani
LDTHM	Lista me Detyra Themelore të Misionit
LIVEX	Ushtrime stërviçore reale
LMC	Limitet Mission Capable (Aftësi e Kufizuar për Mision
LKM	Luftë Kundër Minave
MZ	Mbështetje me Zjarr
MADM	Mbrojtje nga Armët e Dëmtimit në Masë
MC	Mission Capable (Aftësi për mission)
MD	Dialogu I Mesdheut
ML	Mbështetje e Luftimit
MM	Ministri e Mbrojtjes
MLSH	Mbështetje e Luftimit me Sherbime
MKA	Mbrojtje Kundër Ajrore
MU	Manuali I Ushtarit
MKK	Mbrojtje Kundër Kimike
MTI	Detyrat Ushtarake për Interveprim
NC	Not Classify (Jo e klasifikuar)
NEL- 1	Niveli i Parë i Vlerësimit
NEL- 2	Niveli i Dytë i Vlerësimit
NMC	Not Mission Capable (Jo Aftësi për mission)
NRF	Forca Reaguese e NATO-s
NSC	NATO Strategic Command
NBC	Nuklear, Biologjik, Kimik

Doktrina e Stërviitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

N/O	Nënoficer
NTL	Lista e Detyrave të Nato-s
OCC	Koncepti i Aftësive Operacionale
O	Oficer
OK	Oficer i Kmisë
OMKA	Oficer i Mbrojtjes Kundërajrore
OMZ	Oficer i Mbrojtje me Zjarr
OPFOR	Forca Kundërshtare
OPLAN	Plan i Operacionit
OPORD	Urdhër i Operacionit
OXH	Oficer i Xhenjos
PCC	Partnership Coordination Cell
PfP	Partneriteti për Paqe
PG	Objektiv i partneritetit
PP	Përgatitje Profesionale
PMC	Partial Mission Capable (Pjesërisht Aftësi për Mission)
PS	Pa Stërvitur
PSM	Plan i Stërvitjes me Mision
PSO	Procedura Standarde të Operacioneve
PM	Program Mësimor
PQ	Procedura të Qëndrimit
QKS	Qëndër Kombëtare e Stërvitjes
QSFA	Qëndër Stërvitje e FA
R	Ka nevoj për Ristërvitje
RSK	Rajon Kombëtar Stërvitor
RST	Rregulla të Sigurimit Teknik
RPV	Rishikim pas Veprimit
S	I Stërvitur
SB	Stërvitje Bazë
SCU	Specialitet i Caktuar Ushtarak
SEL 1	Vetëvlersimi i Nivelit Parë
SEL 2	Vetëvlersimi i Nivelit Dytë
S1	Seksion I Personelit
S2	Seksion i Zbulimit
S3	Seksion i Operacioneve dhe Stërvitjes
S4	Seksion Logjistike

Doktrina e Stërvitjes dhe Arsimimit në Forca e Armatosura të RSH

S5	Seksion i Marrdhënieve Civile
S6	Seksion I Ndërlidhjes
SMC	Superior Mission Capable (Aftësi Superiore për mision)
SFU	Stërvitje Fillestare Ushtarake
SIA	Stërvitje Individuale e Avancuar (SIA)
SI	Stërvitje Individuale
SNJVQ	Stërvitje e Njësisë në Vendqëndrim
SHP	Shtab i Përgjithshëm
SHT	Shkollë Trupe
SHSHP	Shef I Shtabit të Përgjithshëm
SPU	Stërvitje e Përbashkët Ushtarake
SPF	Stërvitje e Përgatitjes Fizike
SS	Sistem Stërvitjeje
SVFL	Sistem Veprues I Fushës së Luftimit
TF	Task Forcë
TOP	Tabelë e Organizimit dhe Paisjeve
TPPF	Test I Përgjithshëm I Përgatitjes Fizike
TS	Test I Stërvitjes
USP	Ushtrim Stërvitor i Përbashkët
USK	Udhëzim Stërvitor i Komandantit
USF	Ushtrim Stërvitor
ËG TEP SO	Grupi i trajnimit/grupi i punës për trajnimin dhe edukimin për operacionet e mbështetjes së paqes.

FJALOR

Aftësi luftarake-Aftësia e një force për të ndërmarr e përmbushur misionin e vet në një teatër të veprimeve luftarake. Termi përfshin edhe aftësitë e forcave të armatosura në operacione joluftarake.

Analiza pas veprimit (APV): Një metodë për sigurimin e feedback duke përfshirë pjesmarrësit e stërviitjes në një proces diagnostikues për të rritur dhe përforcuar rezultate e stërviitjes. APV për drejtuesit rezulton në gjetjen e mangësive dhe të zgjidhjeve për përmirësimin e tyre.

Arsimin-Tërësia e njohurive dhe shprehive që jepen në një mënyrë sistematike e sipas një programi në shkolla e kurse të ndryshme.

Bashkpunim civilo-ushtarak-Burimet dhe masat që mbështetin marrëdhëniet ndërmjet komandantëve e autoriteteve kombëtare, civile e ushtarake, dhe popullatës civile në një rajon ku përdoren ose planizohet të përdoren forca ushtarake. Këto përfshijnë bashkpunimin me agjensitë, organizatat dhe autoritetet joqeveritare ose ndërkombëtare.

Betejë-Një sërë luftimesh taktike të lidhura, me kohëzgjatje më të madhe dhe që mund të ndikojë në zhvillimin e operacionit.

Burime stërvitore-Burime stërvitore të tilla si njerzore, fizike,financiare dhe kohore të përdorura për mbështetjen e stërviitjes. Atom und ti nënshtrohen kontrolleve të brendshëm dhe të jashtëme për shpërndarjen dhe përdorimin e tyre në bazë të kërkesave.

Cikli i menaxhimit të stërviitjes- Proces i ciklik i menaxhimit dhe realizimit të stërviitjes që përdoret në FA, për përcaktimin e kërkesave stërvitore dhe që përfshin planizimin, sigurimin e burimeve, kryerjen dhe vlersimin e stërviitjes.

Delegim i autoritetit- Veprim me të cilin një komandant I jep një komandantivartës një pjesë të kopetencave që lidhen me detyrën e caktuar. Megjithëse përgjegjësia përfundimtare nuk mund të shkarkohet, delegim I kopetencave mbart në vetvete imponimin e një mase të përgjegjësisë. Shkalla e kopetencave që delegohen duhet të përcaktohet qartë.

Detyrë- Aktivitet qartësisht I përcaktuar dhe I matshëm që duhet plotësura nga individët dhe organizmat. Detyrat janë aktivitete të vecanta që kontribuojnë në plotësimin e e të gjithë spektrit të misioneve dhe kërkesave të tjera.

Detyrë themelore e misionit- Një detyrë kolektive në të cilën një organizëm duhet të aftësohet për plotësimin e pjesës së tij në misionin e kohës së luftës.

Detyrë beteje- Nje detyrë qe duhet të plotësohet nga nënrepartet vartëse nëse organizimi më I lartë plotëson një detyrë themelore të misionit.

Dokumenti I stërviitjes(DS)- Formular I përdorur në rregjistrimin e stërviitjes së kryer dhe standardet e arritura nga ushtari.

Drejtimit- Drejtimi është influenza mbi njerzit duke dhënë qëllimin, drejtimin dhe motivimin ndërsa veprojnë për plotësimin e misionit dhe rritjen e organizimit.

Efektshmëri luftarake- Aftësia e një force për të përmbushur misionin e ngarkuar. Faktorët kryesorë që vlersohen për përcaktimin e efektshmërisë luftarake janë: personeli, municionet, gjendja e karburanteve, sistemet e armëve etj.

Elementet e fuqise ushtarake- Mjetet dhe procedurat që përdoren në plotësimin e misionit. Komandantët I përdorin këto elementë për drejtimin dhe kryerjen e operacioneve. Vecanërisht,

komandantët, I planizojnë për sinkronizimin e efekteve kryesore të fuqisë luftarake në vendin dhe kohën e caktuar për të mposhtur kundërshtarin apo dominuar situatën.

Evidencat- Listimi I individëve, grupeve apo elementëve që reflektojnë aftësitë, mjeshtëritë në detyrat kryesore, apo informacionin tjetër bashkëlidhur aftësive luftarake.

Forca luftimi- Forca që luftojnë me armikun nëpërmjet ndërthurjes së manovrës me zjarrin e drejtpërdrejtë, në dallim nga forcat që sigurojnë mbështetjen e tyre me zjarr jot ë drejtpërdrejt ose ndihmë operative (forcat e mbështetjes). Forcat e luftimit ndahen në: forca të blinduara (tanked dhe kembësori e mekanizuar ose e motorizuar), forca të këmbësorisë së zakonshme, forca të kryerjes së zbulimit (tokësor e ajror), si dhe helikopterët e sulmit dhe aviacioni ushtarak.

Forcë e Bashkuar- Forcë e përbërë nga elemente të dy a më shumë llojeve të forcave (shërbimeve), nën një komandë të vetme.

Forcë Operative- Grupim I përkohshëm njësisht e repartesh nën drejtimin e një komandanti, për kryerjen e një misioni a operacionitë posaçëm: organizim gjysëm I përhershëm I disa njësive a reparteve nën drejtimin e një komandanti, që krijohet për të kryer një detyrë të posaçme të vijueshme.

Forcë operative e bashkuar shumëkombëshe- Forcë ushtarake e përbërë nga elemente të dy a më shumë llojeve të forcave (shërbimeve) të dy a më shumë vendeve aleate, që krijohet për kryerjen e një misioni të vecantë ose për të vepruar në mënyrë të vijueshme nën një komandë.

Forcë shumëkombëshe- Forcë ushtarake e përbërë nga elemente të dy a më shumë vendeve aleate.

Formulimi I misionit- Paragraf ose frazë e shkurtër, që përshkruan detyrën dhe qëllimin dhe tregon qartë veprimin që duhet të ndërmerret dhe arsyen e atij veprimi. Zakonisht përmban se kush do të veprojë, çfarë do të bëjë, kur, ku dhe përse do të veprojë, por rrallë specifikon se si do të veprohet.

Fokusimi në betejë- Koncept I përdorur në caktimin e kërkesave stërvitore të kohës së paqes që rrjedhin prej misioneve të caktuara apo të pritshme të kohës së luftës.

Fuqia luftarake- Tërësia e mjeteve me forcë asgjësuese e shkatërruese, që mund të të përdorë një njësi a formacion ushtarak mbi kundërshtarin në një kohë të dhënë.

Gatishmëri- Koha brenda së cilës një njësi a formacion mund të bëhet gatinë vendodhjen e duhur për të përmbushur misionin e deyrën e ngarkuar. Një njësi a formacion konsiderohet në gatishmëri kur është plotësuar me njerëz, është pajisur me armatim e materiale, është stërvitur për detyrën dhe ka mbështetjen e nevojshme.

Grafik stërvitor- Dokument I përgatitur në nivel kompanie e lartë që specifikon kush, çfarë, kur dhe ku, do realizohet për stërvitjen në një njësi.

Informacion- Informacioni përfshin të gjitha njohuritë qëi nevojiten komandantit dhe forcës së tij, si: të dhënat e zbulimit për armikun, njohja e forcave të veta, të dhënat gjeografike etj. Në praktikën e zbulimit janë dhënë të papërpunuar të cdo lloji, që mund të përdoren gjatë përpunimit të informacionit të zbulimit.

Instruktur stërvitje- Nënoficer që ka mbaruar sukseshëm kurset e instruktimit në ANO dhe SHT të FASH, që është I kualifikuar të stërvitjes dhe kontrollojë ushtarët.

Integrimi I forcës- Procesi I cili përfshin doktrinat, pajimet dhe strukturat e reja Brenda një organizimi ndërsa njëherëshi mban nivelet më të larta të mundëshme të gadishmërisë luftarake.

Kerkesë stërvitore- Diferenca ndërmjet rezultatit të demonstruar dhe standardit në aftësi për misionet thelbësore apo detyrat e betejës.

Komandimi dhe kontrolli- Ushtrimi autoritetit dhe I I drejtimin nga një komandant I emëruar në detyrë, sipas rregullave, mbi forca të caktuara dhe të atashuara për përmbushjen e misionit. Ky system mbështet aftësitë e komandantit në marrjen e vendimeve, të delegojë autoritetin dhe të integrojë fuqinë luftarake, për më tepër ai I jep mundësinë komandantit të përmisojë planet për luftimet e ardhshme ndërkohë që është I fokusuar në operacion konkret. Shtabet punojnë sipas qëllimit të komandantit për drejtimin e njësive dhe kontrollojnë shpërndarjen e burimeve. Nëpërmjet C2 komandantët integrojnë të gjithë elementët e fuqisë luftarake drejt qëllimit të përbashkët, plotësimin të misionit.

Komandant I forcës së bashkuar- Një komandant I autorizuar për të ushtruar autoritet komandimi ose kontroll operativ mbi një forcë të bashkuar.

Komandim- Autoriteti që I jepet individit të forcave të armatosura për të drejtuar, bashkërenduar e kontrolluar forca ushtarake.

Komandim I plotë- Autoriteti ushtarak dhe përgjegjësia e një oficeri epror për tu dhënë urdhëra vartësve. Përfshin të gjitha aspektet e operacioneve ushtarake dhe të administratimit: ekziston vetëm Brenda shërbimeve kombëtare, pasi në një forcë shumëkombëshe komandani nuk ushtron komandim të plotë mbi forcat që I janë dhënë, por vetëm komandim operativ ose kontroll operativ.

Komandim operativ- Autoriteti që I jepet një komandanti për tu caktuar misionet a detyra komandantëve vartës, për të përhapur njësi a reparte, për të përhapur njësi a reparte, për të caktuar forca dhe për të përhapur njësi a reparte, për të caktuar forca dhe për të mbajtur a deleguar kontrollin operativ ose taktik, si të gjykohej e nevojshme. Ai, në vetvete, nuk përfshin përgjegjësinë për administrimin ose logjistikën. Termi mund të përdoret gjithashtu për të treguar forcat që I jepen një komandanti.

Komandim taktik- Autoriteti që I delegohet një komandanti për tu caktuar detyra forcave që janë nën komandën e tij për përmushjen e misionit të ngarkuar nga autoriteti më I lartë.

Koncept I operacioneve- Shpallja e qartë e lakonike e idesë së veprimit të zgjedhur nga një komandant për të përmbushur misionin e tij.

Kontroll- Ai autoritet që I jepet një komandanti mbi një pjesë të veprimtarive të organizmave vartës ose të organizmave të tjerë, normalisht jo nën komandën e tij, që përfshin përgjegjësinë për vënien në jetë të urdhrave a direktivave. I gjithë autoriteti ose një pjesë e tij mund të transferohet a të dekegohet.

Kuadër- Gjithë personeli ushtarak dhe civil që komandon, kontrollon, instruktin, stërvit dhe mbështet ushtarët e SB.

Kursi I stërvitjes së kuadrit- Kurs për kuadrot me qëllim ti familjarizojë ata me stërvitjen, organizimin, politikat e procedurat, drejtimin ,përparimin,menaxhimin e arritjeve dhe administrimin.

Kusht- Rrethanat dhe ambjenti në të cilat një detyrë apo mësim duhet plotësuar.

LDTHM FB- Nje listë e detyrave të konsideruara thelbësore për plotësimin e një misioni të caktuar apo të prishëm për forcën e bashkuar.

LDTHM- Detyra kolektive thelbësore të misionit të përpiluar nga një organizëm në mënyrë që ai të plotësojë misionet e kohës së luftës.

Luftë- Shfaqja më e skajshme e një konflikti të armatosur, që karakterizohet nga veprime luftarake intensive, të gjera e afatgjata, zakonisht ndërmjet shteteve.

Manovër- Përdorimi I forcave në fushën e betejës nëpërmjet lëvizjes së ndërthurur me zjarrin ose fuqinë e zjarrit, për të arritur një pozitë mbizotëruese ndaj armikut, me qëllim që të përmbushet misioni.

Mbështetje- Veprimi I një force a I një pjese të saj, që ndihmon , mbron, plotëson ose përkrah një forcë tjetër.

Mbështetje logjistike e luftimit- Mbështetja që u sigurohet forcave të luftimit dhe forcave të mbështetjes luftarake, kryesisht në fushat e administrimit dhe të logjistikës.

Mbështetja e luftimit- Mbështetja me zjarr dhe ndima operative që u sigurohet forcave të luftimit për përmbushjen e misionit të tyre.

Mbështetja shëndetësore- Të gjitha shërbimet që kryhen, sigurohen e përshtaten për të ndihmuar, përmirësuar,ruajtur e përtërirë mirqëniën fizike e mendore të personelit.

Mbledhja stërvitore- Mbledhja periodike e kryer me drejtuesit e togave, kompanive dhe batacioneve për të analizuar stërvitjen e shkuar, për të planizuar dhe përgatitur stërvitjen e ardhëshme si dhe shkëmbimin e përgatitur stërvitjen e ardhëshme si dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet pjesmarrëve.

Menaxhimi I rrezikut- Procesi I njohjes, vlerësimit dhe kontrollimit të rrezikut që rrjedh prej faktorëve operacional dhe marrja e vendimeve që balancojnë e rrezikut me të mirat e stërvitjes me mision.

Menaxhim I stërvitjes- Procesi I përdorur nga drejtuesit e FA në njohjen, analizimin,planizimin e vazhdueshëm, kryerjen dhe vlerësimin e stërvitjes.

Mësimi për gjatë gjithë jetës- Alternativë individuale për të përfituar në mënyrë aktive njohuritë në cdo fushë për rritjen e aftësive profesionale.

Mision- Formulim i qartë e lakonik i detyrës së komandantit dhe i qëllimit të saj. Është shprehja e asaj se çfarë dhe me çqëllim duhet të kryhet nga vartësi. Detyra parësore e caktuar për një individ, njësi apo forcë.

Ndihmë stërvitore- Term që përfshin rajonet dhe poligonet kombëtare, qendrat e simulimit, simulatorët, objektivat, municionet mësimorë, mjetet mësimore, Mjetet e ndryshme të mbështetjes stërvitore etj.

Njësi (repart)- Cdo element ushtarak, struktura e të cilit përcaktohet nga autoriteti kompetent, p.sh., nga një tabelë e organizimit dhe e pajisjes: vecanërisht është pjesë e një organizmi. 2. emërtim organizimi i një nënndarje të një grupi në një forcë operative. 3. Sasia standarte ose të një grupi në një forcë operative. 3. Sasia standarte ose bazë në të cilin ndahet, shpërndahet ose përdoret një artikull furnizimi. Në këtë kuptim, quhet edhe “njësi e shpërndarjes”.

Objektiv- Nje qëllim që duhet të arrihet: objekti fizik i një veprimi të ndërmarrë, p.sh., një objekt taktik i përcaktuar, kapja ose mbajtja e të cilit është me rëndësi vendimtare për planin e komandantit.

Objektiv stërvitor- Formulim që përshkruan rezultatin e dëshiruar për një aktivitet stërvitor.

Operacion- Veprim ushtarak ose kryerja e një misioni ushtarak strategjik, taktik, shërbimi, stërvitor a administrative: procesi i kryerjes së luftimit, duke përfshirë lëvizjen, furnizimin, sulmin, mbrojtjen dhe manovrat që nevojiten për të arritur objektivat e cdo beteje a fushate.

Operacione humanitare- Operacione që kryhen për të lehtësuar vuajtjet njerëzore. Operacionet humanitare mund të bëhen përpara ose sëbashku me veprimtaritë humanitare që realizohen nga organizatat civile të specilizuara.

Operacionet ushtarake joluftarake- Një gamë e gjerë veprimtarish ku përdoren mundësitë ushtarake për qëllime të tjera për operacioneve luftarake në shkallë të gjerë, që zakonisht shoqërojnë luftën.

Operacione në mbështetje të paqes- Operacione shumëfunktionale, që kryhen paanshmërit në mbështetje të një mandanti të Kombeve të Bashkuar ose OSBE-së, të cilat përfshijnë përdorimin e forcave ushtarake e të agjencive diplomatike e humanitare dhe janë të paracaktuara për të arritur një zgjidhje politike afatgjatë ose kushte të tjera të specifikuara në mandate. Përfshijnë: paqeruajtjen, imponimin e paqes, si dhe parandalimin e konfliktit, paqebërjen, ndërtimin e paqes dhe operacionet humanitare.

Plan operacioni- Plan për një a disa operacione të lidhura, që duhen të kryhen njëkohësisht ose njëri pas tjetrit. Zakonisht bazohet në supozime të caktuara dhe është një formë directive, që përdoret nga autoriteti më i lartë për tu lejuar komandantëve vartës të përgatitin planet dhe urdhrat mbështetës. Emërtimi “plan” zakonisht përdoret në vënd të termit “urdhër” gjtë përgatitjes së operacioneve kohë më parë. Një plan operacioni mund të zbatohet në një kohë të paracaktuar ose me dhënien e një sinjali dhe atëherë bëhet urdhër i operacionit.

Plani i stërvitjes me misionin- Dokument përshkrues stërvitor që i siguron njësisë një përshkrim të qartë se çfarë dhe kush do të stërvitet për të arritur aftësitë e nevojshme për misionin në fjalë.

Plani i stërvitjes dhe vlersimit- Dokument përmbledhës që përgatitet për cdo aktivitet stërvitjeje e që siguron informacion për objektivat e stërvitjes kolektive, stërvitjes individuale, burimeve të kërkuara dhe procedurave të vlerësimit.

Rajon i operacioneve- Ajo pjesë e një rajoni të luftës, që është e nevojshme për operacionet ushtarake dhe për adminstrimin e tyre.

Rendimenti i kërkuar- Shkalla e aftësive Brenda së cilës një njësi është në gjendje, me një stërvitje minimale, të realizojë detyrat kryesore të kohës së luftës.

Sistem i mbështetjes së stërvitjes- Sistemi i cili përfshin teknologjitë e informimit, ndihmën stërvitore, pajimet e pajisjes, simulatorët e mjete e simulimit, produktet mbështetësetë stërvitjes, shërbimet dhe lehtësirat e tjera të nevojshme për stërvitjen.

Sistemi i përgatitjes së nënoficerëve- Përgatit nënoficer të drejtojnë dhe të stërvisin ushtarët që të punojnë dhe luftojnë nën drjtimin e tyre dhe të ndihmojnë drejtuesit e tyre në realizimin e misioneve.

Sistemi I përgatitjes së oficerëve- Përgatit korpusin e oficerëve të jenë plotësisht të aftë teknikisht, taktikisht, me aftësi drejtuese, me njohuri dhe qëndrim dinjitoz, që janë në gjendje të ndjekin ecurinë e kohës, që demonstronë besim, integritet, gjykim të fortë, dhe përgjegjësi, që mund të veprojnë në një ambient kompleks dhe që ndryshon shpejt e që mund të ndërtojnë organizma efektiv, si dhe mund të përshtaten dhe zgjidhin problemet me krijimtari.

Shtab I Forcës së Bashkuar- Shtab operativ I komandantit të forcës së bashkuar, që vendoset praën ose brenda teatrit të veprimtarive luftarake.

Stërvitja në vendqëndrim- Stërvitje e kryer në një instalim, në një njësi, me të njëjtët kadro.

Stërvitja e fazuar- Ndarja e stërvitjes në periudha. Cdo periudhë ka objektivat e saj për ushtarët dhe njësinë.

Stërvitje ndreqëse- Stërvitje shtesë e dhënë ushtarëve ti mundësoj ata të arrijnë standartet e stërvitjes.

Standartizim- Në kuadrin e NATOS-s, është procesi I përpunimit të koncepteve, të doktrinave, të procedurave dhe projekteve për të arritur e ruajtur nivelin më të efektshëm të pajtueshmërisë, të ndërveprueshmërisë, të ndërkëmbimit dhe të përbashkësimit në fushat e operacioneve, të administrimit dhe të materialeve.

Stërvitje kritike- Stërvitje që relatton në luftimin mbijetues dhe në procesin e kthimit nga civil në ushtar.

Stërvitja individuale e avancuar (SIA) – Stërvitje e efektivave të FA pasi ata përfundojnë SB në kualifikimin e tyre të mëtejshëm në specialitetin e caktuar.

Stërvitja bazë (SB) – Stërvitja në subjekte ushtarake kryesore e mjeshtërive të përbashkëta të luftimit bazë për të gjithë të mobilizuarit e të rinj të komponentit aktiv e rezervistë të FA.

Stërvitje e drejtuesit- Stërvitje e drejtuesve është zgjerimi I aftësive për drejtimin e efektivave.

Stërvitje kritike- Stërvitje që relatton në luftimin mbijetues dhe në procesin e kthimit nga civil në ushtar.

Strategji stërvitore- Metoda e përdorur në mbajtjen e standardëve të aftësive stërvitore për LDTHM.

Stërvitje- Instruktimi I personelit për rritjen e aftësive të tyre në kryerjen e funksioneve specifike ushtarake të bashkuara detyrave individuale dhe kolektive.

Stërvitje shumëshkallëshe- Teknikë stërvitor në stërvitjen e më shumë se një hallke në detyra të ndara njëkohësisht.

Standard- Minimumi I pranueshëm I aftësive të kërkuara për plotësimin e një detyre të vecantë në kushte stërvitjeje të caktuara.

Strategjia stërvitore e FA – Politikat e përgjithëshme për stërvitjet e tashme dhe të ardhshme të FA. Ajo vendos e FA kërkesat për stërvitjen e njësisve, drejtuesve dhe ushtarëve si dhe përshkëuan se si do të stërviten FA për ruajtjen e standardeve stërvitorë. Ajo gjithashtu përcakton dhe burimet e kërkuara në realizimin e procesit stërvitor.

Synim I komandantit- Formulim I qartë dhe I përmbledhur I veprimit që duhet të kryjë forca për të pasur sukses në lidhje me armikun, terrenin dhe gjendjen përfundimtare të dëshiruar. Ai siguron lidhjen ndërmjet misionit dhe konceptit të operacioneve. Zakonisht synimi shprehet në katër ose pesë fjali dhe është I detyrueshëm të vihet në të gjithë urdhrat. Misioni dhe synimi I komandantit duhet të kuptohen dy hallka më poshtë.

Taktikë- Mjeshtëria e përdorimi të njësisve e reparteve në luftim: vendosja e renduar dhe manovra e njësisve e reparteve në raport me njëra-tjetrën dhe me armikun për të shfrytësuar mundësitë e tyre të plota.

Teknikat- Janë metoda që përdoren nga trupat dhe komandantët për të kryer misionet dhe funksionet e caktuara, sidomos metodat e përdorimit të personelit dhe të pajisjeve.

Testi I përgatitjes fizike I FA- Një test tre rastësh I caktuar në masë të komponentët bazë të fizikut dhe përparimin e mundësive të ushtarit në kryerjen e detyrave fizike.

Ushtrim me qitje luftarake I armëve të kombinuara- Ushtrim stërvitor intensive në të cilin njësitë pjesmarrëse lëvizin apo kryejnë manovër duke përdorur armatimin luftarak apo mbështetës me përdorimin e municioneve luftarak shoqëruar me integrimin funksioneve të mbështetjes me shërbime të tij.

Ushtrim stërvitor taktik pa trupa- Ushtrim stërvitor që kryhet në terren për misione specifike. Ai përdoret për të stërvitur drejtuesit vartës dhe shtabet në analizën e terrenit, vendosjen e njësisë dhe armëve si dhe për planizimin dhe kryerjen e misionit të njësisë.

Ushtrim stërvitor I kombinuar I armëve dhe shërbimeve- Stërvitje kolektive që kryhet bashkërisht nga njësitë e manovrës, të mbështetjes së luftimit dhe mbështetjes me shërbime.

Ushtrim komandimi në post- Një ushtrim stërvitor në të cilin forcat pjesmarrëse janë të simuluar dhe mund të kryhet në një garnizon apo me pjesmarrjen e dy shtabeve.

Udhëzim stërvitor I komandantit- Dokument I planizimit I stërvitjes